

# Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit

Justinian Topulli

Dorëzuar  
Universitetit European të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në shkencat sociale, me profil sociologji antropologji sociale, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Aleksandër Dhima

Përmbajtja e lëndës . . . . .

Hyrje.....

**Kapitulli Metodologjik**

Qëllimi i këtij studimi

Fusha e punimit të këtij studimi

Tipologjia teorike e punimit

Përkufizim i disa prej termave të përdoruar në këtë punim

Metodologjia dhe metodat e qasjes

Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Struktura e punimit

**Kapitulli I:** Besimi fetar si pjesë e natyrës njerëzore

1.1 Feja si element natyror universal i qenies njerëzore

1.2 Jeta njerëzore bazohet mbi besimin dhe sigurinë

1.3 Çfarë na mëson *Psikologjia konjitive*

1.4 Të lindur besimtarë

1.5 Shkenca nuk e rrezikon fenë

1.6 Përhapja e fesë në shoqërinë e sotme njerëzore

1.7 Rigjallërimi i fesë në botë

**Kapitulli II:** Teoritë e modernizimit mbi fenë

2.1 *Shekullarizimi* në Sociologjinë Klasike

2.2. Teoritë e *shekullarizimit*

*Shekullarizimi* në teoritë bashkëkohore

2.3 *Qasja e parë:* Procesi i modernizimit imponon rënien e fesë

Kritikat ndaj teorisë klasike të modernizimit dhe teoritë alternative

2.4 *Qasja e dytë:* Modernizimi shkakton gjallëri fetare, kështu që shekullarizimi është një proces vetëkufizues

2.5 *Qasja e tretë:* Modernizimi e transformon fetarinë

### **Kapitulli III: Komunizmi dhe feja në Shqipëri**

- 3.1 Komunizmi si “zëvendësues” ideologjik i fesë
- 3.2 Trajtimi i fesë nën regjimin komunist
- 3.3 Presioni ligjor ndaj komunitete fetare
- 3.4 Pasqyrimi dokumentar nga lufta kundra fesë
- 3.5 Zëvendësimi i festave dhe kremtimeve fetare me ato socialiste
- 3.6 Propaganda antifetare
- 3.7 Bilanci tragjik i luftës kundër fesë
- 3.8 Mbijetesa e fesë nën regjimin komunist

### **Kapitulli IV: Rigjallërimi fetar në Shqipëri pas rënies së komunizmit**

- 4.1 Qasje teorike: Shembja e komunizmit dhe rigjetja e fesë
- 4.2 Kriza e shtetit komunist dhe rigjetja e fesë
- 4.3 Rikthimi i shqiptarëve te feja
- 4.4 Kuadri ligjor i lirive fetare
- 4.5 Ngritja e infrastrukturës fetare

### **Kapitulli V: Dështimi i ideologjisë komuniste dhe rikthimi te besimet fetare**

- 5.1 Metodologjia
- 5.2 Identifikimi i problemit kërkimor
- 5.3 Hipoteza qendrore, nën-hipotezat, implikimet dhe indikatorët
- 5.4 Rezultatet e përpunimit të të dhënave empirike

### **Kapitulli VI: Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri**

- 6.1 Vështrim mbi përqindjet e përkatësive fetare në Shqipëri
- 6.2 Anketimet/ Sondazhet e përkatësisë fetare ndër vite
- 6.3 Analizë e përqindjeve të përkatësive fetare të censusit të 2011 në Shqipëri
- 6.4 Vështrim mbi fetarinë e sotme të shqiptarëve ndër vite

### **Kapitulli VII: Feja mes besimtarë praktikantë**

- 7.1 Besimtarët e sotëm praktikantë dhe feja
- 7.2 Rezultatet e anketimit

## **Kapitulli VIII:**

Përfundime dhe Rekomandime

Literatura

Shtojca

**Hyrje**

Feja e ka shoqëruar njeriun përgjatë gjithë ekzistencës së tij dhe vazhdon ta shoqërojë edhe në kohët moderne. Ajo ka qenë pjesë e të gjitha shoqërive njerëzore të njohura deri më sot. Një nga dëshmitë me domethënëse të pranisë së fesë në jetën e njeriut, e ndeshim pa dyshim tek zbulimet arkeologjike. “Telajot” e shumta “shkëmbore” të zbuluara në Francë, në shpellat e Shovesë (Chauvet), të cilat datojnë 37000-40000 vjet përpara erës sonë, dhe në ato të Laskosë (Lascaux), të cilat datojnë 10000-20000 vjet përpara erës sonë, krahas shkallës së arrirë artistike, shpalosin skena qoftë të jetës në bashkësi të njeriut, qoftë të jetës së tij fetare<sup>1</sup>. Më pas, feja jo vetëm ka luajtur një rol të rëndësishëm, por është edhe një nga elementët strukturorë të të gjitha qytetërimeve që në zanafillat e tyre të hershme, nga qytetërimet e periudhave mitike dhe arkaike, deri tek qytetërimet e periudhave të njohura si “historike”.

Në të gjitha qytetërimet, feja vështrohej si boshti i jetës shoqërore, një nga elementët kryesorë e thelbësorë që i dhanë trajtë dhe përmbajtje, një mënyrë dhe një model paradigmatic të jetuari dhe rregulla etike dhe norma morale jo vetëm për individin, por edhe për shoqërinë njerëzore<sup>2</sup>. Këtë funksion të themeltë të fesë e ndeshim qartazi edhe në kohët tona, tek fetë monoteiste; shprehimisht, tek Hebraizmi, Krishterimi dhe Islami.

E megjithatë, pavarësisht sa më sipër, që nga lindja dhe zhvillimi i iluminizmit, mendimtarë të ndryshëm perëndimorë kanë hedhur tezën se feja do të shuhet apo do të dobësohet gradualisht në botë, dhe kjo falë përhapjes së ideve shkencore, të cilat do të zëvendësojnë besimet fetare dhe besëtytnitë, me mënyrën racionale dhe laike të jetës moderne. Dhe siç shprehet edhe Giddens, studimet sociologjike mbi fenë janë ende nën ndikimin e fortë të ideve të Marksit, Durkheimit dhe Weberit, të cilët, edhe pse asnjëri prej tyre nuk ishte besimtar, por që të tre mendonin se feja në thelb është një iluzion dhe se rëndësia e saj në kohët moderne do të pakësohej bashkë me venitjen e këtij iluzioni.<sup>3</sup> Ndërkohë sot, të përballur me një realitet të ri, gati të paparashikueshëm nga këta mendimtarë klasikë, janë zhvilluar teori të reja, të cilat shpjegojnë vazhdimësinë e fesë dhe rigjallërimin e saj në kohët moderne.

Ajo çka intrigon jo pak në këtë rast, është fakti se në dekadat e fundit, duket se ky parashikim është venitur. Anëmbanë globit, feja mbetet një forcë me ndikim të madh, ajo vijon të ndikojë në mënyrën se si njerëzit e shohin vetveten, njëri-tjetrin, dhe botën rreth tyre. Madje qartazi flitet për një rigjallërim fetar në mjaft shoqëri dhe shtim të prezencës së saj në jetën publike<sup>4</sup>, sidomos në vendet në zhvillim, si në Lindjen e Mesme, në Amerikën Latine, në Lindjen e largët dhe madje edhe në ish-vendet e bllokut komunist, ku bënte pjesë dikur edhe vendi ynë. A mund të thuhet në fakt se parashikimi i këtyre mendimtarëve mund të ketë qenë më realist për një pjesë të botës, sidomos asaj të industrializuar perëndimore, apo edhe në mes saj ka përjashtime, siç është rasti i SHBA, ku feja vazhdon të ushtrojë një ndikim të fuqishëm në jetën sociale të këtij vendi? Por, çfarë mund të thuhet për rigjallërimin fetar në ish-vendet socialiste të Evropës Lindore? A ka realisht një rigjallërim të tillë? Studime të ndryshme janë kryer për disa prej këtyre vendeve, ku janë treguar rritje të dukshme në fetarinë e njerëzve në to.<sup>5</sup> Një studim i tillë i thelluar në këtë drejtim për rastin e Shqipërisë – në dijeninë tonë – nuk është bërë, edhe pse janë kryer anketime të ndryshme në këtë drejtim dhe janë bërë shkrime dhe analiza të pjesshme të këtij fenomeni

<sup>1</sup> Alain Testart, *Art et religion de Chauvet à Lascaux*, Gallimard, Paris 2016, f. 14-17.

<sup>2</sup> Mircea Eliade, *Myth and Reality*, Harper & Row, New York 1968, f. 28.

<sup>3</sup> Anthony Giddens, *Sociologjia, Botimet “Çabej”*, Tiranë 2004, f. 437.

<sup>4</sup> Gjergj Sinani, *Feja dhe edukimi*, Fondacioni “Friedrich Ebert”, 2017, f.4.

<sup>5</sup> P.sh. *Transformations of Religiosity, Religion and Religiosity in Eastern Europe 1989 – 2010*, Me editor Prof. Dr. Gert Pickel dhe Dr. Kornelia Sammet. Publikuar nga Springer; Andrew B. Kipnis, *The Flourishing of Religion in Post-Mao China and the Anthropological Category of Religion*, *The Australian Journal of Anthropology*, 2001; John Micklethwait dhe Arian Wooldridge, *God Is Back: How the Global Revival of Faith Is Changing the World*, botuar nga Penguin Press, 2009. etj.

social.<sup>1</sup> Kështu që, nisur nga ky realitet, si dhe nga pozicioni personal i klerikut, e pamë të udhës të merrnim në shqyrtim këtë fenomen shoqëror, duke u fokusuar te rigjallërimi fetar në Shqipëri, parë së pari si reagim kundërshtues ndaj armiqësisë së regjimit komunist ndaj fesë, në veçanti në vitet e para të shembjes së regjimit komunist.

Procesi i shekullarizimit të shtetit dhe shoqërisë shqiptare nuk nis me regjimin komunist, por formimi i shtetit shqiptar në 1912 dhe ndarja e tij nga perandoria osmane shënon ndoshta edhe fillimin zyrtar të shekullarizimit të këtij vendi (edhe pse në fakt ligjërimi kombëtar rilindas ishte shekullar dhe iluminist), i cili u pasua me masa konkrete në këtë drejtim, si heqja e ndarjes së sistemit të *mileteve*, që praktikohesh në periudhën e perandorisë osmane, heqja e gjykatave të sheriatit dhe vendosja e ligjeve pozitiviste, hapja e shkollave shtetërore të mësimit laik, oksidentalizimi gradual i kulturës vendase, nëpërmjet përhapjeve të ideve iluministe dhe prurjeve perëndimore etj. Gjatë gjithë kësaj periudhe, deri në ardhjen në pushtet të regjimit komunist pas përfundimit të luftës së dytë botërore, faktet historike dëshmojnë se shoqëria shqiptare ishte shekullarizuar në një masë të konsiderueshme dhe se feja, edhe pse vazhdonte të ruante ndikim të fuqishëm në mjaft zona, sidomos në ato rurale, kishte rënë ndjeshëm. Por, gjithsesi, periudha e cila realisht u mendua se e “varrosi” besimin fetar dhe fetarinë në këtë vend, ishte periudha e sundimit komunist ateist.

Sot, pas tre dekadash nga rënia e regjimit komunist dhe e ndryshimeve demokratike që përfshinë Shqipërinë, si në të gjithë bllokun lindor, duket qartë se feja nuk është zhdukur nga jeta e njerëzve. Janë rihapur objektet e kultit, janë ndërtuar të reja, festohen ngado festat fetare në mënyrë masive dhe publike, vizitohen në masë të madhe vendet që konsiderohen si të shenjta, janë hapur shkolla të karakterit fetar, që frekuentohen nga një numër i konsiderueshëm nxënësish, janë shfaqur në jetën publike simbole dhe veshje me motive fetare, çështjet fetare ose që burojnë prej saj bëhen shpesh objekt i diskutimit publik, politikanë të ndryshëm shfaqin hapur përkatësinë e tyre fetare, e ndonjëherë përdorin edhe tekste fetare në ligjërimin e tyre publik etj. Të gjitha këto shfaqje fetare në jetën publike shqiptare pas gjithë asaj historie shekullarizimi, të intrigon të ndërmarrësh një studim sesa është real ky rigjallërim fetar, çfarë përmasash ka ai, dhe cilat janë disa nga arsyet dhe shkaqet e tij?

Por, pavarësisht arsyeve të ndryshme që kanë karakterizuar rigjallërimin fetar në Shqipëri gjatë gjithë kësaj periudhe tridhjetë vjeçare, ky punim është përqendruar tek dështimi i komunizmit si faktor ideologjik, social dhe politik dhe pasojave të tij në shoqërinë shqiptare në drejtim të rigjallërimit fetar.

E thënë në pak fjalë në këtë studim nisemi nga premisa se feja apo besimi fetar, me të gjitha format dhe nuancat e saj, është pjesë e së natyrshmes njerëzore dhe si e tillë ajo jo vetëm që nuk mund të zhduket, pavarësisht transformimeve që pëson në kohë dhe ngjyimeve që merr, por projektet e qëllimshme për ta përjashtuar atë nga jeta sociale publike apo edhe ajo individuale e njerëzve, jo vetëm që nuk kanë sukses në planin afatgjatë, por mund të jenë shkak për rigjallërimin e saj dhe veç kësaj janë përpjekje që dëmtojnë natyrshmërinë njerëzore dhe çdo trashëgimi të dobishme që na vjen nga e kaluara jonë e largët.

Është e rëndësishme të vë në dukje këtu në këtë fillim se besimi fetar dhe fetaria edhe pse janë koncepte të lidhur pazgjidhshmërisht me njeri-tjetrin, shpesh ato ndahen dhe janë dy gjëra të ndryshme. Kështu besimi fetar është një element që e shoqëron qenien njerëzore në përgjithësi gjatë gjithë kohës së ekzistencës së tij, ndërsa fetaria, pra masa e fetarisë, që shfaqet përmes

---

<sup>1</sup> Shih p.sh. *Zoti në vendin e mercedeseve* nga Nathalie Clayer, në revistën “Përpjekja”, nr. 20, viti 2005.

përkushtimit fetar, është diçka që shtohet dhe pakësohet, ngrihet dhe bie, dhe kjo në varësi të rrethanave social-kulturore, përmes të cilave kalon shoqëria njerëzore.

## **Kapitulli Metodologjik**

### **Qëllimi i këtij studimi**

Shoqëria shqiptare ndodhet në një tranzicion historik të jetës së saj dhe në këtë periudhë ajo ka përfituar, por edhe ka humbur njëkohësisht shumë vlera; ka përfituar elementë të dobishëm që nuk i ka pasur më parë, por edhe ka humbur disa nga virtytet e saj të dikurshme, që e lidhnin me traditën e vjetër të saj, siç është vlera e solidaritetit dhe e lidhjeve të forta familjare, duke u bërë më egoiste dhe më individualiste.

Për shkak të një aspirote mbarëkombëtare, për t'u bërë pjesë integrale e perëndimit dhe Evropës në veçanti, herë me vetëdije e herë pavetëdije, shumë prej qëndrimeve politike të qeverive të këtij vendi, por edhe atyre sociale e kulturore të qarqeve akademike dhe intelektuale, lënë në harresë dhe anashkalojnë mjaft ndjeshmëri fetare të këtij populli, qofshin këto të trashëguara a të fituara në këto vite tranzicioni. Studimi, krahas objektivit kryesor të tij, që lidhet me tezën e këtij studimi, ka si qëllim edhe të zbulojë – për aq sa është e mundur – përmasën reale dhe objektive të kësaj fetarie, në mënyrë që qasja sociale, politike dhe ligjore ndaj rolit që mund të luajë besimi fetar në shoqërinë tonë të jetë sa më objektive, dhe në dobi të shoqërisë sonë.

Studimi ka si qëllim gjithashtu të tregojë se projektet ideologjike që prodhoi periudha kohëve moderne, të tilla si komunizmi, që tentojnë të zëvendësojnë fenë apo rolin e fesë në të gjitha ndikimet e saj individuale dhe sociale janë të destinuara të dështojnë, kohë pas kohe.

Studimi gjithashtu ka si qëllim të vërë në pah se pavarësisht ndryshimeve të thella që ka pësuar shoqëria shqiptare ndër vite dhe në veçanti në vitet e një regjimi antifetar, ajo vazhdon të identifikohet në shumicë me fetë tradicionale, qoftë kjo edhe vetëm në nivel përkatësie të trashëguar nga paraardhësit e tyre.

Ky studim ka si qëllim po ashtu të tregojë se populli shqiptar, përtej mitit të krijuar se është një popull afetar, është një popull si gjithë të tjerët në këtë drejtim dhe fetaria e tij natyrshëm ndikohet duke shfaqur ulje dhe ngritje, si pasojë e rrethanave historike, politike dhe sociale nëpër të cilat ai kalon, pa ja tjetërsuar thelbin e tij njerëzor të të besuarit fetar, në çfarëdo forme qoftë ajo.

Studimi gjithashtu ka si qëllim të nxjerrë në pas disa nga shkaqet dhe arsyet kryesore sociale që kanë ndikuar drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në uljen apo ngritjen e fetarisë tek njerëzit.

### **Fusha e punimit të këtij studimi**

“Në qoftë se duam të kuptohemi, së pari është e domosdoshme të përkufizojmë termat” – shprehej Voltaire në veprën e tij “Fjalor filozofik”<sup>1</sup>. Në rastin e punimit tonë, kjo kërkesë e shfaqet metodologjikisht në trajtën e një kushti të pakapërcyeshëm e të patjetërsueshëm. Në rastin e një teme si kjo e këtij punimi, gjendemi përpara një mozaiku semantik e konceptual të

---

<sup>1</sup> Voltaire, *Dictionnaire philosophique*, tome VII, 2ème édition, Baudouin Frères Éditeurs, Paris 1772, f. 101.

ndërlikuar, i lidhur në mënyrë të pashmangshme me jetëgjatësinë dhe me shkallën e lartë të përdorueshmërisë së termit-subjekt të këtij punimi; konkretisht, të termit “fe”.

Çdo epokë ka terminologjinë e vet, ka fjalorin, bagazhin e vet gjuhësor, shprehjet, konceptet, paradigmat etj., të cilat varen tërësisht nga, dhe janë fryt i zhvillimeve të mendësisë dhe frymës kulturore e botëkuptimore të vetë epokës dhe një nga elementët e dallimit të saj nga epokat e tjera<sup>1</sup>. Për shembull, termat “filozofi”, “demokraci”, “kozmos” etj., janë disa nga termat të periudhës klasike, siç janë termat “teologji” apo “dogmatikë” për periudhën e Mesjetës, apo termi “shkencë”, “industri”, “teknologji” etj. për periudhën e kohëve moderne e atyre pas-moderne. Nga ky këndvështrim, termi “fe” është mbarë-epokal, dhe kjo për shkak se e ndeshim në të gjitha epokat dhe në të gjitha periudhat, në ato historike dhe ato të cilësuar si “jo-historike”<sup>2</sup>. Kjo jetëgjatësi e termit lidhet ngushtë me shpeshhtësinë dhe me shkallën e dendur të përdorimit të tij. Shkalla e dendur e përdorimit na vendos përballë një dukurie të njohur gjuhësore, e cila lidhet me “jetën” e fjalës, ku, si të gjitha fjalët e leksikut, edhe termi “fe” i nënshtrohet po të njëjtës ligjësi të gjuhës. Më konkretisht, fjala është për dukurinë, që në teorinë e gjuhësisë njihet me emërtimin “riformatim semantik” i fjalëve, i veshjes së tyre me kuptime të reja.

Përdorimi i dendur i një fjale sjell “konsumimin” dhe “inflacionin” e saj semantik, duke e zbehur mjaft ndjeshëm funksionin e saj shprehës, arsye për të cilën fjala ose 1) do të dalë jashtë sferës së përdorimit, për shkak se nuk kumton më asgjë, duke ndëprerë spiralen e komunikimit mes folësve; ose 2) do t’i nënshtrohet procesit të riformatimit apo zgjerimit semantik, ku fjala përfiton një kuptim të ri dhe pëson një lloj risemantizimi, në varësi të fushës dhe të kontekstit në të cilët përdoret, çka i siguron asaj mbijetesën dhe përdorimin e mëtejshme. Rasti i dytë i brendashkruhet termit “fe”, i cili, nisur nga dukuria gjuhësore në fjalë, mbart në vetvete një kuptimësi e përkufizueshmëri kontekstuale, në varësi të kontekstit dhe të fushës së përdorimit. Në rastin konkret, përkufizimi që termi “fe” ka në fushën e teologjisë, për shembull, është i ndryshëm nga përkufizimi që ka në fushën e filozofisë, e sociologjisë, e psikologjisë, e antropologjisë kulturore etj. Për të parën “feja” është “zbulesë”, “ligj hyjnor”, “mënyrë jetese”, “marrëdhënie mes njeriut dhe Zotit, krijesës dhe Krijuesit”<sup>3</sup> etj., ndërsa për të dytët ajo është një “dukuri”, e cila jepet e specifikuar jo vetëm sipas fushës përkatëse, por edhe sipas prirjeve e ngjyresave vetjake të filozofit, sociologut, psikologut etj.

Një fakt i tillë nuk mund, dhe nuk duhet të anashkalohet kurrsesi, për shkak se mund të pohohet se ekzistojnë aq konceptime të termit “fe” sa ç’ekzistojnë edhe fushat e tij të përdorimit, ku asnjëra nuk mund të vështrohet sot si “fusha parësore”. Një fakt i tillë heq çdo mundësi për ta “ndrydhur” fenë në hullinë e një konceptimi të përcaktuar qartë dhe të pranueshëm nga të gjithë (qoftë edhe në mënyrë të përkohshme), pasi studiuesit që kanë mëtuar të japin një përkufizim të saj, kanë dhënë më tepër pamjen që ky term shfaq brenda fushës së tyre profesionale dhe, në mënyrë të veçantë, në dritën e bindjeve botëkuptimore, ideologjike, politike etj.

Duke mbajtur parasysh kuadrin e mësipërm, në këtë punim jemi përpjekur të lëvizim në disa fusha e disiplina, të tilla si historia, sociologjia, psikologjia, antropologjia kulturore, shkencat politike, etj., duke e vështruar qasjen ndërdisiplinore si më të pranueshme dhe më të

<sup>1</sup> Oswald Spengler, *The Decline of the Western Civilisation*, Princeton University Press, Princeton 2001, f. 39 dhe f. 167-168.

<sup>2</sup> Krh. René Guénon, *Kriiza e botës moderne*, përkth. shqip nga Shpëtim Doda, LogoKron, Tiranë 2009, f. 22.

<sup>3</sup> Ky është edhe përkufizimi tashmë paradigmantik i termit nga studiuesit e fetarisë së krahasuar. Çdo besim fetar ka tre elementë përbërës: 1) ekzistenca e Zotit, 2) Njeriu, dhe 3) Marrëdhënia mes tyre. Shih: Roger Eastman, *The Ways of Religion: An Introduction to the Major Traditions*, Oxford University Press, Oxford 1999, f. 6 e më tej. Sakaq, fjalët e Alasdair MacIntyre-it tingëllojnë mjaft domethënëse në këtë drejtim, teksa tek *Marxism and Christianity: An Interpretation* (Durckworth, London 1995, f. 86) shprehet: “Kur njeriu lutet, nuk flet rreth Zotit, por i flet drejtpërsëdrejti Zotit. Ai e percepton kështu vetveten në marrëdhënie dramatike me Zotin, jo në marrëdhënie hamendësuese.”



përshtatshme me objektin e studimit, për ta paraqitur kësaj sipas larmisë semantike e konceptuale që shfaq, pa u përpjekur të krijojmë një hibrid, por duke i vështuar dhe trajtuar ndarazi. Ky përvijim, i cili përbën edhe tipologjinë e këtij studimi, dikton edhe metodologjinë dhe metodat e qasjes ndaj objektit të studimit.

### Tipologjia teorike e punimit

Nisur nga gjithë sa u parashtrua më sipër, objekti i studimi i përgjigjet një tipologjie të përcaktuar dhe të kufizuar. Shprehimisht, lidhet me fetarinë si dukuri, dhe me një vend dhe një periudhë kohore të caktuar të shfaqjes së kësaj dukurie. Vështuar nga kjo qasje, termi “fetari” kalon përmes topologjisë brenda së cilës shtrëzohet trajtimi i objektit të këtij punimi. Vendi, ndërkaq, nuk duhet vështuar kurrësi si një përcaktim i ngurtë gjeografik; përkundrazi, përmbledh në vetvete, më së pari, një mendësi dhe përvojë historike, madje edhe një kulturë dhe një botëkuptim, duke mos lënë kurrësi jashtë trajtimin e atyre prurjeve dhe ideve të lëvruara edhe përtej shtrirjes gjeografike. Po e njëjta gjë vlen të thuhet edhe për shtrirjen kohore, e cila përfshin dy periudha, atë të vendosjes së regjimit komunist dhe pas tij. Krahas sa më sipër, ky punim mbështetet tek gërshetimi i dy pamësive teorike.

Së pari, tek pamësia teorike e antropologjisë kulturore, sipas të cilës njeriu nuk vjen në botë si një *tabula rasa*. Shprehja tashmë klasike e Aristotelit, sipas të cilës “çdo njeri, për nga vetë natyra që shfaq, mbart brenda vetes dëshirën për të njohur”<sup>1</sup>, tingëllon tejet domethënëse në këtë drejtim. Në këtë punim, besimi fetar vështrohet po ashtu si pjesë e natyrës njerëzore, ngjashëm siç është edhe dëshira e tij për të njohur. Një pamësi e tillë, sikurse vërehet lehtë, boshtohet rreth vështrimit të njeriut si qenie individuale.

Së dyti, tek një pamësi teorike sociologjike, e cila plotëson pamësinë e parë, për aq sa, krahas të qenit qenie individuale, njeriu është edhe qenie shoqërore. Cilësimi i njeriut si një qenie shoqërore i hap udhë pyetjes: të qenit “qenie shoqërore” a i brendashkruhet natyrës së njeriut, si në rastin e dëshirës për të njohur?

Jeta e njeriut është shoqërore në kuptimin që është thelbësisht komunitare. Nga njëra anë, nevojat njerëzore, përfitimet, kënaqësitë, puna dhe veprimtaria janë në thelb shoqërore dhe sistemi shoqëror nuk mund të mirëmbahet përveç se përmes ndarjes së punës, ndarjes së përfitimeve dhe përmbushjes së përbashkët të nevojave brenda një grupi të veçantë sistemesh e formash jetese. Nga ana tjetër, qeniet njerëzore udhëhiqen përgjithësisht nga ide, ideale, arsye, synime, e zakone, duke u dhënë atyre një ndjenjë uniteti dhe integrimi. E shprehur me fjalë të tjera, shoqëria mishëron një grup qeniesh njerëzore, të cilët bashkohen me njëri-tjetrin dhe integrohen në një *continuum* jetese të përbashkët duke përmbushur disa kushte, rregulla dhe kërkesa të caktuara, si dhe në dritën e një sërë bindjesh, idealesh, qëllimesh, arsyesh etj. Thënë

---

<sup>1</sup> Aristoteli, *Metaphysics* (eng. trans. C.D.C. Reeve), Hackett Publishing, London 2016, f. 2.

kjo, pyetja shtrohet: po njeriu, a është për nga natyra qenie shoqërore, siç është, po nga natyra që shfaq, qenie individuale? Apo e thënë pak më ndryshe: njeriu, a lind me instinktin e jetës në bashkësi, apo të jetuarit në bashkësi është diçka që i imponohet nga jashtë, në formë detyrimi? Nisur nga natyra që shfaq, a është i prirë të jetojë një jetë të ndarë, jo në bashkësi, dhe a është i prirë, po nga natyra që shfaq, të mos pranojë asnjë lloj detyrimi që i imponohet, pavarësisht se të tilla detyrime shfaqen thelbësore për vetë jetesën në bashkësi? A mos ka arritur vallë të mësojë nga përvojat e tij jetësore se askush nuk është në gjendje të jetojë një jetë të veçuar nga të tjerët dhe, për rrjedhojë, është i detyruar t'u dorëzohet kufizimeve të imponuara nga jeta në bashkësi? Apo, ndonëse të jetuarit në bashkësi nuk i brendashkruhet natyrës që shfaq, arsyeja që u bind të pranojë jetesën në bashkësi nuk ishte detyrimi, por arsyetimi se mënyra më e mirë për të zhvilluar e shijuar dhuntitë e tij të natyrshme dhe natyrore dhe për të siguruar tërë sa arrin të krijojë përmes tyre, është jetesa në bashkësi dhe, për rrjedhojë, zgjedhi të jetonte në shoqëri me qenie të tjera njerëzore? Këto pyetje nxjerrin në pah tre pamësitë e lëvruara nga lashtësia deri më sot në lidhje me çështjen në fjalë. Më konkretisht: pamësia sipas të cilës njeriu (1) është qenie shoqërore për nga natyra që shfaq; (2) është qenie shoqërore për shkak të një detyrimi, qoftë ky rrethanor apo jo; si dhe (3) është qenie shoqërore për shkak të zgjedhjes së tij të lirë. E para, e formuluar fillimisht nga Aristoteli tek *Politika*, paraqet pamësinë sunduese deri te periudha e Rilindjes evropiane; e dyta, e formuluar fillimisht nga Thomas Hobbes tek *Mbi qytetarin*, përbën pamësinë sunduese të periudhës moderne; ndërsa e treta përbën pamësinë sunduese të kohëve pasmoderne, nga shfaqja e Nietzsche-s e këndejsmi, deri në kohët tona.

Në këtë punim, tematika kryesore dhe çështjet apo çështjet shoqëruese janë trajtuar duke mbajtur parasysh dy pamësitë e fundit, për aq sa lidhen jo thjesht në kohë, por edhe në përmbajtje me zhvillimet e trajtuara.

### **Përkufizim i disa prej termave të përdoruar në këtë punim**

*Feja dhe besimet fetare:* Në këtë punim me termin fe (religjion) dhe besime fetare, kuptohet çdo bindje apo pikëpamje, të cilat konsiderohet rëndom si të tilla në gjuhën e përditshme nga njerëzit, kryesisht këto të lidhura me fetë e njohura tradicionale në Shqipëri, siç janë Krishterimi dhe Islami, por edhe traditat e tjera apo prurjet e reja në këtë drejtim.<sup>1</sup>

*Rigjallërim i fesë:* rikthim i vitalitetit, i jetës fetare (në këtë punim), pas përgjumjes, venitjes apo ndrydhjes së fesë, përmes bindjeve, besimeve dhe praktikave fetare, publike ose jo.

*Moderne:* ajo që është bashkëkohore, që i përket epokës tonë, është periudha kohore e cila vazhdon deri në ditët e sotme, në të cilën në botë kanë ndodhur ndryshime rrënjësore strukturore, sociale dhe ideore në jetën e njerëzve, që e dallojnë atë nga epokat e mëparshme.

---

<sup>1</sup> Siç është përmendur edhe më sipër, është e vështirë të japësh një përkufizim përmbljedhës dhe gjithëpërfshirës të asaj që kuptohet me fjalën fe, ndaj dhe jemi mjaftuar këtu me këtë sqarim.

*Moderniteti*: vetë epoka moderne.

*Modernizimi*: është tërësia komplekse e procesit dhe mekanizmave përmes të cilave ka ndryshuar bota moderne, siç është industrializimi, racionalizimi, urbanizimi etj.

*Shekullare*: laike, ajo që nuk i përket fesë, që ndryshon dhe dallon nga feja, që është tokësore dhe nuk përfshin pikëpamjen fetare mbi dijen, botën, jetën, shoqërinë etj.

*Shekullarizimi*: laicizim, procesi përmes të cilit shoqëritë tradicionale dhe individët kalojnë nga pikëpamja fetare tek ajo shekullare.

## Metodologjia dhe metodat e qasjes

Metodat dhe metodologjia kanë një rol të rëndësishëm në shkencë, pasi shpesh në pamundësi për të identifikuar të vërtetën mes dijeve shkencore, nuk mbetet veçse të kërkojmë rrugët më të mira që na afrojnë tek kjo e vërtetë. Në këtë drejtim mjaft studiues të shkencave sociale e theksojnë, siç pohon dhe A. D. Monroe se “Synimi i metodave dhe i teknikave të shkencës është të testoj pohimet empirike”.<sup>1</sup> Ndërkohë A. C. Isaak, e trajton më ndryshe marrëdhënien metodës me shkencën. Sipas tij, “Ka dy rrugë për t’iu qasur shkencës. Nga njëra anë, ajo mund të shihet si një korpus dijesh; dhe nga ana tjetër, si një metodë për t’i siguruar ato.” Ndërkohë ai pohon se “... dija shkencore arrihet vetëm duke ndjekur metodat shkencore.”<sup>2</sup>

Në punimin e tij *Kundër sociologjisë së dijes*, Karl Popper duke trajtuar problemin e zanafillës së dijes pohonte se:

Kanti braktisi idealin, që s’mbahet dot në këmbë, të shkencës, e cila është e lirë prej çdo lloj supozimi... Ai e bëri krejt të qartë që ne nuk nisemi nga hiçi dhe se mund t’i qasemi detyrës sonë të pajisur me një sistem supozimesh, të cilat i pranojmë pa i testuar me metodat empirike të shkencës. Një sistem i tillë mund të quhet ‘aparaturë kategorish’. Kanti besonte se mund të zbulohet ai aparat kategorish, i vërtetë dhe i pandryshueshëm, i cili përfaqëson, si të thuash, kornizën domosdoshmërisht të pandryshueshme të pajimit tonë intelektual, d.m.th. të ‘arsyes’ njerëzore.<sup>3</sup>

Me fjalë të tjera, kur ne na duhet të arsyetojmë për një çështje konkrete, e nisim këtë arsyetim jo nga analizimi i të dhënave që na jep përvoja, por nga një mori supozimesh postulative, të cilat i përdorim si bazë apo pikënisje të arsyetimit, pa i kontrolluar apo testuar ato më parë me metodat empirike të shkencës. Por Popper thotë se këto supozime, edhe pse janë të domosdoshme si fillim për të fituar përvojë shkencore, ato nuk janë të pandryshueshme dhe të papërgënjeshtroshme nga përvoja shkencore dhe nuk qëndrojnë mbi dhe përtej metodave të testimit shkencor. Si shembull ai jep rastin e Ajnshtajnit, i cili e zgjidhi mospërputhjen e teorisë fizike ekzistuese me të dhënat eksperimentale, pikërisht duke ndryshuar disa nga supozimeve të nënkuptuara si postulative për natyrën e hapësirës dhe kohës fizike, por që në fakt doli se ishin

1 Monroe, A.D., (2000), *Essential of Political Researches*, Westview Press, Illinois State University, p.2.

2 Isaak A.C., (1985), *Scope and Methods of Political Sciences*, The Dorsey Press, Homewood, Illinois, p.28.

3 Popper R.K., sipas D. Miller (2000), *POPPER Vepra të Zgjedhura*, Soros & Afërdita, f.358.

paragjykime,<sup>1</sup> duke krijuar kështu një teori të re fizike.<sup>2</sup> Popperi pohon se përparimi i shkencës hedh poshtë hap pas hapi këto paragjykime të fshehta që gjenden midis supozimeve fillestare.<sup>3</sup>

Nga citimi i mësipërm i Popperit, vihet re se ai e lidh tërësinë e supozimeve fillestare, me qasjen ndaj problemit për t'u zgjidhur si pikënisje të dijes tonë. Popper i është rikthyer problemit të pikënisjes së dijes apo shkencës. Në punimin e tij *Logjika e Shkencave Sociale*, Popper shkruan:

Në rast se mund të flitet në përgjithësi se shkenca apo njohja fillon diku, atëherë vlen pohimi sa më poshtë vijon: Njohja nuk fillon me perceptimet apo me vëzhgimet apo me mbledhjen e të dhënave ose të fakteve, përkundrazi ajo fillon me ekzistencën e problemeve. Nuk ekziston asnjë dije pa ekzistencën e problemeve – por nuk ekziston gjithashtu asnjë problem pa ekzistencën e dijes. Kjo do të thotë se njohja fillon me praninë e tensionit midis dijes dhe padijes. Nuk ekziston asnjë problem pa ekzistencën e dijes – pra nuk ekziston asnjë problem pa ekzistencën e padijes. Xhanëm çdo problem lind nëpërmjet zbulimit se diçka nuk është në rregull tek dija jonë e pandehur; ose e soditur logjikisht, problemi lind me zbulimin e një kundërtie të brendshme tek dija jonë e pandehur ose të një kundërtie midis dijes sonë të pandehur dhe fakteve; apo ndoshta e shprehur disi më saktë me zbulimin e një kundërtie me sa duket midis dijes tonë të pandehur dhe fakteve të pandehura.<sup>4</sup>

Edhe në punimin e tij *Për teorinë e shkencës*, Popper theksonte se “Shkencat e natyrës si dhe shkencat sociale nisen gjithmonë nga problemet; ato nisen nga diçka që ngjall habinë tonë siç thoshin filozofët grekë.”<sup>5</sup>

Pra, sipas qasjes së metodologjisë së racionalizmit kritik fillohet nga identifikimi i një problemi kërkimor dhe më pas testohet empirikisht zgjidhja që propozohet për këtë problem.

Popper po ashtu thotë:

Teza ime thotë se duhet kuptuar që pikënisja e çdo zhvillimi shkencor është një problem, apo një situatë problemore, domethënë shfaqja e një problemi në një situatë të caktuar të dijes sonë të përgjithshme. Kjo pikë është me rëndësi të madhe. Teoria e vjetër shkencore<sup>6</sup> lektonte – dhe ajo lektonte ende –, se pikënisja e shkencës është perceptimi ynë shqisor ose vëzhgimi shqisor. Kjo tingëllon fillimisht krejt e arsyeshme dhe bindëse, por është krejt e gabuar.<sup>7</sup>

Pak a shumë këtë ide jep edhe A. D. Monroe kur pohon se “Shkenca nis dhe përfundon me teoritë”.<sup>8</sup> Në këtë linjë ideje R. R. Alford pohon duke thënë: “Ju nisni një projekt kërkimor me një problem: një temë, një çështje, apo diçka që paraqet interes, e cila në fillim të procesit është në

---

<sup>1</sup> Siç është p.sh. rasti për ekzistencën e supozuar të *eterit*, si lëndë që mbushte hapësirën boshe në të cilën përhapej drita në trajtë valësh, duke pohuar kështu se ajo nuk ishte grimcë dhe nuk i nënshtrohej forcës së gravitetit, ndërkohë matjet gjatë një eklipsi diellor, pohan tezën e Ajnshtajnit se drita kishte natyrë grimcore dhe se eteri nuk ekzistonte. Apo mendimi se koha rrjedh njëtrajtësisht kudo në mënyrë të pandryshueshme. (Shih Filip Frank, *Jeta dhe vepra e Ajnshtajnit*.)

<sup>2</sup> Popper R.K., sipas D. Miller (2000), POPPER Vepra të Zgjedhura, Soros & Afërdita, f. 364-365.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Popper R.K., *Për Filozofinë dhe Shkencën*, Fan Noli, 2009, f.183-184.

<sup>5</sup> Ibid, f.90-91.

<sup>6</sup> Bëhet fjalë për qasjen pozitiviste, apo empiriciste që konsideron si dije pozitive vetëm ato që jepen nga përvoja shqisore.

<sup>7</sup> Ibid, f.94.

<sup>8</sup> Monroe, A.D., *Essential of Political Researches*, Westview Press, Illinois State University, 2000, p.17.

mënyrë të paevitueshme e përcaktuar në mënyrë jo precize për qëllimet e kërkimit.”<sup>1</sup>

Pra me fjalë të tjera ne e nisim studimin me një skemë teorike shpjeguese paraprake, të cilën kërkojmë ta testojmë empirikisht me të dhënat e vëzhgimit apo të eksperimentit. Nga ky testim empirik natyrisht nuk shpresohet se do të gjendet e vërteta finale, por se ky proces mund të konsiderohet si përafrimi më i mirë ndaj të vërtetës dhe me një forcë shpjeguese më të madhe se sa thëniet e tjera rivale. Kjo e justifikon përpjekjen për testimin empirik, si një mjet për të siguruar argumente për pranueshmërinë ose jo të tyre.

### Rreth anketimeve

Në rastin e këtij studimi supozimi lidhet me idenë se kriza identitare që shkaktoi dështimi i ideologjisë komuniste, si pasojë e zhgënjimit, i dha mundësi fesë të rimbushte boshllëkun ideologjik dhe identitar për një pjesë të madhe të njerëzve. Dhe pikërisht për të testuar këtë supozim menduam si metodë më të mirë atë të anketimit të drejtpërdrejtë të njerëzve, me një seri pyetjesh të cilat në thelb synojnë të marrin prej tyre opinionet dhe qëndrimet e tyre rreth temës në fjalë.

Duke qenë se çështja e cila kërkojmë të analizojmë lidhet me një perceptim dhe ndjeshmëri sa individuale aq edhe kolektive, dhe ka karakter të përgjithshëm, atëherë anketimi i një kampioni përfaqësues do të na mundësonte sadopak të bënim përgjithësime në këtë drejtim.

Numri i kampionit, nëse marrim të dy anketimet së bashku edhe pse të ndara në kohë, por me njerëz të ndryshëm, shkon në 1320 vetë, numër ky besojmë i pranueshëm për të marrë një opinion që mund të përgjithësohet më pas deri në një masë të pranueshme. Kjo për shkak se anketimi është bërë me njerëz të rastësishëm dhe të dhënat tregojnë se kemi përfshirje nga të dyja gjinitë, nga shtresa të ndryshme sociale dhe prejardhje të ndryshme krahinore, siç tregojnë edhe tabelat përkatëse në shtojcë. Duke qenë se çështja që studiohet lidhet më së shumti me ndjeshmërinë dhe perceptimin e drejtpërdrejtë të një brezi që i ka përjetuar të dyja periudhat kohore që prek ky studim, atëherë jemi munduar që pjesa më e madhe e të anketuarve të jenë në moshë madhore, por kjo natyrisht nuk i përjashton as të rinjtë të cilët edhe pse nuk e kanë përjetuar drejtpërdrejtë periudhën e komunizmit dhe atë që erdhi menjëherë më pas, presupozohet se edhe ata duke jetuar në një mjedis qoftë familjar qoftë shoqëror mjaft të afërt në kohë me këto dy periudha, kanë krijuar edhe ata opinionin dhe qëndrimin e tyre për çështjen që studiohet në këtë punim. Çështja që studiohet nuk mendojmë se ka ndjeshmëri të atillë, siç mund të jenë ato politike, apo edhe pyetja e drejtpërdrejtë për përkatësinë fetare, që t'i ketë shtyrë të anketuarit të japin përgjigje që do të vinin në dyshim sinqeritetin e tyre, aq sa të cenonin seriozisht rezultatit e anketimit. Gjithashtu duke qenë se Tirana, është qyteti ku përfaqësohen të gjitha shtresat sociale dhe kulturore dhe nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe bashkë me Durrësin, sipas INSTAT-it, janë të vetmet qytete që kanë shtim popullsie për shkak të migrimit të brendshëm, atëherë mendojmë se Tirana përbën një vend të përshtatshëm për testimin e tezës, përmes anketimit.

### Kufizimet e anketimit

Natyrisht edhe kjo metodë ka kufizimet e veta, pasi qëllon që të anketuarit të mos i kenë kuptuar pyetjet siç duhet dhe të kenë përzgjedhur gjithashtu përgjigjet me u menduar gjatë. Përveç kësaj periudha kohore më e përshtatshme dhe ideale për një anketim apo testim të tillë do të kishte qenë në vitet e para pas rënies së komunizmit, pasi do të jepte një përjetim më të drejtpërdrejtë

---

<sup>1</sup> Alford, R.R., *The Craft of Inquiry. Theories, Methods, Evidence*, Oxford University Press, 1998, p.25.

dhe të afërt në kohë me procesin e krizës identitare, në dallim me kohën e sotme ku ndjeshmëria apo kujtesa mund të mos jetë më e njëjtë.

## Qasjet e tjera

Sikundër vërehet qartazi nisur nga objekti dhe natyra që shfaq ky punim, i vështruar në tërësinë e tij, është rezultante e një qasjeje ndërdisiplinore, e cila implikon vetvetiu shfrytëzimin e një morie mjeteve dhe metodash analitike, perspektivash, rrafshesh, konceptesh, parimesh interpretative, elementësh dhe të dhënash historike dhe statistikore, duke ruajtur të pacenuara, brenda mundësive objektivitetin, në përpjekje për të dhënë një artikulum dhe një pamje sa më të qartë dhe sa më të plotë në lidhje me objektin e përfshirë në studim.

Përvetësimi në këtë punim i një paradigme kontekstualizuese (kohore dhe vendore) duhet parë edhe si pjesë e një kuadri dhe një qëndrimi të tillë ndaj vetë paradigmës dhe ndjeshmërisë historizuese të kohëve tona, duke qenë më se të vetëdijshëm se interesat, prirjet dhe nevojat e një konteksti të caktuar historik janë të ndryshme nga ato të një konteksti tjetër.

Pra, për t'iu përgjigjur sa më mirë një kuadri dhe qëllimi të këtillë, krahas metodës analitike përshkruese dhe analizës empirike, në këtë punim, një vend të veçantë zë edhe përvetësimi dhe shfrytëzimi i metodave dhe mjeteve të hermeneutikës, kryesisht këtu sipas frymës gjenealogjike dhe dekonstruksionaliste<sup>1</sup>, të cilat, së paku, ndryshojnë nga njëra-tjetra në rrafshin e drejtimit të lëvizjes; më konkretisht, e para nisur nga burimi i një dukurie, për të arritur tek tiparet dhe karakteristikat e saj, ndërsa e dyta nisur nga zberthimi i tipareve dhe karakteristikave të dukurisë, për të arritur tek burimi i saj. Përvetësimi i metodave dhe mjeteve të hermeneutikës shfaqen të rëndësishme, për faktin se ndihmojnë ta shohim dukurinë jo nën dritën e simptomave, por të shkaqeve, të cilat në të shumtën e rasteve janë mjaft komplekse dhe ndjekin shpeshherë një lidhje zinxhir me njëra-tjetrën. Kështu, për shembull, pjesa më e madhe jo vetëm e anës ideore dhe ideologjike, por edhe e veprimeve të regjimit komunist, përfshirë edhe ato që lidhen me fenë, nuk është se ishin shpikje *ex nihilo* e komunistëve, dhe as nuk u zbatuan në një terren të papërgatitur paraprakisht. Përkundrazi, në këtë drejtim, krahas prurjeve ideologjike të eksportuara nga jashtë, komunistët shfrytëzuan (apo edhe i keqpërdorën) jo pak edhe prurjet, idetë e ideologjitë ekzistuese të brendshme, shprehimisht, idetë iluministe të disa mendimtarëve të periudhës së Rilindjes kombëtare, të cilave iu bënë vazhdimisht jehonë. Parë nga kjo qasje, prurjet kryesore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e këtij punimi janë këndvështrimet që iluministët lëvruan në lidhje me njeriun, me shtetin dhe fenë, të cilat përbëjnë edhe një ndër boshtet kryesore të tërë sa ndërmorën komunistët fill sapo erdhën në pushtet. Në këtë drejtim, do të mjaftonte të silleshin në kujtesë idetë e njohura të iluminizmit, të gjendura që në fillesat e veta tek shkrimet e Voltaire-it, Rousseau-së dhe Montesquieu-s, të tilla si zhvendosja e ligjërimit në lidhje me njeriun nga rrafshi individual, në atë shoqëror (“qytetari”), i cili përbën edhe terrenin ideologjik për asgjësimin e lirive individuale në emër të drejtësisë shoqërore<sup>2</sup>, apo vendosja e shtetit në atë vend që i përkiste Zotit<sup>3</sup>, nga e cila vite më vonë Kant do të merrte shtysën për të dhënë përkufizimin e tij mbi iluminizmin, i kthyer tashmë në përkufizim klasik<sup>4</sup>, dhe Hegel-i shtysën për ta hyjnizuar, pavarësisht se këtë hyjnizim e kryen në mënyrë të tërthortë,

<sup>1</sup> Shih: Arben Haxhiymeri, *Shtyllat e hermeneutikës*, Etika dhe Metafizika, 2017, nr. 4.

<sup>2</sup> Rousseau, *Discours sur l'origine et les fondements de l'inégalité parmi les hommes*, GF Flammarion, Paris 2011, f. 86-88.

<sup>3</sup> Voltaire, *Du gouvernement et de la divinité d'Auguste*, *Œuvres complètes*, vëll. XXV, Paris 1879, f. 585.

<sup>4</sup> Në hyrje të esesë “Përgjigje ndaj pyetjes: Çfarë është iluminizmi?”, Kant-i e përkufizon iluminizmin si dalje e njeriut nga gjendja e “paafësisë për të përdorur arsyen pa udhëzimin e një tjetri”, ku me “tjetër” Kant-i ka parasysh një qenie jo-njerëzore, vetë Zotin.

duke e fshehur pas togfjalëshit “Shpirt objektiv” dhe një gjuhe teknike tejet të ndërlikuar dhe shpeshherë të errët<sup>1</sup>, në disa raste qëllimisht rrëshqitëse.<sup>2</sup>

## Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Sa i përket metodës analitike përshkruese dhe analizës empirike, fillimisht duhet të silltet në vëmendje se ky punim pikëniset nga, dhe mbështetet tek një hipotezë; shprehimisht se “Komunizmi ishte në thelb një ideologji gati fetare dhe kështu që zbrazësia ideologjike (zhgënjimi nga utopia komuniste) dhe kriza identitare që përjetuan shqiptarët pas rënies së kësaj quasi-feje, favorizuan në një masë të konsiderueshme rikthimin e njerëzve drejt besimeve fetare.”.

### Pyetjet kërkimore

Kjo hipotezë përbën edhe përgjigjen ndaj çështjes, apo pyetjes kërkimore të këtij punimi; shprehimisht:

“Si ose përse zbrazësia ideologjike dhe kriza identitare, që pasoi rënien e komunizmit në Shqipëri sollën rikthimin drejt besimeve fetare?”

Ndërsa si nënpyetje kërkimore të këtij studimi, në mënyrë logjike i pararendin pyetjet:

“A ka pasur rigjallërim të besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit?” dhe

“Cilat janë disa nga shkaqet dhe arsytet e rigjallërimit të besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit?” dhe

“Në çfarë niveli dhe përmasash paraqiten besimet fetare sot në vendin tonë?”

Duke u mbështetur në faktin se, epistemologjikisht, çdo përftesë duhet t’i nënshtrohet testimit racional dhe empirik, në këtë punim, në kuadër të testimit empirik të hipotezës, u përcaktuan indikatorët që do të nxirrnin të dhënat e nevojshme për testimin empirik të implikimeve-parashikimeve të nxjerra nga hipoteza. Për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për këtë testim, janë bërë dy anketime me diferencë kohore 5 vjeçare, ku si objekt testimi kanë pasur tezën e këtij punimi, pra dhe i përgjigjen pyetjes qendrore kërkimore.

Ndërkohë pyetjeve të tjera i jemi përgjigjur duke iu referuar të dhënave statistikore të përfutuara nga një mori anketimesh të bëra ndër vite në Shqipëri, të cilat pasqyrojnë përqindjet fetare pas viteve 90’ si dhe fetarinë e shqiptarëve gjatë këtyre viteve si dhe duke u bërë atyre një vështrim analitik. Gjithashtu i jemi referuar të dhënave historike si dhe një anketimi të kufizuar, jo gjithëpërfshirës, në radhët e një grupi besimtarësh praktikantë, për të parë më thellë çështjen e rigjallërimit fetar në një nivel më individual. Në përpunimin e të dhënave janë përdorur programet Exel dhe SPSS.

## Struktura e punimit

### Kapitulli I: Besimi fetar si pjesë e natyrës njerëzore

Studimi nis me shqyrtimin e fesë nga pikëpamja e psikologjisë konjitive, duke iu referuar kësaj dege të re të studimit të fesë si dhe disa prej studimeve më të fundit të saj, të cilat provojnë se elementet e burimit të fesë dhe fetarisë njerëzore janë individuale, të lindura dhe shfaqen që në jetën e hershme të njeriut, kur akoma fëmija nuk ka nisur të komunikojë dhe kuptojë idetë e shoqërisë mbi botën. Pra se feja, duke mos qenë një fenomen thjesht social, por edhe psikologjik

<sup>1</sup> Hegel, *Outlines of the Philosophy of Right*, Oxford University Press (eng. trans. T. M. Knox), Oxford 2008, f. 47, 86, 133, 160, 170 etj.

<sup>2</sup> I tillë është, për shembull, përdorimi i foljes “krijoj ligje” (shih: Hegel, *Po aty*, f. 99, 117, 147, 155, 163 etj.), në vend të “formuloj ligje” (shih: Hegel, *Po aty*, f. 5, 131, 243, 259 etj.) në ato raste kur Hegel përvijon paralele mes “Shtetit” dhe “Shpirtit objektiv”, “Idesë”, vetë “Zotit”.

njerëzor, është e pamundur të zhduket thjesht dhe vetëm përmes ndryshimeve shoqërore, të cilat mund ta transformojnë atë, apo edhe t'ia humbasin disa nga funksionet e saj sociale, por nuk mund ta zhdukin atë, ajo është përsëri aty për të shfaqur dhe rishfaqur sa herë këtë e favorizon ndryshimi i kushteve të mjedisit social, politik e kulturor etj. Nisur nga e njëjta perspektivë psikologjike në këtë kapitull trajtohet edhe problemi mes fesë dhe shkencës dhe sa e rrezikon kjo e fundit të parën. Më pas merrem me shqyrtimin e të dhënave që provojnë se feja është prezentë në të gjithë botën dhe se kjo e fundit është përfshirë nga një rigjallërim domethënës fetar në dekadat e fundit të saj, sidomos pas rënies së “perdes së hekurt”. Ky rigjallërim duket se është produkt si i kthimit të vëmendjes njerëzore karshi fesë, por edhe i rritjes së popullsisë me prirje më të forta fetare dhe tradicionale përmes lindshmërisë më të lartë, sidomos në vendet në zhvillim në dallim me vendet e zhvilluara përëndimore ku vihet re e kundërta.

#### Kapitulli II: Teoritë e modernizimit mbi fenë

Në këtë kapitull merren në shqyrtim disa nga qasjet dhe teoritë e ndryshme klasike si a ajo Komtit, Marksit, Weberit dhe Durkheimit dhe ato të reja, që flasin për procesin e shekullarizimit dhe efektet e tij, si dhe për teoritë që shpjegojnë fenomenin e rigjallërimit fetar, si ajo e tregut fetar dhe e sigurisë ekzistenciale.

#### Kapitulli III: Komunizmi dhe feja në Shqipëri

Ky kapitull merret me shqyrtimin e periudhës komuniste që kaloi vendi ynë, vendin që zuri ideologjia komuniste dhe luftën që u bë për shkatërrimin e fesë, deri në ekstremin e ndalimit të saj në 1967.

#### Kapitulli IV: Rigjallërimi fetar në Shqipëri pas rënies së komunizmit

Në këtë kapitull bëhet një shqyrtim teorik i shkaqeve të rikthimit të besimeve fetare të shqiptarëve, duke e lidhur këtë me një fenomen me përmasa më të gjera ndërkombëtare. Më pas bëhet një pasqyrim i përmbledhur i përmasave institucionale të rikthimit të besimeve fetare, duke iu referuar kryesisht të dhënave për Komunitetet kryesore fetare në vend, atij mysliman, bektashi, ortodoks, katolik dhe ungjillor.

#### Kapitulli V: Dështimi i ideologjisë komuniste dhe rikthimi i besimeve fetare

Në këtë kapitull merremi me tezën e këtij studimi doktoral, që lidhet me arsyen në nivel makro të rikthimit të besimeve fetare dhe rigjallërimit të tyre, si pasojë e dështimit të ideologjisë dhe praktikës komuniste, e cila shkaktoi një lloje krize të identitetit social dhe ku feja u bë një nga ata elementë që zëvendësoi në një masë të konsiderueshme këtë zbrazëti që shkaktoi kjo krizë. Këtu detajohet hipoteza kryesore në nënhipoteza ndihmëse dhe nxirren implikimet dhe indikatorët e ndryshëm, në bazë të cilave ndërtohet edhe pyetjet e anketimit të bërë. Më pas merren në shqyrtim dy anketime e kryera në kohë të ndryshme, të cilat përmes një procesi përpunimi analitik dhe korrelacioneve përkatëse të përpunuara në SPSS testojnë hipotezën e këtij studimi.

#### Kapitulli VI: Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri

Në këtë kapitull bëhet një vështrim i detajuar i përkatësisë fetare të sotme të shqiptarëve përmes anketimeve të ndryshme si dhe i censusit të 2011, ku analiza rreth tij merr një vend të veçantë shqyrtimi. Këtu merren në shqyrtim një mori anketimesh të bëra ndër vite, të cilat pasqyrojnë si përkatësinë fetare të deklaruar të banorëve të Shqipërisë, por edhe nivelin e tyre të besimit, përmes ndjesisë personale, besimit ose jo në Zot, ndjekjes së riteve fetare, frekuentimit të objekteve të kultit etj. Bëhen analiza sasimore dhe cilësore për të kuptuar dimensionet krahinore,



gjinore, kulturore, intelektuale etj., të marrëdhënieve të shqiptarët sot me besimin fetar. Ky është edhe kapitulli më i gjatë në këtë punim doktoral.

Kapitulli VII: Feja mes besimtarë praktikantë

Ky kapitull i kushtohet analizimit të një anketimi të kufizuar, brenda një grupi të besimtarëve të sotëm praktikantë, për të kuptuar më thellë shkaqet dhe arsyet individuale, përse njerëzit i janë kthyer besimeve fetare apo i kanë ruajtur ato.

## **Kapitulli I: Besimi fetar si pjesë e natyrës njerëzore**

1.1 Feja si element natyror universal i qenies njerëzore

1.2 Jeta njerëzore bazohet mbi besimin dhe sigurinë

1.3 Të lindur besimtarë

1.4 Shkenca nuk e rrezikon fenë

1.5 Përhapja e fesë në shoqërinë e sotme njerëzore

1.6 Rigjallërimi i fesë në botë

1.7 Çfarë na mëson *Psikologjia konjitive*

## **Besimi fetar si pjesë e natyrës njerëzore**

Në epokën moderne mes shumë pikëpamjeve për besimin fetar ekziston edhe ideja se feja është një produkt thjesht social, i cili përcillet brez pas brezi përmes indoktrinimit, që në moshë të re, dhe se evoluimi teknologjik dhe shoqëror do ta venisë apo edhe zhdukë atë. Nisur nga kjo pikëpamje, të cilin komunizmi ateist, që u instalua në Shqipëri e merrte për të vërtetë absolute, u ndërmor një proces i përshpejtuar dhe i ashpër, për çrrënjosjen e fesë nga jeta sociale dhe individuale e shqiptarëve. Në këtë kapitull do të paraqiten të dhëna se pse besimi fetar është pjesë e pandarë jo vetëm e shoqërisë njerëzore, por së pari e individit, i pavarur nga shoqëria.

Rrënjët e besimit fetar shfaqen tek çdo individ që në moshë të re, si një mënyrë njohje e botës, e vetes dhe e nevojës për t'i dhënë kuptim gjërave. Ndërsa mjedisi social vetëm se e orienton këtë besim drejt një tradite të caktuar fetare ose jo.<sup>1</sup> Besimi fetar pavarësisht formave të tij të thjeshta apo të ndërlikuara ka qenë dhe do të mbetet pjesë e jetës njerëzore, si asaj individuale edhe asaj shoqërore. Ndoshta krahasimi më i përshtatshëm për të, në këndvështrimin social, do të ishte me prezencën e përdorimit të teknologjisë në jetën njerëzore që në fillesat e saj dhe paradigmen antropologjike që thotë se, sa më i vjetër të jetë një element kulturor në jetën njerëzore aq më e vështirë është që ai të zhduket. Dhe besimi fetar, nisur nga zbulimet historike, është po aq i vjetër sa edhe përdorimi i teknologjisë, duke nisur ndoshta që nga epoka e gurit dhe përdorimit të tij si mjet pune. Kështu që projekti i komunizmit ateist, militant, që u zbatua në Shqipëri dhe jo vetëm, ishte i destinuar të dështonte një ditë.

### **1.1 Feja si element natyror universal i qenies njerëzore**

Besimi është një nga elementët thelbësor mbi të cilin është ngritur jeta sociale e njerëzimit. Mund të mos biem dakord për origjinën e besimit, nëse është i mbinatyreshëm ose jo, a është ai produkt i evolucionit njerëzor apo i vetë të mbinatyreshmës, por ndërkohë është fakt se besimi ka qenë dhe është kaq natyral për qeniet humane, dhe kjo që nga epokat më të hershme të njerëzimit, për të cilat ne mund të provojmë ekzistencën -me sigurinë më të madhe- të këtij elementi kulturor të historisë sonë njerëzore. Dhe vjetërsia e një elementi kulturor dhe universaliteti i tij, të cilit është e vështirë t'i përcaktohet data e fillimit, është një nga argumentet bazë që tregojnë për natyrshmërinë e tij. Dhe këtë fakt, mes të tjerash, e pohojnë edhe personalitete të shquara të dijes.

---

<sup>1</sup> Një koncept i tillë në thelb përkon edhe me një këndvështrim fetar tradicional, siç është ai islam, që e sheh besimin fetar si një gatishmëri të lindur njerëzore për të besuar, por që nën ndikimin e mjedisit social ai formësohet në trajtën e një kulture fetare të caktuar, qoftë kjo edhe politeiste.

Kështu biografrit dhe filozofit grek Plutarkut (v. 120 e.s) i atribuohet të ketë thënë: “Nëse udhëtojmë nëpër botë, është e mundur të gjejmë qytete pa mure, pa shkrim, pa mbretër, pa pasuri, pa monedha, pa shkolla dhe teatër; por një qytet pa tempull, apo që nuk praktikon adhurime, lutje dhe të ngjashme me to, askush kurrë nuk e ka parë.”<sup>1</sup>

Feja ose besimi në fuqinë e mbinatyrshme është një nga dukuritë kulturore më të vjetra të njerëzimit dhe siç pohon Talcott Parsons, në hyrjen e tij kushtuar veprës së Max Weber-it *Sociology of Religion*: “nuk njihet asnjë shoqëri njerëzore, pa diçka, të cilën studiuesit modern social do ta klasifikonin si fe... Feja është po aq universale sa edhe gjuha.”<sup>2</sup>

Të njëjtën gjë pohon edhe një nga antropologët më të rëndësishëm të shekullit XX, i njohur si themeluesi i antropologjisë sociale, Bronislaw Malinowski,<sup>3</sup> i cili thotë se: “Nuk ka popuj, sado primitiv, që të mos kenë pasur fe e magji.”<sup>4</sup>

Sociologu gjerman Hans Freyer, gjithashtu pohonte se: “Faktorin fe do ta hasim gjithnjë, pavarësisht sesa thellë zbresim në histori, madje edhe në periudhat parahistorike. Individit, që nga kulturat më primitive, ka jetuar brenda grupeve shoqërore, ka jetuar i lidhur pas një feje të caktuar.”<sup>5</sup>

Apo siç pohon edhe Anthony Giddens: “Feja e ka shoqëruar njeriun gjatë gjithë ekzistencës së tij dhe vazhdon ta shoqërojë atë edhe në kohët moderne. Ajo ka qenë pjesë e të gjitha shoqërive njerëzore që njihen deri më sot.”<sup>6</sup>

Këto pohime, edhe të tjera, janë konfirmime të drejtpërdrejta, të asaj përvoje të gjatë njerëzore dhe fakteve të panumërta që e vendosin fenë në gjenezë të racës njerëzore e për rrjedhim edhe si pjesë e natyrshme e saj. Duke qenë e tillë, e natyrshme për njeriun, besimi fetar është i paçmontueshëm nga natyra e tij dhe bashkëshoqërues i përjetshëm i qenies njerëzore. Sepse sa më i lashtë të jetë një element i kulturës njerëzore, aq më e vështirë është të zhduket ai nga jeta e tyre. Kështu që feja mund të transformohet, mund të marrë forma dhe shfaqje nga më të ndryshmet, por kurrë nuk mund të zhduket.

## 1.2 Jeta njerëzore bazohet mbi besimin dhe sigurinë

Një nga veçoritë më thelbësore që e dallon njeriun nga gjallesat e tjera është fakti se qenia njerëzore e mbështet jetën në bashkësi, jo vetëm mbi përvojën e përkohshme të individëve dhe bashkësisë ekzistente, por edhe mbi përvojën e saj historike të akumuluar ndër vite e shekuj. Njerëzit pra kanë memorie historike, një akumulim përvoje mijëra vjeçar, të cilën ata e përdorin në interes të tyre, çka kafshët p.sh. çuditërisht nuk e kanë, edhe pse biologjikisht ata janë shumë të ngjashëm me njerëzit. Kjo është dhe arsyeja pse mënyra e të jetuarit të kafshëve nuk ndryshon kurrë, të paktën as që krahasohet me ato ndryshime që ka pësuar jeta njerëzore që nga fillimet e saj e deri më sot.

<sup>1</sup> C.N. Douglas, comp. Forty Thousand Quotations: Prose and Poetical. 1917. Plutarch

<sup>2</sup> Weber, Max, The Sociology of Religion. Introd. by Talcott Parsons, Beacon Press, 1963, f. xxvii, xxviii.

<sup>3</sup> <https://www.britannica.com/biography/Bronislaw-Malinowski>

<sup>4</sup> Njeriu Primitiv dhe Feja e Tij. Shqip, Botimet Zenit, f. 8.

<sup>5</sup> Freyer, Hans, Sociologjia e fesë, Shtëpia Botuese Logos A: Shkup 2016, f.57.

<sup>6</sup> Giddens, Anthony, Sociologjia, Botimet “Çabej” & Fondacioni Soros, Tiranë, 2004, f.

Njerëzit procesin e akumulimit dhe përcjelljes së memories historike e mbështesin te besimi, besimi se kjo trashëgimi u jep atyre siguri se ajo çka ka funksionuar për ata që qenë para tyre do të funksionojë edhe për ta, ky besim nuk tronditet edhe as shuhet, për atë kohë sa trashëgimia u tregon brezave se gjërat vazhdojnë të funksionojnë duke u mbështetur tek tradita, pra tek memoria historike e brezave. E gjitha kjo krijon sigurinë e nevojshme, themelin mbi të cilin njerëzit ndërtojnë jetën e tyre normale. Njerëzit ndryshe nga kafshët, përgjithësisht, nuk përballen me të njëjtën intensitet sfide ekzistenciale për mbijetesë, dhe ndryshe nga kafshët, të cilët duhet të mbështeten kryesisht në instinktet personale të mbijetesës, ata e mbështesin jetën e tyre mbi siguri, të cilat janë produkte të fituara nga të mirat e memories historike. Këto siguri themeltare për jetën e njeriut janë institucionet sociale dhe mënyra sesi ato funksionojnë. Çdo tronditje e këtyre institucioneve apo keqfunksionimi i tyre do të sjellë tronditje edhe në jetën e njerëzve. Duke qenë se siguria është elementi më i rëndësishëm i jetës së përditshme të njeriut në këtë botë, burimit të saj ai do t'i kushtoj besimin dhe besnikërinë e tij. Fetë, besimet dhe ideologjitë e ndryshme janë pjesë e atyre elementëve të kulturës njerëzore, të cilët i japin njeriut besimin e nevojshëm për të jetuar në këtë botë, sidomos ato administrojnë frikën e tij nga ardhmja dhe e panjohura, përveç faktit se i përgjigjen nevojës për kuptim të botës.

### 1.3 Çfarë na mëson Psikologjia konjitive

Fjala “konjitiv” vjen nga latinishtja që do të thotë “të njohësh”. Psikologjia konjitive është ajo degë e psikologjisë që studion sjelljen e njohjes ose mendimit.<sup>1</sup> Ajo është një qasje e psikologjisë, që fokusohet në marrëdhëniet në mes proceseve njohëse ose mendore dhe sjelljes.<sup>2</sup> Proceset njohëse (të cilat mund të përfshijnë gjuhën, simbolet ose imazhet) përfshijnë perceptimin, njohjen, kujtesën, imagjinatën, konceptimin, gjykimin, arsyetimin dhe përpunimin e informacionit për planifikimin, zgjidhjen e problemeve dhe për përdorime të tjera.<sup>3</sup> Qëllimi kryesor i psikologjisë konjitive (njohëse) është të sigurojë kuptimin e aktivitetit mendor nëpërmjet përdorimit të metodës shkencore. Sepse është aktiviteti mendor ai që ndërmjetëson mes stimujve që i paraqiten një personi dhe përgjigjeve të tij, dhe për këtë arsye ky aktivitet nuk është drejtpërdrejtë i dukshëm.<sup>4</sup>

Duke iu referuar kësaj disipline, studiues të ndryshëm kanë nxjerrë në pah karakterin natyror të besimit fetar, duke marrë për bazë hulumtimet e ndryshme që janë bërë me individë të ndryshëm, në veçanti me fëmijët e vegjël.

Kështu profesori i psikologjisë në Universitetin e Yale-it, Paul Bloom, në artikullin e tij “Religion is natural” pohon se “dy aspektet themelore të besimit fetar -besimi në dualizmin mendje-trup dhe besimi te agjentët hyjnorë- vijnë natyrshëm te fëmijët e vegjël.”<sup>5</sup> Ashtu si Parsons, ai thotë se feja është universale siç është edhe gjuha dhe të gjitha shoqëritë kanë më së paku një fe, ashtu siç kanë më së paku një gjuhë. Të përbashkëtat mes gjuhës dhe fesë, që ai vë në dukje, janë disa, si

<sup>1</sup> Kazdin, Alan E, Editor-in-Chief, Encyclopedia of Psychology, f. 131.

<sup>2</sup> Strickland, Bonnie B, The Gale encyclopedia of psychology, 2nd ed, Gale Group, 2001. f. 133

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Kazdin, Alan E, Editor-in-Chief, Encyclopedia of Psychology, f. 153.

<sup>5</sup> Bloom, Paul. (2007) “Religion is natural”, Developmental Science, Vol. 10, f. 147–151.

p.sh. gjuha nuk është prezentë që nga momenti i lindjes, por zhvillohet përmes përfshirjes në një mjedis shoqëror, ashtu edhe feja që njeriu merr përcaktohet nga ky mjedis.<sup>1</sup>

Aftësia e njeriut për të folur është e lindur, ajo është e lidhur me dhuntinë tonë gjenetike,<sup>2</sup> por padyshim është mjedisi ai që ja zhvillon më tej këtë aftësi ose jo, po kështu supozohet se ndodh edhe me besimin.<sup>3</sup>

Bloom thotë se edhe pse krahasimi mes gjuhës dhe fesë nuk qëndron në çdo detaj, por është fakt se ngjashmëria universale mes tyre është e evidente. Ai na jep një shembull duke thënë:

Gjuhëtarët dhe psikolinguistët kanë vëzhguar një proces të njohur si 'creolization',<sup>4</sup> në rastet kur fëmijët, që nuk janë të ekspozuar ndaj një gjuhe plotësisht të zhvilluar, e zhvillojnë një të tillë, duke shtuar vetë parime dhe struktura abstrakte. Disa nga demonstrimet më dramatike të kësaj ndeshen në rastet kur fëmijët e shurdhër, që nuk janë të ekspozuar ndaj gjuhës së shenjave do ta krijojnë vetë një të tillë, duke përdorur kapacitetet e lindura për të shkuar përtej të dhënave që posedojnë... Ashtu si studimi i *creolization*-it në gjuhë na ka dhënë njohuri se cilat aspekte të gjuhës janë të varura nga kultura dhe cilat janë të pamësura dhe universale, ashtu edhe studimi i *creolization*-it fetar mund të na jap njohuri të ngjashme.<sup>5</sup>

Nga ky krahasim Bloom kërkon të thotë se: ashtu si njerëzit për nevoja komunikimi -edhe kur nuk janë mësuar nga mjedisi që i rrethon- janë të aftë të sajojnë natyrshëm një gjuhë që nuk ekziston, po ashtu ata janë të prirë natyrshëm drejt një besimi fetar, edhe pa pasur më parë njohuri për të.

Dy argumentet e sugjeruar nga Bloom janë: 1) ndjesia dualiste për shpirtin njerëzor, atë të vdekshëm dhe atë të pavdekshëm që fëmijët perceptojnë dhe 2) qëllimsia me të cilën ata e perceptojnë botën.

Për argumentin e parë ai thotë:

1. Ndjesia dualiste... Fëmijët në mënyrë të natyrshme i japin kuptim dallimit në terma, mes entiteteve fizike dhe atyre psikologjike, pra mes fizikës naive dhe psikologjisë naive... Është ideja se ne mendojmë për trupin dhe shpirtin si të ndarë... Sipas një varianti

---

<sup>1</sup> Ibid.

<sup>2</sup> <https://www.livescience.com/7973-human-speech-gene.html>

<sup>3</sup> Studime të ndryshme hedhin hipotezën e ekzistencës së gjeneve që kontribuojnë në spiritualitetin e njeriut, si p.sh. *The God Gene: How Faith is Hardwired Into Our Genes*, nga Dean Hamer, 2004. Por a mund të shpjegohet besimi vetëm përmes reaksionit kimik të gjeneve? Donald Davidson në *Essays on Actions and Events* (2001) del në përfundimin se "Ngjarjet mendore si kategori nuk mund të shpjegohen nga shkencat fizike... Ne i shpjegojmë veprimet e lira të një njeriu, p.sh. me anë të shprehjes së dëshirave të tij, zakoneve, njohurive dhe perceptimeve të tij. Këto vlerësime të sjelljes së qëllimshme veprojnë në një kuadër konceptual larg nga mundësitë e drejtpërdrejta të ligjit fizik duke përshkruar edhe shkaku edhe pasojën, arsyen dhe veprimin si aspekte të portretit të agentit njerëzor. Kështu pra, *anomalizmi* mendor është kusht i nevojshëm për t'i parë veprimet si të pavarura." (kapitulli 20 f. 147)

<sup>4</sup> *Creole* rrjedh nga portugalishtja, dhe ka për qëllim të tregojë një pasardhës të një evropiani, të lindur dhe rritur, në një territor kolonial. Ndërsa në psikologji ka për qëllim: procesin kur një gjuhë e sajuar nga një komunitet heterogjen me gjuhë të ndryshme, për arsye komunikimi, kthehet në gjuhën e parë të fëmijëve të porsalindur. Si p.sh. disa forma të anglishtes, të përziera me gjuhët vendase të ish kolonive britanike. Shih Andrew M. Colman, 2015, *Oxford dictionary of Psychology*. f. 177.

<sup>5</sup> *Developmental Science* (2007), f. 147–151.

shpjegimi, dualizmi ynë është një nënprodukt i natyrshëm i faktit se kemi dy sisteme të veçantë njohëse, një për trajtimin e objekteve materiale, tjetrin për subjektet shoqërore. Këto sisteme kanë rezultate jo të krahasueshme... Ideja e dualizmit ka rrjedhoja interesante, sepse nëse pranohet që trupi dhe shpirti janë të ndarë, atëherë mund të kesh njërin pa pasur tjetrin. Më konkretisht për besimin fetar dualizmi i jep mundësi shpirtit të imagjinohet pa trupin. Dualizmi jonë po kështu hap mundësinë se njerëzit, shpirtrat e tyre, i mbijetojnë vdekjes së trupit. Besimi se shpirti është çliruar nga trupi njerëzor pas vdekjes, është një element i përhapur ndërkulturore.<sup>1</sup>

Bloom pohon gjithashtu se dualizmi është krejt i natyrshëm për fëmijët:

Shembulli më dramatik i dualizmit të fëmijërisë lidhet me zhvillimin e besimeve për jetën e përtejme. Bering dhe Bjorklund u treguan fëmijëve të moshave të ndryshme histori rreth vdekjes së një miu dhe i pyetën ata për vazhdimësinë e disa elementëve të veçantë. Kur ata u pyetën rreth elementëve biologjik të miut, fëmijët morën në konsideratë pasojat e vdekjes, duke përmendur se truri nuk punonte më tashmë. Por, kur ata u pyetën për elementët psikologjik, shumica e fëmijëve thanë se ato do të vazhdonin, se miu i vdekur mund ketë mendime dhe dëshira. Trupi nuk ishte më, por shpirti mbijetonte. Dhe fëmijët e besojnë këtë gjë më shumë sesa të rriturit, çka sugjeron se kur ne na duhet të mësojmë për një lloj jete specifike të përtejme, të cilën e besojnë njerëzit e kulturës tonë (si parajsja, rimëshirimi, shpirti i botës, etj.), nocioni se ndërgjegjja është e ndarë nga trupi nuk është aspak diçka e mësuar; ajo vjen vetvetiu.<sup>2</sup>

Pas kësaj Bloom edhe pse vë në dukje se në lëndën e psikologjisë dualizmi konsiderohet si diçka e gabuar dhe se jeta mendore, sipas shkencëtarëve, është produkt i trurit fizik, megjithatë ai thotë se ka pak konsensus sesi e gjitha kjo funksionon.<sup>3</sup>

Për argumentin e dytë, ku ngjarjet dhe dizajni i atribuohen të përtejshmes, ai thotë:

2. Shembulli klasik në këtë rast është ai i Heider dhe Simmel (1944), të cilët sajuan një film të thjeshtë në të cilin figurat gjeometrike -rrethi, katrori, trekëndëshi- lëviznin në mënyrë të caktuar sistematike, të dizajnuar, duke u mbështetur në intuitën e psikologëve, për të rrëfyer një tregim. Kur ky film u pa, njerëzit instinktivisht i përshkruan figurat si të ishin njerëz konkretë (tiranë, viktima, heronj) të cilët kishin synime dhe dëshira, dhe ata përsëritën pothuajse të njëjtën histori që psikologët kishin synuar të tregonin. Studimi i mëtejshëm konstatoi se ju nuk keni nevojë as për figura të konfiguruar – ju mund të merrni pothuajse të njëjtën efekt duke vënë në lëvizje pika, po njëllon si në filmin ku “karakteret” nuk janë fare objekte, por grupe në lëvizje, siç janë tufat e katrorëve të vegjël... Ne jemi tepër të ndjeshëm ndaj shenjave të aktivitetit njerëzor, aq sa ne i shohim si të qëllimshme atje ku e gjitha kjo në realitetin që ekziston është trill ose rastësi... Madje edhe në mesin e pakicës së atyre që pretendojnë të mbështesin evolucionin darvinist, shumë e shtrembërojnë atë në një mënyrë ose në një tjetër, shpesh duke e parë atë si një forcë e brendshme misterioze që dirigjon speciet drejt përsosmërisë... Katërvjeçarët këmbëngulin se çdo gjë ka një synim, duke përfshirë edhe objekte si luani (për të shkuar

---

<sup>1</sup> Ibid.

<sup>2</sup> Ibid.

<sup>3</sup> Ibid.

në kopsht zoologjik) dhe retë (për të sjellë shiun). Kur ata pyeten për të shpjeguar se pse një grumbuj gurësh janë me majë, të rriturit preferojnë të japin një shpjegim fizik, ndërsa fëmijët zgjedhin përgjigje funksionale, siç është ajo “që kafshët të mund të fërkohen mbi to, kur ato ndjejnë kruajtje”.<sup>1</sup> Duke u bazuar në të tilla gjetje, (Deborah)Kelemen propozoi se fëmijët janë të prirë drejt tendencës së “teleologjisë konfuze” (*promiscuous teleology*) më shumë sesa të rriturit, për ta parë botën në termat e dizajnit dhe qëllimit. Një tjetër studim konstaton se kur fëmijët janë pyetur direkt rreth origjinës së kafshëve dhe njerëzve, ata priren të pëlqejnë shpjegime që përfshijnë një krijues të qëllimshëm, edhe nëse të rriturit që i kanë rritur ata nuk e bëjnë këtë gjë.<sup>2</sup>

Bloom e mbyll artikullin e tij duke thënë se:

Këto prirje e bëjnë të natyrshme besimin në Zota dhe shpirtra, në jetën e pëtejme dhe në krijimin hyjnor të universit. Këto janë farat nga të cilat rritet feja... Disa mund të argumentohen duke thënë se të gjitha këto janë besime fetare, duke përfshirë dualizmin dhe kreacionizmin. Hulumtimi zhvillimor i mësipërm sugjeron që nuk është ky rasti, sepse fëmijët duket se kanë disa besime që nuk janë të pranishme, ose të paktën nuk janë aq të forta, tek të rriturit që i rrethojnë.<sup>3</sup>

#### 1.4 Të lindur besimtarë

Profesori i psikologjisë zhvillimore dhe një psikolog eksperimental, Justin L. Barrett<sup>4</sup> mbron tezën se qeniet njerëzore lindin me aftësi konjitive (njohëse), që në mënyrë të natyrshme do të prodhojnë besimin në Zot/perëndi. Studimi i tij më i njohur në këtë drejtim është libri *Born Believers: The Science of Children's Religious Belief*.<sup>5</sup>

Ai thotë se:

(shpesh) dëgjojmë të thuhet për dikë se ai është një “këngëtar i lindur” ose “artist i lindur”. Fëmijët nuk janë lindur për të kënduar, pikturuar dhe kërcyer, por këto shprehje duan të thonë se foshnjat kanë lindur me aftësi të cilat -nëse u jepet mundësia minimale dhe mbështetja kulturore- do nxjerrin në pah në një mënyrë ose tjetër mjeshtërinë në të kënduar, në art ose sport. Në të njëjtën mënyrë (por jo identike), në thelb të gjitha foshnjat njerëzore janë lindur për të folur -të destinuara për të mësuar gjuhën- dhe lindur

---

<sup>1</sup> Në fakt kjo tregon se fëmijët dhe njerëzit në natyrshmërinë e tyre janë të prirë të kërkojnë dhe të japin shpjegime për arsyen e ekzistencës së sendeve, pra se ata janë teleologjik në natyrë, ndërsa të rriturit e arsimuar japin shpjegime shkakësore, si pasojë e edukimit shkencor të tyre. Në thelb, nga aspekti shpjegues i botës, nuk ka një kontradiktë në mes tyre, edhe pse shpjegimet e fëmijëve mund të mos jetë të sakta, sepse ndërmjet shkakut dhe arsyes ka një diferencë të rëndësishme në këtë drejtim, që është se arsyeja ka qëllim mendor, pasi ajo përfshin procese njohëse (konjitive), siç është në këtë rast paraqitja e shpjegimeve dhe sinkronizimi me realitetin, në dallim me shpjegimet shkakësore fizike, të cilat përmbushin një tjetër aspekt njohës të botës.

<sup>2</sup> *Religion is natural* në *Developmental Science* 10:1 (2007).

<sup>3</sup> *Religion is natural* në *Developmental Science* 10:1 (2007), f. 151.

<sup>4</sup> Drejtor i Thrive Center for Human Development në Pasadena, Kaliforni. Profesor i Shkencave zhvillimore dhe profesor i psikologjisë në Fuller Graduate School të Psikologjisë. Studiues dhe ish-drejtor i Qendrës së Antropologjisë e Intelektit dhe Institutit të Antropologjisë Konjitive dhe Evolucionare në Universitetin e Oksfordit. Dr. Barrett është një editor themelues i *Journal of Cognition & Culture* dhe autor i artikujve dhe kapitujve të shumtë në lidhje me shkencën konjitive të fesë. Profesori Barrett vlerësohet si një nga themeluesit e shkencës konjitive në fushën e fesë ([https://en.wikipedia.org/wiki/Justin\\_L.\\_Barrett](https://en.wikipedia.org/wiki/Justin_L._Barrett))

<sup>5</sup> *Born Believers: The Science of Children's Religious Belief*, Free Pres, New York, 2012.

për të ecur- natyrshëm të mësojnë të ecin. Në të njëjtën mënyrë, fëmijët janë lindur besimtarë në një lloj zoti.<sup>1</sup>

Barret për të mbështetur tezën e tij paraqet mjaft eksperimente interesante rreth zhvillimit të fëmijëve, duke përfshirë:

- Zbulimi i agjentëve. Fëmijët e vegjël mësojnë shpejt të dallojnë mes objekteve të pajetë, siç janë gurët dhe objektet e gjalla, siç janë njerëzit dhe kafshët, të cilët kanë qëllime dhe bëjnë zgjedhje. Agjentët kanë disa cilësi: a) lëvizin vetë dhe lëvizin edhe të tjerët, b) veprojnë duke pasur synime (në vend që thjesht të lëvizin në mënyrë arbitrare), c) nuk kanë nevojë t'i përngjasin njerëzve dhe d) nuk kanë nevojë të jenë të dukshëm.<sup>2</sup> Eksperimentet sugjerojnë se që nga viti i parë i jetës, fëmijët zhvillojnë sistemin konceptual për t'iu dhënë kuptim agjentëve, që nuk janë të kufizuar vetëm te njerëzit, duke lënë kështu të hapur mundësinë që bebet mund të përdorin të njëjtin sistem konceptual kur ata mendojnë për zotat.<sup>3</sup> Bebet eventualisht e kuptojnë se edhe kur prindërit nuk janë të dukshëm, ata mund të veprojnë (të shkojnë tek ta) dhe mund të veprohet tek ta (duke i thirrur përmes të qarës). Ndoshta evidenca më e fortë që fëmijët e vegjël lehtësisht mund të konceptojnë dhe besojnë në ekzistencën e agjentëve të padukshëm vjen nga hulumtimet rreth shokëve të padukshëm ose imagjinarë. Më shumë se 40% e njerëzve ka pasur më së paku një shok imagjinar gjatë fëmijërisë së hershme.<sup>4</sup> Fëmijët kanë tendencë për të identifikuar objektet si agjentë dhe me pak provokim t'i shohin ngjarjet si të shkaktuara nga agjentë. Kjo tendencë për të gjetur lehtësisht agjentë (nganjëherë pa sasi të mëdha të provave) vazhdon në moshën madhore dhe e bën zbulimin e zotave jo vetëm të mundshme, por të pritshme. (Kapitulli 1)
- Zbulimi i qëllimit. Fëmijët e vegjël janë të prirë të kërkojnë qëllimin pas ngjarjeve dhe të mendojnë se objektet orientohen drejt një objekti. Agjentët kanë besime, dëshira dhe qëllime që motivojnë veprimet e tyre; objektet e zakonshëm jo. Fëmijët e zbulojnë me padurim dizajnin dhe qëllimin në botën natyrore.<sup>5</sup> Arsyetimi teleologjik i fëmijëve shtrihet edhe në gjërat jo të gjalla në natyrë, siç janë shkëmbinjët, dëborat, malet dhe mbarë kafshët dhe bimët. Për fëmijën, është krejtësisht e arsyeshme jo vetëm të pyesin veten për çfarë shërben feçka dhe veshët e një elefanti, por edhe për çfarë shërben vetë elefanti, apo për çfarë shërben një lumë, ose për çfarë shërben një shkëmb i dalë nga toka.<sup>6</sup> Për fëmijët karakteristikat e botës natyrore, nuk janë thjesht aksidente që ndodhë të jenë të dobishme, por janë të urdhëruara dhe të qëllimshme.<sup>7</sup> Psikologu zhvillimor dhe evolucionist Jesse Bering sugjeron se njerëzit që nga fëmijëria zotërojnë një paramendim për të parë qëllim në botën natyrore. Ai e quan këtë *teoria ekzistenciale e mendjes*. Që do të thotë se njerëzit kanë një tendencë të fortë për të kërkuar dhe parashtruar kuptim përtej ngjarjeve.<sup>8</sup> Madje Deborah Kelemen ka demonstruar në mënyrë eksperimentale se edhe

---

<sup>1</sup> Ibid f. 18.

<sup>2</sup> Ibid f. 31.

<sup>3</sup> Ibid f. 34-35.

<sup>4</sup> Ibid f. 36

<sup>5</sup> Ibid f. 44

<sup>6</sup> Ibid f. 45

<sup>7</sup> Ibid f. 48

<sup>8</sup> Ibid f. 50



të rriturit, madje edhe ata të trajnuar shkencërisht, kanë paramendime që favorizojnë shpjegime të bazuara në qëllime. (Kapitulli 2)

- Zbulimi i dizajnit. Fëmijët e vegjël e pranojnë se qeniet njerëzore krijojnë objekte, por ata nuk krijojnë objekte natyrore si pemët dhe malet. Eksperimentet me fëmijët e vegjël tregojnë se ata mendojnë se dikush e shkakton atë që ata shohin, si një rend të qëllimshëm në botë, dhe ata qysh herët i lidhin agjentët e qëllimshëm me rregullin; ata shohin qëllim, funksion dhe dizajn në botën natyrore; dhe kështu ata natyrisht supozojnë se dikush e solli atë.<sup>1</sup> Që nga fëmijëria e hershme, truri ynë na inkurajon të mendojmë në këtë mënyrë. Edhe midis evolucionistëve të përkushtuar dhe kundra dizajnit, gjuha e dizajnit dhe qëllimit shfaqet e pashmangshme. Mënyra se si truri ynë zhvillohet natyrshëm, na detyron të pyesim se kush ose çfarë fshihet pas modelit dhe qëllimit të dukshëm në natyrë. Kush është dizajneri i madh? A është vetë natyra? Evolucioni? Përzgjedhja natyrale? Një Zot? Njerëzit me padurim kërkojnë shenja të agjentëve të padukshëm rreth tyre. Këtij fakti i shtojmë edhe tendencën për të parë modelim dhe qëllim në botën natyrore. Kështu që ndërthurja e këtyre në intuitën e thellë thotë se njerëzit apo qeniet e tjera të vullnetshme sjellin një modelim të rregullt, ndërsa forcat natyrore nuk prodhojnë qëllim. Në fund, pjesëzat priren vazhdimisht për të pyetur veten se çfarë nënkuptojnë ngjarjet e pazakonta? Dhe tashmë një recetë e gatshme, që zhvillohet natyrshëm, gjendet në mendje, dhe që dëshiron një përgjigje për pyetjen: Kush është përtej të gjithave?<sup>2</sup> Studimet e kryera nga Deborah Kelemen dhe Cara DiYanni për idetë e fëmijëve për origjinën, zbuluan se fëmijët që ofruan shpjegime të qëllimshme, pse ekziston stuhia e parë, lumi, zogjtë dhe gjërat e tjera natyrore, për një pyetje me zgjedhje, ata priren të pohojnë përgjigje që përfshijnë dizajnim inteligjent.<sup>3</sup> Hulumtimet tregojnë se fëmijët nga mosha tetë ose nëntë vjeç, por edhe katër vjeç (ose edhe më të vegjël), e kuptojnë se njerëzit nuk bëjnë gjëra natyrore, por vetëm artefakte. E nëse bota natyrore shfaqet kaq e dizajnuar me qëllim, atëherë kush e bëri projektimin nëse jo njerëzit? Zoti duket të jetë një kandidat i fortë për fëmijët që të përqafojnë këtë rol modelues.<sup>4</sup> (Kapitulli 3)
- Dijsa. Fëmijët e vegjël supozojnë se agjentët e tjerë kanë vetëm besime të vërteta. Fëmijët tre deri në pesë vjeç në mënyrë tipike i atribuojnë super dije shokëve të tyre të padukshëm, duke arsyetuar rreth tyre ashtu siç ata bëjnë rreth Zotit në eksperimente.<sup>5</sup> (Kapitulli 4)
- Morali. Fëmijët e pranojnë se faktet morale janë objektive dhe nuk janë vendosur nga tekat e nënave apo pritshmëria kulturore. Tendenca për të besuar në të paktën një të plotfuqishëm, gjithëdijshëm, gjithë-ndjeshëm, Zoti i interesuar për moralin, duket se është pjesë e zhvillimit normal të fëmijës njerëzor para moshës pesë vjeç.<sup>6</sup> (Kapitulli 5)

---

<sup>1</sup> Ibid f. 49

<sup>2</sup> Ibid f. 51

<sup>3</sup> Ibid f. 55

<sup>4</sup> Ibid f. 57

<sup>5</sup> Ibid f.37

<sup>6</sup> Ibid f. 123

Bazuar në këto tendenca të provuara në mënyrë eksperimentale, nuk është e vështirë të shihet se pse fëmijët janë të gatshëm të besojnë se ekziston një agjent që ka krijuar dhe dizajnuar universin për një qëllim të caktuar, dhe që zotëron mbidije dhe gjykon veprimet morale.

Barret thotë se:

Ne kemi arsye të mjaftueshme të mendojmë se në vitin e parë të jetës, foshnjat tashmë janë të qarta me vetitë themelore të objekteve fizike dhe kuptojnë se agjentët mund t'i thyejnë këto rregulla. Në veçanti, agjentët mund ta lëvizin veten dhe gjërat e tjera, duke vepruar për të arritur synimin (në vend që të lëvizin vetëm në mënyrë arbitrare), ata nuk kanë nevojë t'i ngjajnë njerëzve, dhe nuk kanë nevojë të jenë të dukshëm për fëmijët, që ata të mendojnë rreth tyre dhe t'iu atribuojnë atyre veprime. Këto përfundime janë blloqe ndërtuese për të menduar rreth njerëzve dhe kafshëve, por gjithashtu edhe rreth zotave. Zotat janë agjentë që shpesh nuk shihen ose nuk i përngjajnë njerëzve, por megjithatë veprojnë.<sup>1</sup>

Barret kundërshton hipotezën e njohur, por të pasaktë të 'indoktrinimit', e cila thotë se të gjitha pretendimet fetare përhapen nga indoktrinimi i fëmijëve. Ai vë në dukje se nëse kjo teori do të ishte e vërtetë, atëherë të gjitha besimet fetare do të zhdukeshin në pak gjenerata, për shkak të venitjes. Hipoteza e indoktrinimit përsëritet si tezë -thotë ai- sepse njerëzit shpesh e nënvlerësojnë informacionin që zotërojnë fëmijët e lindur apo injorojnë aftësinë e tyre për të mësuar shpejt dhe thjeshtë. Njerëzit e marrin për të mirëqenë se mendja e foshnjave i ngjan një rezervuari të zbrazët që pret të mbushet, ndërkohë që ky supozim injoron faktin se mendjet njerëzore kanë sasi të konsiderueshme prirjesh natyrore, të cilat u japin atyre mundësinë të zgjidhin probleme të rëndësishme për mbijetesën e tyre dhe shqetësimet që u paraqiten.<sup>2</sup>

Barret thotë:

Pyetja që kërkon përgjigje është atëherë, se si dhe pse shumë ide fetare janë kaq të lehta për tu adoptuar nga fëmijët? Një përgjigje ndaj kësaj pyetje ka qenë në qendër të teorisë së studimit shkencor të fesë dhe në veçanti në psikologjinë e fesë për më se një shekull. Kjo përgjigje mund të quhet hipoteza antropomorfiste. Fëmijët mund të krijojnë lehtësisht idenë për Zotin, sepse mekanizmat e tyre mendorë kanë dy veti që favorizojnë të mësuarit rreth Zotit. Së pari, kjo pajisje i ndjen lehtësisht agjentët jo-njerëzorë. Së dyti, ajo duket se paramendon veti mbinjerëzore, derisa të zbulojë diçka ndryshe. Superagjentët, për njeriun, qëllojnë më afër parametrave natyrorë të parazgjedhur.<sup>3</sup>

Barret gjithashtu thotë:

Psikologu zviceran Jean Piaget, padyshim psikologu zhvillimor më me ndikim i shekullit XX, argumenton se tendenca për të menduar për botën natyrore si të bërë, nuk vjen për shkak të konfuzionit të edukimit fetar, por "dikush e zbulon... se para se ndonjë mësim

---

<sup>1</sup> Ibid f. 37

<sup>2</sup> Ibid f. 20

<sup>3</sup> Ibid f. 66

fetar të zër vend, pyetjet artificialiste janë konturuar nga fëmijët e moshës 2 deri në 3 vjeç: “Kush e bëri diellin?”, pyeti Frani kur ishte 2 vjeç e 9 muaj.”<sup>1</sup>

Barret tregon gjithashtu shembuj interesant të zhvillimit konjitiv të natyrshmërisë së teizmit të fëmijët, në veçanti raportimet që vijnë nga prindër ateist të çuditur, që flasin për besimet fetare të fëmijëve të tyre. Barret dallon mes ‘fesë natyrore’, me të cilën ai nënkupton prirjen për të besuar në Zot/perëndi, dhe ‘teologjisë’, me të cilën ai nënkupton një besim me përmbajtje specifike për Zotin.

Barret pohon duke përmbledhur se:

Hulumtimi shkencor rreth mendjes në zhvillim të fëmijëve dhe besimeve mbinatyrore, sugjeron se fëmijët në mënyrë të natyrshme dhe me shpejtësi përvetësojnë mendime që lehtësojnë besimin të agjentët e mbinatyrshëm. Veçanërisht në vitin e parë pas lindjes, fëmijët bëjnë dallimin midis agjentëve dhe jo-agjentëve, duke i kuptuar agjentët si të aftë të lëvizin vetë në mënyra të qëllimshme për të përmbushur synimet. Fëmijët janë të prirë të gjejnë agjentë përreth tyre, madje edhe duke pasur prova të pakta. Jo shumë kohë pas lindjes së tyre, foshnjat duket se e kuptojnë që agjentët, dhe jo forcat natyrore ose objektet e zakonshëm, mund të krijojnë rregull nga çrregullimi. Para se fëmijët të fillojnë shkollën, ata e shohin botën natyrore si të dizajnuar me qëllim -madje edhe në mënyra që prindërit fetarë nuk ua mësojnë ose miratojnë. Kjo tendencë për të parë funksion dhe qëllim, plus kuptimi se qëllimi dhe rendi vijnë nga qenie me mend, i bën fëmijët me gjasë t’i shohin fenomenet natyrore si të krijuara me qëllim. Por kush është krijuesi? Fëmijët e dinë se njerëzit nuk janë kandidatë të mirë. Kështu që duhet të ketë qenë një zot. Zotat nuk janë vetëm njerëz me aftësinë për të bërë male, pemë dhe flutura. Qasjet e hershme, të paracaktuara, për agjentët me mendje, e bëjnë të lehtë për fëmijët t’i kuptojnë perënditë si të pajisura me njohuri të plota, super-perceptim, superfuqi, pavdekësi dhe mbasë mirësi morale. Në fakt, në disa prej këtyre dimensioneve, fëmijët tregojnë aftësinë e arsytimit në mënyrë teologjike të saktë përpara se të arrijnë të arsyetojnë me saktësi për qeniet njerëzore në të njëjtat dimensionë. Ky koleksion idesh fetare është ndër tiparet e asaj që unë (J. Barret) e quaj feja e natyrshme.<sup>2</sup>

Fëmijët pra, kanë lindur besimtarë të asaj që Barret e quan fe natyrale - paralel me gjuhën natyrore për të cilën shumë gjuhëtarë thonë se mendja e fëmijëve natyrisht është e prirë për ta kuptuar.<sup>3</sup> Prirjet dhe tendencat konjitive, të lindura nga sistemet e maturimit natyral dhe jo nga veçoritë kulturore, i bëjnë fëmijët besimtarë të lindur, pohon Barret.<sup>4</sup>

### 1.5 Shkenca nuk e rrezikon fenë

Robert McCauley, profesor i filozofisë, psikologjisë, fesë dhe antropologjisë, në librin e tij “Why Religion is Natural and Science Is Not”,<sup>5</sup> mbron tezën se mendjet njerëzore janë më të përshatshme për besimin fetar sesa për hulumtimin shkencor. Kjo për shkak se shpjegimet që

<sup>1</sup> Ibid f. 54

<sup>2</sup> Ibid f. 102

<sup>3</sup> Ibid f. 102

<sup>4</sup> Ibid f. 105

<sup>5</sup> Robert N. McCauley, Why Religion Is Natural and Science Is Not, 2011 Oxford University Press, Inc. Në vazhdim do t’i referohem këtij libri, për qasjen e autorit.

jep feja kanë kuptim intuitiv për njerëzit dhe pajtohen me sistemet e tyre natyrore konjitive, ndërkohë që shkenca përfshin të menduarin abstrakt dhe forma të reflektimit që kërkojnë shumë punë mendore.

Duke u mbështetur në hulumtimet e fundit dhe duke ilustruar argumentin e tij me shembuj të zakonshëm, McCauley argumenton se feja ka ekzistuar për mijëra vjet në çdo shoqëri, sepse llojet e shpjegimeve që ajo ofron janë pikërisht llojet që vijnë natyrshëm në mendjet njerëzore. Shkenca, nga ana tjetër, është një zhvillim shumë më i ri dhe më i rrallë, sepse i shtrin përfundimet e saj në nivele radikale dhe kërkon një lloj mendimi abstrakt, që lind vetëm në mënyrë të vazhdueshme në kushte shumë specifike shoqërore. Feja ka kuptim intuitiv për ne, ndërsa shkenca kërkon shumë punë, pohon ai. McCauley vjen në përfundimin se duke qenë se feja është e natyrshme, kjo do të thotë që shkenca nuk paraqet ndonjë kërcënim të vërtetë për të, ndërsa jonatyrshmëria e shkencës -sipas tij- e vendos atë në një pozitë çuditërisht të pasigurt.

Ai trajton në librin e tij konceptin e ‘sistemeve të maturuar natyrore’ që janë sisteme njerëzore konjitive që veprojnë automatikisht, në mënyrë joreflektive dhe (më së shumti) të pavetëdijshme. Ai thotë se këto sisteme përfshijnë elementë si gjuha, njohja e fytyrës dhe më e rëndësishmja ‘teoria e mendjes’. *Teoria e mendjes* i referohet aftësisë dhe prirjes konjitive njerëzore për të interpretuar sjelljen dhe ngjarjet në terma të agjentëve dhe veprimit të tyre, tendencë kjo që emërtohet si ‘agjencia hiperaktive e zbulimit’, e cila sipas McCauley është bërthama konjitive natyrore e fesë popullore, siç e quan ai. Ai thotë se fetë në tërësi përmbajnë “një numër minimal agjentësh kundër intuitiv” për të shpjeguar një gamë të gjerë të fenomeneve natyrore. Pra feja qarkullon në disa prej aftësive më themelore konjitive të njeriut. Në esencë, natyrshmëria e fesë është pasojë e natyrshmërisë së sistemeve konjitive që ajo aktivizon. Këto sisteme, sipas McCauley, kanë evoluar për të zgjidhur probleme të tjera të paraardhësve tanë me të cilat ata përballeshin (si gjuetia, dominimi shoqëror, zbulimi i gënjeshtres etj.) Mendimi dhe sjellja fetare përdorin të njëjtat sisteme konjitive njohëse dhe kjo është arsyeja pse feja ndjehet dhe është kaq e natyrshme

McCauley krahason themelet konjitive të fesë dhe të shkencës, nga aspekti njohës psikologjik, dhe jo nga ai metafizik apo epistemologjik. Libri i tij fokusohet tek mendimi, tek procesi sesi ai ndodh. Ai pohon se “pothuajse të gjithë ata që punojnë në shkencat konjitive supozojnë se mendimi shfaqet në të paktën dy lloje.” Të cilët janë: mendimi “i natyrshëm” i cili ka të bëjë me njohjen e natyrshme, që prek pjesën e padukshme të jetës mendore dhe që përbën mendimin e shpejtë, (kryesisht) të pavetëdijshëm, automatik, i pamundimshëm, intuitiv, i cili është shpesh i vështirë për t’u artikuluar. Ndërsa mendimi “jo i natyrshëm” është ai ngadalti, i vetëdijshmi, i kontrolluar, i mundimshëm, reflektues. Mendimi i natyrshëm, intuitiv, i menjëhershëm -sipas McCauley- vjen nga dy burime. Njërin burim ai e quan natyrshmëri “e praktikuar” e cila vjen nga praktika dhe përvoja e gjatë në disa fusha, siç janë gjykimet e ekspertëve të një fushe për çështje të caktuara, si p.sh. lëvizja e një mjeshtri shahu për të shmangur kurthin e kundërshtarit, gjykimi i një inxhinieri për strukturën e një ndërtese etj. Ndërsa burimi i dytë vjen nga ajo që ai e quan njohje natyrore “e maturuar”, tek i cili përqendrohet edhe teza e autorit për natyrshmërinë e fesë. *Njohja natyrore e maturuar* ka të bëjë me pikëpamje të menjëhershme, intuitive, që shfaqen në mendje në fushat ku njerëzit mund të kenë pasur pak ose aspak përvojë dhe pa udhëzime paraprake. Shembuj të njohjes natyrore të maturuar, janë folësit që dinë të thonë diçka në gjuhën e tyre amtare, të cilën ata as nuk e kanë thënë vetë dhe as kanë dëgjuar dikë tjetër ta thotë më

parë; njerëz që e dinë se çfarë po ndjen dikush ose çfarë po mendon ai, mbi bazën e vëzhgimit të shprehjeve të fytyrës së tjetrit. Shembuj të tjerët, për të dalluar ndërmjet këtyre dy aftësive konjitive natyrore janë p.sh. të folurit, të përtypurit, të ecurit, të cilat sipas emërimit të McCauley janë natyrore të maturuara, dhe nuk lidhen me kulturën dhe për të cilat nuk kërkohet ndonjë trajnim specifik apo udhëzues për t'u përvetësuar, ato përftohen që nga fëmijëria e hershme, dhe nuk kujtohen se kur kanë nisur në dallim p.sh. me leximin, shkrimin apo dhënien e biçikletës, të cilat edhe pse janë të natyrshme për shumë njerëz, ato nuk janë universale dhe kërkojnë trajnues dhe udhëzues për t'u përftuar si aftësi dhe janë detyrimisht të lidhura me kulturën. Mendimi fetar, ai i nivelit popullor, siç e quan autori dhe jo ai i strukturuar teologjikisht, operon pikërisht në këtë hapësirë konjitive të maturuar. Feja është e natyrshme sepse është një zgjatim dhe shprehje e mënyrës sesi ne tashmë, natyrshëm mendojmë për botën.

McCauley shpjegon, nga qasja konjitive mendore njerëzore, se pse shkenca nuk është një aktivitet i natyrshëm njerëzor, sepse teoritë e saj janë skajshmërisht kundërintuitive dhe ajo varet nga një ndërthurje shumë e veçantë e përbërësve kulturor, të cilat janë shkrimi dhe leximi, arsimimi i gjatë, liria nga presioni politik, mbështetja institucionale e kërkimeve shkencore, etj. Ndërthurja e favorshme e këtyre përbërësve kulturor është e rrallë në histori dhe e brishtë. Ndoshta dallimi më i rëndësishëm mes shkencës dhe fesë, pohon ai, është fakti se shkenca përfshin procedura që evidentojnë 'zbulimin sistematik të gabimeve', duke mbledhur, ruajtur, gjeneruar dhe analizuar faktet. Më pas këto përdoren kundra hipotezave shkencore që rezultojnë të pasakta dhe kështu shkenca ecën përpara. Sipas McCauley, kjo praktikë është faktikisht unike për shkencën dhe mungon te feja.

Nisur nga kjo qasje konjitive McCauley pohon se është ateizmi, jo feja, ai që njerëzit duhet të punojnë për ta përvetësuar. Fushatat bashkëkohore kundër fesë bazuar në një admirim të shkencës dhe racionalitetit të shkencës, nga njerëz si Sam Harris, Richard Dawkins, Christopher Hitchens dhe Daniel Dennett, nuk do të kenë shumë sukses, pohon ai. Në varësi të kushteve materiale dhe kulturore, feja mund të fuqizohet ose venitet, por feja kurrë nuk do të zhduket. Fushatat për ta larguar nuk do të funksionojnë, thotë McCauley.

Shkenca dhe feja, sipas McCauley, kanë hapësira të ndryshme për të cilat ato interesohen. Shkenca ka të bëjë kryesisht me përshkrimin, shpjegimin, parashikimin dhe manipulimin e botës empirike. Ndërsa fetë shfaqin interesa të përsëritura në standardet për sjelljen njerëzore dhe në drejtim të kuptimit të jetës njerëzore, bazuar në qasje për agjentë empirikisht të paarritshëm. Por këto të vërteta të njohura nuk përjashtojnë në disa raste edhe fërkime midis fesë dhe shkencës, pohon McCauley. Duke përmbledhur argumentin e tij ai pohon se:

- Gjetjet e shkencës kanë të bëjnë me botën empirike.
- Pothuajse të gjitha perënditë janë (supozohet se janë) empirikisht të paarritshëm pothuajse gjatë gjithë kohës.
- Prandaj: Gjetjet shkencore, në të vërtetë gjetjet empirike të çfarëdo lloji, nuk do të kenë rëndësi të drejtpërdrejtë mbi pretendimet për ekzistencën e këtyre perëndive.

Kështu që duhet të pranojmë, thotë McCauley, se zbulimet shkencore e kanë të kufizuar ndikimin ndaj pretendimeve fetare për ekzistencën dhe sjelljen e hyjnore.

## 1.6 Përhapja e fesë në shoqërinë e sotme njerëzore

Edhe në kohën e sotme anketimet dhe studimet e ndryshme tregojnë se besimi fetar është një nga dukuritë më të përhapura dhe mbizotëruese në botë. Kështu sipas *Pew Research Center*<sup>1</sup> tetë nga dhjetë njerëz në botë e identifikojnë veten me një grup fetar. Sipas “një studimi gjithëpërfshirës demografik në më shumë se 230 vende dhe territore, i realizuar nga *Pew Research Center’s Forum*, për fenë dhe jetën publike vlerësohet se ka rreth 5,8 miliardë të rritur dhe fëmijë të lidhur me fenë në mbarë globin dhe që përfaqësojnë 84% të popullsisë botërore në 2010, prej 6,9 miliardë gjithsej.”<sup>2</sup> Sipas të njëjtit burim, edhe pjesa e mbetur prej 16% e botës që identifikohet si afetare, mes tyre përfshihen përveç ateistëve dhe agnostikëve edhe shumë njerëz, të cilët edhe pse nuk e përfshijnë veten tek ndonjë fe ata kanë ndonjë element të besimit fetar. “Për shembull, besimi në Zot ose në një fuqi të lartë besohet nga 7% e kinezëve të rritur të identifikuar si të pafe, 30% e të pafeve francezë dhe 68% e të pafeve amerikan. Disa prej të pafeve përfshihen gjithashtu edhe në disa praktika fetare.”<sup>3</sup>

I njëjti burim gjithashtu vë në dukje se 62,2 % e të gjithë të pafeve gjenden në Kinë, pasur nga Japonia me 6%, SHBA me 5%, Vietnam me 2% dhe Rusia gjithashtu me 2% të të gjithë të pafeve në botë. 76% e të pafeve në të gjithë botën janë të përqendruar në Azi dhe në Paqësor. Ndërkohë Evropa përmban 12 % të të pafeve të botës dhe 18 % të banorëve të saj. Ekzistojnë gjashtë shtete ku identifikimi si i pafe përbën shumicën e popullsisë dhe ato janë: Çekia me 76% të popullsisë së saj, Koreja e Veriut me 71%, Estonia me 60%, Japonia me 57%, Hong Kong me 56% dhe Kina me 52%.<sup>4</sup> Ajo çka të bie në sy është se me përjashtim të Japonisë, pjesa e tjetër e këtyre vendeve kanë qenë pjesë e regjimeve komuniste ose vazhdojnë të jenë pjesë e tij, çka na sugjeron se afetaria apo ateizmi masiv mes njerëzve është më së shumti produkt i imponuar nga politika të caktuara sesa një zhvillim i natyrshëm i shoqërive njerëzore.

Madje edhe shumë prej atyre që e identifikojnë veten si të “pa fe”, shprehen disa studiues, shpesh e bëjnë këtë për arsye specifike:

Vernon dhe Baker & Smith raportojnë se në mesin e atyre që thonë se nuk kanë ‘asnjë fe’, afërsisht vetëm një e katërta ishin ateistë, një e katërta agnostik, dhe 50% i mbetur, realisht mbartnin besime të mbinatyrshme, por e klasifikonin veten si jofetarë për t’u distancuar nga grupimet e padëshirueshme religjioze. Kjo është e rëndësishme sepse tregon, krahasuar me të tjerë që përdorin klasifikimin ‘jofetar’, se klasifikimi i ateistëve dhe agnostikëve si jofetarë reflekton më saktë skepticizmin e veçantë filozofik rreth ideve fetare dhe mbinatyrore.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Është një qendër e njohur studimore, jo partiake, me qendër në Washington të SHBA.

<https://www.pewresearch.org/about/>

<sup>2</sup> December 18, 2012. *The Global Religious Landscape* në <https://www.pewforum.org/2012/12/18/global-religious-landscape-exec/>

<sup>3</sup> December 18, 2012, *The Global Religious Landscape, Religiously Unaffiliated* në <https://www.pewforum.org/2012/12/18/global-religious-landscape-unaffiliated/#ftn10>

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Kenneth E. Vail III, Jamie Arndt, and Abdolhossein Abdollahi. 2012, *Exploring the Existential Function of Religion and Supernatural Agent Beliefs Among Christians, Muslims, Atheists, and Agnostics*, në *Personality and Social Psychology Bulletin* 38 (10) f. 1289.

Pra jo vetë besimin në një qenie të mbinatyrshme apo mohimin e saj.

Duke marrë parasysh këto shifra, por edhe elementët kulturor, historik dhe social të vendeve ku numri i të pafeve është i madh, dhe që jo domosdoshmërisht të gjithë lidhen me ateizmin, siç u përmend, atëherë mund të themi qartësisht se shoqëria njerëzore vazhdon të identifikohet në shumicën e saj dërmuese me besimin fetar, çka e bën fenë një normë shoqërore referenciale normative dhe jo afetarinë si të tillë. Pra duke u nisur nga ky fakt, që feja është një element kulturor esencial i shoqërisë njerëzore dhe një nga më të vjetrit e saj dhe është mbizotëruese për mijëra vjet, pavarësisht rritjes së afetarisë në epokën moderne, atëherë është apriori më logjike që besimi fetar të konsiderohet si diçka e natyrshme për shoqëritë njerëzore, dhe dukuria e mungesës së tij të jetë ajo që duhet të studiohet, pra cilat janë shkaqet apo arsyt pse njerëzit nuk besojnë. Natyrisht kjo nuk e pengon absolutisht studimin e shkaqeve dhe arsyeve të besimit, por nuk mund të thuhet se mosbesimi është norma nga duhet të nisemi, duke e marrë kështu për të vërtetë apriori këtë pohim, ndërkohë që vërtetësia ose jo e besimit, nuk është objekt studimi i sociologjisë. Më e pakta që mund të thuhet në këtë drejtim është se është e padrejtë të merret si e pasaktë shkencërisht kjo qasje.

### 1.7 Rigjallërimi i fesë në botë

Në këtë nënkapitull do të paraqiten të dhëna statistikore që flasin për rigjallërimin e fesë në pjesë të ndryshme të botës, çka tregon se proceset e modernizimit të shoqërive njerëzore nuk kanë vepruar në mënyrë të njëjtë kudo mbi besimet fetare dhe se feja nuk është zhdukur apo venitur nga ky proces, përkundrazi në mjaft raste ka ndodhur e kundërta.

Deri së paku në mesin e shekullit XX ekzistonte një konsensus i gjerë, mes studiuesve të shkencave sociale, dhe elitave intelektuale se feja e kishte humbur rolin e saj të dikurshëm në shoqëri dhe domethënien në jetën e individit gjithashtu.<sup>1</sup> Shoqëritë kudo në botë, besohej se po bëheshin gjithmonë e më shumë shekullare, falë modernizimit ekonomik dhe shoqëror, dhe feja dukej se po përmbushte gjithmonë e më shumë parashikimin e disa prej klasikëve të sociologjisë, të cilët kishin parathënë se feja do të venitej plotësisht ose do të strukej në jetën private dhe thellësinë e shpirtit të njeriut për të mos dalë më prej aty. Në fund të po këtij shekulli dhe në vazhdim, në vende të ndryshme të botës ndodhën ngjarje dhe ndryshime të mëdha, të cilat vunë seriozisht në pikëpyetje këtë konsensus akademik. Ndodhi ajo që nuk pritej ose nuk mendohej nga shumica e studiuesve, ajo që politologu francez Gilles Kepel do ta quante në 1991 si “*La Revanche de Dieu*”<sup>2</sup> apo sociologu Peter Berger në një artikull të tij të vitit 1999 si “The desecularization of the world”.<sup>3</sup>

A ka ndodhur në realitet një rikthim i njerëzve te feja, apo kjo është thjeshtë rritje e numrit të fetarëve, për shkak të rritjes së tyre demografike më të lartë sesa shekullarët? Edhe pse ka fakte të dukshme ngado, se feja dhe motivet fetare janë bërë objekt sjelljesh dhe debatesh publike, ngjarjesh të dhimbshme, luftërash, transformimesh kulturore, sociale dhe politike, në mjaft vende të botës, përsëri dikush mund të pohoj se kjo është “grahma e fundit e fesë që po jep

<sup>1</sup> Huntington, Samuel, Përplasja e qytetërimeve, f.144.

<sup>2</sup> Titulli i plotë i librit: *La Revanche de Dieu. Chrétiens, juifs et musulmans à la reconquête du monde, Seuil, Paris, 1991.*

<sup>3</sup> Titulli i plotë: *The desecularization of the world. Resurgent religion and world politics.* Publikuar nga Ethics and Public Policy Center, Washington, D.C. 1999.

shpirt kudo”, kështu që a ka vërtetë një rikthim të besimit, vlerat dhe praktikat fetare të dikurshme?

Natyrisht përgjigja ndaj kësaj pyetje kërkon një studim empirik statistikor, në të gjitha vendet e botës, ose së paku në shumicën e tyre. Dhe pikërisht këtë bën studiuesi izraelit Assaf Moghadam në një hulumtim të tij, publikuar në 2003 nga Universiteti i Havardit.<sup>1</sup> Por edhe pse në këtë nëntemë jam kufizuar kryesisht në të dhënat që jep ky autor, këtë e kam bërë për shkak të burimeve të referimit ku ai mbështet, që janë institucione ndërkombëtare me zë në fushën e anketimit dhe të dhënave globale. Por ndërkohë studime të tjera, jo të pakta, konfirmojnë në përgjithësi përfundimet e këtij studimi.<sup>2</sup> Ndërkohë studime të tjera e shtrijnë fokusimin e tyre të ndikimi që ka pasur në politikë ky rikthim i besimeve fetare në rang global.<sup>3</sup>

Gjithsesi studimi në fjalë i Moghadam -it, e adreson përgjigjen e kësaj pyetje tek ekzaminimi i prirjeve globale në identifikimin e përkatësisë fetare dhe në matjen e ndryshimit të sjelljes dhe vlerave religjioze ndër vite, “në një mori vendesh që shtrihen në të gjashtë kontinentet.” Studimi identifikon shtatë kritere, me të cilat mund të matet fetaria e një popullsie të caktuar, duke përdorur të dhënat e ndryshme në kohë, që nga viti 1980. Studimi hulumton gjithashtu edhe marrëdhëniet mes fesë dhe shtetit në shumë vende, nga disa aspekte.

Moghadam duke iu referuar World Christian Encyclopedia, si burimi që posedon të dhënat më të kompletuara të identifikimit fetar, citon popullsinë e botës në 1900, 1970, 2000, 2002 dhe parashikimin për 2025. Sipas këtyre të dhënave në vitin 2000 të krishterët përbënin 33% të popullsisë së botës me një trend rritjeje prej 1,27%, myslimanët përbënin 19,6% të popullsisë, me një trend rritjeje prej 2,11%, hindusët 13,4% të botës me një trend rritjeje prej 1,54%, feja folklorike kineze 6,4%, budistët 5,9% etj.

Sipas këtyre të dhënave jofetarët përbënin rreth 12,69% të popullsisë së botës, me një trend rritjeje prej 0,8%, ndërsa ateistët rreth 2,48% të popullsisë me një trend rritjeje prej 0,24%.<sup>4</sup>

Të dhënat tregojnë se Evropa, duke përfshirë edhe Rusinë, ka popullsinë më të madhe të krishterë në botë, por sipas projektimit të WERC<sup>5</sup> për 2025, Amerika latine dhe Afrika të dyja së bashku do t’ia kalojnë Evropës për numrin e të krishterëve.<sup>6</sup> Kjo ka lidhje pikërisht me rritjen demografike të këtyre popullsisë. Nga 1990 deri në vitin 2000, të krishterët janë rritur me 1,36%. Natyrisht kjo rritje nuk vjen vetëm nga rritja e popullsisë, por edhe nga konvertimet, gjithsesi më

---

<sup>1</sup> A Global Resurgence of Religion? Publikuar dhe iniciuar nga Weatherhead Center For International Affairs; Havard University. <https://wcfia.harvard.edu/publications/global-resurgence-religion>

<sup>2</sup> Shih p.sh. *GOD IS BACK, How Global Revival of Faith is Changing the World*, nga John Micklethwait & Adrian Wooldridgem botuar nga The Penguin Press, New York 2009. *Is God Back? Reconsidering the new visibility of religion*, grup autorësh, edituar nga Titus Hjelm, botuar nga Bloomsbury Publishing Plc, 2015. *The Global Resurgence of Religion and the Transformation of International Relations: The Struggle for the Soul of the Twenty-First Century*, nga Scott M. Thomas, botuar nga Palgrave Macmillan, 2005. *The Resurgence of Religion A Comparative Study of Selected Themes in Christian and Islamic Fundamentalist Discourses*, David S. Zeidan, Botuar nga Brill 2003. etj.

<sup>3</sup> Shih p.sh. *The Desecularization of the World: Resurgent Religion and World Politics*, grup autorësh me editor Peter Berger, 1999. *The Triumph of Tradition: How the Resurgence of Religion is Reawakening a Conservative World*, nga Steve Turley, 2019. *The Global Resurgence of Religion and the Desecularization of American Foreign Policy, 1990-2012* nga Gregorio Bettiza, tezë doktorature në London School of Economics and Political Science. Questioning the Secular State: *The Worldwide Resurgence of Religion in Politics* nga David Westerlund, 1995 botuar nga Hurst & Co. etj..

<sup>4</sup> Assaf Moghadam 2003, f.4.

<sup>5</sup> World Evangelization Research Center.

<sup>6</sup> Assaf Moghadam 2003, f. 5.



të pakta. Kështu nga 1990-2000 të konvertuarit në të krishterë ishin sa 11% e numrit të rritjes së tyre natyrore.<sup>1</sup> Brenda traditës së krishterë, të krishterët e pavarur dhe ata të lidhur me kishën Anglikane kanë rritjen më të lartë, ndërsa Kisha Ortodokse atë më të ulët. Katolicizmi roman vuan nga numri i lart i konvertimeve në fe të tjera.<sup>2</sup>

Myslimanët nga 1990-2000 kanë pasur një rritje prej 2,13%, duke pasur kështu rritjen më të lartë mes feve të mëdha. Kjo rritje i atribuohet si rritjes natyrore ashtu edhe konvertimeve. Sipas të njëjtit burim, Moghadam tregon se të konvertuarit në Islam ishin sa 3,98 % e numrit të rritjes së tyre natyrore.<sup>3</sup>

Hindusët nga 1990-2000 patën një rritje prej 1,69%, vetëm nga rritja natyrore, ndërkohë që kanë humbjen më të lartë, nga konvertimet në fe të tjera.<sup>4</sup>

Budistët edhe pse kanë pasur rritje të madhe gjatë një shekulli, parashikohet që në 2025 nga 5,9% të bien në 4,8% të popullsisë së botës. Ata kanë pasur një rritje prej 1,09% nga 1990-2000, ku të konvertuarit janë 4,4% e numrit të rritjes natyrore të budistëve.<sup>5</sup>

Judenjtë kanë pësuar një rritje prej 0,91% në vit nga 1990-2000, por ndërkohë kanë edhe humbje të mëdha nga konvertimet në fe të tjera, të cilat përbëjnë 36% e numrit të rritjes së tyre natyrore.<sup>6</sup>

Ndërkohë fetë e tjera si feja folklorike kineze, sikhët, bahaitë, shintoistët, zoroastrianët etj. kanë pasur rritje natyrore, por edhe humbje, për shkak të konvertimeve në fe të tjera. Mes tyre duket se rritjen më të madhe në këtë dhjetëvjeçar e kanë pasur zoroastrianët me 2,65% dhe rënien më të madhe nga konvertimet shintoistët me -1,09%.<sup>7</sup>

Ndërkohë për sa i përket jofetarëve dhe ateistëve të dhënat janë konfuze, për shkak të përkufizimit se kush kategorizohen si jofetarë dhe kush si ateistë. Gjithsesi sipas burimit që i referohet Moghadam, njerëzit që prononcohen se nuk kanë fe përbëjnë së paku 12% dhe më e shumta rreth 15%, ndërsa si ateistë më e pakta 2,4% dhe më e shumta rreth 4%. Sipas këtyre të dhënave për dekadën mes 1990-2000 jofetarët janë rritur me 0,83%, ndërkohë që numri i konvertimeve tek ta në fe të caktuara përbën 8,06% të numrit të rritjes së tyre natyrore. Ndërsa tek ateistët rritja e tyre për këtë dekadë është 0,3%, ndërkohë numri i konvertimeve tek ta në diçka tjetër përbën 66,62% të numrit të rritjes së tyre natyrore.<sup>8</sup>

Ndërkohë Huntington vë në dyshim edhe rritjen e jofetarëve dhe ateistëve nga 0,2% në 1900 në 20,9% në 1980, pasi ky shtim, pohon ai, “i afrohet 19% të rënies së numrit të atyre që quhen “fe popullore kineze” ku nga 23,5% që ishin në 1900 shkuan në 4,5% në 1980” Pra thjesht vendosja e komunizmit në Kinë i klasifikoi ata në jobesimtarë!<sup>9</sup>

---

<sup>1</sup> Ibid. f. 7.

<sup>2</sup> Ibid. f. 6.

<sup>3</sup> Ibid. f.8.

<sup>4</sup> Ibid. f.9.

<sup>5</sup> Ibid. f.10.

<sup>6</sup> Ibid, f.11.

<sup>7</sup> Ibid. f.13.

<sup>8</sup> Ibid. f. 14.

<sup>9</sup> Përplasja e qytetërimeve, f.92.

Moghadam natyrisht tërheq vëmendjen se vetëm përqindjet sasiore të përkatësive janë të pamjaftueshme për të treguar nëse feja po bëhet më e fortë ose e dobët në pjesë të ndryshe të botës, ndaj kjo duhet shoqëruar me qasjen kualitative, që mat sjelljen dhe vlerat fetare në një varietet vendesh dhe gjatë një periudhe kohore.<sup>1</sup> Për këtë ai i është referuar të dhënave nga tre institucione ndërkombëtare:

Në të dhënat e World Christian Encyclopedia (WCE), që përmban statistika fetare për shumicën e feve që praktikohen në botë, sidomos për të krishterët, për të cilët të dhënat i ka tepër të detajuara, dhe i bazon në regjistrimet që bëjnë rreth dhjetë milion udhëheqës kishtarë, klerikë dhe të tjerë.<sup>2</sup>

Në të dhënat e World Values Surveys (WVS), i cili kryen anketime në 65 vende të ndryshme në të 6 kontinentet, duke marrë një kampion prej së paku 1000 vetash për çdo vend.<sup>3</sup>

Në të dhënat e European Values Surveys (EVS).

Moghadam për të matur fetarinë ka identifikuar 7 kritere:

1. Ndryshimi në përqindje në kohë i popullsisë që deklaron se “beson në Zot”, duke u bazuar te përgjigjet pohuese.
2. Ndryshimi në përqindje në kohë i popullsisë që deklaron se “sa Zoti është i rëndësishëm në jetë”, duke marrë për bazë përqindjet e përgjigjeve nga niveli 6-10.
3. Ndryshimi në përqindje në kohë i popullsisë që deklaron se “është rritur si fetar”, duke u bazuar tek ato pohuese.
4. Ndryshimi në përqindje në kohë i popullsisë që deklaron se “sa është feja e rëndësishme në jetë”, duke marrë për bazë përgjigjet “shumë” dhe “mjaftueshëm”.
5. Ndryshimi në përqindje në kohë i popullsisë që deklaron se ka gjetur “qetësinë dhe forcën tek feja”, duke u bazuar tek përqindja e pohuesve.
6. Ndryshimi në përqindje në kohë i popullsisë që deklaron se merr pjesë rregullisht në shërbesat fetare, duke marrë për bazë përqindjen e përgjigjeve “një herë në muaj” dhe më shumë.
7. Ndryshimi në përqindje në kohë i popullsisë që deklaron se është ateiste ose jofetare, duke u bazuar tek përqindja e kombinuar e këtyre përgjigjeve.

Duke ndjekur këto kritere dhe duke iu referuar të dhënave të disponueshme<sup>4</sup> Moghadam arrin në këto përfundime:

Në Amerikën e veriut, në SHBA feja rezulton se ka një rigjallërim të lehtë fetar, ndërsa Kanadaja ka rënie të fetarisë.

---

<sup>1</sup> Ibid. f.15.

<sup>2</sup> Ibid. f.16.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Moghadam vë në dukje se nuk ka qenë e lehtë dhe e mundshme për të ndjekur zbatimin e këtyre të dhënave në të gjitha rastet dhe vendet, sepse jo gjithmonë të dhënat kanë qenë të plota dhe jo të gjitha kriteret ishin të plota në kohë dhe vende të ndryshme, sidomos nga vendet e Lindjes së Mesme dhe ato të Afrikës.

Në Amerikën latine, Argjentina dhe Brazili, rezultojnë se kanë rigjallërim fetar, ku kisha Pentokostaliste ka pasur një rritje tepër të madhe brenda dy dekadave, ndërsa Kili dhe Meksika nuk kanë një prirje të qartë rigjallërimi apo rënie. Për vendet e tjera nuk ka të dhëna të qarta.

Në Evropën perëndimore, Belgjika, Britania, Franca, Gjermania, Islanda, Holanda, Norvegjia dhe Zvicra, rezultojnë se kanë rënie të fetarisë, ndërsa Finlanda, Irlanda dhe Italia se kanë rigjallërim. Kurse Danimarka, Spanja dhe Suedia nuk kanë një prirje të qartë.

Sipas Moghadam: Belgjika, Franca dhe Danimarka kanë shenjat më të qarta të shekullarizimit, ku asnjë nga kriteret nuk tregojnë rritje të fetarisë, ndërsa në Gjermani, Holandë, Norvegji, Britani dhe Islandë, shumica e kriterëve tregojnë një prirje drejt shekullarizimit, ndërsa disa të tjerë të kundërtën. Për shembull në Gjermani përgjigjet tregojnë një rëndësi të madhe të Zotit dhe fesë edhe pse të gjithë kriteret e tjera tregojnë rënie në sjelljen dhe vlerat fetare.<sup>1</sup> Autori vë në dukje se në Evropën perëndimore ka rënie të theksuar të frekuentimit të kishave që nga vitet 80', por Moghadam citon edhe studiues të tjerë të cilët theksojnë se, duhet bërë dallim mes pjesëmarrjes në kishë, e cila ka rënë dhe vlerave dhe besimeve fetare të cilat ende vazhdojnë.

Në Rusi, Evropën lindore dhe juglindore të dhënat tregojnë se Bosnja, Bullgaria, Çekia, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Rusia, Sllovakia, Sllovenia, Ukraina dhe Jugosllavia<sup>2</sup> kanë rigjallërim të qartë të fesë, ndërsa Polonia tregon rënie (!). Moghadam pohon se të dhënat p.sh. për Rusinë tregojnë se që nga viti 1970 numri i popullsisë jofetare/ateiste ka rënë nga 52% në 1970 në 33% në vitin 2000 dhe parashikohet që kjo popullsi të bjerë edhe më tej deri në 2025 deri ndoshta në 20%. Nga 1990 deri në 1997 besimi në Zot është rritur nga 35% në 60%.

Në të gjithë Evropën lindore ka një rënie të njerëzve që identifikohen si jofetar/ateist, duke përfshirë këtu edhe Çekinë (nga 39,3% në 36,9%), Estonin (nga 39,8% në 36%), Hungarinë (nga 12,5% në 11,6%), Poloninë (nga 3,5% në 2,5%) etj. Në Hungari p.sh. rritja e përqindjes së atyre që besonin në Zot u rrit nga 44% në 1981 në 58% në 1990, pra edhe para se të shpërbëhej ish Bashkimi Sovjetik dhe kampi komunist. Polonia këtu duket se bën përjashtim nga vendet e tjera të ish bllokut komunist, por ndërkohë kjo vlen vetëm për disa prej kriterëve që janë marrë për bazë për fetarinë, ndërkohë që Polonia rezulton të jetë nga vendet më fetare, ku 96% e tyre pohonin në 1997 se janë rritur si fetar, 1% më pak se në 1996, por rënie ka pësuar në ndjesinë sesa rehat ndjeheni me fenë. Megjithatë Moghadam nuk citon të gjitha të dhënat ku tregohet se ka rënie të fetarisë tek polakët, që gjithsesi ngelen tepër fetar si popull.

Moghadam tregon se për Evropën juglindore vetëm për katër vende, të përmendur këtu, ka pasur të dhëna, dhe ato tregojnë rritje të përqindjes së atyre që besojnë në Zot dhe e shohin këtë gjë si të rëndësishme dhe ka pasur rënie të atyre që e identifikojnë veten si jofetar dhe ateist.<sup>3</sup>

Në Azinë qendrore dhe Kaukaz, vende si Armenia, Azerbajxhani, Kazakistani, Tashikistani, Turkmenia dhe Uzbekistani, të dhënat tregojnë se të gjitha kanë rigjallërim të qartë të fesë.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Ibid. 23-24.

<sup>2</sup> Me Jugosllavi në atë kohë identifikoheshin shtetet e mbetura në të, si Serbia dhe Mali i Zi, apo dhe Kosova që ishte pjesë e Serbisë në atë kohë.

<sup>3</sup> Ibid. f. 26-27.

<sup>4</sup> Ibid, f.28-29.

Në Afrikë vende si Nigeria dhe Afrika e Jugut, të dhënat tregojnë për një rigjallërim të fesë. Ndërkohë nuk ka të dhëna për vendet e tjera dhe është e vështirë pa to, për të bërë një përgjithësim për kontinentin, thotë Moghadam. Por ai vë në dukje se ka një pajtim të gjerë mes studiuesve se feja në Afrikë ka rritje në realitet edhe pse të dhënat konkrete (anketimi) janë të vështira për t'u siguruar. Ai thotë se është e qartë se Afrika ka përjetuar një bum në drejtim të katolicizmit, pentokostalizmit dhe kishave të krishtere vendase, por në të njëjtën kohë Islami vazhdon të jetë i fortë në shumë pjesë të Afrikës.<sup>1</sup>

Në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e veriut është e paqartë prirja, për shkak të mungesës së të dhënave, por mendohet se ka rigjallërim të fesë, pohon Moghadam. Në këto zona të dhënat mungojnë dhe ka pak të tilla dhe janë të pamjaftueshme për të parë ndryshimet fetare në to. Në mungesë të këtyre të dhënave, Moghadam pohon se, rigjallërimi i fesë në këto zona është pohuar përmes shfaqjes së atyre që janë etiketuar si “fundamentalizmi islamik”, “islami militant”, “islamizmi” etj. Sipas John Esposito-s -pohon Moghadam- rishfaqja e Islamit në vitet 70' qe më e thellë sesa rigjallërimet e mëparshme dhe përfshiu sferën personale dhe private, qoftë në praktikën fetare, qoftë në thellimin e njohurive që lidheshin me Islamit.<sup>2</sup>

Për Azinë e jugut dhe atë juglindore, ky studim nuk e ka pasur të mundur të arrijë në ndonjë konkluzion, për shkak të mungesave të të dhënave, njëlloj si për Afrikën dhe Lindjen e Mesme. Por, sipas disa raportimeve, pohon Moghadam, në disa vende të Azisë jugore janë shfaqur rigjallërim fetar te myslimanët, si p.sh. në Singapor dhe në Indonezi.<sup>3</sup>

Për sa i përket Indisë, duke u nisur nga kriteret që kemi përdorur këtu, pohon Moghadam, të dhënat tregojnë se ka një rënie të moderuar në sjelljen dhe vlerat fetare, dhe kjo duket më qartë, thotë ai, në rënien e pjesëmarrjes në shërbimet fetare, me rreth 16% nga 1990-1997, si dhe në aspekte të tjera, por gjithsesi në 1997 rezultonte se kishte më shumë indianë që mendonin se Zoti është i rëndësishëm në jetë, sesa në 1990 (nga 73,7% në 83,4%).

Në Azinë lindore, Kina rezulton se ka rigjallërim të fesë. Në Japoni është e paqartë, ndërsa në Korenë e Jugut gjendja është statike. Duke u nisur nga dy variabël, që mund të identifikohen, thotë Moghadam, që është ndryshimi në kohë i popullsisë jofetare dhe nga përshtypja për rëndësinë e fesë, mund të gjykohet se feja është në rritje në vendin me popullsinë më të madhe në botë. Sipas WCE jofetarët dhe ateistët kanë rënë në popullsinë kineze që nga vitet 70' nga 59,3% në 50,3% në 2000 dhe parashikohet të bien në 48,1% në 2025. Në të njëjtën kohë rëndësia e fesë është rritur nga 3,6% në 1990 në 14,2% në 1997. Por të dhënat statistikore, pohon Moghadam, paraqesin vështirësi dhe e bëjnë të pamundur për të njohur numrin e saktë të aderuesve fetarë në Kinë. Por pavarësisht këtyre vështirësive, në media dhe shkrime akademike, është raportuar gjerësisht për një rigjallërim fetar në Kinë, dhe këto raportime thonë se ka një numër të madh kinezësh që përqafojnë fenë, në veçanti Krishterimin.<sup>4</sup>

Për sa i përket Koresë së Jugut, Moghadam vëren se WVS dhe WCE nuk japin të dhëna për ndryshime në panoramën fetare të Koresë, por të dhëna të tjera nga media dhe studime

---

<sup>1</sup> Ibid, f. 30-31.

<sup>2</sup> Ibid. f. 33.

<sup>3</sup> Ibid, f. 34.

<sup>4</sup> Ibid. f.35-36.

akademike tregojnë për një rritje të madhe të fetarisë në dekadat e fundit, sidomos të të krishterëve.<sup>1</sup>

Një rritje e fetarisë vihet re edhe në Vietnam, sipas DASH, në raportin për liritë fetare në 2002, thuhet se në këtë vend ka rritje domethënëse të pjesëmarrjes në aktivitet fetare, pohon Moghadam duke cituar këtë raport.<sup>2</sup>

Sipas Moghadam Australia rezulton të ketë rënie, të fetarisë së njerëzve, po kështu edhe në Zelandën e re. P.sh. në Australi besimi në Zot nga 79% në 1981 ka rënë 75% në 1997, po kështu popullsia jofetare dhe ateiste është rritur nga 6,1% në 1970 në 16,2% në 2000, në Australi dhe nga 3,5% në 13,6% në Zelandën e re.<sup>3</sup>

Moghadam pohon se analizat tregojnë se ndryshimi në sjelljen dhe vlerat fetare janë të lidhura në disa raste me zona të caktuara gjeografike. Duke i analizuar vendet nga statusi i zhvillimit, Moghadam vë re se shumica e vendeve të zhvilluara kanë një prirje mbizotëruese të rënies së fesë dhe përjashtim këtu bëjnë disa vende Evropiane dhe veçanërisht SHBA.

Mirëpo, Moghadam nuk vë në dukje faktin se, përtej të dhënave nga ana numerike këto shtete edhe pse janë më pak, vetë ekzistenca e SHBA si përjashtim e bën atë një përjashtim të madh, siç e quante këtë Peter Berger. Kështu që pyetja që shtrohet në këtë rast është, a mund të thuhet se rënia e fetarisë është e lidhur domosdoshmërisht me zhvillimin ekonomik, industrial e shoqëror të një vendi, ndërkohë që SHBA është lideri botëror i vendeve të zhvilluara dhe një nga vendet më të mëdha në botë edhe për nga numri i popullsisë? Apo faktorë të tjerë janë ata që ndikojnë krahas këtyre faktorëve, padyshim të rëndësishëm?

Një tjetër element që Moghadam vë në dukje, edhe pse nuk është pjesë qendrore e studimit të tij, është fenomeni i rritjes së interesit për fenë në perëndim, siç është “shtimi i të dhënit rëndësishëm programeve fetare në televizion; përhapja e librave fetar; rritja e muzikës ungjillore dhe e rokut të krishterë, punësimi i këshilltarëve shpirtëror nga disa kompani (p.sh., Boeing dhe Xerox); dhe përhapja e fesë në internet, shpesh mbështetur nga kapitali sipërmarrës.” Ai vazhdon e thotë se “një numër i madh njerëzish nga vendet e industrializuara janë përfshirë në përvoja fetare dhe forma të ndryshme të New Age - një rritje kjo që ndoshta është një formë përshtirje, sesa një formë e fesë së organizuar.”<sup>4</sup>

Moghadam gjithashtu thotë:

Përpyekja për të pajtuar këto dy tendenca, në dukje të kundërta, të zakonshme në Shtetet e Bashkuara dhe Evropën Perëndimore - rënia e fesë tradicionale nga njëra anë dhe rritja e “spiritualitetit” nga ana tjetër - ka qenë një sfidë e madhe për ata që ndjekin tendencat fetare. Richard Higgins i Boston Globe ofron një shpjegim për këtë rritje të spiritualitetit. Ai shkruan se ka tre arsye kryesore për të: Së pari, ekziston një kërkesë e madhe, si për shkak të “rritjes së mirëfilltë të dëshirës shpirtërore”, por edhe për shkak se tregtarët e produkteve dhe shërbimeve po e shfrytëzojnë këtë dëshirë të zjarrtë. Së dyti, ka një shfaqje të një nocioni më fleksibël të spiritualitetit, që i bën njerëzit të ndjehen më të lirë

<sup>1</sup> Ibid. f.36-38.

<sup>2</sup> Ibid f. F.38.

<sup>3</sup> Ibid, f. 39.

<sup>4</sup> Ibid, f. 58.

për të kapërcyer kufijtë fetarë. Feja është copëzuar, “Shumëzuar, ndër-ngjizur me kulturën pop dhe është ringjallur në forma të reja.” Së treti, ekziston një ide moderne për vetveten, e cila e vë theksin te përvoja dhe kuptimi personal mbi të vërtetat fikse të fesë tradicionale, e cila po rimodelon natyrën e hulumtimit fetar për shumë amerikanë. Ndërsa një theksim i tillë mund t’i japë kuptim të ri traditave antike, ai gjithashtu mbart rrezikun që çdo gjë - si mbajtja e dietës, vënia e muskujve, e lundrimi në internet - të mund të shihen si diçka shpirtërore.<sup>1</sup>

Një tjetër fenomen në lidhje me fenë që përmend Moghadam, që shfaqet më së shumti në shoqëritë post-industriale, është edhe “pluralizmi fetar”. Kjo përfshin atë që njihet si “tregu fetar” që tregon konkurrencën mes feve, “ku ekziston liria e blerësit të zgjedh dhe marrë mes produkteve ideologjike, që fe të ndryshme ofrojnë.”<sup>2</sup> Sipas WCE, pohon Moghadam, në vitin 2000 numri i sekteve nëpër botë e kalonte shifrën e 33820 të tilla, me një mesatare prej 10 sektesh të reja të organizuara çdo javë.<sup>3</sup> Këtu Assaf Moghadam i referohet David Roosen, i cili beson se një nga arsyet e rritjes së asaj që ai e quan “bari i sallatës religjioze” është rënia e autoritetit qendror fetar.<sup>4</sup> Ndërsa Richard Cimino dhe Don Lattin pohojnë se përkundrejt faktit se amerikanët janë fetar, ka rënie të besnikërisë amerikane ndaj një sektit apo tradite të veçantë. Dhe pas kësaj qëndron kërkimi për një besim të përvojës, një fe të zemrës (emocionit) dhe jo të mendjes, një fe që minimizon doktrinën dhe dogmën, dhe ndërkohë kënaqet me përvojën e drejtpërdrejtë të hyjnore.<sup>5</sup>

Moghadam vë në dukje ndër të tjera se prirja drejt rigjallërimit fetar në ish vendet komuniste lidhet qartësisht me kolapsin e Bashkimit Sovjetik, i cili propagandonte dhe impononte zakonisht me forcë shekullarizimin, si standard të politikës së tij shtetërore, në ish vendet e paktit të Varshavës. Duke imponuar ndonjëherë me dhunë një shekullarizëm strikt, thotë Moghadam, kjo “ka hedhur themelet për ringjalljen e tanishme fetare pothuajse në të gjitha vendet që ishin nën ombrellën Komuniste.”<sup>6</sup> Ai citon Rodney Stark që kishte thënë që në 1981 se:

shitetet represive duket se rrisin nivelet e privimit individual dhe, duke vepruar kështu, ndezin impulsin fetar. Duke e bërë besimin më të kushtueshëm, ata gjithashtu e bëjnë atë më të nevojshëm dhe të vlefshëm. Ndoshta feja nuk është kurrë aq e fortë sa kur ajo është një institucion i nëndheshëm.<sup>7</sup>

Ai gjithashtu citon edhe profesorin Harvey Cox, të Havardit, i cili pohon se konkluzioni i tij për fenë është se “ajo që po shohim nuk është as shekullarizim, as e kundërta e tij (rigjallërim i fesë). Përkundrazi, është një transformim interesant i fesë, një seri krijuese dhe vetëpërshtatjeje nga fetë, në kushtet e reja të krijuara nga moderniteti, të cilin disa prej tyre e ndihmuan të lindte.” Sipas profesorit Cox, shekulli XXI do të jetë një shekull “larmie të shumta formash” ku njerëzit

<sup>1</sup> Ibid, f. 58-59, shih dhe Richard Higgins, “Sold on Spirituality,” Boston Globe, Magazine Section, 3 December 2000, 19.

<sup>2</sup> Ibid, shih dhe William H. Swatos, Jr., and Kevin J. Christiano, “Secularization Theory: The Course of a Concept,” *Sociology of Religion* 60.i3 (Fall 1999) Vepër e cituar.

<sup>3</sup> Barrett, et.al., *World Christian Encyclopedia*, 10, siç citohet nga Moghadam në f. 60.

<sup>4</sup> Assaf Moghadam f.60.

<sup>5</sup> Ibid, shih dhe Richard Cimino and Don Lattin, “Choosing my Religion,” *American Demographics*, April 1999, 62. Vepër e cituar.

<sup>6</sup> Moghadam 2003 f. 65.

<sup>7</sup> Rodney Stark, “Must all Religions be Supernatural?” in B. Wilson, ed., *The Social Impact of New Religious Movements* (New York: Rose of Sharon Press, 1981), 175. Siç citohet nga Moghadam 2003 në f. 66.

do të vazhdojnë të vështrojnë te feja për kuptim, por njëkohësisht do të zhvillojnë shumë forma të reja të saj.<sup>1</sup>

Duke përmbyllur Moghadam konstaton se, në rang global ndryshimet në përkatësinë fetare janë të lidhura me rritjen natyrore të popullsisë dhe nga konvertimet, si dhe nga shfaqja e disa prirjeve interesante. Vetë përkatësia fetare nuk tregon ndryshim të fetarisë së njerëzve, por kjo mund të konstatohet duke analizuar sjelljen e tyre dhe ky studim provon se feja është rigjallëruar në realitet në një numër të madh vendesh, ku banojnë shumica e popullsisë së botës, përjashtim nga kjo prirje bëjnë shumica e vendeve post-industriale, me përjashtim të një vendi tepër të rëndësishëm që është SHBA. Por ndërkohë në këto vende duket se krahas rënies së fesë tradicionale dhe fesë së organizuar, kjo është shoqëruar me ngritje të përvojave fetare individuale, përvoja këto që janë quajtur “spiritualitet”.

Duke përmbledhur diskutimin më sipër -thotë Moghadam- “ka prova të mjaftueshme që argumentojnë se ka një “rigjallërim global të fesë” që mund të mbështetet gjerësisht, me përjashtim të dukshëm nga kjo prirje, e vendeve post-industriale, ku megjithatë, prirja drejt shekullarizimit, nuk është e qëndrueshme.”<sup>2</sup>

Pippa Norris dhe Ronald Inglehart, dy autorët e teorisë së *sigurisë ekzistenciale*, kanë një qëndrim më të moderuar duke pohuar se e vërteta qëndron midis atyre që thonë se kemi një rigjallërim global të fesë dhe atyre që pohojnë apo parashikuan të kundërtën. Sipas tyre të dhënat e ekzaminuara globale për një kohë të gjatë, të marra nga World Values Survey, tregojnë se feja realisht është bërë më e rëndësishme në shumë vende, po njëkohësisht ka rënie në shumë vende të tjera.<sup>3</sup> Ashtu si edhe Moghadam ata vënë në dukje se të dhënat tregojnë se vendet me të ardhura më të larta tregojnë rënie të fetarisë, ndërsa vendet e tjera siç janë ato ish komuniste, tregojnë rritje të rëndësisë së fesë në to. Në tabelën grafike që ata paraqesin për të ilustruar këtë konstatim kanë vendosur 49 shtete, duke përdorur vetëm një kriter, atë të se “Sa i rëndësishëm është Zoti në jetën tuaj” Duke paraqitur të dhënat e dy anketimeve ndërmjet viteve 1981-2007, të zhvilluara WVS dhe EVS. Ku nga këto 49 vende, 15 të tilla, paraqesin rënie të rëndësisë së Zotit në jetën e njerëzve, ndërsa 34 të tjerat ngritje të kësaj rëndësie.<sup>4</sup> Lista e vende që ata shqyrtojnë është më pak përfaqësuese se ajo e Moghadam-it, ku dominohet nga vendet evropiane dhe perëndimore me 35 të tilla, 6 vende aziatike, 2 afrikane dhe 6 amerikano latine, ndërkohë mes tyre nuk ka asnjë vend të Lindjes së Mesme, as të Kaukazit dhe rajoneve të tjera. Nisur nga këto të dhëna ata thonë se nuk konstatojnë një rigjallërim universal të fesë, por ky rigjallërim vihet re në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste, ndërsa në vendet me të ardhura të larta, rëndësia e vlerave fetare ka rënie dhe vazhdon të bjerë.<sup>5</sup> Megjithatë, ata duke ia atribuar tendencës së rritjes demografike më të lartë, popullsisive më fetare, pranojnë se “bota në tërësi tani ka më shumë njerëz me pikëpamje fetare tradicionale se kurrë më parë”.<sup>6</sup>

Ajo që mund të arrijmë si konkluzion këtu është se ndoshta faktori më i rëndësishëm në rigjallërimin e fesë në epokën e sotme, është tendenca në rritje e numrit të popullsisë me tradita

<sup>1</sup> Quoted in Bob Harvey, “Religion’s Transformation,” Ottawa Citizen, 26 December 1999, A3, siç citohet nga Moghadam po aty.

<sup>2</sup> Moghadam 2003, f.68.

<sup>3</sup> *Sacred and Secular*, 2012, f. 276.

<sup>4</sup> *Ibid*, f.277.

<sup>5</sup> *Ibid*. f.280.

<sup>6</sup> *Ibid*. f.25.

më të forta fetare, për shkak të lindshmërisë më të lartë, në krahasim me popullsitë më pak ose aspak fetare, që rezultojnë ta kenë lindshmërinë më të ulët. Megjithatë, ky nuk është faktori i vetëm dhe krahas tij dhe të lidhur me të, janë edhe ata kulturor, politik, historik e social. Kështu që vështruar nga një perspektivë përgjithësuese, besimet fetare sot në botë vihet re se kanë një ndikim, të dukshëm ose jo, më të madh se më parë.

## **Kapitulli II: Teoritë e modernizimit mbi fenë**

2.1 *Shekullarizimi* në Sociologjinë Klasike

2.2. Teoritë e *shekullarizimit*

2.3 *Shekullarizimi* në teoritë bashkëkohore

2.4 Qasja e parë: Procesi i modernizimit imponon rënien e fesë

2.5 Kritikkat ndaj teorisë klasike të modernizimit dhe teoritë alternative

2.6 Qasja e dytë: Modernizimi shkakton gjallëri fetare, kështu që shekullarizimi është një proces vetëkufizues

2.7 Qasja e tretë: Modernizimi e transformon fetarinë



## Teoritë e modernizimit mbi fenë

Në këtë kapitull do të paraqesim disa nga pikëpamjet më kryesore që mendimtarë dhe studiues të ndryshëm të shoqërisë, kanë pasur dhe kanë për fenë, të cilat edhe në fushën e ideve e kundërshtojnë apo moderojnë dhe e mbështesin pikëpamjen marksiste mbi fenë.

Siç u përmend edhe më parë studimet teorike në fushën e fesë janë të ndikuara shumë nga qasja e atyre që konsiderohen si klasikët e këtij lëmi të dijes njerëzore. Kështu që këtu jemi të detyruar t'ia nisim me ta.<sup>1</sup>

### 2.1 Shekullarizimi në Sociologjinë Klasike

Teoria e shekullarizimit, si koncept, gjendej e pranishme në mënyrë të nënkuptuar që në fillimet e sociologjisë. Sociologu David Martin vë në dukje se sociologjia ka pasur në fokus të saj çfarë ka ndodhur me fenë gjatë proceseve të modernizimit dhe transformimeve të shpejta që ai shkaktoi. Në thelb, sociologjia e ka përshkuar periudhën e modernitetit, si një skenar në të cilin njerëzimi zhvendoset nga fetarja tek shekullarja.<sup>2</sup>

#### August Komti

August Komti parashihte rënien e fesë tradicionale, me në qendër Zotin, dhe propozonte si alternativë “fenë e njerëzimit”. Kjo ide, është domethënëse, sepse ajo hidhte themelet e teorisë së shekullarizimit në sociologji. Sipas Komtit, procesi i evolucionit të mendjes njerëzore ka kaluar nëpër në tri etapa. Në atë *teologjike, metafizike* dhe në fund në atë *shkencore* apo *pozitiviste*. Duke e

---

<sup>1</sup> Në përmbledhjen e këtij pasqyrimi, i jam referuar si në strukturë edhe në citime më së shumti autorit Germán McKenzie, siç ai do të citohet më poshtë, me përjashtim të rasteve kur i referohem burimeve të tjera apo vetë autorëve që përmenden në tekst.

<sup>2</sup> Germán McKenzie, në *Sophia Studies in Cross-cultural Philosophy of Traditions and Cultures*, volume 20, Springer International Publishing AG 2017, f.4.

cilësuar këtë të fundit si etapën e fitores së arsyes mbi dogmën dhe të menduarin fetar.<sup>1</sup> Etapa këto të cilat ai i lidhte me dijen njerëzore për botën dhe qasjen ndaj saj. Etapa teologjike -sipas tij- karakterizohej nga shpjegimi i dukurive duke u dhënë atyre cilësi antropomorfe, dhe kalon përmes tre fazave: fetishizmi, politeizmi dhe monoteizmi. Në etapën e parë, ndjenjat dhe imagjinata -sipas Komtit- janë mbizotëruese. Në etapën dytë, atë metafizike, perënditë zëvendësohen me entitete ontologjike abstrakte, të cilat Komti i sheh si abstraksione të personifikuara. Pas kësaj arsyeja fillon e bëhet mbizotëruese dhe shfaqen sintezat e mëdha teologjike mesjetare. Në etapën e fundit, pozitiviste ose shkencore, arsyeja dhe vëzhgimi i fakteve bashkohen për të mundësuar studimin racional të dukurive, në mënyrë që të zbulohen ligjet që i administrojnë ato.<sup>2</sup>

Qasja pozitiviste e redukton fokusin e saj në atë që është e vëzhgueshme dhe premtion të jetë e dobishme. Njohuritë që përfitohen në këtë rast nuk janë absolute, por varen nga aftësitë dhe kushtet tona.<sup>3</sup> Si rezultat, çdo pikëpamje fetare në lidhje me të mbinatyrshmen është e destinuar të shfuqizohet nga Rendi Pozitiv.<sup>4</sup>

Sipas mendimit të Komtit, shkenca pozitiviste do të kthehet në dogmën e “fesë së njerëzimit”,<sup>5</sup> e cila nga ana tjetër do të kërkojë një rend moral dhe një praktikë adhurimi, e madje edhe krijimin e një Kisha Pozitiviste me hierarkinë, mësimet dhe katekizmin e saj, sakramentet, kalendarin liturgjik, përkushtimet dhe kërkesat etike, si dhe përmbushjen e ekuilibrit të rolit të shtetit.<sup>6</sup> Pra në thelb, duket se Komti nuk e mohon vlerën dhe rëndësinë e fesë për njerëzit, por ai mendon dhe madje propozon një fe shekulare, e cila do të zëvendësojë fetë tradicionale që e vendosin objektin e tyre të adhurimit përtej botës së dukshme materiale. Duket sikur në thelb edhe ideologjia dhe praktika komuniste marksiste këtë pikëpamje u ofroi njerëzve.

### **Karl Marks**

Idetë e Marksit për fenë burojnë nga shkrimet e teologëve dhe filozofëve të ndryshëm të shekullit XIX, siç ishte Fojebahu.<sup>7</sup> Marksisi ishte i mendimit se feja, tradicionale, që përfshin forcat hyjnore, ishte pranë zhdukjes.<sup>8</sup> Ai promovoi shekullarizimin e shtetit dhe çrrënjësien e fesë, të cilën ai e shihte si një “ideologji” tëhuajsuere që ka punuar për të legjitimuar shfrytëzimin e proletariatit nga pronarët e mjeteve të prodhimit.<sup>9</sup> Kuptimi i tij për fenë është i lidhur ngushtë me pikëpamjen e tij për tëhuajsimin, koncept ky që tregon faktin se njerëzit humbasin përmes fesë vetëkuptimin dhe njohjen e vërtetë të vetvetes.<sup>10</sup> Si pasojë, në themel të tëhuajimit fetar, Marksisi gjen tëhuajsimin ekonomik, që ndodh kur njerëzit nuk i shohin frytet e punës së tyre si një vetë-shprehje, por si një mall që duhet të shitet. Në këtë këndvështrim, feja atëherë, është një iluzion. Marksisi thoshte:

<sup>1</sup> Mcguire, Meredith B. Religjioni konteksti shoqëror, Logos-A, 2007, f.434.

<sup>2</sup> Shih Lewis Coser & Larry Ridener, Teoritë Sociologjike, Botuar nga “Plejad” 2005, f.19.

<sup>3</sup> Germán McKenzie, f.5.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Shih Lewis Coser & Larry Ridener, Teoritë Sociologjike, Botuar nga “Plejad” 2005, f.27.

<sup>6</sup> Germán McKenzie, f.5.

<sup>7</sup> Giddens, Sociologjia, f. 438.

<sup>8</sup> Ibid, f. 440.

<sup>9</sup> Shih “Feja është opium për popullin”, grup autorësh. N.SH. Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë 1964, f. 8, 10.

<sup>10</sup> Germán McKenzie, f.8.

Hegja e fesë nga të qenit lumturi iluzionare e njerëzve, duhet të bëhet për lumturinë e tyre të vërtetë. Kërkesa për të hequr dorë nga iluzionet për shkak të kushtit të tyre është kërkesë për të hequr dorë nga një kusht i cili ka nevojë për iluzione. Kritika ndaj fesë është pra në embrion kritikë ndaj luginës së mjerimit, aureola e së cilës është feja.<sup>1</sup>

Duke qenë se feja është iluzion atëherë, ajo do të zhduket dhe kjo zhdukje nuk është thjesht rezultat i një programi të mirëpërcaktuar të realizuar nga komunistët, por tashmë është gdhendur në rrjedhën e historisë njerëzore, por natyrisht ithtarët e Marksit mendonin se mund ta përshpejtonin atë. Marksi besonte se bashkë me zhdukjen e klasave dhe antagonizmin mes tyre do të zhdukej edhe feja, si formë e trashëguar e ndërgjegjes klasore që i mban klasat e shoqërisë të nënshtruara. Si pasojë, në këndvështrimin e Marksit, shekullarizimi do të ndodhë domosdoshmërisht në të gjitha nivelet e shoqërisë. Dezyrtarizimi i fesë është një domosdoshmëri, pasi “shteti nuk duhet të strukturohet nga feja, por nga arsyeja e lirisë”,<sup>2</sup> të cilën feja nuk mund ta ofrojë.

Në nivelin organizativ, duhet të ndërmerret një veprim i fortë kundër fesë për të treguar natyrën e saj tëhuajsuere, si dhe mënyrat në të cilat ajo i shërben interesave të të pasurve në mbajtjen e *status quo*-së kapitaliste. Sidoqoftë, ky veprim i planifikuar nuk duhet të përqendrohet në ndalimin ose përndjekjen e fesë, e cila vetëm do të forconte ndjenjat fetare. Në të kundërt, një veprim i tillë duhet të përqendrohet në ndryshimin e kushteve sociale në Kapitalizëm, të cilat i japin jetë fesë dhe të tregojë se si shkenca e shoqërisë (Marksizmi) e provon fenë të gabuar: “Refleksi fetar i botës reale mund, në çdo rast, të zhduket përfundimisht vetëm atëherë, kur marrëdhëniet praktike të jetës së përditshme i ofrojnë njeriut vetëm se marrëdhënie plotësisht inteligjente dhe të arsyeshme me sojin e tij dhe natyrën”.<sup>3</sup>

## Max Weber

Weberi përqendrohet në shkrimet e tij për fenë në lidhjen që ka mes saj dhe ndryshimit shoqëror. Weber edhe pse nuk ka folur për “vdekjen e fesë” ai besonte se urbanizimi dhe industrializimi do të ndikonin negativisht mbi fenë. Këto ndryshime do të çonin në “çmagjepsjen e botës” dhe në një botë në të cilën feja nuk do të ketë ndonjë rol në jetën publike. Feja do të bëhej një çështje private dhe nuk mund të mbetej më një burim i padiskutueshëm i autoritetit. Weberi që i mendimit, ndryshe nga Marksi, se feja nuk është domosdoshmërisht një forcë konservatore, por ajo përkundrazi nëpërmjet ideve të saj ka frymëzuar lëvizje që kanë çuar në lëvizje shoqërore dramatike, siç është p.sh. Protestantizmi në lindjen e Kapitalizmit modern.<sup>4</sup> Por megjithatë idealet që dikur përbënin motivin për protestantët e parë reformatorë e kanë humbur tashmë thelbin e tyre religjioz.<sup>5</sup> Weber i referohet procesit të shekullarizimit me termat *intelektualizim*, *racionalizim* dhe *çmagjepsje*.<sup>6</sup> Racionalizimi, për Weberin, duket se është i lidhur në

<sup>1</sup> Works of Karl Marx 1843. A Contribution to the Critique of Hegel's Philosophy of Right <https://www.marxists.org/archive/marx/works/1843/critique-hpr/intro.htm>

<sup>2</sup> Germán McKenzie, f.9.

<sup>3</sup> Ibid, f. 10. Shih gjithashtu “Feja është opium për popullin”, grup autorësh. N.SH. Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë 1964, f. 12-13

<sup>4</sup> Giddens, Sociologjia, f.440.

<sup>5</sup> McGuire, Meredith B. Religjioni konteksti shoqëror, Logos-A, 2007, f.434.

<sup>6</sup> Germán McKenzie, f.5.

mënyrë të pashmangshme me shekullarizimin edhe në nivelin shoqëror. “Tensioni midis fesë dhe njohurive intelektuale padyshim del në pah kudo ku dijet racionale, empirike kanë vepruar vazhdimisht deri në çmagjepsje të botës dhe shndërrimin e saj në një mekanizëm shkakësor”.<sup>1</sup> Pra, për aq kohë sa rriten dijet intelektuale njerëzore dhe bota shpjegohet gjithmonë e më shumë përmes zbulimeve shkencore, shkak-pasojë, aq më shumë nuk ka vend për shpjegimet fetare dhe të mbinatyrshme dhe aq më shumë shoqëria njerëzore shkon drejt shekullarizimit të mëtejshëm. Sipas Weberit, modernizimi i largoi perënditë, sepse racionalizoi kuptimin e botës.<sup>2</sup> Kjo, për Weberin, gjithashtu ka përfshirë edhe procesin me të cilin secila sferë e shoqërisë kuptohet dhe organizohet në sisteme, secila bazuar në ligjet e veta të brendshme. Sa më i madh shekullarizimi i brendshëm i këtyre sferave, aq më i lartë është tensioni i tyre me fenë. Natyra e një tensioni të tillë varet gjithashtu nga karakteristikat e veçanta të secilës traditë fetare.<sup>3</sup>

Weber mendonte se kishte një proces “intelektualizimi”, që po ndodhte në Perëndim. Kjo u përmbush me shkencën moderne, me anë të të cilës kushdo që dëshiron të njohë kushtet e përgjithshme në të cilat ai jeton, mund ta bëjë një gjë të tillë në çdo kohë. “Kjo do të thotë që nuk ka forca misterioze të pallogaritshme që hyjnë në lojë, por përkundrazi dikush, në parim, mund t’i zotërojë të gjitha gjërat duke bërë llogaritë. Kjo do të thotë se bota është çmagjepsur”.<sup>4</sup> Në këtë vështrim, edhe pse si proces i heshtur, racionaliteti instrumental dhe teknologjia e kryejnë punën dhe, në një mënyrë të paqëllimshme, ato e gërryejnë fenë. Një ilustrim i kësaj ideje është Puritanizmi dhe roli i tij në ngritjen e Kapitalizmit. Fakti që motivimi që vinte nga etika fetare u zhduk me kalimin e kohës, dëshmon për Weberin se, “përparimi i qëndrueshëm i procesit karakteristik të “shekullarizimit”, i nënshtrohen në kohët moderne të gjitha fenomenet që buruan nga konceptet fetare”.<sup>5</sup> Pra sa më shumë që një traditë fetare të racionalizojë të menduarit e saj për kuptimin e botës, dhe sa më shumë të jetë e organizuar në mënyrë racionale bashkësia që merret me botën e jashtme, aq më e madhe do të jetë rritja e përthyerjes fetare ndaj “botës tjetër”. “Çdo rritje e racionalizimit në shkencën empirike shtyn gjithnjë e më shumë fenë nga racionalja në hapësirën irracionale; por vetëm sot feja bëhet fuqia mbinjerëzore joracionale ose anti-racionale”.<sup>6</sup> Pra ajo që thotë Weberi, me fjalë të tjera, është se sa më shumë t’i ngushtohet fesë hapësira racionale aq më shumë i mbetet asaj të veprorë vetëm në sferë joracionale madje edhe anti-racionale, kjo padyshim vetëm se mund t’i largojë njerëzit gjithmonë e më shumë prej fesë. Por kjo nuk do të thotë se feja do të zhduket plotësisht, dhe sipas Weberit ajo do të vazhdojë të jetojë vetëm në situata njerëzore vetjake.<sup>7</sup>

## **Emile Durkheim**

Durkheimi e sheh shekullarizimin si një rënie të vazhdueshme në kohë të fesë, që nis me fazën e fundit të epokës mesjetare, dhe vazhdon me përshpejtimin e rënies së saj në Perëndim. Zhvillimi i shoqërive moderne venit ndikimin e fesë, sepse mendimi shkencor gjithmonë e më shumë po zëvendëson shpjegimin fetar dhe ritet fetare zënë vetëm një pjesë të vogël të jetës së individëve. Ai mendonte se feja tradicionale ishte në prag të zhdukjes. Por feja sipas tij feja mund të

---

<sup>1</sup> Ibid. f.6

<sup>2</sup> Shih Lewis Coser & Larry Ridener, Teoritë Sociologjike, Botuar nga “Plejad” 2005, f.159.

<sup>3</sup> Germán McKenzie, f. 6.

<sup>4</sup> Essays in Sociology, Science as Vocation, Publikuar nga Routledge 1991, f.139.

<sup>5</sup> Germán McKenzie, f. 6.

<sup>6</sup> Ibid. f.7

<sup>7</sup> Fjalori Sociologjik, f.104. Botimet IDK.

vazhdojë në një formë të ndryshuar.<sup>1</sup> Ai pohon se feja po përqafon pjesë gjithmonë e më të vogla të jetës shoqërore:

Fillimisht, ajo shtrihej në gjithçka; gjithçka shoqërore ishte fetare - dy fjalët ishin sinonime. Pastaj gradualisht funksionet politike, ekonomike dhe shkencore u shkëputën nga funksionet fetare, duke u bërë entitete të ndara dhe duke marrë gjithnjë e më shumë një karakter të përkohshëm kohor.<sup>2</sup>

Ky proces, sipas Durkheimit, fillon me totemizmin dhe vazhdon me politeizmin dhe monoteizmin, veçanërisht me ndarjen e krishterë midis natyrës dhe të mbinatyrshmes, e cila lejoji shfaqjen e shkencës, dhe nënvlerësimin e jetës rituale, ndërkohë që feja filloi ta vinte theksin tek etika.<sup>3</sup> Si pasojë, feja është tërhequr në mënyrë progresive, ndikimi i saj “është bërë më i përgjithshëm dhe i papërcaktuar, dhe i ka lënë të lirë frerët për forcat njerëzore”.<sup>4</sup> Kjo nënkupton një humbje graduale të kontrollit shoqëror nga ana e feve tradicionale dhe rënie të përdorimit të simbolizmit fetar në jetën shoqërore.<sup>5</sup>

Në lidhje me Perëndimin, Durkheim pretendon se ka pasur një përshtetje të shekullarizimit që nga Rilindja dhe Reforma. Ndër arsyet që ai jep për këtë gjë humbjen e fuqisë së përkohshme të Krishterimit, veçanërisht të Kishës Katolike, e shprehur në ndarjen midis kishës dhe shtetit; fakti që feja është bërë vetë objekt studimi shkencor; pamundësia e krishterimit për të zbatuar rregulla në lidhje me sakrilegjin dhe, përgjithësisht, pamundësia për të kontrolluar jetën e individëve; dhe fakti që në çështjet e së vërtetës, është shkenca ajo që duhet të ndiqet në vend të fesë.<sup>6</sup> Nga të gjitha këto shkaqe, shkenca për të, është padyshim më vendimtarja për rënien e fesë. Pavarësisht kësaj, shkenca nuk do të ndikojë në aspektin ritual të fesë, por vetëm atë njohës:

Që atëherë e këtej, besimi nuk ushtron më po atë epërsi si në të kaluarën mbi sistemin e përfytyrimeve që mund të vazhdojnë të quhen fetare. Përballë tij ngrihet një fuqi rivale që, megjithëse është pjellë e tij, e vë atë në kritikën dhe kontrollin e vet. Dhe gjithçka jep shpresë të parashikohet se ky kontroll vazhdimisht do të zgjerohet vazhdimisht edhe më shumë, do të bëhet më efektiv, dhe nuk do të ketë asnjë mundësi t'i vihet një cak ndikimit të tij të ardhshëm.<sup>7</sup>

Duke pasur parasysh që në këndvështrimin e Durkheimit, paraqitjet fetare, në fund të fundit, janë shprehje të vetë shoqërisë, nuk është e mundur që feja të zhduket. Ndryshimet shoqërore gjithnjë do të sjellin ndryshime fetare. Rënia e disa formave fetare gjithmonë do t'u jepte vend formave të reja.<sup>8</sup> Si rezultat, Durkheim e sheh “fenë e së ardhmes” si diçka që në thelb do të ishte racionale, duke mirëpritur lirinë e mendimit, duke promovuar adhurimin në çfarëdo mënyre që individit të ndihet i qetë, dhe shekullar në pamje. Kjo pikë e fundit do të thotë që “feja e së ardhmes” do të shpreh unitetin e shoqërisë, vlerat më të shenjta të saj; që zhvillon tubime rituale

<sup>1</sup> Sociologjia, Giddens, f.440.

<sup>2</sup> Emile Durkheim, The division of labour in society, Botimi i Dytë, botuar nga Palgrave Macmillan, 2013, f.132.

<sup>3</sup> Germán McKenzie, f. 7.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Ibid.

<sup>7</sup> Emile Durkheim, Format elementare të jetës fetare, Botimet “Korbi” 2000, f.339.

<sup>8</sup> Shih Shih Lewis Coser & Larry Ridener, Teoritë Sociologjike, Botuar nga “Plejad” 2005, f.103.

periodike, që i referohet njohurive “objektive” të shoqërisë dhe ka drejtësinë sociale si shqetësim kryesor të saj.<sup>1</sup>

## 2.2. Teoritë e shekullarizimit

Teori të ndryshme janë zhvilluar për t'i dhënë përgjigje ndryshimeve fetare në nivelin individual, shoqëror dhe institucional të shoqërive moderne.

Teoria e shekullarizimit është njëra nga qasjet e rëndësishme dhe mbizotëruese për shumë vjet në këtë drejtim. Shekullarizimi është ai proces në të cilin, në veçanti në shoqëritë moderne industriale, besimet, praktikat dhe institucionet fetare humbasin rëndësinë e tyre të dikurshme.<sup>2</sup> Studime të ndryshme që nga vitet 60', e kanë parë këtë proces rënie si të bashkëlidhur me modernizimin e kulturës dhe industrializimin e shoqërisë. Ndër mbështetësit më të rëndësishëm të kësaj pikëpamje kanë qenë sociologët Thomas Luckman, Steve Bruce, Bryan Wilson dhe Peter Berger, në qëndrimin e tij të parë etj.

Në vitet 90' del në skenë një tjetër teori, që propozon një qasje krejt të ndryshme ndaj pasojave të modernizimit të shoqërive. Studiues si Roger Finke dhe Rodney Stark janë disa nga mbështetësit më të rëndësishëm të kësaj teorie. Kjo teori mbështet në “Teorinë e zgjedhjes racionale” e zbatuar në qasjen ndaj fesë. Kjo qasje i jep një kuptim të ri rolit që luan pluralizmi fetar modern në gjallërinë fetare, duke e parë pluralizmin si inkurajues të gjallërisë fetare, në kundërshtim me qasjen e parë që thotë se “pluraliteti dhe natyra fragmentare e lëvizjeve të reja fetare... përbëjnë faktikisht një provë të humbjes së autoritetit social” të institucioneve fetare.<sup>3</sup> Kjo qasje mbështet nga studiues të shumtë, dhe ka nga ata që e kanë aplikuar atë edhe në rastin e rigjallërimit të fesë në ish-vendet komuniste.<sup>4</sup>

Studiues të tjerë si David Martin dhe Jose Casanova apo edhe Pippa Norris dhe Ronald Inglehart, kanë të tjera qasje, që janë rishikime dhe përmirësime të qasjes së parë.

Pra kemi tre qasje të ndryshme. E para, që mund të quhet klasike, që pohon se procesi i modernizimit dobëson në mënyrë të pashmangshme fenë dhe e margjinalizon atë, në të kundërt, qasja e dytë, ajo e zgjedhjes racionale që e sheh modernizimin si nxitës të gjallërisë fetare, për shkak se krijon një “treg të lirë fetar” në të cilin bashkësitë dhe organizatat fetare konkurrojnë me njëra-tjetrën. Ndërkohë qasja e tretë mban një pozicion të ndryshëm, duke kritikuar të parën, apo përmirësuar atë, por pa mbështetur të dytën. Mbështetësit e qasjes së fundit kanë pikëpamje të ndryshme, por ata bien dakord se modernizimi shkakton ndryshime domethënëse të fetarisë, por jo domosdoshmërisht çon pashmangshëm në rënie apo rigjallërim të fesë. Më poshtë do të bëjmë një pasqyrim më të detajuar për disa nga këto qasje dhe autorë.

## Shekullarizimi në teoritë bashkëkohore

<sup>1</sup> Germán McKenzie, f.8 shih dhe Giddens, Sociologjia, f. 440.

<sup>2</sup> Fjalor Sociologjik, Oksford, f. 415.

<sup>3</sup> Ibid, f. 415-416.

<sup>4</sup> Shih p.sh. Paul Froese, Hungary for Religion: A Supply-Side Interpretation of the Hungarian Religious Revival. Në Journal for the scientific study of religion, Vol. 40, No. 2 (Jun., 2001), f. 251-268.



### 2.3 Qasja e parë: Procesi i modernizimit imponon rënien e fesë

Kjo qasje, në thelb, pohon se, ndryshimet shoqërore që ndodhën në Perëndim me modernizimin rrënuan në përgjithësi besimet, praktikat, institucionet dhe funksionet që kryen feja në shoqëri. Edhe kur disa nga studiuesit që mbështesin këtë mendim, pranojnë në teori, se shekullarizimi mund të jetë një proces i kthyesëm, ata pohojnë se diçka e tillë nuk ka shumë të ngjarë të ndodhë.

Teza e lidhjes mes modernizimit dhe rënies së fesë mbështetet nga tre arsytetime:

1. Përparimi shkencor e teknik do të ndryshojë për njerëzit përfytyrimin që ata kanë për botën, ai do të mund ta shpjegojë atë tërësisht në mënyrë shkakësore materiale, duke shmangur kështu nevojën për shpjegime fetare apo metafizike. Kështu bota në sytë e njerëzve do humbasë magjinë dhe misterin e saj të dikurshëm, që shihej si një produkt i forcave të mbinatyrshme, ose duke e shprehur me fjalët e Weberit “çmagjepsur” atë në sytë e njerëzve, duke e kthyer kështu qendrën e vëmendjes nga hyji te njeriu, që do të jetë burimi i këtij ndryshimi.

2. Rënia e ndikimit social të institucioneve fetare. “Në rrjedhën e ndarjeve funksionale të nënsistemeve shoqërore, kishat dhe bashkësitë fetare e humbasin ndikimin në drejtësi, politikë dhe mirëqenien shoqërore, në kulturë, arsim dhe shkencë; ato vetëkufizohen në funksionin e tyre të mirëfilltë të administrimit të vlerave të shenjta, të cilat e bëjnë ushtrimin e fesë një çështje pak a shumë private duke humbur në përgjithësi peshën e tyre shoqërore.”<sup>1</sup>

3. Rritja e sigurisë ekzistenciale dhe e mirëqenies që prodhoi modernizimi janë faktori i tretë drejt shekullarizimit. “Zhvillimi i shoqërive nga agrare në industriale dhe postindustriale ka sjellë si pasojë një nivel më të lartë mirëqenieje dhe rritje të sigurisë shoqërore; me lehtësimin e barrës së rreziqeve jetësore dhe me rritjen e sigurisë ekzistenciale, për individin zhduket edhe nevoja për një praktikë e cila premtonte mposhtjen e pasigurive të pakontrollueshme nëpërmjet komunikimit me një fuqi “të përtejme”, përkatësisht kozmike.”<sup>2</sup>

*Steve Bruce*

Sociologu britanik Steve Bruce, është ndër ata studiues që është marrë më së shumti me këtë temë dhe ka mbrojtur me forcë këtë qasje dhe ka bërë edhe trajtimin më të gjerë dhe më përmbledhës të kësaj teorie. Sipas Bruce: Paradigma e shekullarizimit synon të shpjegojë ndryshimin e madh që ka ndodhur në strukturën shoqërore dhe në kulturë: zhvendosjen e fesë nga qendra e jetës njerëzore.<sup>3</sup> Në mënyrë të përmbledhur Bruce pohon se shekullarizimi përfshin:

- rrënimin e institucioneve fetare;
- zëvendësimin e sjelljes, rregullave dhe parimeve fetare me kërkesa që përputhen me kritere strikte teknike;
- sekuestrimi i pronësisë dhe shërbimeve fetare nga fuqitë politike;

<sup>1</sup> Jürgen Habermas, Dialektika e sekularizimit, bot. ISHM & IDK, fq. 9

<sup>2</sup> Ibid.

<sup>3</sup> Steve Bruce, Secularization, In Defence of an Unfashionable Theory, Oxford University Press Inc., New York, 2011, f.1

- zëvendësimin e vetëdijes së veçantë fetare (e cila mund të variojë nga varësia tek magjitë, ritet, hajmalitë ose lutjet, deri te shqetësimi etik i frymëzuar gjerësisht nga ana shpirtërore) me orientimin empirik, racional dhe instrumental;
- zhvendosjen nga kontrolli fetar në atë shekullar të një larmie aktiviteteve dhe funksioneve shoqërore;
- zvogëlimin e kohës, energjisë dhe burimeve që njerëzit i kushtojnë çështjeve të mbinatyrshe.<sup>1</sup>

Bruce i lidh të gjitha këto me shfaqjen e protestantizmit duke paraqitur këtë skemë kronologjike shkakësore sesi ka ndodhur shekullarizimi në tre ndarje:

(1) Në nivelin racional, besimi monoteist u zëvendësua nga racionaliteti, i cili u shndërrua në shkencë dhe teknologji. Kjo nuk do të thotë që arsyeja dhe feja ishin reciprokisht përjashtuese, por mënyrat natyraliste mbizotëruan të menduarit për botën.

(2) Në nivelin social dhe ekonomik, etika protestante nxiste kapitalizmin industrial dhe rritjen ekonomike. Këta faktorë nga ana e tyre krijuan “diferencim strukturor” (në kuptimin e prishjes së jetës shoqërore në sfera të ndryshme dhe autonome të qeverisura nga arsyeja instrumentale) dhe “diferencim shoqëror” (domethënë që klasa të ndryshme shoqërore dhe lëvizja e tyre solli copëzimin e koncepteve komunitare të urdhrave morale dhe të mbinatyrshe). Në këtë mënyrë, u shfaq pluralizmi fetar dhe egalitarizmi, duke çuar në relativizëm dhe privatizim të besimit.

(3) Në nivelin e institucioneve fetare, prirja kaloi nga individualizmi protestant në një prirje drejt skizmës, duke çuar te fenomenet e sekteve dhe duke e vënë theksin te fakti i pjesëmarrjes vullnetare sesa tek ajo me anëtarësim.

Të gjithë faktorët e përmendur shihen si shkaqe të ndërmjetme ose të menjëhershme të shekullarizimit. Por, Bruce thekson se, secila prej tyre nuk është e mjaftueshme vetvetiu, por kërkon veprimin e të tjerave, dhe se ato nuk janë domosdoshmërisht të pacenueshme, që pasi të vijë pasojat e tyre në jetë, ato vazhdojnë më vete dhe të mbeten të varur nga faktori që i nisi ato.




Figure 2.1. The secularization paradigm

<sup>1</sup> Ibid, f.2



Sipas Bruce, faktorët më të fuqishëm shekullarizues janë pluralizmi fetar, privatizimi dhe relativizmi, të cilët ai i sheh të lidhur ngushtë së bashku.<sup>1</sup>

Sipas Bruce shekullarizimi nuk është universal dhe i pashmangshëm, dhe nuk ndjek një rrugë evolucionare çliruese, edhe procesi nuk është kusht të ketë një trajektore të njëtrajtshme, dhe përfundimi nuk është detyrimisht ateizmi. Sidoqoftë, ai mendon se procesi i shekullarizimit, i nisur dikur, është i pakthyeshëm dhe çon në marginalizimin e fesë.<sup>2</sup>

## **Kritikat ndaj teorisë klasike të modernizimit dhe teoritë alternative**

### **2.4 Qasja e dytë: Modernizimi shkakton gjallëri fetare, kështu që shekullarizimi është një proces vetë-kufizues**

Studiuesit më të njohur të kësaj qasjeje janë Rodney Stark, Roger Finke, William S. Bainbridge dhe Lawrence Iannacone.<sup>3</sup> Ata kanë kritikuar modelin e mësipërm dhe kanë ngritur ndaj tij kritikak e mëposhtme:

-Nuk ka përputhje mes pretendimeve të qasjes së shekullarizimit dhe fakteve. Kjo është e vërtetë si për Shtetet e Bashkuara, ku anëtarësimi në kisha është rritur, por edhe në Evropë, në të cilën nivelet e fetarizmit subjektiv mbeten të larta.

- Ekziston një lloj “miti” në lidhje me devotshmërinë fetare të së kaluarës në Evropë, i cili pretendohet të ketë qenë i lartë, por kjo nuk është e saktë.

-Ekziston një ndjenjë e fortë e fetarizmit subjektiv edhe në vendet ku pjesëmarrja në ritet fetare është e ulët.

- Në mesin e shkencëtarëve, ku mendohet se ekziston një konflikt midis fesë dhe shkencës, nuk ka pasur rënie të besimit në një afat të gjatë kohor.

- Në vendet e ish-blokut komunist ka pasur një rigjallërim fetar.

- Islami dhe fetë aziatike kanë demonstruar aftësi për të bashkëjetuar me modernizimin.

Sipas këtyre studiuesve teoritë e shekullarizimit janë një produkt i mendimit dëshiror.<sup>4</sup>

Këta autorë kanë propozuar një qasje alternative ndaj shekullarizimit. Të frymëzuar nga puna e ekonomistit amerikan Gary Becker, i cili aplikoi analizën ekonomike në sferat e tjera të shkencave shoqërore, duke iu qasur kështu fesë në mënyrë të ngjashme. Këta studiues mbështesin atë që njihet si “teoria e zgjedhjes racionale” ose si qasja e “ekonomisë së tregut” për fenë. Brenda këtij kuadri, këta studiues kanë formuluar një teori të përgjithshme të fesë.<sup>5</sup> Sipas

---

<sup>1</sup> Germán McKenzie, f.11.

<sup>2</sup> Ibid, f. 12.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Ibid. f. 16

<sup>5</sup> Ibid.

këtij këndvështrimi, feja është duke lulëzuar në këtë kohë. Përzgjedhja e fetarisë është një fenomen racional, sepse ajo i përgjigjet analizës së kostos dhe përfitimit nga ana e individëve. Kjo qasje merr për të mirëqenë faktin se kërkesa e publikut për fenë është relativisht konstante ndërkohë që aktiviteti fetar luhetet me nivelin e konkurrimit religjioz dhe ofertës. Hipoteza e Starkut dhe Iannaccone thotë se, shteti ka rolin madhor në përcaktimin e nivelit të konkurrimit fetar, nëpërmjet subvencionimit të institucioneve fetare të favorizuara dhe në disa raste, thjesht duke shtypur grupe të padëshiruara fetare. Teoria e kërkesë-ofertës religjioze vendos një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet konkurrimit religjioz dhe niveleve të fetarisë.<sup>1</sup>

Studiuesit e zgjedhjes racionale pohojnë se feja forcohet nga pluralizmi fetar dhe pëson ndryshime që nuk nënkuptojnë rënien e saj.<sup>2</sup> Teoricienët e të kësaj teorie i identifikojnë institucionet fetare si “ofertë dhënësit” në “tregun fetar”, ndërsa individët si “kërkuesit” e këtij shërbimi. Kërkimi racional për “shpërblime të botës tjetër” lidhet vazhdimisht me ekuacionin e kërkesë/ofertës.<sup>3</sup> Nëse ka rënie të fetarisë, kjo duhet t’i faturohet rrënjëve organizative të institucioneve fetare ose shoqërore, sipas kësaj qasjeje. Në këtë dritë, çdo proces i shekullarizimit shihet si një proces “vetë-kufizues”, i karakterizuar nga një llogaritje e kostos dhe përfitimit. Sipas kësaj teorie ndikimi i shkencës i sfidon fetë në një mënyrë në të cilën ato janë të detyruara të filtrojnë doktrinat, ritet dhe doket e tyre nga të gjitha ato elemente që tani mund të interpretohen në një mënyrë thjesht natyraliste. Kjo quhet “shekullarizim i brendshëm”. Në këtë mënyrë, një numër i shërbimeve apo shpërblimeve shpirtërore që dikur ofroheshin apo propagandoheshin nga institucionet fetare zhduken. Sidoqoftë, përfitimet e botës tjetër gjenden përtej fushëveprimit të shkencës, kështu që ato mbeten si pjesë e fesë dhe kërkohen shumë nga njerëzit. Të mirat e tjera shpirtërore, të tilla si siguria në jetë dhe ngushëllimi për vuajtjet, gjithashtu mbeten tërheqëse në hapësirën e fesë për njerëzit. Në këtë mënyrë, institucionet fetare që i ofrojnë ato konkurrojnë në tregun fetar shumë më tepër, sesa ato institucione fetare që kanë kaluar një rrugë të gjatë në shekullarizimin e tyre të brendshëm. Kjo gjendje provokon lëvizje ripërtëritjeje brenda vetë këtyre institucioneve që janë në proces vetë-shekullarizimi, dhe kanë për qëllim rigjallërimin e tyre. Kjo gjithashtu nxit shfaqjen e organizmave fetare të reja, që krijojnë forma fetare novatore. Vetë-shekullarizimi vë në lëvizje institucionet fetare, qoftë për të mos humbur gjallërinë e vetë, qoftë duke nxitur indirekt të tjerët jashtë saj. Kjo dinamikë është e vazhdueshme, kështu që shekullarizimi mbahet gjithnjë midis kufijve, duke e shndërruar atë në një realitet vetë-kufizues.<sup>4</sup> Një nga argumentet më kundërshtuese në këtë teori, në lidhje me qasjen e parë, është se pluralizmi fetar shihet se promovon konkurrencën fetare midis organizatave fetare brenda “tregut fetar”, dhe jo rënien, siç pretendon qasja shekullarizuese.<sup>5</sup>

## 2.5 Qasja e tretë: Modernizimi e transformon fetarinë

Studiuesit e këtij grupi, edhe pse të ndryshëm në pikëpamjet e tyre, të gjithë ndajnë bindjen se shekullarizimi ka të bëjë me transformimin e fetarisë. Në vijim, po paraqesim shkurtimisht disa prej tyre.

---

<sup>1</sup> Philip S. Gorski & Ateş Altınordu, *After Secularization*, *Burimi: Annual Review of Sociology*, Vol. 34 (2008), f. 55-85

<sup>2</sup> Germán McKenzie, f.16.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Ibid.

*Thomas Luckmann*

Studiuesi gjerman Luckman pikëpamjen e tij për shekullarizimin e shpreh në librin e tij “The Invisible Religion”. Ai kritikon konfuzionin që bëhet mes institucionit fetar (kishës) dhe fesë, veçanërisht në Perëndim, një konfuzion ky që shoqërohet me një kuptim shumë të ngushtë të institucioneve sociale, dhe nga paragjykimi pozitivist - ku feja shihet si një etapë primitive në evolucionin e arsyes njerëzore dhe që do të zëvendësohet në të ardhmen nga shkencat.<sup>1</sup>

Luckmann thotë se “në mungesë të një teorie të bazuar, shekullarizimi është konsideruar në mënyrë tipike si një proces i patologjisë fetare që matet me tkurrjen e kishave. Meqenëse boshllëku institucional nuk po mbushet nga një kundër-kishë - e cila ishte parashikuar nga Komti - dikush nxjerr përfundime me lehtësi se shoqëria moderne është jofetare”.<sup>2</sup>

Luckmann pyet se me çfarë është zëvendësuar në shoqërinë moderne roli që feja kryente dikur?

Sipas Luckmann feja vazhdon të jetë një tipar i rëndësishëm i shoqërisë moderne, por që nuk duhet interpretuar ngushtë si praktikë e të shkuarit në kishë. Feja përfshin përfitimin e kuptimit, që shfaqet objektivisht në kulturë, prandaj dhe e kapërcen përjetimin e drejtpërdrejtë.<sup>3</sup>

Luckmann e sheh shekullarizimin si një proces ku modernizimi e ka transformuar fetarinë, ku funksioni që feja-kishë ka luajtur në të kaluarën, duke i dhënë kuptim jetës së individit dhe gjithë strukturës shoqërore, tani kryhet nga një aktor i ndryshëm, që ai e quan “feja e padukshme”. Feja e padukshme, për Luckman, karakterizohet nga natyra e saj private, dhe jetohej nga një individ autonom, që në botën e tij të shenjtë ai pleks një fe “të vjetër” në rënie, me burime të tjera. Pavarësia individuale, vetë-shprehja, vetë-realizimi, një etikë e ndryshueshme, e kuptuar si ngjitje e shkallëve shoqërore, çlirimi i seksualitetit nga kontrolli shoqëror dhe nga familja, bëhen, sipas mendimit të Luckmann, temat më të përhapura moderne fetare.<sup>4</sup> Në këtë këndvështrim, industrializimi dhe urbanizimi, apo edhe shfaqja e ideologjive armiqësore ndaj fesë dhe dalja në skenë e sistemeve vlerore të ndryshme, siç është shkencizmi nuk janë shkaqet e vetme të shekullarizimit.<sup>5</sup> Sipas Luckman efekti i industrializimit dhe shekullarizimit është jo i drejtpërdrejtë. “Me pak fjalë, rënia e fesë tradicionale të kishës mund të shihet si pasojë e tkurrjes së rëndësishme së vlerave, të institucionalizuara në fenë e kishës, në integrimin dhe legjitimimin e jetës së përditshme të shoqërisë moderne”.<sup>6</sup>

*David Martin*

Martin pohon se shekullarizimi është një proces i diferencuar që ndodh në Perëndim dhe në zonat me ndikim perëndimor (të tilla si Australia dhe Zelanda e Re). Martin e sheh shekullarizimin si një proces të përbërë nga histori të ndryshme, në varësi të natyrës specifike të shoqërisë në të cilën zhvillohet. Për Martin shekullarizimi është një proces i rënies fetare në

---

<sup>1</sup> Ibid. f.17.

<sup>2</sup> Ibid, f.17.

<sup>3</sup> Fjalor Sociologjik, Botimet IDK, f.103.

<sup>4</sup> Germán McKenzie f.18.

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Ibid

nivelin shoqëror, që kryesisht nxitet nga diferencimi shoqëror.<sup>1</sup> Në këtë vështrim, shekullarizimi në Perëndim vjen për shkak të rritjes së autonomisë së sferave të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. Konteksti gjeografik i analizës së tij e detyron atë të përqendrohet te krishterimi. Në analizën e tij, Martin shfrytëzon një numër burimesh empirike për të krijuar “filtra historikë” që shërbejnë për të analizuar shekullarizimin në mënyra të ndryshme. Më të rëndësishmet nga këto “filtra” janë: Evropa Veriore Protestante, Amerika Veriore Protestante, Evropa Latine (Evropa Perëndimore që shpreh një vitalitet katolik), dhe Amerika Latine.<sup>2</sup> Në secilën prej këtyre rasteve, ai kryen një analizë të bazuar në një numër çelësash interpretues: ndryshimet midis monopoleve fetare dhe pluralizmit konkurrues; marrëdhëniet midis kishave dhe partive politike; marrëdhëniet midis fesë dhe shoqatave vullnetare; dhe dinamika e qendrës dhe e periferisë që shkon në mënyrë tërthore në elementet e lartpërmendura. Konceptet e tjera interpretuese janë lidhja e mundshme midis identitetit kulturor dhe fesë, veçanërisht në rastet e shtypjes së jashtme ose pakicave të rëndësishme kulturore; veprimi i industrializimit në gërryerjen e lidhjeve ndër njerëzore dhe shkalla në të cilën individët i rezistojnë kësaj duke kërkuar riintegrim përmes familjes dhe kishës; ndikimi homogjenizues i mediave masive në shoqëri së bashku me komunikimin e tyre të vlerave të komoditetit dhe konsumatorizmit; dhe ndikimin e etikës kalviniste dhe idealeve iluministe në kulturë.<sup>3</sup>

Si pasojë e kësaj qasjeje, Martin jep një përshkrim të larmishëm dhe të ndërlikuar të ndryshimeve fetare në zona të ndryshme gjeografike, duke shpjeguar pse në shumë raste ka një rënie dhe pse, në disa të tjera, feja akoma mbahet në këmbë apo lulëzon.<sup>4</sup> Ai nuk e sheh shekullarizimin si një trend afatgjatë, as si diçka që çon në mënyrë të pashmangshme në një situatë në të cilën feja është e parëndësishme. Ndryshimet nuk janë mekanike dhe pasojat e procesit të diferencimit në një kontekst kulturor mund të nënkuptojnë gjëra shumë të ndryshme për fenë. Për shembull, në disa zona, pluralizmi fetar do të provokonte rënie fetare, ndërsa në të tjera, kjo do të shkaktonte ringjallje fetare.<sup>5</sup>

*Peter Berger*

Berger në qasjen e dytë të tij për shekullarizimin thotë se “supozimi se ne jetojmë në një botë të shekullarizuar është i rremë”.<sup>6</sup> Që modernizimi ka pasur efekte shekullarizuese është e vërtetë, por gjithashtu ka shkaktuar lëvizje të forta të kundër-shekullarizimit. Ndërsa në nivelin organizativ disa fe mund të kenë humbur fuqinë dhe ndikimin, por organizma të reja fetare janë shfaqur. Edhe ato organizata fetare që janë zvogëluar në anëtarësi ende kanë luajtur role të rëndësishme sociale dhe politike. Nga ana e saj, fetaria individuale, në mënyrën e besimeve të vjetra dhe të reja, vazhdon të jetoj dhe madje të lulëzojë. Ripërkufizimi i rolit të fesë në shoqëri ndonjëherë ka evoluar në formën e revolucioneve fetare, por më shpesh atë të këmbënguljes së një nënkulture fetare të caktuar.<sup>7</sup>

---

<sup>1</sup> Ibid.

<sup>2</sup> Ibid.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> The Desecularization of the world, Publikuar nga Ethics and Public Policy Center, Washington D.C. 1999, F.2.

<sup>7</sup> Ibid, f. 3-4.

Berger pranon se teoria e shekullarizimit ka funksionuar për vendet e Evropës perëndimore të industrializuara, por kjo nuk mund të përgjithësohet jo vetëm për pjesën tjetër të perëndimit, siç është SHBA, por as për pjesën tjetër të botës, e cila rezulton të mos jetë shekullare. Amerika thotë ai, nuk është një përjashtim i madh, siç e kanë trajtuar teoricienët e shekullarizimit, por Evropa perëndimore është përjashtim. Ndërkohë që pjesa më e madhe e botës vazhdon që shoqëritë e tyre të mos jenë shekullare. Sipas Bergerit, feja në pjesë të Evropës perëndimore ka rënë sepse, feja në to ka qenë monopol i kishave shtetërore, për rrjedhojë dhe nuk ka pasur konkurrencë të lirë në tregun e “kërkesë/ofertës fetare” dhe kjo ka sjellë rënie të fetarisë. Pra sipas tij, kjo është edhe arsyeja pse në Evropë shohim të tilla fenomene si ndjekja e besimet të reja ekzotike lindore, apo ato që përfshihen nga lëvizja New Age. Ndërkohë Berger tërheq vëmendjen, se përveç Islamit, që ka pësuar një rigjallërim të dukshëm në botën myslimane, ka edhe një lëvizje tjetër, më pak të njohur, por reale, ajo në botën hispanike, që është pentokonstalizmi i krishterë. Berger e cilëson rigjallërimin e fesë, apo siç e quan ai “deshekullarizim” si lëvizje anti-elitë, për shkak se elita kulturore dhe politike ka qenë ajo që e ka udhëhequr shekullarizimin e shoqërisë. Berger pohon se ne jetojmë në një botë pluraliste fetare.<sup>1</sup>

*Jose Casanova*

Studiesi spanjoll Casanova, e pranon se diferencimi social, shpie drejt shekullarizimit, në kuptimin klasik të ndarjes së shtetit dhe institucioneve të ndryshme të shoqërisë nga kisha, por ai kritikon dy idetë e tjera, që kontestohen nga provat empirike, ato janë: shekullarizimi si rënie e fetarisë dhe praktikave fetare në shoqërinë moderne, dhe privatizimi i fesë, të dyja të kuptuara si një trend i përgjithshëm historik modern.<sup>2</sup>

Ai pohon se ekzistojnë modele të shumta të shekullarizimit dhe të modernizimit në perëndim, dhe ato janë të lidhura rrënjësisht me dallimet historike të ndarjeve dhe kishave të ndryshme të krishterimit.<sup>3</sup> Kjo është një konceptim më adekuat dhe një pamësi më pragmatike e prirjeve moderne globale, sesa kozmopolitizmi shekullar apo përplasja e qytetërimeve, thotë ai.<sup>4</sup> Ai pohon gjithashtu se që në vitet 60' një shumicë e popullsisë evropiane ka ndërprerë pjesëmarrjen e tyre të rregullt në praktikën fetare tradicionale, por ata kanë ruajtur ende nivele relativisht të larta të besimeve private fetare, duke u karakterizuar kështu nga ajo që quhet “besim pa përkatësi”.<sup>5</sup> Dhe pyetjes se pse evropianët, pasi kanë humbur besimin te kishat e tyre kombëtare, nuk shqetësohen të kërkojnë një fe alternative? Ai i përgjigjet, sepse evropianët vazhdojnë të jenë anëtarë të nënkuptuar të kishave të tyre kombëtare, edhe pasi i kanë braktisur qartë ato. “Kishat kombëtare mbeten atje si një e mirë publike në të cilën ata kanë qasje të drejtpërdrejtë, kur vjen koha për të festuar ritet transcendentë të kalimit, lindjes dhe vdekjes. Është kjo situatë e veçantë

---

<sup>1</sup> Peter Berger on the failure of the secularization hypothesis, shih <https://www.youtube.com/watch?v=62zSU-U9GGE>

<sup>2</sup> Rethinking Secularization: A Global Comparative Perspective, January 2006. <https://www.researchgate.net/publication/265540966>

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Ibid.

që shpjegon mungesën e kërkesës dhe mungesën e një tregu fetar me të vërtetë konkurrues në Evropë.”<sup>1</sup>

Casanova duke kritikuar qasjen shekullarizuese thotë:

Në të vërtetë çështja më interesante sociologjikisht nuk është fakti i rënies progresive fetare midis popullatës evropiane që nga vitet 1950, por fakti që kjo rënie interpretohet përmes lenteve të paradigmes së shekullarizimit dhe prandaj shoqërohet nga një vetëkuptim “shekullarist” që e interpreton rënien si “normale” dhe “progresive” - kjo do të thotë, si një pasojë pothuajse normative e të qenit evropian “modern” dhe “i ndriçuar”. Shekullarizimi i shoqërive të Evropës Perëndimore mund të shpjegohet më mirë në terma të triumfit të regjimit të dijes së shekullarizimit, sesa në aspektin e proceseve strukturore të zhvillimit socio-ekonomik. Ndryshimet e brendshme brenda Evropës, për më tepër, mund të shpjegohen më mirë në drejtim të modeleve historike të marrëdhënieve kishë-shtet dhe kishë-komb, si dhe në terma të ndryshme drejtimesh të shekullarizimit mes degëve të ndryshme të krishterimit, sesa në termat e niveleve të modernizimit.<sup>2</sup>

Pyetjes: A ka rënie, rigjallërim apo transformimi të fesë sot? Ai i përgjigjet se për fenë, nuk ka asnjë rregull global. Të gjitha fetë botërore po transformohen rrënjësisht sot, nga ajo që kanë qenë dikur gjatë epokës së kolonializimit evropian, nga proceset e modernizimit dhe globalizimit. Por ato po transformohen në mënyra të ndryshme dhe të shumfishta.<sup>3</sup>

Pyetjes: A kemi privatizim të fesë, deprivatizim të saj apo të dyja? Ai i përgjigjet se nuk ka gjasa që regjimet autoritare moderne apo sistemet moderne demokratike liberale të dëshmojnë përfundimisht se janë të suksesshme në dëbimin e fesë në sferën private. Regjimet autoritare, mundet të jenë përkohësisht të suksesshme, përmes masave shtypëse në zbatimin e privatizimit të fesë. Ndërsa, regjimet demokratike vështirë ta bëjnë këtë, vetëm nëse përdorin tiraninë e një shumice laike mbi pakicat fetare, siç bën Franca, që ndalon “simbolet e dukshme fetare” në sferën publike, sepse i sheh ato si një kërcënim për sistemin kombëtar laik të saj.<sup>4</sup>

*Ronald Inglehart dhe Pippa Norris*

Studiuesit, Ronald Inglehart dhe Pippa Norris, në librin e tyre “Sacred and Secular”<sup>5</sup> kanë zhvilluar një teori alternative të shpjegimit të fetarisë së lartë dhe të ulët. Ky libër zhvillon teorinë e “sigurisë ekzistenciale”. Libri zhvillon dhe rivlerëson teorinë e shekullarizimit. Ai e përkufizon fenë në rënie, jo përmes racionalizimit ose diferencimit, por përmes zhvillimit të “sigurisë ekzistenciale” që sjell modernizimi dhe zhvillimi njerëzor. Argumenti qendror i tyre thotë se,

---

<sup>1</sup> Ibid.

<sup>2</sup> Rethinking Secularization: A Global Comparative Perspective, January 2006. f. 15.  
<https://www.researchgate.net/publication/265540966>

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Pippa Norris & Ronald Inglehart. Sacred and Secular, Religion and politics worldwide. Publikuar nga Cambridge University Press, 2004 dhe 2011.



njerëzit sa më të shëndetshëm dhe më të mbrojtur të jenë, aq më të sigurt ata ndjehen, dhe aq më pak ata ndiejnë nevojën për fe.<sup>1</sup>

Autorët pohojnë se popullsitë e pothuajse të gjitha shoqërive të përparuara industriale janë zhvendosur drejt orientimeve më shekullare, gjatë gjysmëshekullit të kaluar, por ndërkohë bota, si një e tërë, tani ka më shumë njerëz me pikëpamje tradicionale fetare se kurrë më parë. Ata pohojnë se besimi fetar është më i fuqishëm në mesin e popullatave vunerabël, veçanërisht në kombet më të varfra dhe në shtetet e dështuara. Vendet e varfra nuk po shekullarizohen, dhe ato përmbajnë pjesën në rritje të popullsisë së botës. Norris dhe Inglehart përpiqen të shpjegojnë këtë zhvillim duke zhvilluar tezën e “sigurisë ekzistenciale” që thotë se: përvoja e njerëzve që jetojnë në shoqëritë e dobëta dhe vunerabël rrit rëndësinë e vlerave fetare, ndërsa përvoja e njerëzve në shoqëritë e pasura dhe të sigurtat e pakësojnë atë, ku një erozion sistematik i praktikave, vlerave dhe besimeve fetare ka përfshirë shtresat më të zhvilluara në këto vende. Inglehart madje në një intervistë të tij të 2006 pranon se sot ka më shumë njerëz fetar se dikur, por jo se kemi të bëjmë me një rigjallërim të fesë. Ai thotë:

Evolutioni i fesë është jashtëzakonisht i ndërlikuar. Do të ishte e pandershme që të thosha se ka një rigjallërim global të fesë kur ka shumë dëshmi, në fakt, që në shumë vende feja në mënyrë të qartë është në rënie. Megjithatë, unë do të thosha, si vijën e fundme, krejt në mënyrë të qartë, pa mëdyshje, pa llomotitje, ka më shumë njerëz sot të gjallë me besimet tradicionale fetare se kurrë më parë në histori, dhe ata kanë përqindje më të lartë në popullsinë e botës se sa ata ishin 20 vjet më parë. Të dhënat e “The World Values Survey” e bëjnë këtë fakt të padyshtimtë.<sup>2</sup>

Shtetet e Bashkuara, për ta, janë më fetare për shkak të pabarazisë sociale dhe imigrimit masiv të njerëzve që kanë pikëpamje tradicionale mbi botën. Ekskluziviteti fetar i Amerikës shpjegohet më së miri, thonë autorët, në dritën e ekskluzivitetit të saj në mirëqenien sociale. Megjithatë ata pohojnë se supozime të caktuara themelore të teorisë së shekullarizimit duhet të rishikohen në mënyrë thelbësore. Në thelb, feja vazhdon atje ku njerëzit përballojnë nivele të larta rreziku për shkak të pabarazisë, varfërisë dhe furnizimit të papërshtatshëm shoqëror nga shteti. Në të kundërt, shoqëritë më të barabarta, më pak të varfra, veçanërisht ato me të ardhura gjithëpërfshirëse të mirëqenies, janë bërë gjithnjë e më shekullare nga çdo vlerësim përkatës. Duke përmbledhur ata pohojnë:

Edhe pse ne besojmë se zhvillimi njerëzor dhe kushtet e barazisë ekonomike zakonisht gjenerojnë nivele në rritje të sigurisë, ky përgjithësim duhet të kuptohet si probabilist (i mundshëm), jo determinist; faktorët specifikë të situatave e bëjnë të pamundur parashikimin saktësisht se çfarë do të ndodhë në çdo shoqëri të dhënë.<sup>3</sup>

Këto ishin disa nga pikëpamjet më të rëndësishme me të cilat interpretohen zhvillimet e sotme fetare nëpër botë. Sigurisht, edhe pse ato janë të ndryshme, ndonjëherë edhe kundërtë, gjen tek to elementë të vlefshëm dhe të saktë për të shpjeguar për kontekste të ndryshme atë që ka

<sup>1</sup> Diçka të ngjashme e gjejmë edhe në tekstet fetare, ku përmendet se ndjenja e vetëmjaftueshmërisë dhe e pasurisë zhvillon egon dhe arrogancën njerëzore. (Kurani,96: 6-7)

<sup>2</sup> <http://www.pewforum.org/2006/05/08/is-there-a-global-resurgence-of-religion/>

<sup>3</sup> Pippa Norris & Ronald Inglehart. Sacred and Secular, Religion and politics worldwide. Publikuar nga Cambridge University Press, 2011. f.16.

ndodhur me besimet fetare nëpër botë. Madje është mundur që elementë të ndryshëm të këtyre teorive të rrinë bashkë mjaft mirë mes tyre. P.sh. në rastin e Shqipërisë elementë të teorisë së “tregut fetar” mund të ndërthuren me ato të “sigurisë ekzistenciale”. Kështu p.sh. besimet fetare pas rënies së komunizmit në Shqipëri luajtën rolin e një strehe sigurie dhe shprese për njerëzit, të cilët e gjetën veten të rrezikuar, jo vetëm nga pikëpamja materiale, por edhe ajo sociale, identitare dhe kulturore. Ndërsa përhapja në Shqipëri e lëvizjeve të reja fetare, qofshin këto edhe nën ombrellën e atyre tradicionale, mund të shihet me syrin e teorisë së tregut fetar, ku nevoja për besim nga njëra anë dhe oferta religjioze joshëse që ofronin këto lëvizje nga ana tjetër, janë disa nga faktorët kyç të përqaimit nga shqiptarët të këtyre besimeve. Natyrisht këtu mund të përfshihet edhe e kundërta e teorisë së shekullarizimit për diferencimin social, ku humbja e rolit të institucioneve të shtetit, dhe zvogëlimi i ndikimit të tij në jetën e njerëzve, dhe rimarrja e këtyre roleve në një përmasë jo të vogël nga ana e institucioneve fetare, siç qe arsimiti, mjekimi, përkrahja sociale, punësimi etj. ka në luajtur një rol të ndjeshëm në drejtim të rigjallërimit të ndjenjës fetare mes njerëzve.

### **Kapitulli III: Komunizmi dhe feja në Shqipëri**

- 4.1 Komunizmi si “zëvendësues” ideologjik i fesë
- 4.2 Trajtimi i fesë nën regjimin komunist
- 4.3 Presioni ligjor ndaj komunitete fetare
- 4.4 Pasqyrim dokumentar nga lufta kundra fesë
- 4.5 Zëvendësimi i festave dhe kremtimeve fetare me ato socialiste
- 4.6 Propaganda antifetare
- 4.7 Bilanci tragjik i luftës kundër fesë
- 4.8 Mbijetesa e fesë nën regjimin komunist



## Komunizmi dhe feja në Shqipëri

Në këtë kapitull do të trajtojmë sesi u zbatua lufta kundra fesë në Shqipëri dhe si vetë ideologjia komuniste iu imponua shqiptarëve si një lloj feje shekullare.

### 3.1. Komunizmi si “zëvendësues” ideologjik i fesë

Marksit e identifikonte fenë me opiumin e popullit, dhe e shihte kritikën ndaj saj si “parakusht i të gjitha kritikave” ndaj rendit të kalbur social-politik botëror. Luftën ndaj fesë si “një luftë kundër botës” së atëhershme, ku feja ishte shpirti i saj. Ai nuk “dëshiron ta përgënjeshtrojë, por ta shfarosë”<sup>1</sup> fenë dhe rendin e vjetër shoqëror. Dhe kjo sepse sipas tij feja legjitimonte padrejtësinë që sundonte në shoqëri dhe nxiste njerëzit të durojnë dhe harrojnë të këqijat e kësaj bote, në vend që t’i shëronte ato. Njerëzit duke besuar te bota e përtejme as që shqetësohen për rregullimin e kësaj bote.<sup>2</sup>

Por në anën tjetër vetë marksizmi u kthye në një lloj feje, për ithtarët e tij:

Marksizmi është kryekëput një fe, në kuptimin më të papastër të kësaj fjale. Me të gjitha trajtat e ulëta të jetës fetare ai ka të përbashkët sidomos faktin se është përdorur vazhdimisht, sipas fjalës aq të përshtatshme të Marksit, si një opium për popullin.<sup>3</sup>

Dhe ky opium ishte pikërisht shpresa e fuqishme për një ardhme të pashmangshme, ku nuk do të kishte më padrejtësi, por një të ardhme të lumtur, pa klasa sunduese dhe të sunduar, pa të varfër dhe të pasur, pa skllevër dhe pronarë dhe ku të gjithë do të jetonin si vëllezër në paqe. Parajsa komuniste mbi tokë ishte opiumi për popullin.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Works of Karl Marx, 1843, A Contribution to the Critique of Hegel’s Philosophy of Right, Introduction.

<https://www.marxists.org/archive/marx/works/1843/critique-hpr/intro.htm>

<sup>2</sup> Raymond Aron, në *Opiumi i intelektualëve*, Shtëpia botuese “Dituria” 2005, f.324.

<sup>3</sup> Thënie e Simone Weil, cituar nga Raymond Aron, në *Opiumi i intelektualëve*, Shtëpia botuese “Dituria” 2005, f.5.

<sup>4</sup> Në një nga numrat e revistës sovjetike “Feja dhe shkenca” autorët e saj duke iu referuar porositë të Leninit, shprehen se komunistët duhet të zëvendësonin parajsën që feja u premtonte njerëzve në botën tjetër me parajsën që po ndërtonte socializmi shkencor të cilin ata e quanin “drejtësia sociale”. Siç citohet në “Belshevetul Islam indel marksijin uel ishterakijin el-arab” (Bolshevizimi i Islamit te marksistët dhe socialistët arab), Salahundin el-Munexhid, Bot. Darul el-Kitab el-Xhedid, 1967, f.20.

Ndërkohë në të njëjtin kontekst Emilio Gentile thotë:

Lëvizjet marksiste, me gjithë konceptimin materialist e racionalist të njeriut dhe historisë, morën shpeshherë karakter të besuari kolektiv në gjirin e proletariatit, te klasa e destinuar për çlirimin e njerëzimit nga çdo nënshtrim, përfshi atë ndaj besëtytnisë, të përfaqësuar nga fetë e Zotit, për ta shndërruar me “fenë e njeriut”.

Nga vullneti për të kapërcyer dhe neutralizuar fetë tradicionale u zhvillua një eksperiencë e sakralizimit të politikës ... sepse kërkon ekskluzivitetin e devotshmërisë kolektive, nuk pranon bashkëjetesën me fetë tradicionale dhe i lufton për t'i asgjësuar, siç ka vepruar komunizmi marksist kudo ku ka ngritur një regjim...

Komunizmi ka qenë eksperimenti më universal i sakralizimit ateist të politikës, duke gjeneruar fenomene të ngjashme dogmatizimi të marksizmit, ekzaltim të rolit të partisë së vetme dhe hyjnizim të udhëheqësit.<sup>1</sup>

Daniel Chirot pohon:

Asnjë mendimtar shoqëror i shekullit të nëntëmbëdhjetë nuk propozoi një vizion kaq joshës sa Karl Marksi dhe asnjë nuk pati aq shumë ndikim në shekullin e njëzetë. Marksistët pretendojnë gjithmonë se janë armiq ndaj fesë. Në të vërtetë ata ishin, por kjo ndodhi sepse ata ofruan besimin e tyre për ta zëvendësuar fenë. Ata pretendonin se kishin prova shkencore, të bazuara në studimin e historisë së ekonomisë dhe se parashikimi i tyre do të provohej si i saktë. Por në realitet, kjo ishte e para nga fetë e reja të mëdha që u flak nga Revolucioni industrial, e bazuar aq shumë në mendimin voluntarist si edhe në besimet që mendohej se zëvendësonte.<sup>2</sup>

Lufta kundër fesë ishte pra lufta kundër një rivali ideologjik, dhe si e tillë lufta ndaj saj ishte një nga frontet e rëndësishme ideologjike të partisë komuniste.<sup>3</sup>

Raymond Aron pohonte se:

Komunizmit i shkon për shtat formula e Mishlesë: “Revolucioni nuk pranoi asnjë kishë. Pse? Sepse vetë ai ishte një kishë.” Ashtu si feja civile, edhe komunizmi i shenjtëron detyrat që ka çdonjëri ndaj partisë, ndaj shtetit socialist, ndaj së ardhmes së njerëzimit.<sup>4</sup>

Duke qenë se revolucioni ideologjik komunist shihte si rival të tij kryesor të gjitha pikëpamjet e tjera mbi botën, të cilat i emëronte si feudalo-borgjeze, feja për të ishte një nga bazat ideologjike të rendit të vjetër, që ai kërkonte të përmbyste. Feja ishte burim ushqimi dhe mjet përhapje i këtyre ideologjive,<sup>5</sup> kështu që për këtë arsye ajo shihej si një nga armiket më të ashpra dhe penguese për rendin e ri socialist.<sup>6</sup>

Për komunizmin shqiptar vetë ndërtimi i socializmit ishte vetvetiu një luftë dhe goditje ndaj fesë dhe ndaj besimeve e praktikave të saj. Duke qenë se sipas pikëpamjes komuniste puna ishte kulti i ri dhe i vetëm, përmes të cilës do të ndryshonte bota e brendshme dhe shpirtërore e njeriut, ajo

<sup>1</sup> Emilio Gentile, *Fetë e politikës*, Pika pa sipërfaqe, 2017, f.12.

<sup>2</sup> Daniel Chirot, *Si Ndryshojnë Shoqëritë*, bot. AHS, Tiranë 2012, f. 160

<sup>3</sup> Hulusi Hako, *Akuzojmë fenë*, Shtëpia Botuese “Naim Frashri” Tiranë 1968, f.122.

<sup>4</sup> Raymond Aron, në *Opiumi i intelektualëve*, Shtëpia botuese “Dituria” 2005, f.315.

<sup>5</sup> Ibid, f.113

<sup>6</sup> Shih PPSH, *Dokumenta kryesore*, I, Tiranë 1960, f.357, cituar nga Hako në “Akuzojmë fenë” f.123.

do të transformonte edhe natyrën dhe jetën shoqërore të njeriut. Dhe përmes këtij parimi të materializmit dialektik, shihej se do të zhdukej edhe feja. Edhe pse ky kult i ri nuk shprehej me terminologjinë e feve tradicionale, por përdorte terminologjinë e tij tipike marksiste, ai kishte arritur të kuptohej si i tillë, pra si fe, edhe nga njerëzit e thjeshtë, të cilët dallonin qartësisht elementët e përbashkët mes fesë dhe ideologjisë komuniste të punës. Vetë, Hulusi Hako, ndoshta trumbetuesi më i madh i ateizmit marksistit shqiptar, e miratonte këtë këndvështrim popullor ndaj komunizmit. Ai thoshte në një nga librat e tij kundra fesë: “Kot nuk e tha një fjalë plaku 70-vjeçar në Kombinatin e tekstit “Stalin”: “Puna është feja jonë.”<sup>1</sup>

Nuk ishte e rastësishme që propaganda komuniste, citonte edhe të tilla shprehje, nga gjuha e popullit, edhe pse vetë nuk e përdorte diçka të tillë, por qëllimi ishte i qartë për të përcuar në mendësinë e njerëzve se tashmë një fe e re ka ardhur, e cila për më tepër nuk pranon të bashkëjetoj me asnjë tjetër para saj. “Se ne fe tjetër nuk kemi veç partisë që na ndryshoi jetën e zezë ne dhe gjithë Shqipërisë”<sup>2</sup> edhe ky një tjetër burrë plak, që propaganda komuniste e citonte në fushatën e saj për vendosjen e kultit të ri. Partia-shtet ishte pra nëna, ishte babai, ishte gjithçka “lutjet që brezat e mëparshëm e kishin zakon t’u bënin perëndive, tani ishte shteti që dukej në gjendje t’i plotësonte.”<sup>3</sup>

Në terrenin shqiptar nuk kishte shprehje më të qartë të këtij hyjnizimi të shtetit komunist sesa parulla e njohur e asaj kohe se “Ç’do populli bën Partia, ç’thotë Partia bën populli”. Partia ishte pra hyjnia që i përgjigjej çdo kërkesë të njerëzve dhe njëkohësisht ishte pikërisht ajo që njerëzit i bindeshin urdhrave të saj, si të ishte vetë Zoti i tyre.

Komunizmi u premtoi njerëzve një parajsë, por jo një parajsë në qiell, por një parajsë mbi tokë. Shpëtimtari, gati mesianik, ishte partia, ose për të qenë më të saktë, Sekretari i Parë i KQ të Partisë. Vendin e Librave të Shenjtë e zinin veprat e kryetarit të partisë.<sup>4</sup>

Diktatori komunist ishte njëri nga idhujt më të rëndësishëm të regjimit, madje idhulli më i rëndësishëm lokal, ku ai vetes, bashkë me partinë që ai drejtonte, i dhanë asaj përmasa ndërkombëtare, duke e cilësuar si “të vetmen fanar ndriçues në botë” dhe e vetmja pasardhëse e denjë dhe e vërtetë e marksizëm-leninizmit.

Enver Hoxha dhe partia e tij besonte dhe propagandonte se të gjitha shtetet socialiste të bllokut lindor kishin tradhtuar, me hir ose me pahir, vijën e drejtë të marksizëm-leninizmit dhe se ishte pikërisht Partia e Punës e Shqipërisë, që mishërohej në Enver Hoxhën, që i kishin qëndruar besnik mësimëve të komunizmit dhe se kjo e “vërtetë” e ruajtur me fanatizëm nga kjo parti një ditë do të triumfonte; duke i dhënë vetes kështu një rol profetik e mesianik ndërkombëtar.

Thëniet dhe citatet e diktatorit mbushin ngado muret dhe tabelat e institucioneve, që nga kopshtet e fëmijëve e deri te burgjet politike. Edhe autori i këtyre rreshtave nuk e harron, sesi në kabinetin e matematikës të shkollës tetëvjeçare, shkruhej mbi mur me shkronja të mëdha shtypi, një thënie e diktatorit, ku ai ishte shprehur se, nëse do të kishte qenë edhe njëherë i ri, do t’i kishte hyrë studimit të matematikës. Kjo thënie e tij nuk kishte asnjë vlerë ideore, përveç faktit se

<sup>1</sup> Ibid. f.118.

<sup>2</sup> Shih Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare – shprehje e luftës së klasave, Shtëpia Botuese “Naim Frashri”, Tiranë 1967. f.83.

<sup>3</sup> Manlio Graziano, Lufta e shenjtë dhe e shenjta aleancë, f.22

<sup>4</sup> Gjergj Sinani, Feja dhe edukimi, f.8.

thuhej nga vetë Enver Hoxha, dhe fakti që thuhej nga ai përbënte vetë argumentin e citimit të saj, si të ishte një citat i librave të shenjtë, ku ka folur vetë Zoti, apo ndonjë profet i Tij. Ishte gati e pamundur që gati në çdo libër të fushave të ndryshme të dijës, të mos gjeje thënie të tija, si të ishin urtësi hyjnore. Ai përcaktonte parimet e shkencës dhe të artit, në të cilat ato duhet të ecnin. Ai ishte i gjithanshmi, që nuk kishte lënë fushë të dijës pa shprehur diçka të vyer për të.

Diktatori ishte objekt adhurimi edhe i artit të realizmit socialist. Edhe pse dikush me të drejtë mund të vër në pah se figura e tij nuk del si personazh në asnjë skenë teatri apo kinemaje, por kjo jo për shkak të mos shenjtërimit të tij, por pikërisht për të kundërtën, sepse ai ishte i paimitueshmi dhe sepse askush nuk ishte i denjë të mund të aktronte rolin e tij. Por, ndërkohë prezenca e tij jo fizike ndjehej përmes venerimit dhe emocionalitetit të tepruar që përçonin aktorët kur përmendin emrin e tij, sikur të flinin për Mesinë që po vjen.

Por ndërkohë arti figurativ e paraqet atë si një Mesi të popullit shqiptar, pse jo edhe të botës:

Figura e Diktatorit, ose ajo e udhëheqësit, ndryshe nga tematikat e tjera artistike të zhvilluara nën regjimet totalitare, “gëzon” superioritetin absolutë në hierarkinë tematike. Kjo pasi ajo nënkupton ose simbolizon vetë shtetin, pushtetin e shpesh edhe vetë kombin. Ajo gjendet në shtëpinë e çdo nënshtetasi, në zyra, mure institucionale e faqe mali... ajo ngrihet nëpër pankarta, udhëheq masa gjigande njerëzish në beteja, revolucione ideologjike e reforma ekonomike. Ajo gjendet kudo, mes intelektualëve, mes punëtorëve, mes bashkëlufëtareve e liderëve botërorë. Dhe e gjithë kjo është detyrë parësore e artistëve, që të materializohet “në mënyrën e duhur”. E pasi të jetë arritur kjo, figura e tij... kulti i tij, do të ketë arritur ngritjen e atij që quhet “Kult i Individit”<sup>1</sup>.

Në sytë e njerëzve të thjeshtë, ky shkëmbim objektsh adhurimi duhej të kalonte pa rënë në sy, si një tentativë e qartë për mbivendosje kulti, ai gjithnjë vendoset në qendër të kompozimit, rrethuar nga stereotipa që përfaqësojnë shtresa shoqërore, krahina, mosha e profesione të ndryshme, dhe, aq sa të sjell ndërmend shpesh hyrjen e Krishtit në Jerusalem.<sup>2</sup>

E natyrisht kjo nuk mund të jetë vetëm se një trajtim hyjnor i një njeriu që në fakt mohonte ekzistencën e Hyjit. Ky hyjnizim i tij vazhdoi edhe pas vdekjes së tij, duke tentuar ta përjetësojnë atë përmes vendosjes së emrit të tij në mjaft objekte dhe institucione, dhe përmes vendosjes së busteve të tij me përmasa vigane, në të tilla pozicione dominuese në disa qytete kryesore të vendit, ku “dukej sikur fuqia e Enver Hoxhës i mbijetonte vdekjes fizike”<sup>3</sup> si të ishte një perëndi e pavdekshme.

Por dikush me të drejtë do të thotë “A meriton të quhet fe një doktrinë që nuk e pranon Zotin?” Raymon Aron i përgjigjet duke thënë:

Gjithçka varet nga kuptimi që i japim fjalëve. Te doktrina e tyre komunistët e vërtetë zbulojnë një interpretim global të gjithësisë. Kjo doktrinë u frymëzon atyre ndjenja të afërta me ato që kanë pasur kryqtarët e të gjitha kohërave. Ajo cakton hierarkinë e vlerave dhe përcakton sjelljen që duhet mbajtur. Ajo përmbush edhe disa nga veprimet

<sup>1</sup> Ermir Hoxha, *Arti në Shqipëri 1945 – 1990*. Tiranë 2014. f. 13 -14. Tezë doktorature.

<sup>2</sup> Ermir Hoxha, *Arti në Shqipëri 1945 – 1990*. Tiranë 2014. f. 15.

<sup>3</sup> Gjirokastra një udhëtim nëpër kulturë, CHWB Albania, f.46

dhe rolet e shpirtit të njerëzve të veçantë dhe të shpirtit kolektiv, për të cilat zakonisht sociologjia mendon se i kryen feja.<sup>1</sup>

Kështu që edhe këtu jemi munduar t'i përshkruajmë ideologjisë sunduese komuniste në Shqipëri, disa nga dimensionet shoqërore që në shoqëritë tradicionale i përmbushte më së shumtë apo tërësisht feja dhe në shoqëritë moderne pjesërisht ajo, në dallim me sundimin komunist ku feja nxirret tërësisht nga skena sociale, shpirtërore dhe botëkuptimore dhe vendin e saj e zë tërësisht dogma komuniste dhe idhujt e saj.

### 3.2 Trajtimi i fesë nën regjimin komunist

Shteti komunist pasi morri pushtetin nuk u shfaq që në fillimet e tij si armik i betuar i fesë dhe si shtet që sanksiononte ateizmin, si të vetmen ideologji dhe “fe” sunduese të tij, por ai u mjaftua vetëm me të qenin laik. Statuti themeltar i vitit 1946 garantonte lirinë e besimit dhe sanksiononte ndarjen e shtetit nga feja.<sup>2</sup> Madje ligji i 1949 për komunitet fetare parashikonte se shteti mund të mbështeste ekonomikisht besimet fetare. Në fakt kjo ishte një taktikë, siç e tregoi edhe më pas realiteti për t'i bërë ato të varura ekonomikisht nga shteti, për shkak të reformave ekonomike që do të pasonin, të tilla si reforma agrare mbi tokën, reforma tatimore, shtetëzimet e pronave për interesa shtetërore dhe publike, të cilat do të preknin drejtpërdrejtë të ardhurat ekonomike të institucioneve fetare.<sup>3</sup>

Lufta ndaj fesë u zhvillua në disa etapa, dhe nëse do t'i referohemi 1967, viti kur edhe u suprimuan liritë fetare, atëherë mund ta ndajmë ata në dy etapa kohore, në atë para 67' dhe atë pas këtij viti. Kjo nuk do të thotë se në thelb ndryshon diçka nga lufta që i bëhej fesë në të dy etapat kohore, thjesht pas 67' kjo u bë më e vendosur dhe e drejtpërdrejtë dhe u sanksionua me ligj, por ndërkohë betejat për çrrënjosjen e besimit fetar dhe asgjësimin e infrastrukturës së tij njerëzore dhe materiale, kishin nisur në mënyrë të përshkallëzuar që me marrjen e pushtetit nga komunistët. Dhe ja sesi e përmbledh fazën e parë një raport i Komitetit Qendror të Partisë duke e përshkruar periudhën para 67' me këto fjalë:

Sigurisht ky hop i madh nuk është i rastit. Ai është rezultat i gjithë punës 25-vjeçare të Partisë. Qysh në fillim Partia edukoi anëtarët e vet dhe masat me frymën e ateizmit. Mbas çlirimit mori masa të rëndësishme. Ndarja e fesë nga shteti dhe nga shkolla, kufizimi i vazhdueshëm i institucioneve fetare, kufizimi e pastaj likuidimi i mundësive për përgatitjen e kuadrit fetar, duke mbyllur edhe institucionin përkatës, ndalimi i botimit të literaturës fetare etj., përbën një faktor të rëndësishëm pozitiv për luftën kundër fesë. Por kryesore është puna e madhe e partisë për të përhapur arsimin e kulturën, për të zhdukur injorancën, për të përhapur njohuritë shkencore në të gjitha fushat dhe shumë masa të

<sup>1</sup> Raymond Aron, në *Opiumi i intelektualëve*, Shtëpia botuese “Dituria” 2005, f.298.

<sup>2</sup> Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, Art.16, në “Gazeta Zyrtare” nr.19. Tiranë, 19 Mars 1946, f.2. Vepër e cituar siç përmendet në “Procesi i Asgjësimit të Fesë në Komunizëm”, Azem Qazimi, Tiranë 2012, botim i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

<sup>3</sup> Shih për këtë Giovanni Cimbalo, Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri, botuar dhe përkthyer në shqip nga shtëpia botuese “Naimi” 2013, faqet 108, 109.

tjera me karakter ideologjik. Të gjitha këto përbëjnë një periudhë të tërë ndryshimesh sasiore të domosdoshme që po çojnë në ndryshime cilësore.<sup>1</sup>

Lufta ndaj fesë pra, përfshiu shumë fronte, së pari atë ideologjike, duke e paraqitur fenë si mashtrim, si ideologji reaksionare në shërbim të okupatorëve të huaj dhe klasave sunduese feudalo-borgjeze, si përcarëse e popullit, si mbrojtësja e zakoneve të këqija prapanike, si shfrytëzuese dhe shtypëse ekonomike e popullit, si pengesë në rrugën e zhvillimit socialist dhe përparimit të vendit, si mbetje e së kaluarës së errët, si opium për popullin... etj. Natyrisht të gjitha këto akuza do të kishin konkretizimin e tyre në viktima njerëzore, që ishin pikërisht kleri, hoxhallarë dhe priftërinj, murgj, shehlerë dhe baballarë, si dhe besimtarë të thjeshtë. Shumë prej këtyre klerikëve do të akuzoheshin që në fazën e parë të luftës ndaj fesë me akuza absurde, që në pamje të parë godisnin individin, por që në thelb kishin si qëllim të luftonin fenë dhe dëmtonin imazhin e saj në popull, duke i shpallur shpesh fajtorë këta njerëz për krime që nuk i kishin bërë, duke i deklaruar ata si “armiç të popullit”, që kishin bashkëpunuar me fashizmin dhe agjentë të atyre që kërkonin të përmbysnin me dhunë “pushtetin popullor”.<sup>2</sup>

Në frontin ideologjik u sulmua baza e doktrinës fetare, ekzistenca e Zoti dhe e dogmave fetare, duke i paraqitur ato si të pavërteta, si mashtrime, si obskurantiste, si të vjetruara, si të panatyrshme, si të huaja, si të dëmshme për mendjen, trupin dhe ndjenjat e njeriut... Me të njëjtat akuza u sulmuan edhe praktikatat fetare, të cilat u futën në një thes me zakonet e këqija dhe prapanike. U sulmuan kremtimi i festave fetare, si bajrami dhe pashka, adhurimet e ndryshme fetare, si agjërimi, matemi dhe kreshma, praktikatat me origjinë fetare si ajo e të bërit syne, pagëzimi i fëmijëve, shpërndarja e vezëve të kuqe të pashkëve, përdorimi i simboleve fetare, ceremonitë mortore që bëheshin me priftërinj e hoxhallarë, lutjet për të vdekurit... etj. Një rëndësi e veçantë iu kushtua pastrimit të gjuhës së folur dhe folklorit nga fjalët dhe elementët fetar, sidomos ato me origjinë të huaj, turke, arabe dhe latine. Kjo betejë përfshiu edhe emrat e njerëzve, që tash e mbrapa duhet të ishin shqiptarë dhe të mos i referoheshin më fesë.

Sigurisht që lufta ndaj fesë në planin ideologjik shkante krah për krah me ndërtimin e njeriut të ri socialist, brumosjen e tij me ideologjinë marksiste-leniniste, me materializmin dialektik dhe me ateizmin shkencor. Dhe ky qëllim përmbushej përmes propagandës me të gjitha mjetet e informimit dhe edukimit publik që zotëronte shteti, dhe në veçanti përmes arsimit, i cili që në fillim u morr nga shteti si e drejtë ekskluzive e tij për edukimin e brezit të ri.<sup>3</sup> Shteti gjithashtu u hoqi të drejtën komuniteteve fetare të kishin institucione bamirësie, pra ua kufizoi atyre edhe dimensionin human, duke i detyruar ata të ishin vetëm administrues të objekteve të kultit dhe të rriteve brenda tyre.<sup>4</sup>

### 3.3 Presioni ligjor ndaj komuniteteve fetare

<sup>1</sup> Raport informativ: Mbi Rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe Disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj (30. 08. 1967) <http://www.observatorikujteses.al/shqipëria-ateiste-si-u-shemben-2169-kisha-e-xhami/>

<sup>2</sup> Pjesa më e madhe e klerikëve të pushkatuar dhe vdekur nëpër burgje ka ndodhur pikërisht para ndalimit të fesë në 1967.

<sup>3</sup> Që në nëntor të 1946 Ministria e Arsimit miratoi një ligj për mësimdhënien, ku ritheksohej se edukimi i gjeneratës së re i përkiste vetëm shtetit, duke u bazuar në nenin 58 të kushtetutës së 1946 ku thuhej se “shkolla është e ndarë prej fesë.” Shih “Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri” f.111.

<sup>4</sup> Sipas ligjit të 1949 për komunitetet fetare neni 24 nuk u lejonte atyre të hapnin spitale, jetimore, dhe institute të ngjashme, ato që ekzistonin deri atëherë shtetëzoheshin pa shpërblim dhe merreshin nën administrim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Kujdesit Social. <http://licodu.cois.it/?p=289&lang=en>

Nga ana ligjore shteti komunist në 26 nëntor 1949 miratoi dekretligjin nr. 743 “Mbi komunitetet fetare”, ku çdo komunitet do të njihej dhe do të kishte të drejtën të ushtronte aktivitetin e tij, vetëm pas miratimit të statuteve të reja të komuniteteve fetare, të cilat viheshin tashmë *de jure* nën kontrollin e shtetit. Shteti kishte të drejtë të ndërhynte duke propozuar shkarkimin e funksionarëve fetarë, duke nisur që nga kryetarët e komuniteteve fetare. Madje edhe emërimi i tyre nuk mund të bëhej pa marrë më parë aprovimin e Këshillit të Ministrave. Dhe nëse komunitetet fetare nuk merrnin masa për zbatimin e këtyre vendimeve të shtetit, atëherë ky i fundit ndërhynte në mënyrë administrative.<sup>1</sup> Madje sipas nenit 34 ata që fillonin detyrën pa qenë të aprovuar sipas dispozitave të këtij ligji dhe ata që ishin shkarkuar nga detyra, por vazhdonin ta ushtronin atë, dënoheshin me 3 vjet heqje lirie. Ky ligj u kërkonte gjithashtu komuniteteve fetare që në aktivitetin e tyre duhet të zhvillonin te besimtarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit komunist, që ata e quanin si pushtet i popullit.<sup>2</sup> Komunitetet fetare vazhduan aktivitetin e tyre ligjërisht deri në datën 13 Nëntor 1967, ku me dekretin nr. 4337 të Presidiumit të Kuvendit Popullor, me propozim të qeverisë, shfuqizohen të gjitha statutet e komuniteteve fetare dhe ligji hyn në fuqi menjëherë.<sup>3</sup> Por para këtij vendimi, për nxjerrjen jashtë ligjit të komuniteteve fetare, i njëjti organ legjislativ më 11 Prill të po atij viti, me propozim të qeverisë nxjerr dekretin nr. 4263, ku shtetëzon të gjitha pronat e komuniteteve fetare, përveç ndërtesave ku ata ishin vendosur, të cilat duket se u lanë për më vonë. Justifikimi që jepej që se, prona private dhe ajo e komuniteteve fetare “nuk pajtohen aspak me revolucionarizimin e pandërprerë e të gjithanshëm të jetës së vendit tonë.”<sup>4</sup> Pas këtyre vendime nuk mbetej gjë tjetër vetëm se shkatërrimi masiv i objekteve të kultit ose transformimi i tyre në objekte për qëllime të tjera.

Në 1976 miratohet kushtetuta e re e vendit, e cila që në preambulë të saj, duke lavdëruar arritjet e shtetit komunist, mburret edhe për atë që i bëri fesë duke thënë se “u shembën bazat e obskurantizmit fetar” dhe se “figura morale e njeriut punonjës, ndërgjegjja dhe botëkuptimi i tij formohen në bazë të ideologjisë proletare, e cila është ideologjia sunduese.”<sup>5</sup> Neni 37 i kësaj Kushtetute sanksiononte qartë armiqësinë ndaj fesë duke thënë se: “Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjësuar te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor.” Ndërsa neni 55 i saj ndalon krijimin e çdo organizate me karakter fetar, duke e futur atë në radhë me organizatat fashiste dhe antidemokratike. Kodi Penal i vitit 1977 në nenin 55 të tij dënonte mes të tjerave edhe agjitacionin dhe propagandën fetare, si dhe përgatitjen, përhapjen dhe ruajtjen për përhapje të një literature të tillë, me 3 deri në 10 vjet heqje lirie.<sup>6</sup>

### 3.4. Pasqyrim dokumentar nga lufta kundra fesë

<sup>1</sup> Shih nenin 13 dhe 15, të këtij ligji. <http://licodu.cois.it/?p=289&lang=en> Të gjitha ligjet për fenë dhe statutet e komuniteteve fetare ndër vite mund t'i gjeni në këtë adresë: [http://licodu.cois.it/?page\\_id=1036&lang=en](http://licodu.cois.it/?page_id=1036&lang=en)

<sup>2</sup> Shih nenin 12 të këtij ligji. <http://licodu.cois.it/?p=289&lang=en>

<sup>3</sup> Mbi çfuqizimin e disa dekreteve. Ky dekret është firmosur nga kryetari Haxhi Lleshi dhe sekretari Bilbil Klosi. <http://licodu.cois.it/?p=291&lang=en>

<sup>4</sup> Mbi shtetëzimin e lokaleve që janë ndërtuar për ushtrim tregtie, industrie, zejtarie ose profesioni, për zyra ose depo, të cilat janë pronë private, si edhe shtetëzimin e pasurisë së paluajtshme të komuniteteve fetare. <http://licodu.cois.it/?p=349&lang=en>

<sup>5</sup> Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976, <http://licodu.cois.it/?p=383&lang=en>

<sup>6</sup> Shih Azem Qazimi, Procesi i Asgjësimit të Fesë në Komunizëm, f.113.

Në 6 Shkurt të vitit 1967 Enver Hoxha mban një fjalim me disa organizata bazë të partisë të rrethit të Tiranës.<sup>1</sup> Ky fjalim cilësohet edhe si fillimi i procesit dhe nxitësi për fushatën kundra fesë të 1967. I gjithë fjalimi, i përmbledhur në titullin e tij, fokusohet tek ajo që ai e quan “Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe i pushtetit” ku ai merret me kritikën e fenomeneve të gabuara në parti e në shtet, që nuk pajtojnë sipas tij me vijën e partisë dhe të ideologjisë marksiste-leniniste. Në vetëm dy rreshta, të këtij fjalimi prej më shumë se pesëdhjetë faqesh, ai sulmon fenë dhe ato që quheshin zakone prapanike. E vetmja frazë që ai përmend indirekt fenë, është ajo që ai thotë në fillim të fjalimit të tij duke kritikuar mungesën e frymës revolucionare dhe absurditetin e të quajturit në pozita revolucionare të një organizate bazë të partisë, si ajo e portit të Durrësit dhe një punëtori të saj, ndërkohë “që ditën punon mirë, dallohet, bile edhe lavdërohet, kurse në mbrëmje në shtëpi bën ikona kishe dhe i shet në mëngjes në besimtarë privat?”<sup>2</sup> Dhe në të njëjtën frymë kritike pak më poshtë ai flet për atë që quhej si “shitja e vajzave për martesë” duke e shoqëruar me kërcënimin: “Gjithë partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr zakonet prapanike e t’i këputin kokën cilitdo që merr nëpërkëmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave.”

Edhe pse ky fjalim nuk duket se merret në thelb me fenë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as me ato që quheshin zakone prapanike, duket se ai ka “frymëzuar” një mori lëvizjesh dhe veprimesh “revolucionare” në të gjithë vendin nga cepi në cep i Shqipërisë për të luftuar fenë, dhe zakonet prapanike.

E vërteta është se ai fjalim dhe ato pak fjalë ishin thjesht një kushtim për përmbylljen e asaj që tashmë partia komuniste kishte nisur me kohë. Të nesërmen e botimit të këtij fjalimi në gazetën Zëri i Popullit, po kjo gazetë në datën 8 Shkurt boton me shkronja të mëdha në faqen e parë të saj titullin: “Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë kundër ideologjisë fetare”. Aty pasqyrohej iniciativa e të rinjve durrsakë të gjimnazit “Naim Frashri”, që kërkonin mbylljen e kishave e të xhamive.<sup>3</sup> Pra gjithçka ishte planifikuar që më parë dhe nuk ishte aspak një nismë rinore spontane, siç mundohet të paraqitet ndonjë herë.

Zëri zyrtar i pushtetit komunist në 12 shkurt 1967, bënte thirrje se:

Paragjykimet e zakonet fetare ruajnë farën e degjenerimit të njeriut dhe po nuk u luftuan me guxim, nuk mund të formohet njeriu i ri komunist, nuk mund të ecet drejt ndërtimit të plotë të socializmit. Masat punonjëse, me të drejtë janë hedhur në sulm në frontin më të vështirë, në atë për të çrrënjosur nga zemrat dhe mendjet e njerëzve fenë...<sup>4</sup>

Pas kësaj një lumë artikujsh dhe botimesh do të pasonin këtë fushatë historike kundër fesë dhe “zakoneve prapanike”. Feja përfshihej pikërisht te zakonet prapanike, dhe lufta ndaj saj cilësohej si “Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare - shprehje e luftës së klasave”. Ky në fakt ishte edhe një nga titujt e shumtë të botuar po në atë vit, nga makina propagandistike e PPSH, që përmbledhte pesëdhjetë letra, që grupe qytetarësh, pleq e plaka, të rinj dhe të rritur,

<sup>1</sup> I mbajtur në mbledhjen e disa organizatave bazë të partisë të rrethit të Tiranës, publikuar në Enver Hoxha, Vepra 35, botuar nga Shtëpia botuese “8 Nëntori” Tiranë 1982,

<sup>2</sup> Ibid. f.3.

<sup>3</sup> Ngjela, Spartak (2 tetor 2011). "Politikanët e shkurtit '67 që sundojnë Shqipërinë".

<http://fjala.info/arkiv/fjala1/politikanet-e-shkurtit-67-qe-sundojne-shqiperine/> marrë më 3 Nëntor 2020.

<sup>4</sup> “Lufta kundër fesë – Aspekt i luftës së klasave”, *Zëri i Popullit*, 12 shkurt, (1967): 1.



fshatarë dhe qytetarë, punëtorë dhe kooperativistë, i dërgonin sekretarit të parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës, vetë Enver Hoxhës, me një zell patetik dhe një ligjërim standard, që të duket sikur i ka shkruar, në mos i ka redaktuar, e njëjta dorë, ku ata i tregonin të “ngazëllyer” sesi e kishin pritur këtë fjalim dhe sesi kishin reflektuar mbi mësimet e tij, duke kritikuar të metat që ky fjalim vinte në dukje, dhe që për ta kishte lidhje me mbeturinat e së kaluarës dhe zakoneve prapanike, që kishin të bënin kryesisht me sjelljen ndaj grave dhe vajzave, me fejesat e martesat e hershme, me veshjen e tyre të rënduar, me mënyrën e jetesës dhe zakonet dhe traditat që kishin lidhje me fenë dhe zakone të tjera. Në disa raste këto zakone paraqiten si “zakonet e turkut”, si “zakone anadollake të lëna prej osmënllinjve”, si “mbeturinat që na ka lënë si trashëgim sundimi 500 vjeçar otoman dhe regjimi i Zogut”. Në të gjitha këto mesazhe, bashkë me zakonet prapanike, feja dënohet si ideologji e klasave sunduese, feudalo-borgjeze, që i shërbente nënshtrimit të masave dhe si pengesë për të ecur përpara në ndërtimin e socializmit, që tashmë ishte bërë kauza ideale e pse jo edhe “feja” dhe besimi i ri i shqiptarëve. Feja etiketohej si mjet përçarës i pushtuesve të huaj dhe si trashëgimi e tyre, për t’iu shërbyer interesave të tyre pushtuese, si një ideologji reaksionare, e pavërtetë, që përdoret nga klerikët për të mashtruar popullin dhe përfutur në kurriz të tij, si “ndrydhje në errësi të padituri” si “zakone të huaja dhe të dëmshme për familjen shqiptare”. Në këto letra gjejmë akuzat standarde që partia shtet kishte projektuar tashmë prej vitesh, të tilla si p.sh.:

Okupatorët e huaj, qeveritë reaksionare, tradhtarët që ishin shitur tek ata, kleri dhe shërbëtorët e tij, gjatë sundimit në krahinën tonë, si kudo në Shqipëri, së bashku me shtypjen dhe shfrytëzimin e egër futën zakonet prapanike dhe ideologjinë fetare. Kjo u bë nga armiqtë dhe tradhtarët për të sunduar më lehtë mbi popullin, për të marrë prej tij sa më shumë të ardhura, kështu që shtypjes së egër ekonomike ju shtuan edhe ëndrrat e fesë e të klerit me të cilat ai bekonte njëmijë poshtërsi... Të gjithë jemi të një mendje me Ju, se lufta kundër fesë është luftë klase. Ne jemi të mendimi se akoma ruajmë disa mendime dhe zakone prapanike, si besimi në shërbesat fetare, në dogmat e fesë dhe të shërbëtorëve të saj hoxhallarëve dhe priftërinjve. Ata na kanë gënjer për shekuj me radhë dhe ne nuk ishim në gjendje të dallonim të vërtetën nga gënjeshttrat, ëndrrën nga realiteti.<sup>1</sup>

“të gjithë ne jemi dëshmitarë se në të kaluarën feja në vendin tonë ka qenë mbështetje për klasat sundonjëse, për regjimet antipopullore. Ajo ka qenë armike e betuar e çdo përparimi dhe ka përkrahur çdo gjë të prapambetur, fanatizmin, nënshtrimin, injorancën.”

“ne nxënësit zadrimerë, bij të fshatarëve që njohën, ndoshta më shumë se kush tjetër të këqijat më të mëdha të dikurshme: turkun, vërshimin e tmerrshëm të Gjadrit dhe shtypjen e kishës”

Në këto letra mesazhe, lexohen zotime për ndërprerjen e agjërimit të Ramazanit dhe ndalimin e mbajtjes së Kreshmës dhe të Matemit, mos festimin e Bajramit dhe Pashkëve, Ditës së Verës, Nevruzit, Shëngjergjit, për mos bërjen e synetllëqëve, ku edhe kjo etiketohej si një e keqe e lënë nga osmanllinjët, mos pagëzimin e fëmijëve, mos festimin e ditëve të shenjta, ndalimin e therjeve të kurbaneve, ndalimin e ceremonive fetare nëpër varrime, mos kuqja më e vezëve, mos mbajtja

<sup>1</sup> Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare – shprehje e luftës së klasave, f.135.

më e hoxhës dhe priftit në fshat, heqja nga shtëpitë e të gjitha ikonave, kryqeve dhe çdo gjëje tjetër që ka të bëjë me manifestimet fetare...etj.

Edhe rënia e dëshmorëve në luftë lidhej me zhdukjen e fesë, siç thuhet në një nga këto letra: “djalin ia fala partisë. Ai luftoi dhe dha jetën për partinë dhe për popullin, por ama edhe për zhdukjen e këtyre besimeve fetare, që i shërbenin bejlerëve dhe agallarëve, për të na mbajtur rob të tyre”.<sup>1</sup>

Letrat përmbajnë fraza luftarake ndaj fesë si:

“do të luftojmë deri në të rrahurat e fundit të zemrës kundër besimeve të kota e zakoneve prapanike”, “burrë nane nuk do t’i përtërijë ma te ne zakonet e turkut”, “edhe njëherë në pleqni po luftojmë me Osmanllinjte”, “do të luftojmë pa mëshirë çdo mbeturinë fetare në ndërgjegjen tonë”, “ne na kanë gënjyer këta maskarenj hoxhallarë... hoxha që në këtë sahat të qërohet nga fshati”, “kushdo që nuk do të zbatojë këto vendime që kemi marrë pjesë bashkërisht do të kritikohet e dënohet në organizatën e frontit”, “të ngrijmë peshë të gjithë popullin e rrethit të Pukës në luftë kundër zakoneve prapanike e besimeve të kota fetare”, “të luftojmë me ashpërsinë më të madhe të gjitha paragjykimet fetare dhe nxitësit e tyre, të heqim dorë menjëherë nga çdo festë dhe ceremoni fetare, të zhdukim të gjitha ikonat dhe çdo shenj dalluese të karakterit fetar”, “të shkëlmojmë njëherë e përgjithmonë besimet fetare”, “përderisa feja na ka sjellë gjithë këto të këqija, atëherë ne, përse duhet t’i mbetemi rob të këtyre zakoneve fetare”, “të gjithë ata që mbajnë kreshmë dhe ramazan t’i prishin ato që sot duke e konsideruar agjërimin si një besim të kotë fetar, që dëmton njeriun dhe punën.”, “ne ju premtojmë shoku Enver se zjarrin e ndezur për të djegur çdo mbeturinë të fesë do ta mbajmë gjithmonë të ndezur”, “duke pasur në krye Partinë dhe Ju, mësimet Tuaja jetëdhënëse, do t’i mposhtim përfundimisht edhe mbeturinat e moralit fetar”, “ne ju japim fjalën se do të tregojmë kujdesin më të madh që fëmijët tanë, që lindin afetarë, të jenë të tillë gjatë jetës së tyre dhe ne që kemi mbeturina fetare, t’i luftojmë ato për deri sa t’i zhdukim përfundimisht”, “nëpërmjet bisedave leksioneve, shtypit, librave, fotoekspozitave të punojmë me masën e rinisë, pionierëve dhe gjithë popullin, për të vënë në dukje rolin thellësisht reaksionar që ka luajtur kleri në rrethin tonë si dhe dëmin dhe kotësinë e dogmave fetare e zakoneve prapanike”, “nëpërmjet fletë-rrufeve t’i zbulojmë mbeturinat e huaja dhe t’i dënojmë para masës me qëllim që ato të mos lëshojnë rrënjë tek brezi i ri”, “filluam më të vendosur sulmin për të përmbysur çdo mbështetje të ideologjisë fetare borgjeze, këto kalbësira që veçanërisht në qytetin e rrethin tonë me kohë kishin marrë erë”, “zakonet prapanike dhe ato fetare do t’i djegim me zjarr që të mos u mbetet çika”.

Duke i fryrë me të tilla mesazhe dhe duke nxitur në veçanti rininë të ndërmerre e para aksionin kundër institucioneve fetare, gjendja pothuajse doli nga kontrolli.<sup>2</sup>

Dhe të gjitha këto iniciativa, që në fakt kishin nisur me kohë në terren, bëheshin një kohë kur akoma ligji kushtetues garantonte të drejtën dhe lirinë e besimit.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Shih “Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare – shprehje e luftës së klasave.”

<sup>2</sup> Shih P. Kondi dhe L. Hoxha, “Hulusi Hako: Si i bëra “gjyq Zotit” dhe propagandova ateizmin në Shqipëri”, Panorama, 19 shkurt, (2004): 14.

Veprime ekstreme në terren, siç qe shkatërrimi total i bazës materiale të kishave e xhamive, u shoqërua edhe me shkatërrimin e vetë ndërtesave. Objektet e mbetura u mbyllën, apo u transformuan në shtëpi kulture, depo e magazina, derisa në nëntor, “Shqipëria e kishte braktisur përgjithmonë pozicionin e saj asnjëherë fetar dhe ishte bërë vendi i parë dhe i vetmi në botë që formalisht “vendosi” një sistem “fetar” zyrtar, të quajtur ateizëm, duke nxjerrë jashtë ligjit pa një pa dy çdo sistem tjetër.”<sup>2</sup>

Por fjalimi i 6 shkurtit u pasua nga tjetër shkresë, që lideri i partisë komuniste i dërgonte komiteteve të partisë të rretheve, mbi luftën kundër fesë, paragjyqimeve e zakoneve fetare dhe kjo me datën 27 Shkurt të po atij viti.<sup>3</sup> Në këtë letër ai vendos vija të përgjithshme orientuese për rrugën që duhet ndjekur për të qenë sa më të suksesshëm në luftën kundër fesë dhe paragjyqimeve fetare. Enver Hoxha aty pranon se nuk është e lehtë të luftohet feja dhe se ajo është rrënjësor thellë në shpirtat e njerëzve, nëpërmjet bindjes, por edhe praktikës së përditshme të zakoneve të ndryshme. Lufta ndaj saj duhet të jetë e kujdesshme, thotë ai, dhe e studiuar sa më mirë dhe të zbatohet në mënyrë të diferencuar, sipas vendit dhe individit. Ai aty thotë gjithashtu se, lufta ndaj fesë duhet zhvilluar në drejtim të dogmave dhe ideologjisë fetare, por edhe ndaj praktikave dhe riteve. Ai e vë theksin më së shumti tek ritet dhe praktika dhe tek ato elemente që i quanin zakone prapanike dhe paragjyqime fetare, për arsye se sipas tij, shumica e njerëzve ishin të lidhur me këto elemente të fesë dhe jo me filozofinë e saj, pasi edhe kleri në përgjithësi, me përjashtim të katolikëve, sipas tij, ishin injorant dhe e kishin lidhur popullin më shumë me ritet sesa me shpjegimet filozofike të fesë. Madje ai pohon se është veprimi i partisë ai që e ka sjellë në këtë gjendje paditurie klerin duke thënë:

Ne nuk kemi lënë asnjë nga shkollat, qoftë edhe të ulëta, nga dilnin klerikët e rinj, për të interpretuar doktrinën e tyre fetare. Kështu që klerikët e çdo besimi në vendin tonë kanë shteruar vazhdimisht si kuadro. Kurse për sa i përket botimit të librave e të dogmave të tyre, kjo mundësi ka vdekur me kohë për ta.<sup>4</sup>

Ai vazhdon e thotë se, prishja e objekteve të kultit nuk është lehtë, sepse prek ndjeshmërinë e njerëzve, por megjithatë ato vende janë prishur nga “masat” dhe nuk ka pasur kundërshtim, disa prej tyre janë rrënuar e të tjerat janë braktisur, të tjerat janë kthyer në depo, e kështu me radhë, ndaj, ai thotë se, duhet të vazhdohet kështu “derisa t’i rrafshojmë ato nga faqja e dheut”, ndërsa “institucioneve fetare duhet t’u heqim, atje ku u kemi lënë diçka, të gjithë tokën, ndonjë rrënjë ulliri ose të ardhur tjetër që mund të kenë akoma.”<sup>5</sup> Lufta kundër fesë sipas orientimit të tij duhej bërë me frymën patriotike dhe revolucionare, sepse ne “s’na lidhte dhe as na lidh me fenë, me praktikat e saj, jo vetëm si ateistë, por edhe si patriot shqiptarë... të vazhdosh t’u bindesh këtyre

---

<sup>1</sup> Që para 1967 klerikët dhe komunitet fetare i janë ankuar shtetit për dëmtimin e objekteve të kultit dhe kthimin e tyre në muze, shtëpi kulture, qendra argëtimi, marrje objektesh për nevojat e ushtrisë, siç ndodhi me dy dhomat e një manastiri në Elbasan, një kishë në Vithkuq, (74) apo edhe me medresenë e Tiranës e cila në 1950 u detyrua me urdhër të zhvendoset nga godina e vet në një ambient më të vogël, sepse ajo godinë i duhej shtetit për nevojat e tij. Shih për këtë Azem Qazimi “Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm” 2012, f.46, 74. Po ashtu shih “Pluralizmi i besimit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri” f.113.

<sup>2</sup> Edwin Jacques, Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme. Tiranë: Kartë e Pendë – F. A. Linkoln, 1995, f. 533.

<sup>3</sup> Letra gjendet e të plotë në Enver Hoxha, Vepra 35, botim i shtëpisë botuese “8 Nëntori” Tiranë 1982. Nga f. 103-113.

<sup>4</sup> Ibid f.104-105,

<sup>5</sup> Ibid.

ligjeve e zakoneve, do të thotë të jesh shpirtërisht me të huajt, me reaksionin më të zi.”<sup>1</sup> Këtu tregohet se si lideri komunist i jep një theks të veçantë dhe qendror nacionalizmit shqiptar si armë për të luftuar fenë, duke e vënë atë në krah të ateizmit marksist, por duke i dhënë atij edhe më tepër peshë. Është pikërisht ky element që i ka shtyrë disa studiues ta konsiderojnë anti-fetarizmin e Enver Hoxhës më shumë si një armiqësi nacionaliste ndaj fesë, sesa një anti-fetari ateiste mbi baza marksiste. Kështu p.sh. sipas Bernhard Tonnes lufta ndaj klerit dhe fesë në regjimin komunist në Shqipëri nuk buronte nga pikëpamja socialiste, por nga ajo nacionaliste, ai thotë:

Si argumenti i saj kryesor në luftën kundër myslimanëve, ortodoksëve dhe katolikëve, PPSH pretendoi se të tre fetë donin të shkatërronin Unitetin e Kombëtar të shqiptarëve. Në të kundërt, roli shfrytëzues i klerit nuk u sulmua si në vendet e tjera komuniste. Pra, motivi i vërtetë i luftës kundër fesë nuk ishte socializmi, por nacionalizmi. Nacionalizmi është burimi i totalitarizmit në Shqipëri. Slogani, ‘Feja e shqiptarëve është shqiptaria’, e cila i përket fjalorit të tanishëm të Enver Hoxhës, buron në fakt jo nga epoka socialiste e Shqipërisë, por u formulua nga poeti i shekullit XIX Vaso Pasha.<sup>2</sup>

Ndërsa për Fatos Lubonjën, i cili mbështet idenë e Bernd Fisher-it, armiqësia ndaj fesë ngërthente në vetvete dy ideologji, atë komuniste dhe atë nacionaliste. Madje sipas tyre kur komunizmi e humbi fuqinë si fe përbashkuese dhe frymëzuese, diktatori filloi t’i mëshonte më tepër elementit kombëtar në propagandën e tij.<sup>3</sup>

Ndërkohë në të njëjtin kontekst Emilio Gentile shprehet se:

për shumë aspekte karakteristike, simbioza e marksizmit me nacionalizmin dhe e ateizmit me shqiptarizmin, e teorizuar, e predikuar dhe e ritualizuar në regjimin e Hoxhës, ka qenë shembull i veçantë e domethënës i imponimit totalitar të një feje politike, i realizuar me rigozitet të dhunshëm për të çrrënjësuar të besuarit e shqiptarëve në fetë tradicionale dhe për të edukuar njeriun e ri të një shqiptarie gjithashtu të re, tërësisht ateiste e njëkohësisht të sakralizuar.<sup>4</sup>

Në letrën orientuese të Enver Hoxhës arma nacionaliste kundër të tria besimeve fetare përmbledhet duke u shprehur në këtë mënyrë:

Një armë historike kundër fesë dhe klerikëve reaksionar është edhe fakti se feja myslimane ka qenë ideologji e pushtuesve turq, feja ortodokse ideologji e shovinistëve grekë, që kanë pushtuar në të kaluarën vendin tonë, dhe feja katolike, me qendër Vatikanin, ka qenë ideologji e pushtuesve italianë, e imperializmit austriak dhe fashizmit italian.<sup>5</sup>

Por, ndërkohë diktatori nuk harron të pranoj pak më poshtë se vërtetë ka pasur klerikë patriot, të lidhur me popullin dhe idenë e çlirimit kombëtar, por vetë feja asnjëherë nuk ka kontribuar për çlirimin tonë kombëtar. Më pas ky njeri thotë se prishja e kishave dhe xhamive nuk duhet të

---

<sup>1</sup> Ibid f.107.

<sup>2</sup> Bernhard Tonnes (1975) Albania: An atheist state, Religion in Communist Lands, 3:1-3, 4-7.

<sup>3</sup> Fatos Lubonja, Revista “Përpyekja” nr. 20, viti 2006, f. 6

<sup>4</sup> Emilio Gentile, Fetë e politikës, f.13.

<sup>5</sup> Enver Hoxha, Vepra 35, botim i shtëpisë botuese “8 Nëntori” Tiranë 1982. f. 110.

bëhet e menjëhershme dhe me urdhër nga lart, dhe as me dhunë, sepse mund të përdoret nga armiqtë e jashtëm për të prishur imazhin e regjimit, por me anë të bindjes dhe hap pas hapi. Madje ai aty qorton, edhe pse e sheh si veprim pozitiv, iniciativën e klerit mysliman dhe bektashi -në realitet drejtuesit e këtyre komuniteteve, që kontrolloheshin nga shteti- se ishin nxituar dhe nuk kishin ndjekur orientimet e partisë, duke nxjerrë qarkore për heqjen e veshjes së klerikut dhe dorëzimin e xhamive dhe teqeve.<sup>1</sup> Edhe në një shkresë tjetër që daton me 7 prill 1967, nga biseda që diktatori ka pasur me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrethit Dibër, ai thekson me forcë se, nuk duhen marrë masa administrative për zhdukjen e institucioneve fetare dhe se për këtë qëllim “ka vetëm një rrugë: punë politike, ideologjike dhe bindje”.<sup>2</sup> Mirëpo me sa duket ai jo vetëm që nuk i qëndroi kësaj vije, por vetëm pas disa muajsh nxjerr po në atë vit ligjin që ndalon vazhdimësinë e bashkësive fetare në vend dhe suprimon me dekret parlamentar ushtrimin e lirë të besimit.

### 3.5 Zëvendësimi i festave dhe kremtimeve fetare me ato socialiste

Thelbi i festave, cilat do qofshin ato, qëndron te natyra e tyre ciklike, gjë që e bën kremtimin e tyre një procedurë ritualistike. Përmes kapacitetit të saj ritualizues, një festë i jep një rëndësi të pamat realitetit të përditshëm të njerëzve, duke e pasuruar këtë përditshmëri me një vlerë absolute, ndryshe të pamundshme. Kështu që duke shërbyer si një lidhje mes imanentes dhe transcendencës, çdo festë në vetvete ka një natyrë të pastër fetare.<sup>3</sup> Nisur pikërisht nga kjo e vërtetë filozofike komunizmi aplikoi një program zëvendësimi të festave tradicionale fetare me ato të vetat, të cilat nuk duhet kurrsesi të binin për nga vlera dhe rëndësia e atyre të festave të feve tradicionale. Dhe duke qenë se lufta ndaj fesë nga komunistët shqiptarë u fokusua kryesisht te praktika dhe sjellja fetare, pa lënë mënjanë edhe luftën ideologjike, e cila konsiderohej padyshim themeli i kësaj beteje, por që për arsye objektive efekti i saj në popull ishte më i dobët, kështu që theksi u vu tek zhveshja e njeriut të ri socialist nga të gjitha zakonet dhe traditat fetare, të cilat regjimi i identifikonte me zakonet prapanike edhe pse bënte dallim mes tyre. Kështu populli nxitej të braktiste festat dhe kremtimet fetare, si shfaqja më e dukshme e fesë, dhe orientohej “që të kremtet dhe zakonet e tjera të lidhura me fenë t’i zëvendësonte me festa, me zakone e me norma të reja me përmbajtje socialiste”<sup>4</sup> si festat e partisë dhe ato kombëtare, me 7 e 8 Nëntorin, me 10 Korrikun, 11 Janarin, me 28-29 Nëntorin, 1 Majin, 7 e 8 Marsin, Vitin e Ri, me festat lokale, si krijimi i kooperativës bujqësore, marrjen e prodhimit bujqësor, vjelja e rrushit dhe ullirit, ditëlindjet...etj. Edhe pse Partia Komuniste e mbante veten për parti të punëtorëve dhe i jepte rëndësi punës, aq sa e ngriti atë në kult, dhe i konsideronte festat fetare si pengesë në zhvillimin e punës,<sup>5</sup> ajo e kishte të qartë se feja plotësonte te njeriu nevojën për të kujtuar dhe kremtuar data të shënuara, kështu që ajo krijoi kremtime dhe festa alternative që i kushtoheshin kultit të punës e të partisë, e më pas atdheut, dëshmorëve, luftës, themelimit të republikës, mësuesit, gruas, ushtrisë etj. Qëllimi me këto festa nuk ishte vetëm mbushja e zbrazësisë

<sup>1</sup> Ibid, f.112.

<sup>2</sup> Ibid, f.226

<sup>3</sup> Rudian Zekthi, Dehrijunët, Gazeta Panorama, 11 Janar, 2021. <http://www.panorama.com.al/dehrijunet/>

<sup>4</sup> Historia e Partisë Punës së Shqipërisë. Botimi i dytë. «8 Nëntori», Tiranë, 1981, f. 433.

<sup>5</sup> Ndërkohë që partia komuniste shpikte festa qesharake për krijimin e kooperativave bujqësore, konsideronte sabotim pjesëmarrjen në faljen e së premtes në xhami apo e së dielës në kishë! Shih për këtë Azem Qazimi “Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm” 2012, f.12.

emocionale dhe shpirtërore që linin heqja e kremtimeve fetare, por edhe krijimi dhe mbajtja në këmbë e një kulti të ri, e një feje të re, që kishte doktrinën e saj të shpëtimit, kishte parajsën dhe ferrin e saj tokësor, perënditë dhe profetët e saj të pagabueshëm. Komunistët shqiptarë për këtë shpreheshin se:

Duke hedhur poshtë të gjitha festat fetare, ne duhet të organizojmë festimin e festave tona kombëtare, lokale apo familjare. Por t'i organizojmë më mirë, më bukur, më me madhështi seç i organizonin klerikët. Festat tona duhet t'u mbeten në mendje për një kohë të gjatë njerëzve.<sup>1</sup>

Komunistët me këto festa donin të linin mbresa të fuqishme në popull po aq edhe më shumë sesa festat fetare. Kjo lloj ambicie dhe shpirti për të konkurruar fenë nuk mund të buronte vetëm se nga të qenit vetë një ideologji me nuanca fetare, që nuk kujdeset vetëm për trupin e njeriut, por edhe për shpirtin e tij. Në materialin e përgatitur nga Komiteti Qendror për festat e reja socialiste, ndër të tjera thuhej:

Masat e gjera punonjëse dhe në mënyrë të veçantë rinia, kanë marrë zotime që të heqin dorë nga të gjitha festat dhe ceremonitë fetare, nga zakonet e vjetra dhe prapanike dhe të festojnë festat tona socialiste. Mirëpo kjo nuk mund të bëhet menjëherë. Të zhdukësh diçka, dhe aq më tepër që kjo ka të bëjë me botën shpirtërore të njeriut, nuk mund të bëhet po nuk u zëvendësua me diçka më përparimtare për njeriun.

Pasi materiali në fjalë përmend një sërë festash alternative, që nga ato me karakter kombëtar, politik dhe social, vazhdon dhe thotë:

Zhdukja e festave fetare dhe zëvendësimi i tyre me festat socialiste përbën një problem ideologjik. Këtu nuk është fjala vetëm për zëvendësimin e festave fetare me festat tona, por është fjala për ushqimin e përditshëm shpirtëror që ka nevojë njeriu, prandaj organizatat e partisë dhe organizatat e masave duhet të mendojnë seriozisht si ta organizojnë më mirë edukimin dhe dëfrimin e punonjësve në punë dhe pas pune.<sup>2</sup>

Sigurisht që partia komuniste ja kishte arritur qëllimit, aq sa edhe vetë zëra nga njerëzit e thjeshtë në mesazhet dërguar kreut të kësaj partie shpreheshin duke thënë: “bajram për ne do të jetë prej sot e tutje 29 Nëntori”, apo “feja jonë të jetë shqiptaria”, “feja jonë është Atdheu, prandaj prifti e hoxha s’kanë punë në djepat tanë” apo “Na thonë t’i luftojmë zakonet prapanike, e pra o burra t’i luftojmë, se prapë mirë do t’na dalë. Se ne fe tjetër nuk kemi veç partisë që na ndryshoi jetën e zezë ne dhe gjithë Shqipërisë”<sup>3</sup> dhe të gjitha këto thuheshin në kontekstin e heqjes së festave dhe rriteve fetare nga jeta e tyre.

Madje largimi nga besimi fetar shihej si shërim shpirtëror nga një sëmundje kronike:

paragjykimet dhe mendimet fetare ishin bërë si sëmundje kronike në shpirtin tonë, që nuk kish doktor që të na i shëronte. Po vetëm Ju, shoku Enver, jeni doktor i madh që na

---

<sup>1</sup> Letra e PPSH, synetllëku dhe pagëzimi hiqen me vendim. Gazeta Metropol, 8 Shkurt, 2005 f.27. vepër e cituar siç përmendet në Procesi i Asgjësimit të Fesë në Komunizëm, 2012, f.100.

<sup>2</sup> Cituar në Procesi i Asgjësimit të Fesë në Komunizëm, f.101, 102.

<sup>3</sup> Shih Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare – shprehje e luftës së klasave, Shtëpia Botuese “Naim Frashri”, Tiranë 1967. F.83.

kini shëruar trurin, zemrën dhe shpirtin. Prandaj të rroni sa malet dhe marshi nga ditët tona e të fëmijëve tanë.<sup>1</sup>

Ky shërimi shpirtëror që pretendonin këta njerëz, përmes një ideologjie, që në fakt nuk besonte në ekzistencën e shpirtit, nga besimet fetare në besimin tek partia, nuk mund të ishte vetëm se një fe e re që ngrihej mbi gërmadhat e së vjetrës, ku profeti i saj ishte “Ai”, me shkronjë të madhe, mjeku i madh i trurit, i shpirtit dhe i zemrës, ai që meritonte të sakrifikoje jetën tënde dhe të familjes për të, deri edhe fëmijët, pasuria e paçmuar e prindërve. Për asgjë tjetër, veçse për diçka më të shenjtë sesa jeta e tij dhe e pasardhëseve të tij, mund të sakrifikojë njeriu gjithçka, dhe kjo është: gjëja që ai adhuron. Këtë devocion ndaj partisë dhe liderit të saj e gjejmë në mënyrë të veçantë tek fetë, mes tyre Krishterimi dhe Islami, ku ithtarët e tyre janë të gatshëm të sakrifikojnë gjithçka kanë për Zotin, apo edhe për Krishtin e Muhamedin. Këto janë shenja të qarta të një admirimi dhe adhurimi hyjnor ndaj diktatorit komunist.

Enver Hoxha shihej jo vetëm si një udhërrëfyes i urtë, por si “babai ynë, udhëheqësi ynë, mësuesi dhe mbrojtësi ynë; me Partinë dhe Ju në krye ne e ndjejmë veten të lirë, të fortë e guximtarë në këto male me dëborë”.<sup>2</sup>

Urimet për të ishin nga më të habitshmet, për një jetë mijëvjeçare, për një jetëgjatësi e fuqi malesh “sa fuqia e popullit tonë, sa fuqia e shkëmbinjve tanë, ne dëshirojmë të jetë fuqia dhe shëndeti Juaj, që të na mbron nga çdo e keqe, që të na çoni kurdoherë përpara e të rrojmë si shqipe të lira.”<sup>3</sup> shpreheshin populli i katundit të Shëmrisë, nga malësia e Tiranës, në letrën drejtuar liderit komunist, ku i zotohej se do të hiqnin dorë nga zakonet prapanike dhe ku i premtonin ndër të tjera se “rrugën do ta mbarojmë në përvjetorin e ditëlindjes Suaj.”

Është e habitshme sesi partia komuniste në njërin anë pretendonte se luftonte fenë, zakonet dhe sjelljet fetare, se luftonte kultin e individit, sesi fjalën Zoti, Perëndia, e Allahu, që janë emra të përveçëm i fillonin në shkrim me shkronja të vogla, ndërkohë edhe përemrat që identifikonin liderin komunist si Ju, Juaj, Suaj, Tuaj, Ai etj. i shkruanin me të madhe. Është e habitshme sesi një ideologji që nuk besonte te mrekullitë hyjnore, frymëzonte dhe lejonte urime të tilla absurde, pavarësisht hiperbolizimit të kuptueshëm letrar në të. Kjo është një tjetër shenjë e qartë e idhujtarisë komuniste ndaj liderit të tyre dhe një nga arsyet e rivalitetit me fetë tradicionale në vendin tonë. Këtë konfirmon edhe Maks Velo, ish i burgosur politik, kur shprehej se:

Ideologjia e re komuniste, e paraqitur në një mënyrë të veçantë në Shqipëri nga diktatori Hoxha, donte të bëhej religjion me një zot të ri, atë vetë. Lufta kundër fesë kishte si detyrë edhe zhdukjen e festave kristiane dhe kthimin në ritet pagane... besimi i ri komunisto-enverist donte të bashkëjetonte me paganizmin.<sup>4</sup>

### 3.6 Propaganda antifetare

Duke pasur të gjitha mjetet e propagandës në dorë, shteti komunist prodhoi një masiv kolosal literature të shkruar demagogjike, të parë dhe të dëgjuar, propagandistike, analitike dhe artistike,

<sup>1</sup> Ibid. f.90.

<sup>2</sup> Nga letra dërguar nga fshati Shëmrë i malësisë së Tiranës. Siç citohet në “Nuk ka liri të vërtetë shoqërore pa emancipim të plotë të gruas”, Botim i Shtëpisë botuese “8 Nëntori” Tiranë 1967, f.5.

<sup>3</sup> Ibid. f. 8.

<sup>4</sup> Maks Velo, Kohë antishenjë, Tiranë 2005, botimet Zenit, f. 71.

që sulmonte fenë direkt dhe indirekt dhe brumoste në popull idetë dhe pikëpamjet marksiste dhe ateiste mbi botën. Është gati e pamundur të përmblihet e gjithë kjo propagandë në pak rreshta, sepse ajo shtrihet që nga edukimi i brezit të ri në të gjitha nivelet e arsimit dhe në të gjitha lëndët, e deri tek propaganda e veçantë antifetare.<sup>1</sup> Këtu do të citojmë një pjesë të titujve të literaturës së veçantë kundër fesë, sa për të dhënë një imazh:

- Arif Gashi, *Parajsa dhe ferri* (1963).
- Arif Gashi, *Lufta kundër fesë është luftë për formimin e njeriut të ri* (1974).
- Bik Pepa, *Feja lakuriq: vjersha satirike* (1967).
- Detyra për përhapjen e njohurive shkencore dhe luftën kundër zakoneve të këqija e paragjyqimeve fetare (1967).
- Evgraf Duluman, *Përse nuk besoj më tek zoti: tregim i ish kandidatit të teologjisë* (1963).
- Fehmi Xhuglini, *Mjekësia dhe feja* (1967).
- Forma të mundshme të punës kulturore masive në luftën kundër njollave fetare: në ndihmë të punonjësve të institucioneve kulturore (1967).
- G. V. Platonov, *Darvinizmi dhe feja* (1967).
- Gaqo Konomi, *Mbi origjinën e fesë dhe të besimeve të tjera fetare* (1967).
- Gjystina Shyti, *Kisha dhe kleri katolik i kishës së Shënkollit shfrytëzues të pamëshirshëm të bregamatasve* (1969).
- Hulusi Hako, *Feja e parë nën dritën e shkencës* (1962).
- Hulusi Hako, Kristaq Angjeli, Sotiraq Madhi, Bajram Preza, *Feja është opium për popullin* (1964).
- Hulusi Hako, *Akuzojmë fenë* (1968).
- Hulusi Hako, *Gruaja dhe fëmija-viktima më të ndjeshme të ideologjisë fetare* (1968).
- Hulusi Hako, *Gjyq zotit* (1972).
- Hulusi Hako, *Ateizmi shkencor* (1983).
- Hulusi Halo, *Paraziti shekullor i planetit: Vatikani pa maskë* (1984).
- I. Sbrgajev, *Shkenca dhe supersticionet* (1949).
- I. Lupallo, *Shkenca dhe feja* (1955).
- Iljaz Gogaj, *Mbi rolin reaksionar të klerit në fushën e arsimit: 1878-1939* (1972).
- K. L. Voropajeva, *A ka ekzistuar Krishti?* (1958).
- Kolë Jakova, *Dom Gjoni: komedi me tri akte* (1967).
- Kolë Jakova, Moisi Zaloshnja *Dom Lleshi e Zigur efendiu* (1967).
- Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare- shprehje e luftës së klasave* (1967).
- Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë* (1973).
- Mimoza Dojaka, *Lufta kundër fesë -aspekt i luftës së klasave* (1975).
- Mina K. Qirici, *Thelbi reaksionar i myslimanizmit* (1967).
- Mina K. Qirici, *Çudirat e fesë* (1967).
- Mina K. Qirici, *Si kanë lindur besëtytnitë* (1970).
- M. M. Sheinman, *Vatikani dhe katolicizmi në shërbim të imperializmit* (1951).
- M. Pliseckij, *Origjina e njeriut* (1946).
- M. Melinkov, *Vatikani dhe problemet e rindërtimit të mbas luftës* (1947).
- M. Melinkov, *Kapitalet e Vatikanit* (1947).
- Mbi fenë: pjesë të nxjerra nga veprat e K. Marksit, F. Engelsit, V.I. leninit, Stalinit dhe Mao Ce-Dunit* (1967).

---

<sup>1</sup> Për më shumë në këtë drejtim shih *Roli i mediave në propagandën ateiste në periudhën totalitare*, punim doktore nga Sokol Paja, Tiranë 2018.



- Mbi festat dhe të kremtimeve fetare (1967).
- P. Popov, *Mbi politikën e Vatikanit* (1947).
- P. Kolloniskij, *Marxizëm-leninizmi mbi fenë* (1951).
- Petro Marko, *Urata, dhia dhe perëndia: tregime* (1967).
- Pishtar i madh revolucionar që do të djegë mbeturinat e këqija të së kaluarës (1967).
- PPSH mbi fenë dhe edukimin ateist-shkencor të punonjësve : pjesë të nxjerra nga veprat e shokut Enver Hoxha dhe nga dokumente e materiale të tjera të PPSH (1967).
- Rakip Beqaj, *Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik shqiptar* (1969).
- Rakip Beqaj, *Veprimtaria armiqësore e klerit katolik shqiptar 1945-1971* (1973).
- Sami Leka, *Biseda mbi fenë dhe dijen* (1970).
- Sotir Melka, *Dëmet e rriteve dhe festave fetare* (1967).
- Sotir Melka, *Shkenca dhe feja janë të papajtueshme* (1968).
- Studentët e fakultetit histori-filologji, *Të shkulum nga rrënjët ideologjinë fetare* (1967).
- Shkenca dhe feja janë të papajtueshme* (1968).
- Ulvi Vehbiu, *Të ruajmë shëndetin: Sëmundjet psibike dhe feja* (1968).
- Viron Koka, *Ideologjia reaksionare e klerit në vitet 30 të shekullit XX* (1969).
- Zihni Sako, *Populli dhe feja* (1967). etj...<sup>1</sup>

Këto dhe materiale të tjera, botoheshin me tirazhe mijëra kopjesh dhe kanë shërbyer gjatë regjimit diktatorial si burimet bazë të ushqimit shpirtëror, ideologjik konceptformues të brezit të ri dhe “njeriut të ri socialist”.

### 3.7 Bilanci tragjik i luftës kundër fesë

#### *Klerikët e dënuar*

Pjesë e luftës kundër fesë ishte denigrimi, tallja dhe ofendimi i klerikëve, i cili nisi që herët. Aq sa klerikët detyroheshin të ankoheshin në qendrat e tyre në Tiranë, për fyerjet dhe talljet që u bëheshin, madje edhe rrahjet në publik.<sup>2</sup> Por kjo nuk ishte asgjë me burgosjet, torturat dhe vrasjet që ky regjim i shkaktoi klerit.

Numri i klerikëve katolik, të vrarë pa gjyq, të pushkatuar dhe vdekur nga torturat nëpër burgje nga komunistët, i publikuar deri më tani, është 63 vetë.<sup>3</sup> Sipas një tjetër burimi numri i klerit katolik të dënuar qe gjithsej 127 vetë.<sup>4</sup> Ndërsa sipas Pjetër Pepës numri i atyre që vuajtën prëndjekjet e diktaturës qe gjithsej 228 vetë, prej të cilëve 122 autori pohon se i ka njohur vetë.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Për këto tituj dhe të tjerë mund të shihet faqja e Bibliotekës Kombëtare online. <https://www.bksh.al/>

<sup>2</sup> Shih Azem Qazimi, *Procesi i Asgjësimit të Fesë në Komunizëm*, f.21, 22.

<sup>3</sup> Kastriot Dervishi, *Martirët e klerit katolik shqiptar të masakruar nga komunistët*, <http://www.observatorikujteses.al/martiret-e-klert-katolik-shqiptar-te-masakruar-nga-komunistet-ne-vitet-1944-1989/>

<sup>4</sup> Hysamendin Ferraj, në *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Shkup 1999, shih f. 345.

<sup>5</sup> Pjetër Pepa, “Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri”, siç citohet në <https://www.proletari.com/tragjedia-dhe-lavdia-e-kishes-katolike-shqiptare/html>

Numri i publikuar i klerikëve myslimanë, të vrarë pa gjyq, pushkatuar dhe vdekur nëpër burgje, është 18, ndërsa të burgosur 52 vetë.<sup>1</sup>

Numri i publikuar i klerikëve bektashinj, të vrarë, pushkatuar dhe vdekur nëpër burgje është 10 vetë, ndërsa të burgosur 25 vetë, të internuar 6 vetë.<sup>2</sup> Bektashinjtë kanë edhe një numër të caktuar klerikësh të vetëvrarë, në rrethana të paqarta, por kryesisht besohet për shkak të gjendjes së vështirë të persekutimit.

Numri i publikuar i klerikëve ortodoks, të pushkatuar dhe vdekur nëpër burgje është 5 vetë, ndërsa i atyre të burgosur 3 vetë, që kanë qenë edhe disa nga krerët e Kishës Ortodokse.<sup>3</sup>

Padyshim që këto shifra, për të gjitha komunitet janë të mangëta, pasi akoma nuk ka një bilanc të plotë të të gjithë klerikëve që janë persekutuar nga regjimi komunist, duke përfshirë pushkatimin, burgosjen, internimin dhe përndjekjen që i shoqëronte gjatë gjithë jetës. Kështu që edhe këto shifra ngelen vetëm një panoramë e cunguar, por deri diku e mjaftueshme për të kuptuar përmasat kriminale të atij regjimi ndaj fesë dhe klerikëve të saj. Mjafton të përmendim që sipas të dhënave të vetë komunistëve numri total i klerikëve profesionistë në 1967 që dilnin pa punë nga mbyllja e objekteve të kultit ishte 912 të tillë, ku nga këta rreth 550 ishin hoxhallarë,<sup>4</sup> rreth 400 priftërinj, dervishë, shehlerë etj.<sup>5</sup>

#### *Mbyllja e objekteve të Kultit*

Sipas një raporti të Komiteti Qendror, sektori i edukimit i datës 30 Gusht 1967, të publikuar në media, thuhet: “Me përjashtim të kishës së madhe të Tiranës dhe kishës katolike, në të gjithë vendin janë mbyllur të gjitha kishat, xhamitë, teqetë, tyrbet, vakëfet etj. Ky numër arrin gjithsej në 2169, nga të cilat 740 xhami, 608 kisha ortodokse e manastire, 157 katolike, 530 teqe, tyrbe, mekame etj.”<sup>6</sup> Dhe të gjitha këto ndodhën brenda vetëm disa muajve, akoma pa dalë dekreti për nxjerrjen jashtë ligjit të komuniteteve fetare dhe tërësisht në kundërshtim me atë çfarë vetë diktatori kishte orientuar si metodë lufte ndaj fesë! Kjo tregon sesa i paqëndrueshëm dhe i paparashikueshëm ishte ky njeri, sa vetëm pak muaj më parë këmbëngulte se rruga e vetme ishte ajo e bindjes dhe e shkatërrimit gradual të fesë “se në asnjë mënyrë nuk duhet të acarohemi me popullin për majën e një minareje, e cila në rast se nuk rrëzohet sot, do të rrëzohet mot, kur

<sup>1</sup> Rolad Hysa, Listë e hoxhallarëve dhe figurave të shquara muslimane të dënuar dhe të persekutuar nga regjimi komunist, Revista Kibla, nr. 2, shtator dhjetor 2017, <http://hoxhallaret.al/2018/03/19/liste-e-hoxhallareve-dhe-figurave-te-shquara-muslimane-te-denuar-dhe-te-persekutuar-nga-regjimi-komunist/>

<sup>2</sup> Persekutimi i klerit bektashi, faqja zyrtare e Komunitetit Bektashi <https://kryegjyshataboterobektashiane.org/persekutimi-i-klert-bektashi/>

<sup>3</sup> Andon Merdani, Mitropolitit i Elbasanit, <https://interreligiouscenter.com/martiret-e-besimeve-deshmi-atdhedashurie/>

<sup>4</sup> Sipas të dhënave të AQSH, Fondi nr. 890, të vitit 1952, dosja nr. 1427, 23 referuar në “Pluralizmi i besimit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri”, f.94, Komuniteti Mysliman kishte rreth 1500 vetë personel fetar dhe ndihmës, ku nga këta 1269 ishin hoxhallarë të thjeshtë.

<sup>5</sup> Raport informativ: Mbi Rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe Disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj (30. 08. 1967) <http://www.observatorikujteses.al/shqipëria-ateiste-si-u-shemben-2169-kisha-e-xhami/> Këtu vihet re se shuma del të jetë rreth 950 klerikë dhe jo 912, ndërkohë tek shifrat e detajuara mund të jenë përfshirë edhe klerikë joprofesionistë, siç i quan raporti.

<sup>6</sup> Raport informativ: Mbi Rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe Disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj (30. 08. 1967) <https://shqiptarja.com/lajm/lufta-kund-euml-r-fes-euml-nbsp-si-u-mbyll-euml-n-brenda-br-gjasht-euml-muajve-2-169-kisha-e-xhami?r=app> shiko dhe <http://muzeuimemories.info/rreth-muzeut/>

populli të bindet për kotësinë e besimeve fetare”<sup>1</sup> dhe ndërkohë në një kohë shumë të shkurtër miratonte ligje dhe hidhte në veprim turmat historike, për t’i dhënë fund sa më shpejt infrastrukturës fetare.

### *Sekuestrimi i pronave*

Bashkë me institucionet fetare u morën nga shteti edhe pasuritë e paluajtshme të komuniteteve, të cilat kaluan në pronësi të shtetit, duke iu dorëzuar komiteteve ekzekutive, ato që ishin në qytet, kurse ato në fshatra iu kaluan kooperativave bujqësore.<sup>2</sup> Kuptohet një pjesë e tyre u prishën, madje i njëjti raport tregon se është kërkuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, që të ulet numri i objekteve të kultit që nuk do të shkatërrheshin, që sipas tyre nuk kishin vlera historike dhe arkitektonike. U tjetërsua pamja e tyre, që të mos u kujtonte në heshtje njerëzve -siç thotë raporti i KQ- kishën dhe xhaminë dhe shenjtërinë e tyre sepse “te brezat që rriten ndikon keq psikologjikisht”.<sup>3</sup>

Këto objekte u përdhosën duke u kthyer në kinema, shtëpi e vatra kulture, palestra, depo dhe magazina, ofiçina mekanike, pallate sporti, hotele, muze, teatro, reparte ushtarake, klube e garazhe, deri edhe në stalla bagëtish.<sup>4</sup> Ndërkohë marrja e pasurive të komuniteteve kishte nisur që para 67’ dhe vetëm Komunitetit Mysliman deri në atë vit i ishin marrë 3163 hektarë tokë dhe 61 mijë rrënjë ullinj.<sup>5</sup> Vetëm nga reforma agrare, institucioneve fetare ju morën 480 pasuri të mëdha.<sup>6</sup> Sipas një materiali propagandistik të asaj kohe thuhet se institucionet fetare zotëronin 4224 hektarë tokë, dhe rreth 70 mijë rrënjë ullinj, shumë bagëti, pyje, kullota dhe godina.<sup>7</sup>

Natyrisht këto ishin vetëm disa nga dëmet fizike dhe materiale që komunizmi i shkaktoi besimeve fetare, por dëmi më i madh që ai i bëri shqiptarëve ishte produkti i tij njerëzor, “njeriu i ri socialist”, që nuk u bë kurrë ajo qenie imagjinare për të cilën ëndërronte komunizmi shqiptar, por që rezultoi një hibrid identitar, frytet negative të të cilit i kemi parë gjatë gjithë këtyre tre dekadave .

### **3.8 Mbijetesa e fesë nën regjimin komunist**

Pavarësisht të gjithë luftës që u bë kundër besimit fetar, vetë pushteti komunist ishte i bindur se feja mbijetonte në forma të tjera më të dobëta dhe shfaqej si rudiment i zakoneve dhe traditave të së kaluarës, në ato që ai i quante zakone prapanike dhe fetare. Dhe feja mbijetoi pikërisht përmes një kulture popullore, të përhapur në gjuhën e folur, në urtësinë tradicionale të shprehjeve popullore, në ceremonitë mortore, në raste lindjesh dhe martesash, në artin dhe folklorin e trashëguar popullor, madje edhe përmes atyre besëtytnive që fetë i refuzojnë...etj. Edhe pse “syri vigjilent i partisë rrinte gjithmonë zgjuar” për të luftuar edhe këto “mbetje”, ato mundën t’i mbijetonin në fshehtësi represionit dhe ndalimit, dhe jo vetëm këto, por edhe adhurime të mirëfillta fetare siç qenë agjërimi, kremtimi në fshehtësi i festave fetare, dhe simbolikave që i shoqëronin ato. Apo siç shprehet një studiuese “kripto-muslimanët dhe kripto-

<sup>1</sup> Enver Hoxha, Vepra 35, f.226.

<sup>2</sup> Raport informativ: Mbi Rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe Disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj (30.08.1967) Ibid.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Ibid. Shih gjithashtu “Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm” f.110, 111.

<sup>5</sup> AQSH, f.1005, viti 1966, D.24, Fl.22, siç referohet në Procesi i Asgjësimit të Fesë në Komunizëm, f.13.

<sup>6</sup> Shih “Pluralizmi i besimit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri”, f.106.

<sup>7</sup> Ibid, f.108.

të krishterët u shfaqën edhe një herë, megjithëse në një formë të re. Nëse gjatë okupimit osman frymëzimi vinte nga ngurrimi i dikujt për të ndryshuar fenë, gjatë periudhës komuniste frymëzimi vinte nga vullneti për të mbijetuar nën diktaturë.”<sup>1</sup>

Nuk duhet harruar gjithashtu se, ndalimi i dhunshëm i diçkaje që kanë qenë pjesë e pandarë e jetës njerëzore, jep shpesh efekt të kundërt dhe “molla e ndaluar” bëhet më e dashur. “Madje, në shumë raste, persekutimi krijon efektin e kundërt, rrit pjesëmarrjen dhe shtyn një pjesë të madhe të njerëzve ta lidhin përkatësinë e tyre fetare me qëndrimet e tyre politike kundër regjimit.”<sup>2</sup>

“Goditja që iu dha fesë, vërtet e shkatërroi fenë nga pikëpamja institucionale, por, në një farë kuptimi e forcoi ndjenjën fetare... Ndalimi me ligj i fesë nuk do të thotë se ajo u likuidua përfundimisht. Besimtari nuk u ndodh para asgjësë, përderisa ai kishte një zot ekzistencial, një “Ti” hyjnor, të cilit mund t’i lutej në heshtje dhe strukturat e pushtetit nuk mund t’ia zbulonin. Pra, ndalimi me ligj i fesë nuk do të thotë se besimi u zhduk përfundimisht. Ai gjeti forma të mbijetonte.”<sup>3</sup>

## **Kapitulli IV: Rigjallërimi fetar në Shqipëri pas rënies së komunizmit**

4.1 Qasje teorike: Shembja e komunizmit dhe rigjetja e fesë

4.2 Kriza e shtetit komunist dhe rigjetja e fesë

4.3 Rikthimi i shqiptarëve te feja

4.4 Kuadri ligjor i lirive fetare

4.5 Ngritja e infrastrukturës fetare

4.6 Vështrim mbi përqindjet e përkatësive fetare në Shqipëri

---

<sup>1</sup> Celá, Elira, Historical background and characteristics of the evolution of Islam in Albania. Innovation in Social Sciences Research. 1992, Vol. 5 Issue 3, p115-125. 11p.

<sup>2</sup> Giovanni Cimbalo, Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetar në Shqipëri, f. 151

<sup>3</sup> Gjergj Sinani, Feja dhe edukimi, f.8.

## **Rigjallërimi fetar në Shqipëri pas rënies së komunizmit**

### **4.1 Qasje teorike: Shembja e komunizmit dhe rigjetja e fesë**

Çfarë e disfavorizonte rikthimin te feja?

Shqipëria kishte jetuar për gati gjysmë shekullin nën një regjim, i cili theksin e vinte tek “krijimi” i njeriut të ri. Ky njeri në mes të tjerash mbarte edhe një identitet jofetar, antireligjioz dhe materialist. Të gjitha format e edukimit të tij ishin të atilla që përjashtonin çdo ndikim apo përfshirje të fesë në të, qoftë edhe si element dytësor kulturor. Pushteti i atëhershëm dhe të gjitha institucionet e tij i përçuan shoqërisë shqiptare me të gjitha format dhe mënyrat e mundshme një frymë antifetare, përçmuese dhe urrejtëse ndaj fesë dhe çdo gjëje që lidhej me të. Dhe së fundi ideologjia materialiste, pa asnjë vlerë shpirtërore metafizike, ishte tipari thelbësor nga i cili karakterizohej formimi i “njeriut të ri”.

Këto tre element, edukimi ateist, lufta ndaj fesë dhe ideologjia materialiste, ishin faktor të fuqishëm të cilët të bëjnë të mendosh se rigjallërimi fetar ishte disfavorizuar mes njerëzve. Pas lënies së lirë të besimit, duhej që ky besim të kufizohej vetëm tek ai brez njerëzish, të cilit e kishin jetuar kohën e lirisë së besimeve fetare dhe nuk ishin tjetërsuar plotësisht nga tre elementët e mësipërm. Është diçka interesante në fakt sesi ndoshta një pjesë e mirë e intelektualëve shqiptarë nuk e kanë menduar kurrë se do të kishte një rikthim të dukshëm te feja nga shqiptarët, madje edhe nga zëra të shquara të tilla si Ismail Kadare.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Në një intervistë dhënë për Top Channel më 16 Shkurt 2015, për emisionin “Shqip” Kadare pohon ndër të tjera se në bisedë me Ramiz Alinë, ku i kërkonte të rihapeshin objektet e kultit, i kishte thënë atij se afrimi i shqiptarëve me

Kështu që bazuar në këto premisa ajo çka ndodhi pas viteve 90' ishte diçka e papritur, për nga përmasa dhe shtrirja, çka na shtyn të kërkojmë më thellë në arsyet dhe shkaqet që lidhen me vetë efektin që la regjimi i dikurshëm te njerëzit si dhe me realitetin e ri me të cilin ata u përballën pas tij. Pikërisht këtë konstatim shpreh edhe Huntington kur thotë: “Kudondodhja dhe pesha e fesë dolën në dukje befasisht në shtetet e mëparshme komuniste. Duke mbushur zbrazëtinë e lënë nga rënia e ideologjisë, ringjallja fetare është përhapur në këto vende prej Shqipërisë deri në Vietnam.”<sup>1</sup>

#### 4.2 Kriza e shtetit komunist dhe rigjetja e fesë

Për mijëra vjet, por edhe sot, feja ka luajtur një rol të dorës së parë në krijimin e institucioneve shoqërore dhe mbarëvajtjen e tyre. “Feja është në themelin e rendit shoqëror.”<sup>2</sup> Me ardhjen e epokës së modernitetit roli i fesë në këtë drejtim filloi të kalojë gjithmonë e më shumë në duart e shtetit-komb, i cili nga ana e tij krijoi institucione të tjera. Por institucionet që krijoi dhe pasuan krijimin e shteteve kombe, shpesh përballen me kriza, sidomos në kohët e sotme. Këto institucione ishin të shenjta për shtetin-komb, kështu që tronditja e këtyre shenjtërive vjen me pasoja direkt të ndjeshme në botëkuptimin e njerëzve. Kjo sepse njeriu në natyrën e tij gjithmonë kërkon të mbështet në siguri, të cilat për të kthehen në shenjtëri. Kështu që krizat që tronditën këto siguri-shenjtëri sjellin për njerëzit një gjendje pasigurie dhe çorientimi. Në një situatë të tillë shoqëria ose pjesë të caktuara të saj vihen në kërkim të orientimeve dhe sigurive të reja. Natyrisht, që fetë janë shumë më të vjetra sesa shteti-komb dhe institucionet e tij, kështu që ato do të jenë sërish pikë reference të forta për mjaft individ dhe shoqëri.

Në këtë kontekst edhe Peter Berger shprehet duke thënë:

Modernizimi, për arsye plotësisht të kuptueshme, minon të gjitha siguritë e vjetra; pasiguria është një gjendje që shumë njerëz e kanë shumë të vështirë ta durojnë; Prandaj, çdo lëvizje (jo vetëm fetare) që premtun të sigurojë ose të ripërtërijë sigurinë ka një treg të gatshëm.<sup>3</sup>

Edhe Manlio Graziano në të njëjtin kontekst thotë:

Kriza që pësuan institucionet e shtetit e në veçanti ato të shtetit komunist, i cili kishte marrë përsipër të ishte gjithçka për qytetarin, shkaktuan pasiguri dhe çorientim. Kështu që individët, në radhë të parë, ishin dhe janë në kërkim të pikave të reja dhe të forta të referimit. Sigurisht që fetë dhe besimet fetare që ekzistojnë shumë më herët sesa shtetet-kombe dhe që qenë në gjendje t'i mbijetonin atij dhe në veçanti atij komunist, përbëjnë për shumë njerëz pikën më të fortë të referimit.<sup>4</sup>

Komunizmi ishte një produkt modern që kishte dështuar, pikërisht në përmbushjen e idealit të tij përfundimtar, i cili ngeli një dëshirë e porealizuar dhe si e tillë ajo u kthye në një zhgënjim:

---

Evropën vetvetiu do të shtonte numrin e ateistëve..., dhe se ky parashikim i tij nuk doli i vërtetë. <https://www.youtube.com/watch?v=ywoG13ro9NI>

<sup>1</sup> Samuel P. Huntington, Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror, botuar nga Logos-A, 2004. f. 146.

<sup>2</sup> Agust Komti, në Teoritë Sociologjike, nga Lewis Coser & Larry Ridener, Botuar nga “Plejad”, Tiranë 2005, f.24.

<sup>3</sup> Berger, Peter L. 1999. The Desecularization of the World: Resurgent Religion and World Politics. Washington and Grand Rapids: Ethics and Public Policy Center. f.7.

<sup>4</sup> Graziano, Manlio, Lufta e Shenjtë dhe e Shenjta Aleancë, Bot. Saras fq.17.

Kur plotësimi i një dëshire bëhet qartësisht dhe përfundimisht i pamundur, atëherë iluzioni shndërrohet në zhgënjim, besimi tek progresi kthehet në skepticizëm. Në këtë moment vetëm një besim i ri mund ta nxjerrë njeriun nga kjo gjendje e dëshpërimit, dhe ky është një besim i ri mundësisht që ushqen një ideal më të fortë se i pari.<sup>1</sup>

Gjergj Sinani shprehet:

Në kushtet e një mungese të gjatë të lirisë së fesë dhe kur jeta kulturore ishte monokulturore, si dhe sistemi i vlerave ishte i komanduar dhe i kontrolluar nga një strukturë tepër e përpunuar, kalimi në një stad të ri të shoqërisë nuk mund të mos shoqërohej nga një lloj krize në sistemin e vlerave, përfshirë këtu edhe vlerat morale. Kuptohet se në këto kushte feja do të luante një rol të rëndësishëm në jetën shpirtërore të njerëzve. Për një kohë të gjatë njerëzit e sunduar nga ideologjia zyrtare kishin identifikuar veten me institucione të tilla si partia, bashkimet profesionale, organizatat e masave zyrtare etj. Pas vitit 1991, njerëzit besuan në premtimet e partive mbi vendosjen e demokracisë, shtetit të së drejtës, drejtësinë sociale etj. Viti 1997 goditi shumë besime dhe iluzione për sistemin demokratik. Në kushtet kur ndjenja e pasigurisë thellohet, njerëzit kërkojnë dikë ose diçka, që të mund t'u garantojë, në mos jo sigurinë e plotë, të paktën ndjenjën e sigurisë. Një nga karakteristikat e traditave fetare është se ato përcaktojnë normat dhe vlerat e aderuesve të tyre.<sup>2</sup>

Edhe të tjerë studiues vënë në dukje boshllëkun që la rënia e komunizmit dhe rikthimi te feja si pjesë e zëvendësimit të humbjes:

Padyshim që në fillim të shekullit të njëzet e një, shembja e komunizmit dhe rënia e idealizmit socialist, mund të kenë lënë një vakum ideologjik. Kundërshtimi i mbështetjes në forcat e tregut dhe dëshira për t'u kthyer në një mënyrë jetese më të përbashkët, më tradicionale, vazhdon, sidomos në kohë krize, por tani ideologjitë fetare, që dikur mendoheshin si anakronizma të së shkuarës, në pjesë të ndryshme të botës po kthehen në modë.<sup>3</sup>

Ideologjitë e vjetra u diskredituan nga shembja e Bashkimit Sovjetik dhe ideologjisë Komuniste, ndërsa premtimi i përfitimeve madhështore nga shteti liberal-demokratik, kapitalist... dështoi të materializohet në shumë vende nëpër botë.<sup>4</sup>

Siç shihet edhe nga këto pohime rikthimi tek feja, nuk shihet vetëm si krizë e ideologjisë komuniste, por edhe si krizë e vetë modernizimit dhe siç thotë Graziano, se ndonëse kjo krizë është përjetuar nëpër botë në mënyra të ndryshme, qofshin këto vende të zhvilluara apo në zhvillim, kjo krizë “u ktheu të gjitha feve funksionin e tyre të spirancës së inkurajimit dhe ngushëllimit, kur zgjidhjet njerëzore shfaqin kufijtë e tyre.”<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Ibid, f.43.

<sup>2</sup> Gjergj Sinani, Feja dhe edukimi, f.8.

<sup>3</sup> Si Ndryshojnë Shoqëritë, Daniel Chirot, bot. AIIS, Tiranë 2012, fq. 204

<sup>4</sup> Bruce Hoffman, Inside Terrorism (New York: Columbia University Press, 1998), 87., siç citohet nga Mohgadam 2003, f. 63.

<sup>5</sup> Graziano, Manlio, Lufta e Shenjtë dhe e Shenjta Aleancë, Bot. Saras fq.22.

Samuel Huntington mendonte se rigjallërimi fetar, pavarësisht shkaqeve lokale, fakti që ka përmasa globale, kërkon një shpjegim global dhe krahas shkaqeve specifike të secilit vend, ka edhe anën e përgjithshme të tij, që është tepër e rëndësishme. Sipas tij, vetë modernizimi shoqëror, ekonomik dhe kulturor që përfshiu botën në gjysmën e dytë të shekullit XX, është shkak i dukshëm dhe i fuqishëm i rigjallërimit fetar, edhe pse pikërisht ky proces mendohej si shkak vrasës i fesë. Ai pohon se duke qenë se, burimet e dikurshme të identitetit dhe autoritetit u prishën, sidomos me dështimin e komunizmit, për të qenë një ideal i suksesshëm, si në planin ideor, shpirtëror ashtu edhe ekonomik, atëherë ky dështim shkaktoi një krizë identitare. Por, njerëzit kanë nevojë për burime të reja identiteti dhe forma të reja të një bashkësie të qëndrueshme, si dhe për parime të reja morale, që t'u japin atyre ndjenjë kuptimi dhe qëllimi në jetë, dhe pikërisht feja e përmbush këtë më së miri, thotë ai. Sipas Huntingtonit, më të ekspozuarit ndaj kësaj krize janë pikërisht ata që e kanë pësuar më së shumti nga zhvillim i vrullshëm i modernizimit, që reflektohet nga urbanizimi grupeve të mëdha të popullsisë, të cilat zhvendosen nga fshati apo zona të tjera, drejt qyteteve dhe metropoleve, duke ndërë më shumë se çdokush nevojën për socializim, bashkësi dhe komunitet, që do t'u japë atyre një identitet të qëndrueshëm.<sup>1</sup>

Është pikërisht kjo ajo që ka ndodhur edhe në vendin tonë, ku dukshëm të ardhurit nga zonat rurale dhe qytete të tjera drejt Tiranës dhe qendrës së Shqipërisë, apo edhe në qytete të tjera të mëdha, qofshin këta edhe studentë me banim të përkohshëm, ishin ata që iu rikthyen më së shumti fesë. Por, nuk duhet menduar se kjo përfshiu vetëm shtresën rurale të popullsisë, edhe pse është e kuptueshme që pjesa më e madhe do të ishte prej tyre, por përfshiu edhe ata qytetarë, të cilët të përballur me ndryshime të strukturës sociale, që sollli dyndja në qytet, pa harruar këtu zbrazëtirën që la rënia e komunizmit, u lindi nevoja që edhe ata të rigjenin vetveten në këtë realitet të ri social.

Në një kohë ndryshimesh të forta shoqërore, siç pësoi vendi ynë pas 90', identitet e dikurshme u lëkundën, e disa edhe u tretën, dhe kjo kërkonte një ripërcaktim të vetvetes, për të adoptuar një identitet të ri. Natyrisht këtu me identitet të ri, nuk nënkuptohet detyrimisht diçka që nuk ka ekzistuar kurrë më parë dhe nuk ka qenë absolutisht prezentë deri në atë kohë, qoftë edhe si pjesë e një trashëgimie të harruar apo të zbehur nga komunizmi, por këtu kemi për qëllim rigjetjen e këtij identiteti të humbur në kohë. Në fakt njerëzit në shumicën e rasteve ka gjasa ta gjejnë këtë identitet të ri, pikërisht te trashëgimia e tyre, tek identitet dytësore e të mbuluara sociale apo edhe etnike, që ata kanë pasur edhe më herët.

Njerëzit ballafaqohen me pyetjen: Kush jam unë? Ku bëj pjesë? Dhe feja i jep përgjigje bindëse të parës, ndërsa bashkësitë fetare u sigurojnë njerëzve socializimin, që ata humbën përmes urbanizimit të ri të menjëhershëm.<sup>2</sup>

Fakti që kriza identitare që shkaktoi rënia e komunizmit nuk qe e thellë dhe tragjike për shumë shqiptarë, tregon se identitet e tjera sociale të tij ishin aty, edhe pse të pakspozuara dhe të dobëta. Feja i kishte mbijetuar komunizmit, pavarësisht të gjitha dëmeve që ajo pësoi. Ajo ishte aty si alternativë që do të merrte jetë për të zëvendësuar pikërisht atë që kishte qenë armiku i saj më i madh dhe uzurpuesi i vendit të saj në shpirtat e njerëzve. “Në Rusi ringjallja fetare -thotë

<sup>1</sup> Shih “Përplasja e qytetërimeve” f. 147.

<sup>2</sup> Ibid.



Huntington- është pasojë e dëshirës së flakët për identitet, të cilin mund ta japë vetëm kisha ortodokse, lidhja e vetme e pashkëputur me rusët e njëmijë vjetëve të shkuara.”<sup>1</sup>

“Në një vështrim më të përgjithshëm -pohon Huntington- ringjallja fetare në mbarë botën është një reagim kundrejt shekullarizmit” dhe kjo vlen edhe për shqiptarët, të cilët kishin kaluar një nga regjimet më të egra shekullariste, por ndërkohë në pikëpamjen e Huntingtonit, ishte reagim edhe ndaj “relativizmit moral e vetëkënaqjes” i cili duket se u shfaq shumë shpejt me hapjen e shqiptarëve ndaj botës, “si dhe ripohim i vlerave të rendit, disiplinës, punës, ndihmës reciproke e solidaritetit njerëzor”<sup>2</sup> vlera këto që filluan të humbin shumë shpejt pas rënies së komunizmit.

Nëse rigjallërimi fetar është një lëvizje edhe anti-shekullare atëherë vlen edhe pohimi i Bergerit, se duke qenë se baza sociale e shekullarizimit ishte elita, atëherë për pasojë edhe rigjallërimi fetar (Berger e quan *deshkullarizim*) përtej motiveve thjesht fetare, është një “lëvizje proteste dhe rezistence kundër një elite laike”.<sup>3</sup> Madje Bryan Turner shprehet se “Ne mund të shprehemi me një farë ironie se çdo përpjekje për laicizimin e mëtejshëm të shoqërisë, shoqërohet me një rritje të rëndësisë së fesë në sferën publike.”<sup>4</sup>

E parë me këtë sy e aplikuar në rastin e Shqipërisë mund të themi se rigjallërimi fetar është fakt se reflekton deri diku edhe një konflikt social të heshtur dhe shpesh të nënkuptuar dhe të pa artikuluar dhe ekspozuar, që është konflikti latent veri jug. Në këtë kontekst rigjallërimi fetar, i cili dukshëm ka prekur më së shumti zonat veriore, katolike dhe myslimane dhe shumë më pak ato jugore, ortodokse, myslimane dhe bektashiane, është në një farë mënyre edhe shprehje e një revanshi identitar ndaj ish elitës komuniste shekullariste që vinte më së shumti nga jugu i Shqipërisë. Ky identitet i ndrydhur fetar i veriut, natyrisht është ruajtur edhe gjatë kohës së komunizmit dhe ka shërbyer edhe si një lloj disidence e heshtur ndaj atij regjimi, dhe në momentin e rënies së komunizmit në Shqipëri ai rigjallërohet për t’u bërë më i fuqishëm dhe i dukshëm, si një shenjë ngadhënjimi ndaj elitës së dikurshme komuniste dhe regjimit të saj. Natyrisht si në veri ashtu edhe në jug ka pasur zona që kanë qenë më fetare ose më laike si në atë kohë edhe në këtë kohë, por nëse shihen me kujdes do të vihet re se pikërisht zonat më fetare dikur kanë qenë edhe më anti-komunistet si gjatë regjimit dhe më pas. Kjo është reflektuar p.sh. sidomos në ato vitet e para edhe në pjesëmarrjen politike, ku Partia Demokratike p.sh. si forca e parë dhe më e madhe që doli kundra regjimit të dikurshëm në përbërjen e saj kishte më shumë shqiptarë të veriut, myslimanë dhe katolik, në dallim me Partinë Socialiste, e cila shihej si vazhdimësi e Partisë së Punës, në të cilën dominonin dikur ateistët dhe jugorët.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Huntington, f.149.

<sup>2</sup> Ibid.

<sup>3</sup> Berger 1999, f. 11.

<sup>4</sup> Turner, Bryan S. Sociologjia dhe studimi i fesë, e shenjta dhe laikja në shoqëritë moderne. Në “Shkencat e shoqërisë”, editor Fatos Tarifa, Onufri, Tiranë, 2013. f.466.

<sup>5</sup> Sipas një anketimi të Institutit të Studimeve Politike, mes delegatëve të Partisë Socialiste në 2004, mbi 30% e tyre deklaroheshin se ishin ateistë, ndërsa sipas anketimit të 2016 ky numër ishte 12,7%. Shih: <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2019/02/Gjetjet-kryesore-te-sondazhit-te-ISP-ne-Kongresin-e-PS-19-03-2016.pdf> Ndërkohë që sipas të njëjtit burim numri i ateistëve në delegatët e Partisë Demokratik në një anketim të 2018 numri i ateistëve ishte 2% kundrejt 98% që deklaroheshin me një identitet fetar të caktuar. Sipas të njëjtit burim përqindjet nuk kanë ndryshuar pothuajse nga të dhënat e vitit 2005. Shih: <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/05/ISP-GJETJET-KRYESORE-NE-ANKETIMIN-E-ZHVILLUAR-NE-KUVENDIN-E-PD-2018.pdf>

### 4.3 Rikthimi i shqiptarëve te feja

Ideologjisë dhe praktikave komuniste kishte filluar t'i ndjehej dështimi i saj që nga fundi i viteve 80' në Shqipëri. Kjo nuk vihej re vetëm në nivelin shtetëror të dështimeve ekonomike, por edhe te njerëzit e thjeshtë, të cilët e shfaqnin pakënaqësinë në bisedat e tyre private, në etiketimet e koduara që i bënin emrit të diktatorit të vdekur komunist, në ndjekjen e kanaleve të huaja televizive, kryesisht ato italiane, në tendencat e reja të modës që shfaqeshin aty këtu, në pëlqimin e muzikës perëndimore, në dëgjimin e kanalit të “Zërit të Amerikës”, në një lloj shprese për ndryshim që i kishte kapluar një pjesë jo të vogël të njerëzve. Natyrisht këtë gjë e favorizoi edhe një farë klime zbutje që u ndje në atë kohë nga regjimi, sidomos nga disa hapa që u hodhën në drejtim të zbutjes së diktaturës komuniste, siç qe miratimi në 8 maj 1990 nga Kuvendi i Shqipërisë i disa reformave për të drejtat e njeriut, mes të cilave edhe ndryshimin e ligjit për kalim të paligjshëm të kufirit, i cili me këtë vendim nuk konsiderohej më si tradhti e lartë ndaj atdheut, që mund të dënohej edhe me vdekje, por si vepër penale që mund të dënohej maksimumi deri me 5 vjet burg.<sup>1</sup> Vizita për herë të parë e Sekretarit të Përgjithshëm i OKB-së, Perez De Kuelar, ishte padyshim një sinjal se diçka e madhe po ndryshonte në Shqipëri. Natyrisht rol të madh ndikues në këtë drejtim, patën zhvillimet në Evropën lindore dhe proceset transformuese që ndodhën në to, që nga revoltat popullore në Poloni dhe Hungari në fillim të 1989, deri te rënia e murit të Berlinit në 9 nëntor të po atij viti dhe më pas ngjarjet e Rumanisë.

Ideja se revolucioni komunist ecte përpara i pamposhtur deri në fitoren përfundimtare të tij, tashmë pothuajse qe venitur në sytë e mjaft intelektualëve dhe sigurisht në sytë e një pjese të madhe të popullit, që i priste ndryshimet padurim, në veçanti brezi i ri. Ky zhgënjim dhe dëshirë për ndryshim u pa nga futja nëpër ambasadat e huaja të mbi pesë mijë shqiptarëve në korrik të 1990 dhe nga revoltat studentore dhe ato popullore që pasuan në ditët në vazhdim. Ky dështim dhe zhgënjim ndaj ideologjisë komuniste, i cili duket se erdhi natyrshëm dhe gradualisht dhe jo me thyerje të menjëhershme, shkaktoi një vakum ideologjik dhe krijoi një hapësirë të re kulturore të favorshme për besimet fetare. Njerëzit filluan, të paktën një pjesë jo e vogël e tyre, të rizbulonin, ndër të tjera edhe fenë si një forcë bashkuese, gjatë periudhës çorientuese të krizës që pasoi rënien e regjimit. Mes kaosit dhe amullisë dhe pamundësisë për të sjellë kohezionin në shoqëri, organizatat si dhe bashkësitë e rilindura fetare siguruan, një strehë shpirtërore për “turmat e vetmuara” që ishin vënë në kërkim të një identiteti individual dhe një nevoje për përkatësi kolektive.<sup>2</sup>

Fenomeni i rigjallërimit fetar shfaqet në disa dimensione, së pari në rritjen e fetarisë mes individëve, në aspekte si: deklarimi i besimit në Zot, deklarimi i përkatësisë fetare, frekuentimi i objekteve të kultit, pjesëmarrja në aktivitete e rituale fetare, si lutjet apo faljet e përbashkëta, kremtimet dhe ceremonitë fetare, pagëzimet, bërja synet, pelegrinazhet në vende të ndryshme, lutja dhe përrshpirtja individuale, ndjesia e brendshme e të qenit fetar, përdorimi i simboleve fetare, si vendosja e kryqeve apo simboleve të tjera fetare, si stoli në trup, në shtëpi, dyqane apo makina, mbajtja e Kuranit dhe e Biblës nëpër rafte apo vitrina, qofshin këto me qëllim konfirmimin e identitetit fetar apo edhe për mbarësi dhe për t'u ndjerë në përkujdesjen hyjnore, sjellja sipas një etike fetare, duke u vetëprivuar nga ushqime apo kontakte të caktuara, veshja

<sup>1</sup> <https://kujto.al/kufij-te-pergjakur/>

<sup>2</sup> Chryssanthi Zachou & Kalie Kerpaci në God's “Second Coming”: Youth and New Religious Movements in Post-Communist Albania, XVII ISA World Conference on Sociology Research Committee 22 Sociology of Religion Gothenburg, Sweden 11-17 July 2010, f.2.

sipas një kodi etik të veçantë, vendosja e emrave mbi bazë fetare,... etj. Aspektet që tregojnë rritjen e fetarisë janë të larmishme dhe dinamike dhe përfshijnë dy anë, si ndjesinë subjektive ashtu edhe motivimin e brendshëm dhe sjelljen e jashtme, ndaj jo gjithmonë ato janë të dukshme dhe të kuptueshme për të tjerët. Të gjithë këta elementë që përmendëm këtu janë tashmë prezentë në shoqërinë shqiptare. Disa prej këtyre elementëve do të merren në shqyrtim nëpërmjet pasqyrimin të anketimeve që janë bërë ndër vite mes shqiptarëve dhe që tregojnë fetarinë e tyre.

#### 4.4 Kuadri ligjor i lirive fetare

Pas ndryshimeve politike në Shqipëri vendi kërkonte një kuadër ligjor për liritë fetare. Kështu që, që në Dispozitat Kryesore Kushtetuese, të miratuara në prill të 1991 nga Kuvendi i Shqipërisë, në nenin 7 të tyre sanksionohej se “Shteti respekton lirinë e besimit fetar dhe krijon kushte për ushtrimin e tij.”<sup>1</sup> Më pas në prill të 1993 miratohet ligji për fondacionet, ku organizatat fetare gjejnë hapësira ligjore për ushtrimin e aktivitetit të tyre.<sup>2</sup> Ky ligj u zëvendësua me atë të Majit 2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i cili është edhe ligji mbi të cilin bazohet ushtrimi i aktivitetit fetar në Shqipëri.<sup>3</sup> Por ndërkohë në 1998 miratohet kushtetuta e re e vendit, e cila sanksionon qartë liritë fetare, në nenin 10 dhe 24 të saj, ku garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit dhe e ushtrimit dhe e shprehjes së lirë të tij, si në privat ashtu dhe në publik.

Në dallim nga të gjitha kushtetutat e mëparshme kjo kushtetutë përmend që në preambulën e saj besimin në Zot, si një nga vlerat themelore të popullit shqiptar. Edhe pse shteti shqiptar, nuk ka fe zyrtare dhe është asnjans në çështjet e besimit, përfshirja që në hyrje të kushtetutës e besimit në Zot, ka një vlerë domethënëse dhe simbolike njëkohësisht, sepse zhbën njëherë e mirë imazhin e kushtetutës së dikurshme që i jepte Shqipërisë statusin si i vetmi vend ateist në botë,<sup>4</sup> ndërkohë që u garanton të gjithëve, si besimtarëve dhe jobesimtarëve lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit. Ndërkohë shteti shqiptar ka nënshkruar marrëveshje me pesë bashkësitë fetare kryesore në vend: Komuniteti Mysliman, Kisha Ortodokse, Kisha Katolike, Kryegjyshata Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore. Këto marrëveshje synojnë rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella mes shtetit dhe bashkësive fetare në interes dhe dobi reciproke.<sup>5</sup> Në vitin 2009 shteti shqiptar ka miratuar edhe një ligj për mbështetjen e kufizuar financiare të bashkësive fetare.<sup>6</sup>

#### 4.5 Ngritja e infrastrukturës fetare

Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri dhe lejimi i lirisë fetare në vend i gjeti besimtarët dhe komunitet fetare pothuajse pa asnjë infrastrukturë kulturi të gatshme për të pritur besimtarët. Në këto kushte e vetmja zgjidhje për momentin ishte rikthimi i atyre objekteve që kishin mbetur pa u shkatërruar si dhe adoptimi i përkohshëm i objekteve të tjera. Në të njëjtën kohë filloi dhe rindërtimi i objekteve të reja të kultit.

<sup>1</sup> Për dispozitat kryesore kushtetuese (Ligji Nr. 7491, datë 29.4.1991). Shih: <http://licodu.cois.it/?p=365&lang=en>

<sup>2</sup> Për fondacionet (Ligj Nr.7695, datë 7.4.1993) Shih: <http://licodu.cois.it/?p=335&lang=en>

<sup>3</sup> Për organizatat jofitimprurëse (Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001) Shih: <http://licodu.cois.it/?p=333&lang=en>

<sup>4</sup> Në fakt disa të dhëna tregojnë se Shqipëria nuk ishte i vetmi vend ateist zyrtarisht në botë dhe as i pari. Shih për këtë [https://en.wikipedia.org/wiki/State\\_atheism](https://en.wikipedia.org/wiki/State_atheism)

<sup>5</sup> Faqja zyrtare e Komitetit shtetëror të kulteve, Legjislacioni për fenë: <http://kshk.gov.al/legjislacioni-per-fene-pas-vitit-1990/>

<sup>6</sup> Shih: [http://kshk.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/06\\_Ligji\\_10140\\_per\\_financimin\\_e\\_bashkesive\\_fetare.pdf](http://kshk.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/06_Ligji_10140_per_financimin_e_bashkesive_fetare.pdf)

Për shkak të gjendjes së dobët ekonomike dhe realitetit të vështirë me të cilën u përballën bashkësitë fetare pas rënies së komunizmit, në rindërtimin e infrastrukturës fetare në Shqipëri një rol tepër të madh kanë dhënë kontributet dhe donacionet e huaja.

#### *Objektet fetare*

Komuniteti Mysliman:

Kështu sipas një raportimi në “Tirana Observer” në vitin 2008,<sup>1</sup> ku thuhet se informacioni është marrë nga vetë institucionet fetare, në Shqipëri gjendeshin 568 xhami. Sipas të dhënave të 2020 nga një deklaram i marrë nga myftiu i Tiranës, nga autori i këtij studimi, në Shqipëri në këtë vit gjenden mbi 840 xhami.

Duke qenë se tarikatet myslimane, me përjashtim të bektashinjve, janë në varësi ligjore të KMSH, atëherë sipas të dhënave që kemi mundur të gjejmë, që datojnë në vitin 2005, rezulton se tarikati halveti bashkë me disa të tjerë më të vegjël, zotërojnë 263 teqe dhe tyrbe.<sup>2</sup>

Komuniteti Bektashi:

Sipas të njëjti burim “Tirana Observer” numri i teqeve bektashiane në të gjithë vendin ishte 70 të tilla. Ndërkohë sipas faqes zyrtare të Kryegjyshitës Bektashiane në vitin 2020, numri i teqeve (jo atyre të rrënuara) rezulton të jetë 127 të tilla.<sup>3</sup>

Kisha Ortodokse:

Sipas “Tirana Observer” Kisha Ortodokse posedon 425 kisha. Ndërsa sipas të dhënave nga faqja zyrtare e Kishës Ortodokse të vitit 2020 del se ky komunitet ka në zotërim 460 objekte, ku veç kishave e manastireve përfshihen edhe kopshte, shkolla, qendra rinore, qendra shëndetësore, seli mitropolitane, shtëpi pritjeje, punishte, mensa për të varfrit etj.<sup>4</sup>

Kisha Katolike:

Po sipas “Tirana Observer” Kisha Katolike ka në posedim 694 institucione katolike.

Vëllazëria Ungjillore:

Vëllazëria Ungjillore, sipas të dhënave të faqes zyrtare rezulton se posedon 114 kisha në të gjithë territorin e Shqipërisë.<sup>5</sup>

Krahas këtyre komuniteteve të njohura nga shteti me marrëveshje dypalëshe ka edhe bashkësi të tjera më të vogla fetare, të cilat janë prezentë në Shqipëri pas viteve 90’, siç janë “Dëshmitarët e

---

<sup>1</sup> Tirana Observer, raport ekskluziv nga Entela Resuli, e shtunë 16 Gusht 2008. Arkivuar nga origjinali më 17 shtator 2008. Marrë më 02 Nëntor 2020.

[https://web.archive.org/web/20080917072216/http://www.tiranaobserver.com.al/al/index.php?option=com\\_content&task=view&id=6374&Itemid=26](https://web.archive.org/web/20080917072216/http://www.tiranaobserver.com.al/al/index.php?option=com_content&task=view&id=6374&Itemid=26)

<sup>2</sup> <https://babadauti.wordpress.com/tarikati-halveti-lista-e-teqeve-viti-2005/>

<sup>3</sup> <https://kryegjyshataboterobektashiane.org/gjyshatat-bektashiane/>

<sup>4</sup> <https://orthodoxalbania.org/2020/2018/03/09/veshtrim-i-pergjithshem-1991-2018/>

<sup>5</sup> <https://vush.al/adresat-e-kishave-ungjillore-ne-shqiperi/>

Jehovait”, të cilët sipas të dhënave që ata vetë japin për Shqipërinë, thonë se kanë 87 kongregacione dhe 5642 mësues Bible.<sup>1</sup>

Një tjetër sekt i krishterë që gjendet dhe ka aktivitet në Shqipëri janë edhe mormonët, të cilët sipas të dhënave që ata raportojnë përbëhet nga 2719 anëtarë dhe nga pesë degë.<sup>2</sup>

Institucionet arsimore dhe humanitare:

Sipas shifrave zyrtare të 2016-ës, grupet, organizatat dhe fondacionet fetare kanë 125 shoqata dhe fondacione anëtare që menaxhojnë 116 institucione arsimore,<sup>3</sup> përfshirë universitete, shkolla fillore, të mesme, dhe parashkollore, kopshte, shkolla profesionale dhe jetimore, të cilat sipas ligjit licencohen nga Ministria e Arsimit.

Ndërkohë sipas raportit më të fundit të DASH-it të vitit 2019, për liritë fetare, përmendet se në Shqipëri Komiteti shtetëror i kulteve sipas regjistrimit të bërë në këtë vit për organizatat fetare numëroi 611 grupe, duke përfshirë 248 fondacione, 323 organizata joqeveritare (OJQ) të lidhura me fenë dhe 40 qendra fetare. KMSH ka një fondacion, ndërsa Kisha Ortodokse ka tre. Kisha Katolike ka 16 fondacione dhe OJQ, ndërsa VUSH ka 160 të tilla.<sup>4</sup>

Komuniteti Mysliman ka në posedimin e tij Universitetin “Bedër” dhe katër medrese që japin edhe lëndë fetare përpos programit të përcaktuar nga shteti.<sup>5</sup>

Kisha Ortodokse edhe ajo ka disa shkolla dhe Universitetin Logos.<sup>6</sup>

Bektashinjtë gjithashtu drejtojnë qendra fetare trajnimi për klerikët.<sup>7</sup>

Sipas faqes zyrtare të “Komisionit Kombëtar të Edukimit Katolik Shqiptar” institucionet katolike të edukimit formal para universitar, të cilat i ndjekin 8000 nxënës janë: 34 kopshte e qendra ditore parashkollore, 4 shkolla fillore, 10 shkolla 9 vjeçare, 5 shkolla të mesme, 7 qendra të formimit profesional, si dhe dhjetëra Qendra Social-kulturore (Oratore), që shoqërojnë fëmijët në edukimin e tyre gjatë kohës së lirë. Po ashtu katolikët posedojnë edhe Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë”<sup>8</sup>

Bashkësia Ungjillore, sipas asaj që ata shprehin në faqen e tyre zyrtare janë të “shtrirë përmes kishave lokale në çdo qytet të Shqipërisë... -dhe kontribuon- ... në hapje shkollash, kopshtesh, kursesh profesionale, shtëpi fëmijësh, azile, qendra shëndetësore e klinika, projekte sociale për fëmijë, të varfër, pensionistë, të burgosur etj.”<sup>9</sup>

---

<sup>1</sup><https://www.jw.org/sq/d/%C3%ABshmitar%C3%ABt-e-jehovait/p/%C3%ABrreth-bot%C3%ABs/AL/> ndërkohë po aty ata pohojnë se ka një dëshmitar për 514 banorë, në Shqipërinë me popullsi 2’881’000 banorë, që i bie 5605 të tillë në gjithë vendin. A përfshihen edhe këta tek numri i mësipërm apo janë më vete, kjo nuk është e qartë. Ndërkohë sipas të dhënave të tyre në 2019 ishin të pranishëm në Përkujtim 12,135 vetë.

<sup>2</sup> <https://www.kishaecjekrishtit.org/about>

<sup>3</sup> Në raportin e 2013 ishin 96 të tilla ndërsa në 2015 numri i tyre ishte 103.

<sup>4</sup> <https://preview.state.gov/reports/2019-report-on-international-religious-freedom/albania/>

<sup>5</sup> Numri i medreseve ka qenë më i madh, por disa prej tyre janë mbyllur për shkaqe financiare etj.

<sup>6</sup> Sipas raportit të DASH 2013. <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/2016/10/2013-International-Religious-Freedom-Report-for-Albania.pdf>

<sup>7</sup> Sipas raportit të DASH 2010. <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/2017/02/2010-Raporti-Nderkombetar-i-Lirise-Fetare.pdf>

<sup>8</sup> <https://edukimikatolik.al/kush-jemi/>

<sup>9</sup> <https://vush.al/kush-eshte-vush/>

### *Mediat dhe literatura*

Tre komunitet më të mëdha në vend kanë në pronësi të tyre periodikë, gazeta dhe revista, kalendarë... etj., si dhe radio të ndryshme si “Drita Islame”, “Zani i naltë”, Radio “Spektrum” të Komunitetit Mysliman, “Hylli i dritës”, “Kumbona e së diellës”, Radio “Maria” të Kishës Katolike, Gazeta dhe Radio “Ngjallja” të Kishës Ortodokse, Revista “Urtësia” i Kryegjyshitës Bektashiane etj...

Sot gjen me qindra tituj librash dhe literaturë fetare, të të gjitha komuniteteve dhe grupimeve fetare në vend, duke nisur që nga librat e shenjtë të besimeve përkatëse të përkthyer në shqip madje disa herë, e deri te literatura predikuese, doktrinare, apologjetike, krahasuese, historike, sociale, artistike etj. Përmasa e literaturës së drejtpërdrejtë fetare, si ato të botuara në shtyp si ato gjenden në internet është kaq e larmishme dhe e madhe sado të kërkonin një studim më vete, për të bërë një përmbledhje të tyre. Po kështu ka një aktivitet të dendur të mediave dhe portaleve online, të cilat kanë lidhje direkt ose indirekt me predikimin fetar, përmasa e të cilave është e vështirë të njihet pa një studim të hollësishëm në këtë drejtim.

Natyrisht kjo është vetëm një pasqyrë e përgjithshme e infrastrukturës fetare ekzistuese në Shqipëri, por nga përvoja dhe konstatimet kemi bindjen se ka vend për të shtuar akoma, por që për arsye që kuptohen e kemi të pamundur të vazhdojmë më tej.

Ajo që është interesant për tu përmendur këtu është se, shpesh madje në masë tepër të madhe në rrjetet sociale predikimin fetar e bëjnë individë besimtarë, të cilët mbajnë portale dhe faqe interneti dhe kanale në Youtube, të cilat nuk kanë asnjë lidhje apo mbikëqyrje zyrtare nga asnjë nga Komunitetet e ndryshme fetare, madje shpesh as nga klerikë që punojnë nën juridiksionin e Bashkësive fetare. Po kështu feja në Shqipëri pas viteve 90’ është karakterizuar jo rrallë nga një individualizëm i theksuar, jo vetëm në interpretimin dhe predikimin fetar, por edhe nga fenomene të tilla nga individë të cilët thonë se nuk i përkasin asnjë feje ekzistuese duke u shfaqur me sinkretizma të ndryshëm fetar, deri në pretendim të profetësisë e shenjtërisë.<sup>1</sup> E gjitha kjo tregon se infrastruktura e predikimit fetar është shumë më e madhe sesa mund të mendohet dhe duket.

---

<sup>1</sup> Këtu sa për ilustrim mund të përmendim rastin e shumëzshëm të “Eleonorës”, apo atë “profeteshës Anilë”, apo “shëruesve të shenjtë” të ndryshëm që pretendojnë se shërojnë njerëzit nga sëmundje vdekjeprurëse, të cilët edhe pse koha ka nxjerrë më pas në pah sharlatanizmin e tyre, në kulmin e tyre kanë pasur ndjekës dhe ithtarë të shumtë.

## **Kapitulli V: Dështimi i ideologjisë komuniste dhe rikthimi i fesë**

5.1 Metodologjia

5.2 Identifikimi i problemit kërkimor

5.3 Hipoteza qendrore, nën-hipotezat, implikimet dhe indikatorët

5.4 Rezultatet e përpunimit të të dhënave empirike

## **Dështimi i ideologjisë komuniste dhe rikthimi i fesë**

### **5.1 Metodologjia**

Siç është përmendur edhe në fillim të këtij studimi, në kuadrin e qasjes metodologjike të racionalizmit kritik, nisur nga realiteti i vëzhguar si dhe nga dhe studimi i literaturës dhe të dhënave që u paraqitën deri këtu, rezulton se rigjallërimi e besimeve fetare mbas vitit 1990 në Republikën e Shqipërisë është një realitet i prekshëm. Përtej këtij fakti qëllimi i këtij studimi është të hetoj shkaqet dhe arsyet e këtij rigjallërimi. Prandaj kjo u identifikua si problem kërkimor i mëposhtëm.

### **5.2 Identifikimi i problemit kërkimor:**

*Rigjallërimi i besimeve fetare në Republikën e Shqipërisë pas rënies së regjimit komunist.*

Nga ky problem formulojmë pyetjen kërkimore që kërkon arsyet apo shkaqet përse ka ndodhur dukuria në fokus dhe përbëhet nga tipi i pyetjes “Përse”; kjo pyetje kërkon përgjigje me një thënie të tipit shpjegues, domethënë me një thënie të tipit *hipotezë*.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Kocani A., (2013), Një qasje plotësuese epistemologjike në Metodologjinë e kërkimit të shkencave sociale, AU Press, f.19-25, 32.



Pyetja kërkimore:

*Si ose përse zbrazësia ideologjike dhe kriza identitare, që pasoi rënien e komunizmit në Shqipëri sollën rikthimin drejt besimeve fetare?*

### 5.3 Hipoteza qendrore, nën-hipotezat dhe implikimet

Hipoteza si përgjigje ndaj pyetjes kërkimore:

*Komunizmi ishte në thelb një ideologji gati fetare dhe kështu që zbrazësia ideologjike (zhgënjimi nga utopia komuniste) dhe kriza identitare që përjetuan shqiptarët pas rënies së kësaj quasi-feje, favorizuan në një masë të konsiderueshme rikthimin e njerëzve drejt besimeve fetare.*

Me që hipoteza ka dy faktorë (shkaqe), ajo mund të reduktohet në dy hipoteza të thjeshta që lidhin pasojën me nga një shkak. Kështu do të mund të kishim sa vijon.

Hipotezat e thjeshta mund të formuloheshin në trajtën:

*H.1) Duke krahasuar rikthimin e individëve të caktuar në Republikën e Shqipërisë drejt besimeve fetare në periudhën e pas viteve 90', shkalla e rikthimit të këtyre individëve te besimet fetare është në përpjesëtim të drejtë me shkallën e zhgënjimit të tyre nga utopia komuniste.*

*H.2) Duke krahasuar rikthimin e individëve të caktuar në Republikën e Shqipërisë drejt besimeve fetare në periudhën e pas viteve 90', shkalla e rikthimit të këtyre individëve te besimet fetare është në përpjesëtim të drejtë me shkallën e krizës identitare, që përjetuan ata pas rënies së regjimit komunist.*

Të dyja hipotezat përbëjnë gjykime konstatimi dhe, si të tilla, nuk lejojnë testim empirik të drejtpërdrejtë.<sup>1</sup> Për të realizuar këtë testim jemi të detyruar që nga secila hipotezë të deduktojmë disa implikime-parashikimi (të tipit të gjykimit kushtor: “Në se ka ndodhur kështu..., atëherë kemi kështu...”), të cilat pranojnë testim të drejtpërdrejtë empirik. Domethënë pranojnë ballafaqimin e thënies parashikim, që ato përfshijnë, me thënien që paraqesin të dhënat e vëzhgimit dhe që konfirmon ose jo empirikisht rezultatin e parashikimit të dhënë nga teoria. Nga kjo do të kemi implikimet si vijon:

#### **Implikim 1.1 [I.1.1 (H.1)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë si një nga shkaqet kryesore të rënies së regjimit komunist atë të karakterit utopik të komunizmit, atëherë është e pritshme që ata të mos besojnë më në shoqërinë komuniste.*

#### **Implikim 2.1 [I.2.1 (H.1)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë pohojnë se janë të zhgënjyer nga ideologjia komuniste, atëherë është e pritshme që ata të deklarojnë se kanë përjetuar një lloj “zbrazësie” shpirtërore apo vlerash.*

#### **Implikim 3.1 [I.3.1 (H.1)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë pohojnë se janë të zhgënjyer nga ideologjia komuniste, atëherë është e pritshme që ata të kërkojnë ta zëvendësojnë atë edhe me një besim fetar.*

### **Për Hipotezën e dytë (H.2)**

---

<sup>1</sup> Kocani A., (2013), Një qasje plotësuese epistemologjike në Metodologjinë e kërkimit të shkencave sociale, AU Press, f. 38-41.

### ***Implikim 1.2 [I.1.2 (H.2)]:***

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë se rënia e regjimit komunist shpuri në rënien edhe të modelit zyrtar të identitetit social, atëherë është e pritshme që ata të besojnë se kjo rënie krijoi një krizë identiteti.*

### ***Implikim 2.2 [I.2.2 (H.2)]:***

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë se rënia e regjimit komunist krijoi një krizë identiteti, atëherë është e pritshme që ata të përpiqeshin që të krijonin një identitet të ri social.*

### ***Implikim 3.2 [I.3.2 (H.2)]:***

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë janë përpjekur që të krijonin një identitet të ri social, atëherë është e pritshme që ata t'u drejtoreshin edhe besimeve fetare.*

## **Indikatorët**

### **Indikatorët për *Implikim 1.1 [I.1 (H.1)]:***

#### ***Implikim 1 [I.1 (H.1)]:***

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë si një nga shkaqet kryesore të rënies së regjimit komunist atë të karakterit utopik të komunizmit, atëherë është e pritshme që ata të mos besojnë më në shoqërinë komuniste.*

Vjelja e informacionit se sa i besojnë individët madhorë regjimit të mëparshëm dhe sa besojnë se ai dështoi nga që ai përbënte një projekt utopik, të paralizueshëm. Vjelja e informacionit në se besojnë që sot është e mundur t'i rikthehemi përsëri modeleve shoqërore komuniste, sepse ato ndoshta mund të kenë sukses. Vjelja e informacionit në se këta individë besojnë se sistemi demokratike nuk është i përkryer, por nuk ka ndonjë tjetër që të jetë më i mirë.

### **Indikatorët për *Implikim 2.1 [I.2 (H.1)]:***

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë se rënia e regjimit komunist krijoi një krizë identiteti, atëherë është e pritshme që ata të përpiqeshin që të krijonin një identitet të ri social.*

Vjelja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për ideologjinë komuniste që lanë prapa. A kanë ata ndjenjën e zhgënjimit nga dështimi i kësaj ideologjie? A mendojnë ata se me rënien e kësaj ideologjie u krijua një farë zbrazëtie shpirtërore individuale dhe shoqërore në vendin tonë?

### **Indikatorët për *Implikim 3.1 [I.3 (H.1)]:***

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë pohojnë se janë të zhgënjyer nga ideologjia komuniste, atëherë është e pritshme që ata të kërkojnë ta zëvendësojnë atë edhe me një besim fetar.*

Vjelja e informacionit për faktin se, nëse ata kanë ndjerë zbrazëti shpirtërore, a kanë menduar ta plotësojnë atë me diçka tjetër. Vjelja e informacionit se çfarë rruge kanë kërkuar të ndjekin për ta plotësuar këtë mangësi. A ka qenë përqafimi i një besimi fetar një nga rrugët e ndjekura?

## **Për Hipotezën 2:**

### **Indikatorët për *Implikim 1.2 [I.1 (H.2)]:***

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë se rënia e regjimit komunist shpuri në rënie edhe të modelit zyrtar të identitetit social, atëherë është e pritshme që ata të besojnë se kjo rënie krijoi një krizë identiteti.*

Vjelja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për pasojat e mundshme që la rënia e regjimit komunist në cenimin e identitetit të tyre social. A ka shkuar ky cenim deri në krizë identiteti?

#### **Indikatorët për Implikim 2.2 [I.2.2 (H.2)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë se rënia e regjimit komunist krijoi një krizë identiteti, atëherë është e pritshme që ata të përpqeshin që të krijonin një identitet të ri social.*

Vjelja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për një proces të mundshëm të krijimit të një identiteti të ri social tek individët e shoqërisë së sotme shqiptare.

#### **Indikatorët për Implikim 3.2 [I.3 (H.2)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë janë përpjekur që të krijonin një identitet të ri social, atëherë është e pritshme që ata t'u drejtoheshin edhe besimeve fetare.*

Vjelja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për një prirje ndaj kthimit të besimeve fetare si pjesë e procesit të mundshëm të krijimit të një identiteti të ri social tek individët e shoqërisë së sotme shqiptare.

#### **Skema praktike**

Për testimin empirik të parashikimeve që japin implikimet, për secilin prej tyre janë skicuar variablat (pyetjet) që janë kryqëzuar për të parë shoqërimet e mundshme statistikore ndërmjet tyre. Për këtë arsye kemi listën si vijon me kryqëzimet.

Crosstabet<sup>1</sup> për testimin e Implikimit 1.1 (Për H1): **Implikim 1.1 [I.1.1 (H.1)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë si një nga shkaqet kryesore të rënies së regjimit komunist atë të karakterit utopik të komunizmit, atëherë është e pritshme që ata të mos besojnë më në shoqërinë komuniste.*

Indikatorët për I.1.1:

Vjelja e informacionit se sa i besojnë individët madhorë regjimit të mëparshëm dhe sa besojnë se ai dështoi nga që ai përbënte një projekt utopik, të përealizueshëm.

Vjelja e informacionit në se besojnë që sot është e mundur t'i rikthehemi përsëri modeleve shoqërore komuniste, sepse ato ndoshta mund të kenë sukses.

Vjelja e informacionit në se këta individë besojnë se sistemi demokratike nuk është i përkryer, por nuk ka ndonjë tjetër që të jetë më i mirë.

---

<sup>1</sup> Tabelat e kryqëzuara që tregojnë marrëdhënien midis dy ose më shumë variablave.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P1 (Besimi te regjimi komunist)

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P3 (Kthimi i regjimit komunist si zgjidhje)

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P4 (Demokracia si zgjidhje).

Crosstabet për testimin e Implikimit 2.1 (Për H1): **Implikim 2.1 [I.2.1 (H.1)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë pohojnë se janë të zhgënjyer nga ideologjia komuniste, atëherë është e pritshme që ata të deklarojnë se kanë përjetuar një lloj “zbrazëtie” shpirtërore apo vlerash.*

Indikatorët për I.2.1:

Vjelja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për ideologjinë komuniste që lanë prapa. A kanë ata ndjenjën e zhgënjimit nga dështimi i kësaj ideologjie? A mendojnë ata se me rënien e kësaj ideologjie u krijua një farë boshllëku shpirtëror individual dhe shoqëror në vendin tonë?

P5 (Vlerësimi i ideologjisë komuniste) + P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste)

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste) + P7 (Përjetimi i dështimit)

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste.) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror).

Crosstabet për testimin e Implikimit 3.1 (Për H1): **Implikim 3.1 [I.3.1 (H.1)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë pohojnë se janë të zhgënjyer nga ideologjia komuniste, atëherë është e pritshme që ata të kërkojnë ta zëvendësojnë atë edhe me një besim fetar.*

Indikatorët për I.3.1:

Vjelja e informacionit për faktin se nëse ata kanë ndjerë boshllëk shpirtëror, a kanë menduar ta plotësojnë atë në një farë mënyre. Vjelja e informacionit se çfarë rruge kanë kërkuar të ndjekin për ta plotësuar këtë zbrazëti. A ka qenë përqafimi i një besimi fetar një nga rrugët e ndjekura.

P7 (Zhgënjimi nga ideologjia komuniste.) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror.)

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P9 (Plotësimi i boshllëkut me ideologji tjetër)

Crosstabet për testimin e Implikimit 1.2 (Për H2): **Implikim 1.2 [I.1.2 (H.2)]:**

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë se rënia e regjimit komunist shpuri në rënien edhe të modelit zyrtar të identitetit social, atëherë është e pritshme që ata të besojnë se kjo rënie krijoi një krizë identiteti.*

Vjelja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për pasojat e mundshme që la rënia e regjimit komunist në cenimin e identitetit të tyre social. A ka shkuar ky cenim deri në krizë identiteti?

P10 (Pasojat e rënies së komunizmit) + P11 (A ka krizë identiteti)

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P11 (A ka krizë identiteti)

Crosstabet për testimin e Implikimit 2.2 (Për H2): **Implikim 2.2 [I.2.2 (H.2)]**:

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë konsiderojnë se rënia e regjimit komunist krijoi një krizë identiteti, atëherë është e pritshme që ata të përpiqeshin që të krijonin një identitet të ri social.*

Vjelja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për një proces të mundshëm të krijimit të një identiteti të ri social tek individët e shoqërisë së sotme shqiptare.

P11 (A ka krizë identiteti) + P12 (A ka krijim identiteti të ri)

Crosstabet për testimin e Implikimit 3.2 (Për H2): **Implikim 3.2 [I.3.2 (H.2)]**:

*Në se individë madhorë në Republikën e Shqipërisë janë përpjekur që të krijonin një identitet të ri social, atëherë është e pritshme që ata t'u drejtoheshin edhe besimeve fetare.*

Vleja e informacionit se çfarë mendimi kanë individët për një prirje ndaj kthimit të besimeve fetare si pjesë e procesit të mundshëm të krijimit të një identiteti të ri social tek individët e shoqërisë së sotme shqiptare.

P12 (A ka krijim identiteti të ri.) + P13 (A ka kthim të besimeve fetare.)

#### **5.4 Rezultatet e përpunimit të të dhënave empirike**

Të dhënat e siguruara nga anketimi i kryer në vitin 2015 dhe 2020

Nisur nga sa u tha më sipër, u përpilua një pyetësor ku u përfshinë të gjitha implikimet që u përmendën më sipër dhe u zhvillua një anketim në terren, në rrugët e Tiranës, me një kampion prej 200 pjesëmarrësish të rritur, nga të dyja gjinitë. Të dhënat janë kryeqyteti i Shqipërisë, por njëkohësisht edhe qyteti më i madhe dhe më përfaqësuar në rang Republike, për sa i përket shtresave sociale, kulturore dhe krahinore ndaj dhe më se i mjaftueshëm për të testuar hipotezën e mësipërme. I njëjti anketim, por me një kampion prej 1120 vetë u përsërit në 2020. Qëllimi ishte për të rritur shkallën e besueshmërisë së të dhënave duke rritur numrin e pjesëmarrësve në të.

Pritshmëria është që midis variablave të kryqëzuara të ketë shoqërim statistikor domethënës. Ky do të përbënte edhe një rezultat pozitiv të testimit empirik të implikimeve të dedukuara nga hipoteza. Nga kryqëzimi i këtyre variablave do të shqyrtojmë vetëm tabelën e ‘Symmetric Measures’<sup>1</sup>, sepse ajo përmban dy indikatorët kyç që të lejojnë të gjykosh në se ka shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Indikatorë të tillë janë: **Cramer's V** që jep forcën e shoqërimit (përqindjen e vlerave të përbashkëta midis dy variablave) dhe kjo është e pranueshme kur është mbi 20%. Indikatorë të tjerë janë **Approximate Significance** që jep

<sup>1</sup> Kocani A., (2013), Një qasje plotësuese epistemologjike në Metodologjinë e kërkimit të shkencave sociale, AU Press, f. 48-49.

domethënien e përafërt të shoqërimit statistikor në fjalë. Domethënë që tregon nëse në këtë shoqërim ka kontribute edhe nga variabla të tjerë që e rrisin artificialisht vlerën e forcës së shoqërimit që jep indikatorit *Cramer's V*. Cilësimi '*shoqërim domethënës*' varet nga raporti i vlerës së indikatorit *Approximate Significance* me vlerën limit që kushtëzohet nga madhësia e kampionimit të përdorur në anketim. Për anketimet me madhësi kampionimi relativisht të vogël (jo më shumë se 200 njësi), kufiri i lejuar i domethënies është  $\leq 10\%$  (ndryshe: '.10'). Për madhësi kampionimi relativisht mesatar (nga 250 njësi në 500 njësi), kufiri i lejuar është  $\leq 5\%$  (ndryshe: '.05'). Kurse për madhësitë e kampionimit relativisht të mëdha (mbi 500 njësi), kufiri i lejuar është  $\leq 1\%$  (ndryshe: '.01'). Në rastin e anketimit të zhvilluar në vitin 2020, madhësia e kampionimit ishte mbi 1000 njësi. Prandaj për të domethënia e shoqërimit statistikor duhet të ishte më pak ose e njëjtë me vlerën '.01'<sup>1</sup>.

Për Implikimin 1.1 kemi si vijon:

Janë kryqëzuar variablat P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) dhe P1 (Besimi te regjimi komunist). Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	.682	.000
	Cramer's V	.278	.000
N of Valid Cases		186	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.278' (apo, 27.8%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P3 (Kthimi i komunizmit si zgjidhje)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	.605	.001
	Cramer's V	.247	.001
N of Valid Cases		185	

<sup>1</sup> Kocani A., (2013), Një qasje plotësuese epistemologjike në Metodologjinë e kërkimit të shkencave sociale, AU Press, f. 50-51. Shih gjithashtu Shtojcën 'Tabela 1. Interpretimi i vlerës së nivelit të shoqërimit'.

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.247' (apo, 24.7%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P4 (Demokracia si zgjidhje)  
Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

	Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal Phi	.716	.000
Cramer's V	.320	.000
N of Valid Cases	189	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.320' (apo, 32.0%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

Për Implikimin 2.1 kemi si vijon:

P5 (Vlerësimi i ideologjisë komuniste) + P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste)  
Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

	Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal Phi	.612	.000
Cramer's V	.274	.000
N of Valid Cases	189	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.274' (apo, 27.4%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste) + P7 (Përjetimi i dështimit)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	.716	.000
	Cramer's V	.320	.000
N of Valid Cases		189	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablove është '.320' (apo, 32.0%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablove të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.469	.081
	Cramer's V	.210	.081
N of Valid Cases		188	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablove është '.203' (apo, 20.3%), që është pak më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.081' (ose 8.1%), është pak më e vogël se sa limiti i lejuar prej 10%, që mund të konsiderohet si e pranueshme. Pra, ende mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablove të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.1.

Për Implikimin 3.1 kemi si vijon:

P7 (Zhgënjimi nga ideologjia komuniste) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror.)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures



		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	.398	.234
	Cramer's V	.178	.234
N of Valid Cases		188	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablove është '.178' (apo, 17.8%), që është nën limitin e lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.234' (ose, 23.4%), që mund të konsiderohet si mbi dy herë më e lartë se sa kufiri i lejuar prej 10%. Pra, mund të thuhet se **nuk** kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablove të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat negativ** të testimit empirik të Implikimit 3.1.

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P9 (Plotësimi i boshllëkut me ideologji tjetër)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	.493	.105
	Cramer's V	.221	.105
N of Valid Cases		188	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablove është '.221' (apo, 22.1%), që është pak më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.105' (ose, 10.5%), që mund të konsiderohet si pak më e lartë se kufiri i lejuar prej 10%. Pra, **nuk** mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablove të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat negativ** të testimit empirik të Implikimit 3.1

Për Implikimin 1.2 kemi si vijon:

P10 (Pasojat e rënies së komunizmit) + P11 (A ka krizë identiteti)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	.774	.000

	Cramer's V	.346	.000
N of Valid Cases		187	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.346' (apo, 34.6%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P11 (A ka krizë identiteti)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

	Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal Phi	.672	.000
Cramer's V	.300	.000
N of Valid Cases	188	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.300' (apo, 30.0%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2.

Për Implikimin 2.2 kemi si vijon:

P11 (A ka krizë identiteti) + P12 (A ka krijim identiteti të ri)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

	Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal Phi	.607	.001
Cramer's V	.248	.001
N of Valid Cases	187	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.248' (apo, 24.8%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej

20%. Kurse domethënia është '.001' (ose, 0.1%), që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.2.

Për Implikimin 3.2 kemi si vijon:

P12 (A ka krijim identiteti të ri) + P13 (A ka kthim te besimi fetar)

Symmetric Measures

		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	.644	.000
	Cramer's V	.263	.000
N of Valid Cases		188	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.263' (apo, 26.3%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 3.2.

### Të dhënat e siguruara nga anketimi i kryer në vitin 2020

Tabelat e kryqëzuara që testojnë empirikisht implikimet e dedukuara nga **Hipoteza 1**.

Për Implikimin 1.1 kemi si vijon:

Janë kryqëzuar variablat P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) dhe P1 (Besimi te regjimi komunist). Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.505	.000
	Cramer's V	.206	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.206' (apo, 20.6%), që është pak më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P3 (Kthimi i komunizmit si zgjidhje)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.520	.000
	Cramer's V	.212	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.212' (apo, 21.2%), që është pak më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P4 (Demokracia si zgjidhje)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.649	.000
	Cramer's V	.265	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.265' (apo, 26.5%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

Për Implikimin 2.1 kemi si vijon:

P5 (Vlerësimi i ideologjisë komuniste) + P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.629	.000
	Cramer's V	.257	.000
N of Valid Cases		1119	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablove është '.257' (apo, 25.7%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablove të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste) + P7 (Përjetimi i dështimit)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.579	.000
	Cramer's V	.236	.000
N of Valid Cases		1119	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablove është '.236' (apo, 23.6%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablove të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.496	.000
	Cramer's V	.203	.000
N of Valid Cases		1119	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.203' (apo, 20.3%), që është pak më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.1.

Për Implikimin 3.1 kemi si vijon:

P7 (Zhgënjimi nga ideologjia komuniste) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror.)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.399	.000
	Cramer's V	.163	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.163' (apo, 16.3%), që është nën limitin e lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se **nuk** kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat negativ** të testimit empirik të Implikimit 3.1.

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P9 (Plotësimi i boshllëkut me ideologji tjetër)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

## Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.695	.000
	Cramer's V	.284	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.284' (apo, 28.4%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 3.1

Për Implikimin 1.2 kemi si vijon:

P10 (Pasojat e rënies së komunizmit) + P11 (A ka krizë identiteti)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

## Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.979	.000
	Cramer's V	.400	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.400' (apo, 40.0%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P11 (A ka krizë identiteti)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

## Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	.612	.000
	Cramer's V	.250	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.250' (apo, 25.0%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2.

Për Implikimin 2.2 kemi si vijon:

P11 (A ka krizë identiteti) + P12 (A ka krijim identiteti të ri)

Tabela që jep indikatorët e shoqërimit të mundshëm statistikor është:

## Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance
Nominal by Nominal	Phi	1.032	.000
	Cramer's V	.421	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.421' (apo, 42.1%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse sinjifikanca është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.2.

Për Implikimin 3.2 kemi si vijon:

P12 (A ka krijim identiteti të ri) + P13 (A ka kthim te besimi fetar)

## Symmetric Measures

		Value	Approximate Significance



Nominal by Nominal	Phi	.765	.000
	Cramer's V	.312	.000
N of Valid Cases		1120	

Nga tabela shihet se vlerat e indikatorit Cramer's V që jep forcën e shoqërimit statistikor ndërmjet dy variablave është '.312' (apo, 31.2%), që është më e madhe se sa limiti i lejuar prej 20%. Kurse domethënia është '.000', që mund të konsiderohet si e shkëlqyer. Pra, mund të thuhet se kemi shoqërim statistikor domethënës midis dy variablave të kryqëzuar. Që do të thotë se kjo tabelë e kryqëzuar jep **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 3.2.

## Interpretimi i rezultateve të përpunimit të të dhënave nga dy anketimet

### Nga anketimi i vitit 2015:

#### Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 1.1 kemi për:

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P1 (Besimi te regjimi komunist).

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 27.8%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator<sup>1</sup> del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si 'të moderuara të forta' dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P3 (Kthimi i komunizmit si zgjidhje)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 24.7%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e

<sup>1</sup> Shih Shtojcën përkatëse dhe referimin WEB:  
[https://www.researchgate.net/post/How\\_can\\_I\\_intepret\\_the\\_effect\\_sizes\\_of\\_Cramers\\_V\\_when\\_DF\\_3](https://www.researchgate.net/post/How_can_I_intepret_the_effect_sizes_of_Cramers_V_when_DF_3)

përfshira në diapazonin 20 – 25% duhen konsideruar si ‘të moderuara’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P4 (Demokracia si zgjidhje)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 32.0%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 30 – 35% duhen konsideruar si ‘të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

**Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 2.1 kemi për:**

P5 (Vlerësimi i ideologjisë komuniste) + P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 27.4%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste) + P7 (Përjetimi i dështimit)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 32.0%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 30 – 35% duhen konsideruar si ‘të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste.) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 21.0%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 20 – 35% duhen konsideruar si ‘të moderuara’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të

kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

### **Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 3.1 kemi për:**

P7 (Zhgënjimi nga ideologjia komuniste.) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 17.8%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 15 – 20% duhen konsideruar si ‘të dobëta’ dhe janë **të papranueshme**. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i **pafavorshëm** (.234), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar **nuk** tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast **nuk** realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat negativ** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P9 (Plotësimi i boshllëkut me ideologji tjetër)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 22.1%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 20 – 25% duhen konsideruar si ‘të moderuara’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jo i favorshëm (.105, ose 10.5%, kur kufiri i lejuar është deri në 10%), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar **nuk** tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast **nuk** realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat negativ** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

### **Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 1.2 kemi për:**

P10 (Pasojat e rënies së komunizmit) + P11 (A ka krizë identiteti)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 34.6%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 30 – 35% duhen konsideruar si ‘të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2.

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P11 (A ka krizë identiteti)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 30.0%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet

dy variablove të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2.

### **Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 2.2 kemi për:**

P11 (A ka krizë identiteti) + P12 (A ka krijim identiteti të ri)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 24.8%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 20 – 25% duhen konsideruar si ‘të moderuara’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.001), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablove të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.2.

### **Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 3.2 kemi për:**

P12 (A ka krijim identiteti të ri.) + P13 (A ka kthim te besimi fetar)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 26.3%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablove të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 3.2

### **Nga anketimi i vitit 2020:**

#### **Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 1.1 kemi për:**

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P1 (Besimi te regjimit komunist).

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 20.6%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator<sup>1</sup> del se vlerat e përfshira në diapazonin 20 – 25% duhen konsideruar si ‘të moderuara’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablove të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P3 (Kthimi i komunizmit si zgjidhje)

---

<sup>1</sup> Shih Shtojcën përkatëse dhe referimin WEB :  
[https://www.researchgate.net/post/How\\_can\\_I\\_intepret\\_the\\_effect\\_sizes\\_of\\_Cramers\\_V\\_when\\_DF\\_3](https://www.researchgate.net/post/How_can_I_intepret_the_effect_sizes_of_Cramers_V_when_DF_3)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 21.2%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 20 – 25% duhen konsideruar si ‘të moderuara’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P2 (Arsyet e rënies së komunizmit) + P4 (Demokracia si zgjidhje)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 26.5%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

**Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 2.1 kemi për:**

P5 (Vlerësimi i ideologjisë komuniste) + P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 25.7%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste) + P7 (Përjetimi i dështimit)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 23.6%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritsshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P6 (A ka dështuar ideologjia komuniste.) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator i Cramer's V është në nivelin e 20.3%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 20 – 35% duhen konsideruar si ‘të moderuara’ dhe janë të pranueshme.

Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

**Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 3.1 kemi për:**

P7 (Zhgënjimi nga ideologjia komuniste.) + P8 (A ka boshllëk shpirtëror)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 16.3%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 15 – 20% duhen konsideruar si ‘të dobëta’ dhe janë **të papranueshme**. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar **nuk** tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast **nuk** realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat negativ** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P9 (Plotësimi i boshllëkut me ideologji tjetër)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 28.4%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.1.

**Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 1.2 kemi për:**

P10 (Pasojat e rënies së komunizmit) + P11 (A ka krizë identiteti)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 40.0%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 35 – 40% duhen konsideruar si ‘shumë të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablave të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2.

P8 (A ka boshllëk shpirtëror) + P11 (A ka krizë identiteti)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 25.0%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 25 – 30% duhen konsideruar si ‘të moderuara të forta’ dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet

dy variablove të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 1.2.

### **Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 2.2 kemi për:**

P11 (A ka krizë identiteti) + P12 (A ka krijim identiteti të ri)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 42.1%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 40 – 50% duhen konsideruar si 'jashtëzakonisht të forta' dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablove të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 2.2.

### **Nga crosstabet që testuan empirikisht implikimin 3.2 kemi për:**

P12 (A ka krijim identiteti të ri.) + P13 (A ka kthim te besimi fetar)

Nga crosstabi del se vlera e forcës së shoqërimit statistikor që jepet nga indikator Cramer's V është në nivelin e 31.2%. Nga tabela që jep vlerësimin e niveleve për këtë indikator del se vlerat e përfshira në diapazonin 30 – 35% duhen konsideruar si 'të forta' dhe janë të pranueshme. Me që edhe indikator i domethënies është jashtëzakonisht i favorshëm (.000), mund të thuhet se kjo tabelë e kryqëzuar tregon një shoqërim statistikor domethënës ndërmjet dy variablove të kryqëzuar. Në këtë rast realizohet pritshmëria për këtë tabelë dhe ajo na jep një **rezultat pozitiv** të testimit empirik të Implikimit 3.2

**Në total, kemi për testimin e implikimeve me të dhënat e nxjerra nga anketimi i vitit 2015, këto rezultate:**

#### **Për Hipotezën 1:**

Për Implikimin 1.1 kemi 3 rezultate pozitive;

Për Implikimin 2.1 kemi 3 rezultate pozitive;

Për Implikimin 3.1 kemi 1 rezultat pozitiv dhe një rezultat negativ.

Pra kemi 7 rezultate pozitive dhe një rezultat negative nga 8 rezultate të mundshme. Mund të pohohet se të tre Implikimet e Hipotezës 1 kanë marrë në përgjithësi rezultat pozitiv nga testimi empirik i drejtpërdrejtë i tyre. Kjo na jep argument që t'i sugjerojmë bashkësisë shkencore të shkencave sociale që ta konsiderojë këtë hipotezë si një nga zgjidhjet e pranueshme për problemin kërkimor që identifikon ky studim doktorat. Pra se rikthimit i individëve te besimet fetare është në përjesëtim të drejtë me shkallën e zhgënjimit të tyre nga utopia komuniste.

#### **Për Hipotezën 2:**

Për Implikimin 1.2 kemi 2 rezultate pozitive;

Për Implikimin 2.2 kemi 1 rezultat pozitiv;  
Për Implikimin 3.2 kemi 1 rezultat pozitiv.

Pra kemi 4 rezultate pozitive nga 4 të mundshme. Mund të pohohet se të tre Implikimet e Hipotezës 2 ka marrë një rezultat pozitiv nga testimi empirik i drejtpërdrejtë i tyre. Kjo na jep argument që t'i sugjerojmë bashkësisë shkencore të shkencave sociale që ta konsiderojë këtë hipotezë si një nga zgjidhjet e pranueshme për problemin kërkimor që identifikon ky studim doktoral. Pra se rikthimit i individëve te besimet fetare është në përpjesëtim të drejtë me shkallën e krizës identitare, që përjetuan ata pas rënies së regjimit komunist.

**Në total, kemi për testimin e implikimeve me të dhënat e nxjerra nga anketimi i vitit 2020, këto rezultate:**

#### **Për Hipotezën 1:**

Për Implikimin 1.1 kemi 3 rezultate pozitive;  
Për Implikimin 2.1 kemi 3 rezultate pozitive;  
Për Implikimin 3.1 kemi 1 rezultat pozitiv dhe 1 rezultat negative.

Pra kemi 7 rezultate pozitive dhe 1 rezultat negative nga 8 rezultate të mundshme. Mund të pohohet se të tre Implikimet e Hipotezës 1 kanë marrë në përgjithësi një rezultat pozitiv nga testimi empirik i drejtpërdrejtë i tyre. Kjo na jep argument që t'i sugjerojmë bashkësisë shkencore të shkencave sociale që ta konsiderojë këtë hipotezë si një nga zgjidhjet e pranueshme për problemin kërkimor që identifikon ky studim doktoral. Pra se rikthimit i individëve te besimet fetare është në përpjesëtim të drejtë me shkallën e zhgënjimit të tyre nga utopia komuniste.

#### **Për Hipotezën 2:**

Për Implikimin 1.2 kemi 2 rezultate pozitive;  
Për Implikimin 2.2 kemi 1 rezultat pozitiv;  
Për Implikimin 3.2 kemi 1 rezultat pozitiv.

Pra kemi 4 rezultate pozitive nga 4 të mundshme. Mund të pohohet se të tre Implikimet e Hipotezës 2 ka marrë një rezultat pozitiv nga testimi empirik i drejtpërdrejtë i tyre. Kjo na jep argument që t'i sugjerojmë bashkësisë shkencore të shkencave sociale që ta konsiderojë këtë hipotezë si një nga dy zgjidhjet e pranueshme për problemin kërkimor që identifikon ky studim doktoral. Pra se rikthimit i individëve te besimet fetare është në përpjesëtim të drejtë me shkallën e krizës identitare, që përjetuan ata pas rënies së regjimit komunist.

E parë më në detaj, nisur nga rezultatet e të dy anketimeve rezulton se 44% e të anketuarve në të parin dhe 47,7% e të anketuarve në të dytin mendojnë se shqiptarët e kanë zëvendësuar zbrazen që la pas komunizmi me besimin fetar. Kjo do të thotë se besimi fetar, qoftë ky edhe në nivelin e një përkatësie fetare dhe jo fetarie të avancuar, ka mbushur boshllëkun që la pas komunizmi. Ndërkohë ky zëvendësim nuk erdhi nga jashtë, por mund të themi se në shumicën e tij u rrit nga brenda, në formën e një rigjallërimi apo ngritje nga një nivel tejet minimal në një nivel shumë më të lartë duke zënë kështu në një masë jo të vogël atë vend që dikur e zinte ideologjia komuniste.



Po kështu, nisur nga rezultatet e të dy anketimeve rezulton se 42,8% e të anketuarve në të parin dhe 80,4% në të dytin, mendojnë se rikthimi te feja është pjesë e krijimit të një identiteti të ri social. Kjo tregon se besimi fetar, qoftë ky ai tradicional ose jotradicional, në shoqërinë e sotme të tranzicionit shqiptar, sipas opinionit që japin të anketuarit, përbën një burim të rëndësishëm të formimit të identitetit social edhe pse kjo nuk mund të shihet domosdoshmërisht si rritje e fetarisë së dukshme në të gjitha rastet, por së pari si një fetari subjektive e brendshme, e cila në jo pak raste shfaqet edhe si fetari e dukshme.

Një tjetër element që na tregojnë rezultatet e këtyre anketimeve është se sa ka ndikuar trashëgimia familjare dhe rilindja fetare në rigjallërimin fetar. Anketimi i parë tregon se 50% e të anketuarve mendojnë se rigjallërimi fetar është kryesisht pjesë e trashëgimisë fetare familjare, ndërsa i dyti për këtë na jep shifrën e 38,2%. Ndërkohë ata që mendojnë se rigjallërimi është më së shumti pjesë e rilindjes fetare është 7% në të parin dhe 22,9% në të dytin, dhe se rigjallërimi është produkt i rilindjes dhe trashëgimisë njëkohësisht, 8,5% në të parin dhe 31,8% në të dytin. Kjo tregon se trashëgimia familjare ka një peshë të rëndësishme në rigjallërimin fetar dhe sidomos sa më shumë i afrohem viteve të para të tranzicionit, ku i vetmi burim i parë dhe i besueshëm për besimin dhe fenë ishte familja, ndërkohë me kalimin e viteve rritet roli i rilindjes fetare që nuk lidhet më me familjen, por me elementë social jashtë saj, që tregon se në këtë rast është e vlefshme teoria e “ofertës fetare”, e cila e aplikuar edhe në disa vende të tjera të ish bllokut komunist rezulton e besueshme, për të shpjeguar një nga shkaqet e këtij fenomeni. Për të dhënat më të detajuara të të gjitha rezultateve të të dy anketimeve mund t’i referoheni shtojcës, në fund të studimit.

## **Kapitulli VI: Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri**

6.1 Vështrim mbi përqindjet e përkatësive fetare në Shqipëri

6.2 Anketimet/ Sondazhet e përkatësisë fetare ndër vite

6.3 Analizë e përqindjeve të përkatësive fetare të censusit të 2011 në Shqipëri

6.4 Vështrim mbi fetarinë e sotme të shqiptarëve ndër vite

## **Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri**

Në këtë kapitull do të merren në shqyrtim të dhëna statistikore të ndryshme, të cilat provojnë ndër vite rritjen e prezencës së besimeve fetare në mesin e shqiptarëve, pas rënies së komunizmit dhe rivendosjes së demokracisë dhe lirisë së besimit.

### **6.1 Vështrim mbi përqindjet e përkatësive fetare në Shqipëri**

Ndoshta tema më e nxehtë për fenë në Shqipëri ka qenë dhe mbetet përqindja e përkatësive fetare të shqiptarëve të sotëm, debat të cilin as Censusi i 2011 nuk e qetësoi. Në vitin 2011 në Shqipëri u zhvillua censusi i banorëve dhe i banesave dhe pas shumë debateve publike në pyetësorin e tij u përfshi edhe përkatësia fetare dhe ajo etnike, të cilat u lanë si pyetje me zgjedhje të lirë. Pas përpunimit të të dhënave INSTAT-i shpalli se 56,7 % ishin deklaruar si mysliman, 2,09 % bektashi, 10,03 % katolik dhe 6,75 % ortodoks. Përveç këtyre besimeve tradicionale, censusi paraqiti edhe 0,14 % ungjillorë, 0,07 % të krishterë të tjerë, 5,49 % besimtar të cilët nuk i përkisnin ndonjë feje, 2,5 % ateist dhe 13,79 % që nuk kishin pranuar të përgjigjeshin për përkatësinë e tyre fetare.

#### Debati mbi Censusin

Rezultati i Censurit u kontestua në veçanti nga Kisha Ortodokse për arsyen e qartë se ai e paraqiste komunitetin ortodoks si më të dëmtuarin gjatë periudhës së regjimit komunist ateist që kaloi Shqipëria, gjë që për ta ishte i pasaktë dhe i papranueshëm. Ata deklarorin se sipas një anketimi me shkrim, të plotësuar nga besimtarët ortodoks në disa qytete të Shqipërisë, fillimisht

me një kampion prej 7118 vetash e më pas me 25870 vetë, rezultonte se 67,1 % kishin deklaruar se “nuk u vizituan nga regjistruerit, ose nuk u pyetën (dhe nuk shkruan) për përkatësinë fetare.”<sup>1</sup> Ata deklarorin gjithashtu se sipas të dhënave kishtarë që ata disponojnë “(regjistrat e pagëzimit, para dhe pas persekutimit, si dhe nga regjistrat e 460 famullive orthodhokse në të gjithë vendin) numri i të krishterëve orthodhoksë e tejkalon 24 % të popullsisë së Shqipërisë.”<sup>2</sup> Veç kësaj ata pohuan se, sipas tyre të dhënat mbështesin faktin se shumica dërmuese e atyre që sipas censusit nuk janë shprehur ose janë përcaktuar si besimtarë të pacilësuar, i përkasin besimtarëve ortodoks.<sup>3</sup> Reagime të ngjashme ka pasur edhe nga disa studiues demograf, të cilët vënë në dyshim dhe pohojnë se këto të dhëna janë të pasakta.

P.sh. Prof. Ilia Telo, duke iu referuar librit të demografit Prof. Fiqiri Sheri “Popullsia e Botës” botim i vitit 2006, tregon se përbërja e popullsisë sipas besimit fetar në Shqipëri është: myslimanët 65%, ortodoksët 23% dhe katolikët 12%,<sup>4</sup> duke mos përfshirë këtu asnjë përkatësi tjetër, qoftë kjo edhe ateiste. Ai shprehet se:

Duke analizuar rezultatet e censusit dhe duke bërë krahasimin me të dhënat e pranuar para censusit vihet re:

- Zvogëlimi i popullsisë së krishterë. Nga rreth 35% në rreth 17%.
- Pesha specifike shumë e ulët e bektashinjve në 2,09%, në një kohë që në të kaluarën, bektashinjte nuk janë paraqitur më vete.
- Në mënyrë të veçantë ka një ulje të madhe në peshën specifike të popullsisë ortodokse. Përqindja e llogaritur aktualisht është më se 1/3 krahasuar me përqindjen e pranuar para censusit të vitit 2011.

Më pas ai i referohet anketimit të bërë nga Kisha Ortodokse si argument të pasaktësisë së censusit.<sup>5</sup>

Një tjetër demograf në të njëjtin organ akademik, Prof. Arqile Bërxfholi në një artikull të tij, ku kritikon me detaje disa elementë të metodologjisë dhe disa koncepte të përdorura nga INSTAT-i për regjistrimin e popullsisë, kundërshton edhe përqindjet fetare të këtij regjistrimi, duke u shprehur se nga të dhënat e hershme deri në vitin 1967 si dhe nga disa anketime (pa specifikuar në detaj se cilat) që janë bërë nga mesi i viteve 1990 tregojnë se struktura fetare e popullsisë së Shqipërisë shfaqet pak a shumë e tillë: “myslimanët dhe bektashinjte zinin gati 2/3 e popullsisë së vendit (63%), ortodoksët zinin rreth 22%, katolikët 8% dhe 7% ishin të padeklaruarit.”<sup>6</sup>

Pra duket se dy studiuesit e mësipërm, ngjashëm me Kishën Ortodokse, më së shumti për refuzimin e këtij rezultati i referohen në thelb të dhënave të vjetra si dhe anketimeve që konfirmojnë pak a shumë të njëjtën përqindje fetare të deklaruar nga regjistrimet e hershme të 1923 dhe 1927 dhe në vazhdim, të cilat pohojnë me disa dallime të vogla pak a shumë të njëjtën përqindje fetare edhe pas periudhës së sundimit ateist në Shqipëri.

---

<sup>1</sup><https://orthodoxalbania.org/2020/kisha-jone/te-dhenat-e-censusit-2011-per-te-krishteret-orthodhokse-te-shqiperise-jane-teresisht-te-pasakta-dhe-te-papranueshme/>

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Fiqiri Sheri, “Popullsia e Botës”. Tiranë, 2006. F 149. (vepër e cituar)

<sup>5</sup> Ilia TELO, REVISTA DEMOGRAFIA Nr. 1 Viti 2013, f.16-17

<sup>6</sup> Arqile Bërxfholi, REVISTA DEMOGRAFIA Nr. 1 Viti 2013, f.35.

Duke iu referuar regjistrimit të popullsisë në 1927 myslimanët përbënin 67,67%, ortodoksët 21,59 %<sup>1</sup> dhe katolikët 10,75 % të popullsisë së vendit.<sup>2</sup> Pra censusi i 2011 paraqet një rënie prej 9,48 % të myslimanëve (përfshirë edhe bektashinjtë) dhe 15,15 % të popullsisë ortodokse në rang vendi, pra një rënie me mbi tre herë e popullsisë ortodokse.

### Problematika që shoqëroi Censusin

Me të drejtë shtrohet pyetja sa të sakta janë të dhënat e censusit në këtë drejtim dhe a ka burime të tjera për të mbështetur apo rrëzuar këto rezultate?

Ajo që e vështirëson përgjigjen ndaj kësaj pyetje është fakti se procesit të regjistrimit i parapriu një debat i madh publik, i cili me siguri ndikoi edhe në përqindjen e lartë të atyre që refuzuan të përgjigjen për këtë pyetje (13,79 %). Këtu mund të përmendet fushata e ndërmarrë nga Aleanca Kuq e Zi, e cila kundërshtonte me forcë përfshirjen e kësaj pyetje krahas asaj të etnisë.<sup>3</sup> Të njëjtës nismë për refuzimin e përfshirjes së pyetjes për përkatësinë fetare, iu bashkua edhe Forumi Musliman i Shqipërisë, ndërsa Komuniteti Musliman u shpreh se ishte dakord për regjistrimin e fesë, por shprehte rezerva dyshuese për mbarëvajtjen e tij.<sup>4</sup> Pas publikimit të të dhënave zëdhënësi i Komuniteti Mysliman deklaroi ndër të tjera se myslimanët ishin më tepër nga shifra që deklaronte censusi, sipas tij ata ishin mbi 70% e popullatës.<sup>5</sup> Ndërkohë Kisha Ortodokse u shpreh para zhvillimit të Censusit se ishte dakord për përfshirjen e pyetjes për fenë në të, madje ajo sugjeronte që pyetja të ishte e detyruar, si pyetjet e tjera. Megjithatë ajo tërheq vëmendjen në deklaratën e saj më pas se ky proces u shoqërua me paqartësi dhe frikë nga qytetarët, pikërisht edhe për faktin e kundërshtimit që iu bë kësaj pyetje nga politikanë të ndryshëm dhe qarqe fetare.<sup>6</sup> Kisha Katolike nuk raportohet të kishe zyrtarisht ndonjë refuzim për rezultatin e dhënë, edhe pse pas zhvillimit të censusit dhe gjatë përpunimit të të dhënave edhe ajo ngriti objeksionet e saj për parregullsitë që kishin vërejtur gjatë regjistrimit.<sup>7</sup>

Një tjetër problematikë është mënyra e deklarimit të përkatësisë fetare, ku në shumicën e rasteve përgjigjet për fenë janë dhënë nga pjesëtarë të caktuar të familjes, të cilët janë gjendur në banesë gjatë kohës së regjistrimit, duke u përgjigjur kështu edhe për ata që nuk ndodheshin në banesë, dhe kjo padyshim ka masën e vetë të subjektivitetit, pasi besimi fetar përmban edhe zgjedhjen individuale të çdo personi dhe jo vetëm trashëgiminë familjare të tij. Problemi tjetër i madh është edhe çështja e emigrantëve, përkatësia e fetare e të cilëve kërkon një studim dhe analizë më vete. Gjithsesi synimi i censusit është të paraqesë një panoramë fotografike në një çast të dhënë të

---

<sup>1</sup> Sipas të dhënave të paraqitura nga Teki Selenica numri total i popullsisë në 1927 rezulton të ishte 828.593 frymë ku prej tyre ortodoksët ishin 178.349, pra ata përbënin 21,52 % të popullsisë, por nga mbledhja e shifrave të paraqitura sipas prefekturave dhe përkatësive fetare numri total rezulton pak më i lartë 829,099 frymë gjithsej dhe popullsia ortodokse në 179,009. Ky gabim mund të jetë rezultat i mbledhjes së gabuar, siç ndodh edhe me disa të dhëna të tjera aty ose për shkak të gabimit në hedhjen e të dhënave. Gjithsesi diferenca është mjaft e vogël dhe ky gabim nuk ndryshon përqindjen bazë.

<sup>2</sup> Teki Selenica, Shqipëria më 1927, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë 1929, fq. 491

<sup>3</sup> <http://www.gazetatema.net/2011/10/01/nis-sot-regjistrimi-i-popullsisë-aleanca-kuq-e-zi-grisni-fleten-per-fene-e-etnine/>

<sup>4</sup> <http://www.e-zani.com/2011/10/04/kmsh-mbeshtet-censusin-edhe-pse-me-rezerva/>

<sup>5</sup> <http://www.panorama.com.al/fete-kunder-censusit-bektashinjte-nuk-u-pyetem/> Shih dhe Ali M. Basha "Islami në Shqipëri gjatë shekujve" f. 216.

<sup>6</sup> <https://orthodoxalbania.org/2020/kisha-jone-te-dhenat-e-censusit-2011-per-te-krishteret-orthodhokse-te-shqiperise-jane-teresisht-te-pasakta-dhe-te-papranueshme/>

<sup>7</sup> <http://www.arkivalajmeve.com/Katoliket-kunder-Censusit-Do-te-regjistrojme-besimtare.1047134631/>

popullsisë rezidente dhe jo të të gjithë shtetasve, pavarësisht vendndodhjes së përkohshme të tyre.

Debati mbi përqindjet fetare të shqiptarëve të sotëm, sidomos pas rënies së shtetit komunist, ka pasur një ndjeshmëri të lartë jo vetëm nga komunitetet fetare, por edhe nga njerëz të tjerë. Dhe ky interesim është reflektuar edhe në anketime të ndryshme të cilat edhe pse shpesh kanë kaluar në heshtje për publikun shqiptar dhe pa u marrë seriozisht në rezultatet e tyre, ato kanë përfshirë edhe përkatësinë fetare të shqiptarëve të sotëm. Edhe pse këto sondazhe nuk kanë saktësinë e një censusi ato falë metodologjisë së saktë shkencore, kur ajo zbatohet me rigorozitet, mund të japin me përafërsi të lartë rezultate përgjithësisht të besueshme në këtë drejtim. Dhe pikërisht më poshtë do të marrim në shqyrtim disa nga këto anketime ndër vite, për t'i krahasuar ato me Censusin 2011. Por para se t'ia nisim me këto anketime, do të citojmë më parë rezultatet e një anketimi masiv, ose ndryshe një mini-census që u ndërmor pak kohë më pas nga INSTAT-i, si testim për saktësinë e Censurit të kryer.

#### Mini censusi

Instat-i për të verifikuar saktësinë e Censurit 2011 zhvilloi në të njëjtin vit një mini-census, për detajet e të cilit ai shprehet:

Madhësia e kampionit të përzgjedhur nga të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 është 3 % e Njësive Ekonomike Familjare (NJEF). Teknika e përzgjedhjes së kampionit është zgjedhje e rastësishme. Kampioni i përzgjedhur në mënyrë rastësore është 21665 NJEF nga 722226 NJEF në të gjithë vendin. Për çdo NJEF të përzgjedhur, u listuan të gjithë individët përkatës të tyre, përkatësisht 83430 individë nga 2800138 që u numëruan në Census. Ky kampion është përfaqësues në nivel qarku dhe në nivel vendi.<sup>1</sup>

Këto të dhëna në dallim me vetë censusin jepen individuale të detajuara, çfarë mundëson të bëjmë edhe korrelacione të mundshme mes tyre, për të kuptuar më tepër rezultatin. Në mënyrë përmbledhëse përqindja e përkatësive fetare që jep ky mini-census të krahasuara me atë të mini-censurit është:

Besimi fetar	Përqindjet e mini-censurit %	Përqindjet e Censurit %
Myslimanë	56,92	56,7
Bektashi	2,07	2,09
Ortodoksë	6,82	6,75
Katolikë	10,01	10,03
Besimtar të pacilësuar	5,44	5,49
Pa përgjigje	13,64	13,79
Ateistë	2,50	2,50
Ungjillorë	0,14	0,14
Krishterë të tjerë	0,08	0,07
Të tjetër	0,01	0,02
Të pavlefshme / pa përcaktuar	2,30	2,43

<sup>1</sup> Faqja zyrtare e INSTAT-it: [http://www.instat.gov.al/media/1548/censusi\\_i\\_popullsis\\_dhe\\_banesave\\_2011\\_-\\_mikrodata.rar](http://www.instat.gov.al/media/1548/censusi_i_popullsis_dhe_banesave_2011_-_mikrodata.rar)

Shuma	100 %	100 %
-------	-------	-------

Sipas këtyre të dhënave, konfirmohen rezultatet e censusit për përqindjet fetare, ndërsa diferencat mes tyre janë të papërfillshme.

## 6.2 Anketimet/ Sondazhet e përkatësisë fetare ndër vite

Këtu do të paraqesim anketimet e zhvilluara ndër vite që kemi mundur të mbledhim nga burime të ndryshme duke nisur nga anketimet e INSTAT-it.

Anketimet e INSTAT-it

INSTAT ka kryer ndër vite, para dhe pas Censusit të 2011 edhe anketime të ndryshme në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare, ku ka përfshirë në to edhe pyetjen për përkatësinë fetare.

Anketimi i 2002

Sipas një anketimi të vitit 2002 të kryer nga INSTAT-i për shëndetin riprodhues në Shqipëri,<sup>1</sup> bazuar në një kampion prej 5697 grash të moshës 15-44 dhe 1740 burrash të moshës 15-49<sup>2</sup> kemi këto të dhëna për përkatësinë fetare të ndara sipas zonave:<sup>3</sup>

Besimi fetar	Gjithsej %	Zona Urbane %	Zona Rurale %	Tirana Metropolitane %	Të tjera urbane %	Të tjera rurale %
Mysliman	84,0	75,9	91,1	84,0	71,6	91,4
Ortodoks	8,8	15,0	3,4	7,6	18,4	3,6
Katolik	4,3	5,6	3,1	3,4	7,3	2,8
Të tjerë/të padeklaruar	2,9	3,5	2,4	5,0	2,7	2,2

Anketimi i 2005

Sipas një tjetër anketimi të kryer për gratë dhe fëmijët nga INSTAT-i, në bashkëpunim me UNICEF në vitin 2005,<sup>4</sup> ku u intervistuan 5150 familje dhe 5091 gra të moshës 15-49 vjeç.<sup>5</sup> Nga

<sup>1</sup> Reproductive health survey Albania, 2002 final report. Publikuar në Maj 2005.

<sup>2</sup> Po aty fq. iii.

<sup>3</sup> Po aty fq. 23.

<sup>4</sup> Monitoring the Situation of Children and Women, Albania Multiple Indicator Cluster Survey 2005 FINAL REPORT, publikuar nga INSTAT dhe UNICEF Shkurt 2008.

<sup>5</sup> Po aty, fq. 14.

5150 familjet e intervistuar, ku meshkujt përbënin 88,1 % dhe femrat 11,9 % të kryefamiljarit,<sup>1</sup> dhe për 5091 e grave të moshës 15-49 vjeç<sup>2</sup> kemi këto të dhëna:

Besimi fetar	Përqindjet për 5150 familje	Përqindjet për 5091 gra	Mesatarja
Myslimanë	79,9	82,3	81,1
Ortodoks, Katolik dhe të tjerë	20,1	17,7	18,9
Gjithsej	100 %	100 %	100%

Anketimi i 2008-2009, 2013 dhe 2017-2018

Nga Instituti i Statistikës dhe i Institutit i Shëndetit Publik në 2008-2009 është zhvilluar një tjetër anketim, ku u përfshinë 7584 femra dhe 3013 meshkuj<sup>3</sup> dhe pothuajse 9000 familje, “të përzgjedhura në një mënyrë të tillë, që të lejonte përlllogaritje në nivel urban dhe rural, si dhe në nivelin rajonal për treguesit kyç të popullsisë dhe shëndetit”.<sup>4</sup>

Një tjetër anketim, ku përfshihet edhe deklarimi fetar, është përgatitur nga një raport kërkimor mbi dhunën në familje në Shqipëri në 2013 nga INSTAT në bashkëpunim me PNUD-in, ku kampioni përfundimtar kishte 3589 familje dhe gra të moshës nga 18 deri 55 vjeç, të shtrirë në të 12 prefekturat e Shqipërisë, duke ruajtur edhe raportet rural-urban, sipas përqindjeve që nxori censusi i 2011.<sup>5</sup> I njëjti studim është kryer në vitet 2017-2018 me pjesëmarrjen e 15000 femrave dhe 6142 meshkujve.<sup>6</sup> Këto tre anketime për përkatësinë fetare japin këto të dhëna:

Besimi fetar	Përqindjet 2008-2009	Përqindjet 2013	Përqindjet 2017-2018
Mysliman	78,05	78,4	78,7
Bektashi	1,55	1,4	1,55
Ortodoks	7,85	8,2	7,2
Katolik	10,45	9,7	11
Tjetër	0,5	0,2	0,55
Pa besim fetar	-	2,1	-
Ateist	1,65	-	0,95
Gjithsej	100 %	100 %	100 %

Anketimet e Eurobarometrit dhe ESV 1991, 1992, 2005

<sup>1</sup> Po aty fq. 49. Në këtë anketim nga INSTAT-i nuk është bërë një ndarje më e detajuar e përkatësive fetare, por janë mjaftuar vetëm me dy ndarje: mysliman dhe ortodoks, katolik dhe të tjerë, pra duke i përfshirë gjithë të krishterët dhe të tjerët në një kategori të vetme.

<sup>2</sup> Po aty, fq. 50.

<sup>3</sup> Institute of Statistics, Institute of Public Health [Albania] and ICF Macro. 2010. Albania Demographic and Health Survey 2008-09. Tirana, Albania: Institute of Statistics, Institute of Public Health and ICF Macro. fq. 38.

<sup>4</sup> Po aty, fq. 10.

<sup>5</sup> Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2013, Raport i përgatitur nga Dr. Robin N. Haarr Konsulente ndërkombëtare e PNUD-it, Nëntor 2013, fq. 27

<sup>6</sup> Institute of Statistics, Institute of Public Health, and ICF. 2018. Albania Demographic and Health Survey 2017-18. Tirana, Albania: Institute of Statistics, Institute of Public Health, and ICF. Fq. 36.

Anketimi i 1991 u zhvillua nga Gallup me një kampion prej 1000 vetash, me pjesëmarrjen e 504 meshkujve dhe 496 femrave, i shpërndarë në 15 qytete, në veri, jug dhe Shqipëri e mesme.<sup>1</sup> Edhe anketimi i 1992 u zhvillua po nga Gallup me një kampion prej 1048 personash, në zonën e Tiranës, në veri, në qendër dhe jug, me pjesëmarrës 533 meshkuj dhe 516 femra.<sup>2</sup> (92 vetë nga zona e Tiranës, 10 pa përgjigje, 247 zona veriore, 283 zona qendrore dhe 417 nga zona jugore). Dhe anketimi i Eurobarometrit i vitit 2005 kishte një kampion prej 1116 pjesëmarrës, nga këta 584 meshkuj dhe 532 femra.<sup>3</sup> Për të tria këto anketime kemi këto të dhëna:

Besimi fetar	Viti 1991		Viti 1992		Viti 2005	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Mysliman <sup>4</sup>	650	65,0 %	690	65,84 %	706	63,26 %
Ortodoks	207	20,7 %	167	15,94 %	162	14,52 %
Katolik	83	8,3 %	98	9,35 %	145	12,99 %
Protestant	-	-	1	0,09 %	-	-
Pa fe	50	5,0 %	83	7,92 %	21	1,88 %
Agnostik	-	-	-	-	4	0,36 %
Nuk e di	7	0,7 %	2	0,19 %	2	0,18 %
Tjetër	1	0,1 %	3	0,29 %	66	5,91 %
Pa përgjigje	2	0,2 %	4	0,38 %	10	0,90 %
Gjithsej	1000	100 %	1048	100 %	1116	100 %

## Anketimet e European Values Study (EVS)

### Anketimi i EVS 2008

Ky anketim është zhvilluar nga European Values Study<sup>5</sup> ku u përfshin 12 qarqet e vendit me pjesëmarrjen e 1534 vetave, 759 meshkuj dhe 775 femra.<sup>6</sup> Ky sondazh ka bërë dy pyetje që duhet të kenë krijuar konfuzion tek një pjesë në përgjigjet e dhëna. Njëra pyetje është: *Ai i përkasin ndonjë grupi fetar?* Dhe i janë përgjigjur në mënyrë të vlefshme kësaj pyetje 1524 vetë, nga këta kanë *pobuar* se i përkasin një grupi fetar 1063 vetë, dhe kanë *mobuar* t'i përkasin ndonjë grupi fetar 461 vetë, pra 30,2 % del se nuk i përkasin asnjë grupi fetar! Këtyre 1063 (ku nga këto 10 janë të pavlefshme) i është drejtuar pyetja se *Cilit grup (fetar i përkasin)?*<sup>7</sup> dhe ata kanë dhënë këto përgjigje:

<sup>1</sup> Reif, Karlheinz, & Cunningham, George (1992). Central and Eastern Eurobarometer 2 (Current Affairs and the Media). Për Shqipërinë Fatos Tarifa, Qendra e Studimeve Sociologjike, Universiteti i Tiranës. Adresa në web: <https://doi.org/10.4232/1.2251>. Shih edhe Central and Eastern EUROBAROMETER, No. 2, Janary 1992, fq. 99, 100.

<sup>2</sup> Reif, Karlheinz, & Cunningham, George (1993). Central and Eastern Eurobarometer 3 (Political Disintegration) Adresa në web: <https://doi.org/10.4232/1.2321>. Shih edhe Central and Eastern EUROBAROMETER, February 1993, No. 3 fq. 133, 135.

<sup>3</sup> Ilirjani, Altin, Bean, Clive, Gibson, Rachel K., McAllister, Ian, Billiet, Jaak, De Winter, Lieven, Frogner, Andre-Paul, (2015). Adresa në web: <https://doi.org/10.7804/cses.module2.2015-12-15>.

<sup>4</sup> Këtu janë përfshirë edhe sunnitë që janë paraqitur si kategori më vete nga myslimanët në anketimin e vitit 2005.

<sup>5</sup> Gedeshi, Ilir (2010). European Values Study 2008: Albania (EVS 2008). Adresa në web: <https://doi.org/10.4232/1.10176>.

<sup>6</sup> EVS, GESIS (2010): EVS 2008 Method Report. GESIS-Technical Reports 2010/17. Retrieved from <http://www.europeanvaluesstudy.eu/>. fq.4

<sup>7</sup> Por ndërkohë pyetjes: *A besoni në Zot?* I janë përgjigjur pozitivisht 1386 vetë, pra mbi 90%, ndërsa 89 vetë i janë përgjigjur negativisht, pra 5,8 %! Kështu që si është e mundur që ata të cilët besojnë në Zot të jenë mbi 90 % (1386 vetë) ndërkohë që ata që nuk i përkasin asnjë grupi fetar të jenë mbi 30 % (461 vetë)?! Mund të thuhet se ky 20 % diferencë janë besimtarë në Zot pa përkatësi fetare. Nëse do të ishte kështu atëherë kjo do të pasqyrohej në një nga



Besimi Fetar	Numri	Përqindja
Mysliman	691	45,05
Bektashi	107	6,98
Ortodoks	119	7,76
Katolik	132	8,6
D. Jehovait	4	0,26
Nuk e di	2	0,13
Pa përgjigje	8	0,52
E pa aplikueshme	471	30,7
Gjithsej	1534	100 %

## Anketimi i EVS 2017

Edhe ky anketim është zhvilluar nga i njëjti institucion me të njëjtat pyetje, duke përdorur të njëjtin tekst në shqip, për sa i përket pyetjeve që kanë të bëjnë me fenë dhe besimin. Në këtë anketim morën pjesë 1435 pjesëmarrës, ku 905 ishin femra dhe 530 meshkujve, me të njëjtat kritere si anketimi i 2008.<sup>1</sup> Pyetjes: *A i përkisni ndonjë grupi fetar?* I janë përgjigjur pozitivisht 1345 veta dhe negativisht 85 veta (dhe 3 pa përgjigje, 2 nuk e di).<sup>2</sup> Ndërsa pyetjes: *A besoni në Zot?* I janë përgjigjur me Po 1384, ndërsa me Jo 51 persona, pra në raportin 96,45 % me 3,55 %. Ndërsa pyetjes se cilit grup fetar i përkisni i janë përgjigjur si më poshtë:

Besimi fetar	Numri	Përqindja
Mysliman	1017	70,87 %
Bektashi	80	5,57 %
Ortodoks	94	6,55 %
Katolik	138	9,62 %
Ungjillor	7	0,49 %
Të tjerë	7	0,49 %
Pa përgjigje	2	0,14 %
E pa aplikueshme	90	6,27 %
Gjithsej	1435	100 %

## Anketimi i European Social Survey 2012

të dhënat e tjera të sondazhit. P.sh. në pyetjen: *Pavarësisht nga fakti nëse shkoni në Objektet Fetare ose jo a do te thonit se jeni 1. Një person fetar 2. Një person jofetar 3. Një ateist i bindur?* Vetëm 42 vetë i janë përgjigjur se janë ateistë të bindur dhe 87 vetë se janë persona jofetar, dhe 1273 se janë fetar, kështu që nëse mbledhim së bashku ateistët me jofetarët dalin të jenë 129 vetë, ndërkohë që më sipër ata që nuk i përkisnin asnjë grupi fetar ishin 461 vetë! Pyetja *“Do you belong to a religious denomination?”* në shqip mendoj se është përshtatur gabim, pasi shqiptarët ‘grup fetar’ e kuptojnë si sekt ose organizatë fetare, ndërsa më e drejtë do të ishte të thuhej: *A i përkisni ndonjë besimi fetar?* Për arsye se shqiptarët komunitetin mysliman, ortodoks dhe katolik i kanë parë si besime fetare, pra si fe të ndryshme dhe jo si grupime fetare, edhe pse ortodoksët dhe katolikët i përkasin të njëjtës fe të krishterë. Ndërkohë termi *denomination* i përdorur në përfundim i përshtatet në shqip më shumë termi sekt dhe ka lindur si domosdoshmëri për të dalluar mes sekteve të krishtera, prandaj mendoj se edhe përgjigjet më pas janë kontradiktore.

<sup>1</sup> Gedeshi, Ilir, Kritzinger, Sylvia, Poghosyan, Gevorg, Rotman, David, Pachulia, Merab, Fotev, Georgy, Kolenović-Dapo, Jadranka,...(2020). European Values Study 2017: Integrated Dataset (EVS 2017). GESIS Data Archive, Cologne. ZA7500 Data file Version 3.0.0, <https://doi.org/10.4232/1.13511>.

<sup>2</sup> Në këtë rast duket se ka një përmirësim të dukshëm në përgjigje, pasi konfuzioni duhet të ketë qenë më i vogël për arsye ndoshta të një sqarimi më të mirë se çfarë kuptohet me këtë pyetje.

Një tjetër anketim nga një organizatë ndërkombëtare e huaj është edhe ai i European Social Survey (ESS). Në këtë anketim të ndërmarrë në terren nga “Open Society Foundation for Albania” morën pjesë 1201 vetë, ku 549 ishin meshkuj dhe 652 femra<sup>1</sup> dhe nga deklaratimet e përkatësisë fetare<sup>2</sup> të tyre kemi këto rezultate:

Besimi fetar	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme
Mysliman	658	54,8 %	73,8 %
Ortodoks	115	9,6 %	12,9 %
Të krishterë të tjerë	6	0,5 %	0,7 %
Fe lindore	1	0,1 %	0,1 %
Të tjerë	5	0,4 %	0,6 %
Gjithsej	891	74,2 %	100 %
E pa aplikueshme	309	25,7 %	
Refuzuan	1	0,1 %	
Gjithsej	310	25,8 %	
Totali	1201	100 %	

#### Anketimi PNUD-it dhe IDM-së i 2017

Anketime të tjera ku përfshihet pyetja për përkatësinë fetare është edhe ai i “United Nations Development Programme” (UNDP) i kryer në bashkëpunim me “Institute for Democracy and Mediation” (IDM). Sipas këtij anketimi të zhvilluar nga UNDP dhe IDM në 2017 në Shqipëri, në lidhje me tolerancën fetare, me një kampion përfaqësues prej 1100 personash, nga 40 bashki të ndryshme rezultuan këto përqindje fetare:<sup>3</sup>

Besimi fetar	Përqindja
Mysliman	52,06
Bektashi	7,5
Ortodoks	13,08
Katolik	13,82
Protestant	1,74
Tjetër	1,19
Ateist	4,03
Nuk e di/ nuk jam i sigurt	5,58
Refuzon të përgjigjet	1
Gjithsej	100 %

<sup>1</sup> Anketa Sociale Evropiane, (2012). ESS Raundi i 6-të i pyetësorit kryesor. Londër: Qendra për Studime Krahësuese Sociale, City University London. Adresa në web: <https://www.europeansocialsurvey.org/data/country.html?c=albania>

<sup>2</sup> Siç duket edhe nga të dhënat në tabelë 309 persona ose 25,7 % e të anketuarve nuk janë përfshirë në përgjigjen e kësaj pyetje, sepse ata i janë përgjigjur pyetjes “A e konsideroni veten se i përkasin ndonjë besimi ose feje të caktuar?” në mënyrë negative, por ndërkohë pyetjes: *Pavarësisht nëse i përkisni ose jo ndonjë feje të caktuar, sa besimtar e konsideroni veten?* i janë përgjigjur aspak fetar vetëm 54 vetë. Kështu që ka një lloj kontradikte mes këtij numri të madh që deklarojnë se nuk i përkasin asnjë besimi apo feje dhe numrit të vogël të atyre që nuk janë aspak fetar!

<sup>3</sup> Toleranca Fetare në Shqipëri, hartuar nga UNDP dhe IDM 2018. fq. 31

## Anketimet e fondacionit “Friedrich Ebert”

Fondacioni gjerman “Friedrich Ebert” me zyrë në Tiranë ka kryer disa anketime sociale ndër të rinj, në disa prej tyre një nga pyetjet e drejtuara ka qenë edhe ajo për besimin fetar.

### Anketimi Albanian Youth 2011 dhe 2015

Në anketimin e 2011<sup>1</sup> dhe 2015<sup>2</sup> me të rinjtë shqiptar morën pjesë 1200 vetë, pyetjes se *Cilën fe ju praktikoni* i janë përgjigjur në këtë mënyrë:

Besimi fetar	Përqindja 2011	Përqindja 2015
Mysliman	55,58 %	76 %
Bektashi	3,75 %	2 %
Ortodoks	11,58 %	7 %
Katolik	8,75 %	10 %
Ateist	1,92 %	1,2 %
Nuk praktikoj asnjë fe	16,5 %	2 %
Të tjerë/ pa përgjigje	1,92 %	1,8 %
Gjithsej	100 %	100 %

Përfshirja e përgjigjes nuk praktikoj asnjë fe mes përkatësive fetare, krijon një lloj konfuzioni, sepse identifikimi me një fe të caktuar nuk nënkupton domosdoshmërisht praktikimin e saj, në të kuptuarin e njerëzve të sotëm dhe këta padyshim, siç ky sondazh i nxjerrë, nuk janë as ateistë, kështu që kjo përqindje relativisht e lartë duhet të ndahet mes besimtarëve të pacilësuar, përkatësive të tjera fetare, ata që thonë nuk e di dhe agnostikëve.

### Anketimi Albanian Youth 2018/2019

<sup>1</sup> Albanian Youth 2011, “Between Present Hopes and Future Insecurities!” publikuar në 2013, fq.35, 36. Burimi në web: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/10056.pdf>

<sup>2</sup> Rinia Shqiptare 2015, “Ndryshim i ngadaltë, mbështetje tek interneti...dhe besim tek BE!” Burimi në web: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>

Në të njëjtën linjë si dy anketimet e mëparshme fondacioni ka kryer një anketim të tretë me 1200 të rinj, nga moshë 14-29 vjeç,<sup>1</sup> ku mes pyetjeve të tjera ka qenë edhe ajo për përkatësinë fetare, të cilës i janë përgjigjur në këtë mënyrë:

Besimi fetar	Përqindja
Mysliman	69
Bektashi	4
Ortodoks	10
Katolik	12
Nuk i përkas ndonjë besimi fetar	3
Protestant	1
Pa përgjigje	1
Gjithsej	100 %

Nëse në dy anketimet e para të kryera nga ky fondacion është përfshirë kategoria e “nuk praktikon asnjë fe”, në rastin e tretë është formuluar ndryshe: “nuk i përkasë ndonjë besimi fetar” që dallon në thelb dhe padyshim që jep rezultat të ndryshëm, dhe natyrisht kjo është më saktë për sa i përket pyetjes për përkatësinë fetare.

#### Anketimet e CSES dhe ALPSA 2005-2006

Këto anketime janë kryer nga “Comparative Study of Electoral Systems” (CSES) me qendër në Michigan të SHBA që merret me studimin e opinionit elektoral nëpër botë. Këto anketime janë kryer në bashkëpunim me “Shoqatën Shqiptare të Shkencave Politike” (ALPSA).

Anketimi i parë është zhvilluar në korrik 2005 me një kampion prej 1500 vetash, ku “48 % e intervistave (ose 705 vetë) u kryen në gjashtë rrethet kryesore të vendit të shpërndara në 83 njësi intervistimi (Primary Sample Units). Pjesa tjetër (ose 795 intervista) <sup>2</sup> u kryen në rrethet e tjera të shpërndara në 90 njësi intervistimi.” Anketimi i dytë është zhvilluar në dhjetor 2005 në 910 familje në Tiranë dhe Durrës.<sup>3</sup> Anketimi i tretë u zhvillua me “një kampion rastësor banorësh në Tiranë, Shqipëri në Qershor 2006. Puna në terren u zhvillua gjatë periudhës 5-11 Qershor. Anketa u administrua nëpërmjet intervistash ballë për ballë në banesa me një kampion përfaqësues prej 1,200 individësh mbi 18 vjeç”.<sup>4</sup>

Besimi fetar	Përqindja Korrik 2005	Përqindja Dhjetor 2005	Qershor 2006	
			Numri	Përqindja
Myslimanë	64,2 <sup>5</sup>	67 <sup>6</sup>	755	63,55 % <sup>7</sup>
Bektashi	6	6	110	9,26 %
Ortodoks	14,7	13	166	13,97 %
Katolik	13,2	6	79	6,65 %

<sup>1</sup> Rinia Shqiptare 2018/2019, fq. 5 burimi në web: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf>

<sup>2</sup> Altin Ilirjani, Përmbledhje e disa rezultateve të Studimit Elektoral Shqiptar 2005, publikuar nga Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike (ALPSA). fq. 2. Burimi në web: <http://alpsa.org/aes/docs/AES2005-permbledhje.pdf>

<sup>3</sup> Altin Ilirjani, Albania Survey #1: Tirana – Durrës The First 100 Days of the Democratic Party Government, fq. 24.

<sup>4</sup> Altin Ilirjani, Anketa e Opinionit Publik Globic # 2: Opinioni Publik Shqiptar, Chapel Hill, Karolina e Veriut, SH.B.A. Qershor 2006, fq.3 Burimi në web: [http://albania.globic.us/docs/globic2\\_report\\_shqip.pdf](http://albania.globic.us/docs/globic2_report_shqip.pdf)

<sup>5</sup> Këtu janë përfshirë edhe 1,5 % që janë deklaruar si myslimanë sunij.

<sup>6</sup> Këtu janë përfshirë edhe 1% që janë deklaruar si myslimanë sunij.

<sup>7</sup> Këtu janë përfshirë edhe 18 ose 1,5 % që janë deklaruar si myslimanë sunij.

Pa fe	1,9	6	58	4,88 %
Të tjerë	-	2	20	1,68 %
Gjithsej	100 %	100 %	1188 <sup>1</sup>	100 %

Siç vihet re edhe në këto dy anketime e fundit, të cilat janë kryer në Tiranë dhe Durrës, numri i katolikëve është më i vogël, për arsyen e kuptueshme të përqendrimit të tyre më të madh në zonën veriore dhe veriperëndimore të Shqipërisë.

Anketimet e World Values Survey (WVS) 1998 dhe 2002

WVS ka organizuar disa anketime edhe në Shqipëri, kur ndër të tjera edhe pyetja për përkatësinë fetare ka qenë pjesë e tyre. Anketimi Albania 1998<sup>2</sup> u zhvillua në dhjetor të 1998 me një kampion prej 999 vetash, të ndarë sipas grup moshave, duke nisur nga 18 vjeç e lartë, po ashtu sipas rajoneve dhe seksit, sipas një përzgjedhje të rastësishme. <sup>3</sup> Anketimi i dytë Albania 2002 u zhvillua në shkurt-mars të vitit 2002 me një kampion prej 1000 vetash.<sup>4</sup> Për këto dy anketime kemi këto të dhëna:

Besimi fetar	Viti 1998		Viti 2002	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Mysliman	706	70,7 %	580	58 %
Ortodoks	204	20,4 %	180	18 %
Katolik	70	7,0 %	88	8,8 %
Protestant, ungjillor	4	0,4 %	13	1,3 %
Jude (hebre)	2	0,2 %	-	-
Asnjë fe	12	1,2 %	129	12,9 %
Të tjerë	-	-	6	0,6 %
E pa aplikueshme	1	0,1 %	-	-
Gjithsej	999	100 %	1000	100 %

Anketimi i USIA-s (United States Information Agency) në 1991

Duke qenë se kjo agjenci e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara është transformuar në 1999 në një tjetër organizëm,<sup>5</sup> e pata të pamundur të siguroj një burim të drejtpërdrejtë për anketimin e kryer prej saj në 1991 në Shqipëri, edhe pas disa kërkimeve në internet. Për këtë arsye i jam referuar Prof. Fatos Tarifës, si publikues dhe drejtues i këtij anketimi për llogari të

<sup>1</sup> 12 anketa duhet të kenë qenë të pavlefshme, edhe pse në material nuk thuhet gjë për këtë diferencë.

<sup>2</sup> Nën drejtimin e Prof Dr Hans-Dieter Klingemann dhe në bashkëpunim me Index Albania, Ltd., Tirana WV3 Technical Report Albania 1998, burimi në web:

<http://www.worldvaluessurvey.org/WVSDocumentationWV3.jsp>

<sup>3</sup> WV3\_Results Study # Albania 1998\_v20180912, fq. 50, Burimi në web:

<http://www.worldvaluessurvey.org/WVSDocumentationWV3.jsp>

<sup>4</sup> Anketimi u krye në bashkëpunim me Index Albania dhe nën drejtimin e Prof. Kosta Bajrabas, WV4\_ResultsStudy #Albania 2002\_v20180912, fq. 77, Burimi në web:

<http://www.worldvaluessurvey.org/WVSDocumentationWV4.jsp>

<sup>5</sup> Duke u integruar në Departamentin e Shtetit në Tetor 1999 shih: <https://www.federalregister.gov/agencies/united-states-information-agency>

këtij institucioni të huaj. Sipas asaj që thotë Prof. Tarifa anketimi u zhvillua në tetor 1991, nga Sektori Shkencor i Sociologjisë pranë Fakultetit të Filozofisë dhe të Sociologjisë të Universitetit të Tiranës me një kampion prej 1000 vetash, nga pesëmbëdhjetë rrethe të vendit. Një nga pyetjet që përmbante ai sondazh qe edhe ai për përkatësinë fetare, ku përgjigjet për të ishin:<sup>1</sup>

Besimi fetar	Përqindja
Mysliman	26
Ortodoks	14,7
Katolik	6,9
Jobesimtarë	52,4
Gjithsej	100 %

Tabela përmbledhëse e të gjitha anketimeve:<sup>2</sup>

---


<sup>1</sup> Fatos Tarifa, To Albania, With Love, Hamilton Books 2007, fq. 69.

<sup>2</sup> Bektashinjtë këtu nuk janë paraqitur më vete, por janë përfshirë te myslimanët. Kategorinë judenj (hebre) e kemi përfshirë tek *të tjerët*.

Feja/viid	1991 USIA	1991 ESV	1992 GL	1998 WVS	2002 WVS	2002 IS	2005 IS	2005 EB	2005 ALPSA KORNIK	2005 ALPSA DHIJET	2006 ALPSA	2008 EVS	2008-9 IS	2011 FE	2012 ESS	2013 IS	2015 FE	2017 EYS	2017 IDM	2017-8 IS	2018-9 FE	MESTARIJA	CENSUSI	
Muslimanë	26	65	65,84	70,7	58	84	81,1	63,26	70,2	73	72,81	52,03	79,6	59,3	54,8	79,8	78	76,44	59,56	80,2	73	67,74	58,79	
Ortodoksë	14,7	20,7	15,94	20,4	18	8,8		14,52	14,7	13	13,97	7,76	7,85	11,58	9,6	8,2	7	6,55	13,08	7,2	10	12,18	6,75	
Katolikë	6,9	8,3	9,35	7	8,8	4,3		12,99	13,2	6	6,65	8,6	10,45	8,75	8,7	9,7	10	9,62	13,82	11	12	9,31	10,03	
Ungjilloreç/Protestante				0,4	1,3													0,49	1,74		1	0,99	0,14	
Kristheretëçitë												0,26			0,5								0,38	0,07
Ateistë													1,65	1,92			1,2		4,05	0,95			1,95	2,5
Agnostik								0,36																-
Pa fe/ Nuk praktikojnë asnjë fe	52,4	5	7,92	0,2	12,9			1,88	1,9	6	4,88			16,5	2,1	2					3		-	
Te padisuar																							5,49	
Te fitetë fe lindore		0,1	0,29	0,2	0,6	2,9		5,91		2	1,68		0,5	1,92	0,5	1,8		0,49	1,19			1,51	0,02	
Pa përgjigje		0,2	0,38					0,9				0,52			0,1			0,14	1		1	0,53	13,79	
Nuk e di		0,7	0,19					0,18				0,13							5,58				-	
Ortodoks Katolik, Kroatik, fitetë							18,9																-	
Pa vlef/pa ap				0,1								30,7			25,7			6,27					2,43	

Këto ishin disa nga anketimet që arrita të mbledh, të cilat siç edhe duken disa prej tyre kanë diferenca të mëdha në përqindjet që tregojnë. Natyrisht është e vështirë të bësh një vlerësim të prerë, por padyshim që ato dallojnë për nga metodologjia dhe praktika e ndjekur. Por ndërkohë disa prej diferencave mes këtyre sondazheve mund të shpjegohen me vitet kur janë kryer dhe ndryshimet demografike, që lidhen me dy elementë kryesorë: migracioni i brendshëm e i jashtëm, si dhe ndryshimi i brezave. Por ndërkohë si shkak i tretë mund të përfshihet edhe vetë ndryshimi i gjendjes së fetarisë mes njerëzve, çka reflektohet në shprehjen e tyre të përkatësisë fetare, edhe pse kjo e fundit është e vështirë të testohet vetëm duke u nisur nga deklaratimet e këtyre sondazheve. Ajo që mendojmë më së shumti është vetë metodologjia dhe praktika e ndjekur në çdo rast. P.sh. pyetjet në disa raste nuk janë të qarta dhe nganjëherë përjashtojnë ose përfshijnë në përgjigje grupime të ndryshme. Po ashtu shpesh edhe paraqitja e alternativave e kufizon dhe e dirigjon të pyeturin në mënyrë të pavetëdijshme drejt një përgjigje të caktuar, siç mund të jetë arsye gjithashtu edhe pse shumë më pak, marrëdhënia momentale që krijohet mes intervistuesit dhe të anketuarit, prezenca ose jo e njerëzve të tjerë, plotësimi i fletës së anketimit nga vetë personi apo intervistuesi etj. Të gjitha këto janë elementë të mundshëm në shpjegimin e këtyre dallimeve.

Gjithsesi përgjigjet për tre besimet tradicionale janë më të lehtë për tu analizuar dhe më të qarta në përgjigje. Kështu që nëse kufizohemi vetëm tek ato të tria, për të cilat ka edhe ndjeshmëri më të lartë do të kemi këtë grafik të anketimeve ndër vite:<sup>1</sup>



Siç duket edhe nga grafiku, anketimet japin ndryshime vlerash të mëdha ndër vite, sidomos për myslimanët dhe ortodoksët, ndërsa për katolikët më pak. Myslimanët sipas këtyre anketimeve lëkundën në vlera ekstreme nga 26 % deri në 84 %, ortodoksët nga 6,55 % deri në 20,7 %, dhe katolikët nga 4,3 % deri në 13,82%, por që për këta të fundit, siç e përmenda edhe më sipër, ky ndryshim është më i lexueshëm dhe më i kuqptueshëm nëse marrim parasysh vendet ku janë zhvilluar sondazhet dhe duke ditur se pjesa më e madhe e tyre janë të përqendruar në një zonë të caktuar të Shqipërisë.

<sup>1</sup> Kam hequr në grafik rezultatet nga anketimi i 2005 i INSTAT-it ku ortodoksët, katolikët dhe të tjerë përfshihen së bashku.



Ndërkohë nëse do t'i merrnim për të mirëqena të gjitha këto vlera dhe do të guxonim të nxirrnim një mesatare, për secilin besim, për këtë periudhë tridhjetë vjeçare, do të kishim këto vlera: myslimanët 67,08 %, <sup>1</sup> ortodoksët 12,18 % dhe katolikët 9,31 %. Nëse i krahasojmë këto vlera me ato të censusit do të kemi këtë diferencë, më pak se mesatarja e anketimeve ndër vite: për myslimanët 8,29 % dhe për ortodoksët 5,43 %. Të dyja këto së bashku bëjnë 13,72 %, që për çudi është gati e barabartë me përqindjen e atyre që kanë refuzuar të përgjigjen gjatë censusit (13,79 %). Kjo mund të tregojë edhe se kujt përkatësie fetare i përkasin pikërisht më së shumti ata që kanë refuzuar të përgjigjen, që rezultojnë të jenë myslimanët dhe ortodoksët. Në fakt kjo mund të mbështet edhe nga ajo që paraqitëm në fillim se komunitetet që kontestuan më shumë para dhe pas censusit të 2011 qenë ortodoksët dhe myslimanët, pra njëkohësisht edhe ata që refuzuan më së shumti t'i përgjigjen pyetjes për përkatësinë fetare të tyre. Gjithsesi kjo mbetet vetëm një hipotezë e mundshme dhe jo diçka e prerë.

Ndërkohë për katolikët në dallim me censusin mesatarja e anketimeve ndër vite i nxjerr me rreth 0,72 % më pak, shifër kjo e tolerueshme, çfarë konfirmon qëndrueshmërinë e të dhënave ndër vite për këtë komunitet. Ateistët del të jenë mesatarisht 1,95 % ndërkohë që censusi i ka nxjerrë në vlerën e 2,5 %. Dallimi këtu mund të shpjegohet me vështirësinë që paraqesin shifrat e disa prej sondazheve, të cilat nuk kanë shpesh një përcaktim të qartë për këtë kategori. Po kështu mund të thuhet edhe për përqindjen e besimtarëve të pacilësuar, të cilët mund të jenë përfshirë në kategorinë *të tjerë* dhe në ndonjë kategori tjetër, nëpër anketimet e paraqitura. Ndërkohë mesatarja e anketimeve për ungjillorët jep një shifër relativisht shumë më të lartë (0,99 %) sesa ajo e censusit (0,14 %), por edhe kjo mund të shpjegohet me shkaqet që dhamë më sipër.

Ajo që duhet pasur parasysh në këtë rast është se kemi një pasqyrim kohor që përfshin tre dekada, dhe çështja e besimit nuk është diçka fikse, siç është çështja e etnisë, por ndikohet si nga nataliteti, migracioni dhe konvertimet. Kështu që censusi i 2011 duke marrë parasysh këtë që thamë, pavarësisht rezervave të ngritura rezultojnë të jetë deri diku i pranueshëm.

Pyetja që ngrihet në këtë rast është se si është e mundur që nisur nga të dhënat e vjetra të 1927 komuniteti ortodoks del të jetë më i dëmtuari, të paktën me rreth 8%, krahasuar me anketimet? Përgjigja për këtë mund të jepet me disa mundësi, të cilat për momentin janë hipoteza të mundshme, por të cilat do të merren në shqyrtim më pas.

Së pari, për shkak se komuniteti ortodoks është më i prekuri nga emigrimi jashtë vendit, sidomos duke përfshirë këtu edhe minoritetin grek që përbën një pjesë të mirë të ortodoksëve në vendin tonë.

Së dyti, për shkak se komuniteti ortodoks duke qenë i përqendruar më së shumti në zonat jugore është prekur nga nataliteti i ulët dhe plakja e popullsisë, që është më e theksuar në këto zona.

Së treti, për shkak se komuniteti ortodoks është më i urbanizuar, dhe duke qenë i tillë ai ka mundësi të jetë prekur edhe më shumë nga shekullarizimi gjatë regjimit komunist dhe konvertimi, pas viteve 90'. Urbanizimi ndikon gjithashtu edhe tek nataliteti i ulët dhe plakja e popullsisë, që përmendëm më sipër.

Së katërti, edhe popullsia myslimane duke qenë tradicionalisht më e madhja në numër dhe shtrirë në të gjithë vendin, është përfshirë nga migrimi, urbanizimi dhe pasojat e tij, pra nga nataliteti i ulët dhe shekullarizimi dhe natyrisht edhe nga konvertimet, pas viteve 90'. Kjo është më se e

---

<sup>1</sup> Në tabelën përmbledhëse mesatarja e myslimanëve del të jetë 67,74 %, por ndërkohë këtu kam paraqitur mesataren ku nuk përfshihet përqindja e myslimanëve të anketimit të INSTAT-it 2005, për shkak se ortodoksë e katolikë dhe të tjerë janë përfshirë në një vlerë të përbashkët.

vërtetë, por kompensimi për myslimanët duket se duhet të jetë bërë nga nataliteti i lartë që kanë pasur zonat veriore dhe verilindore të Shqipërisë në veçanti, të cilat janë zona tradicionale me popullsi të besimit islam. Por të gjitha këto supozime ngelen për tu testuar.

Padyshim e gjitha kjo pasqyrë është një vështrim i përafërt i përqindjeve të përkatësive fetare, duke marrë për bazë të gjitha këto anketime të zhvilluara ndër këto 30 vite, dhe krahasuar ato me Censusin e vitit 2011, ndërkohë që disa prej tyre janë tepër të diskutueshme për vlerat shumë të larta apo të ulëta që japin për secilën nga përkatësitë fetare tradicionale në Shqipëri dhe për kategoritë e tjera. Censusi i ardhshëm, nëse nuk do të shoqërohet me problematikat e ngritura në të kaluarën, mund t'i konfirmojë me saktësi ose jo këto përfundime.

### **6.3 Analizë e përqindjeve të përkatësive fetare të censusit të 2011 në Shqipëri**

Këtu do të marrim në shqyrtim të dhënat e paraqitura nga mini-censusi i vitit 2011,<sup>1</sup> duke testuar lidhjen mes përkatësisë fetare dhe elementëve të tjerë, të cilët përgjithësisht mendohet se kanë ndikuar në ndryshimin e përqindjeve fetare.

#### **Metodologjia**

Të dhënat e minicensusit do të përpunohen përmes programit SPSS duke përdorur analizën Descriptive Statistics përmes përpunimit Crosstabulation me dy të dhëna bazë, fenë dhe një dhënë tjetër demografike, dhe duke nxjerrë përqindjen rezultante për këtë të dhënë brenda çdo komuniteti fetar. Më pas do të bëhet interpretimi i të dhënave duke u mbështetur edhe në konstatime të tjera të jashtme.

#### **Variablat që do të merren në shqyrtim**

Një nga shkaqet kryesore të ndryshimit të fetarisë së njerëzve, për rrjedhojë edhe të përqindjeve të përkatësisë fetare të dikurshme është procesi shekullarizues i shoqërive, i cili mund të matet me disa elementë, siç është urbanizimi, për faktin e njohur se zonat rurale janë më konservatore dhe më pak të prira për të ndryshuar traditën, mes tyre edhe besimin. Element tjetër matës është numri i pjesëtarëve në një familje. Familjet tradicionale që e ruajnë edhe më së shumti fenë, janë ato familje që kanë edhe më shumë pjesëtar, të cilat zakonisht përbëhen nga tre breza. Një tjetër element tregues i rëndësishëm është shkalla e lindshmërisë, për arsye se shoqëritë moderne, dhe të shekullarizuara karakterizohen nga një lindshmëri më e ulët dhe nga plakje e popullsisë gjithashtu. Tjetër element matës është edhe niveli i arsimimit, për arsye sepse shkolla ka qenë një nga vatrat më të fuqishme shekullarizuese të epokës së modernitetit. Këta janë disa elementë për të cilët mund të bëjmë korrelacione nga të dhënat demografike të detajuara që disponojmë nga mini-censusi dhe të shqyrtojmë, se cilat nga komunitetet fetare tradicionale në vend janë prekur më së shumti nga proceset shekullarizuese, në veçanti në periudhën e regjimit komunist. Këtu gjithashtu do të përfshijmë edhe çështjen e emigrimit, e cila mendohet se ka ndikuar gjithashtu në ndryshimin e përqindjes së përkatësive fetare.

---


<sup>1</sup> INSTAT official website: [http://www.instat.gov.al/media/1548/censusi\\_i\\_popullsis\\_dhe\\_banesave\\_2011\\_-\\_mikrodata.rar](http://www.instat.gov.al/media/1548/censusi_i_popullsis_dhe_banesave_2011_-_mikrodata.rar)

Para se të marrim në analizë lidhjen mes përkatësisë fetare dhe elementëve të tjerë, e pamë të arsyeshme të bëjmë një pasqyrim gjeografik sesi ka ndryshuar dhe lëvizur përkatësia fetare nga aspekti gjeografik në Shqipëri, duke e krahasuar mes regjistrimit të detajuar të 1927 dhe censusit të 2011.

Krahasim i shpërndarjes gjeografike fetare mes regjistrimit të 1927 dhe censusit të 2011

Për të kuptuar sesi ka lëvizur shpërndarja gjeografike e shqiptarëve, në 84 vjet, duke iu referuar besimit të tyre do të krahasojmë ndërmjet tabelave dhe grafikëve që paraqet regjistrimi i vitit 1927 dhe ai vitit 2011. Më poshtë, po paraqesim një tabelë dhe grafik të popullsisë sipas regjistrimit të 1927 dhe përkatësive fetar të regjistruara në atë kohë:<sup>1</sup>

Regjistrimi i 1927 i përshtatur sipas ndarjes së re që të përputhet me 2011														
Feja/Prefektura	Shkodër	Lezhë	Kosovë	Dibër	Durrës	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Vlorë	Gjirokastrë	Shuma	Përqindja
Myslimanë	31887	7044	35120	73137	33073	52051	74700	38763	45680	77357	38716	53326	560854	<b>67,64</b>
Katolikë	34009	39219	3532	8497	3821	112	-	-	-	-	-	6	89196	<b>10,75</b>
Ortodoksë	1886	8	-	1372	2832	2641	6438	23071	8709	51107	37631	43314	179009	<b>21,59</b>
Hebrenj (judenjë)											40		40	
Gjithsej													829099	<b>100 %</b>





Këtu është pasur parasysh që renditja të bëhet nga veriu në jug, dhe ndarjet e vjetra të përshtaten me ndarjen e re, të 2011, kur u zhvillua censusi banorëve dhe banesave.<sup>2</sup> Siç duket qartë popullsia katolike ka qenë e përqendruar kryesisht në zonën veriore dhe në veçanti atë veriperëndimore, ndërsa popullsia myslimane gjendet e shpërndarë në të gjithë vendin, por me një prezencë mjaft të ulët në prefekturën e Lezhës, ndërsa popullsia ortodokse ka një prezencë të

<sup>1</sup> Selenica Teki, Shqipëria më 1927, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë 1929, fq.491

<sup>2</sup> Në 1927 me emrin e prefekturës së Kosovës përfshihet kryesisht ajo që është sot qarku i Kukësit, kështu që nuk duhet keqkuptuar se ka të bëjë me krahinën e sotme të Kosovës dhe pjesën që ishte jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë. E njëjta gjë vlen edhe për përdorimin e termimit Çamëri në jug që hasim të përdoret në ndarjen administrative të asaj kohe.

dukshme në jug të vendit, ndërsa në veri ka një prezencë minimale. Ndërsa nëse i referohemi censurit të 2011 do të kemi këto të dhëna:

Censuri 2011														
Feja/ Qarku	Shkodër	Lezhë	Kukës	Dibër	Durrës	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Vlorë	Gjirokastrë	Totali	Përqindje
Mysliman	96568	19845	71483	111551	177274	466760	190550	150559	71226	129964	74013	27815	1587608	<b>56,70</b>
Bektashi	147	177	4	5264	4215	19909	1515	3137	11681	4558	1903	6118	58628	<b>2,09</b>
Katolik	101617	97014	2236	2799	19322	39745	3054	6149	1631	2492	3369	1493	280921	<b>10,03</b>
Ortodoks	813	333	22	123	8675	37890	15295	42695	10624	35814	24125	12583	188992	<b>6,75</b>
Ungjillorë	188	85	23	16	325	1783	147	331	71	660	109	59	3797	<b>0,14</b>
Krishterë tjerë	38	17	31	12	167	797	95	174	290	122	126	50	1919	<b>0,07</b>
Besimtar të pa cilësuar	673	1459	2095	5970	9131	29579	30161	22186	11981	15078	19267	6050	153630	<b>5,49</b>
Ateist	304	175	284	929	2901	20558	9679	11190	4855	4007	10563	4550	69995	<b>2,50</b>
Të tjerë	20	9	3	5	41	270	8	58	52	24	60	52	602	<b>0,02</b>
Pa përgjigje	10632	10724	6989	8502	33754	113844	39313	64960	27017	22595	36749	10945	386024	<b>13,79</b>
Pavlefshme	4347	4189	2122	1876	6980	18230	6010	8892	2516	5043	5356	2461	68022	<b>2,43</b>



Gjithsej	215347	134027	85292	137047	262785	749365	295827	310331	141944	220357	175640	72176	2800138	<b>100 %</b>
----------	--------	--------	-------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	-------	---------	--------------

Siç shihet edhe nga grafikët ka një zhvendosje të dukshme të popullsisë drejt qendrës, kryesisht Tiranës dhe Durrësit, nga të gjitha besimet, sidomos ka një rënie të theksuar të popullsisë në jug të Shqipërisë, nëse e krahasojmë atë me 1927, kur kjo zonë kishte më shumë banorë se çdo zonë tjetër e vendit. Por ndërkohë përhapja gjeografike e feve nuk duket se ka ndryshuar shumë. Katolikët vazhdojnë të jenë shumicë absolute në qarkun e Lezhës dhe të ruajnë një shumicë të lehtë në qarkun e Shkodrës. Ndërkohë vihet re një shtim i prezencës së tyre në Tiranë dhe rënie të theksuar të ortodoksëve në jug. Myslimanët vazhdojnë të ruajnë shumicën në të gjitha qarqet e tjera të vendit. Në thelb nuk kemi ndonjë përmbysje shumicash fetare në asnjë zonë, pavarësisht rritjes së diferencës mes tyre në disa zona. Veç kësaj, larmisë fetare të vendit i janë shtuar edhe besime të tjera si dhe ateistët, ku këta të fundit edhe pse përbëjnë një përqindje të vogël duket se përqendrohen më së shumti në qendër, veçanërisht në Tiranë dhe shtrihen gjatë gjithë jugut, nga

Tirana e poshtë me disa mijëra njerëz, ndërkohë që nga skaji verior deri në Durrës, pa e përfshirë këtë të fundit, janë vetëm disa qindra. Kjo tregon se veriu i Shqipërisë e ka ruajtur përkatësinë dhe besimin fetar më shumë sesa zona e mesme dhe ajo e jugut.

#### Familja tradicionale dhe përkatësia fetare

Urbanizimi i shoqërisë shoqërohet me efekte të ndryshme sociale, mes tyre edhe kalimi nga një familje tradicionale, me shumë pjesëtarë, tek një familje më moderne me më pak pjesëtarë, pra edhe më shekullare. Numri i lartë i pjesëtarëve në një familje tregon për ruajtjen e familjes tradicionale me shumë individë, të përbërë shpesh nga tre breza dhe nga një numër i madh fëmijësh, kjo e fundit padyshim tregon edhe për lindshmërinë e lartë të tyre, të tilla familja kanë edhe më shumë premisa për të ruajtur identitetin fetar gjithashtu. Nisur nga kjo premisë këtë mund ta testojmë duke kryqëzuar të dhënat për përkatësinë fetare me numrin e pjesëtarëve të një familje. Atëherë duke iu referuar kësaj logjike nëpërmjet programit SPSS kemi bërë kryqëzimin e variabëlit të besimit fetar me atë të kodit të individit dhe kemi këtë tabelë:

Besimi fetar		Kodi i individit (numri i familjarëve)																
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
Mysliman	frekuenca	12251	11530	9228	7069	4130	2010	752	278	136	57	30	10	4	2	2	1	1
	%	25,8	24,3	19,4	14,9	8,7	4,2	1,6	0,6	0,3	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Bektashi	frekuenca	534	441	321	228	130	50	20	4	2	2	1	0	0	0	0	0	0
	%	30,8	25,4	18,5	13,2	7,5	2,9	1,2	0,2	0,1	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Katolike	frekuenca	2110	2009	1595	1235	787	369	152	58	25	12	4	1	0	0	0	0	0
	%	25,2	24,0	19,1	14,8	9,4	4,4	1,8	0,7	0,3	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ortodoks	frekuenca	1861	1629	1076	684	308	117	19	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0
	%	32,7	28,6	18,9	12,0	5,4	2,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ungjillorë	frekuenca	30	33	27	19	10	3	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	%	24,2	26,6	21,8	15,3	8,1	2,4	1,6	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Tjetër i krishterë	frekuenca	17	25	13	9	4	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	%	24,3	35,7	18,6	12,9	5,7	2,9	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Besimtar i pacilësuar	frekuenca	1181	1170	917	686	348	162	47	20	9	3	1	0	0	0	0	0	0
	%	26,0	25,7	20,2	15,1	7,7	3,6	1,0	0,4	0,2	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ateist	frekuenca	638	508	430	300	125	56	24	9	3	0	0	0	0	0	0	0	0
	%	30,5	24,3	20,5	14,3	6,0	2,7	1,1	0,4	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Preferon të mos përgjigjet	frekuenca	2743	2614	2457	1878	1013	444	128	56	26	12	7	3	3	2	1	1	0
	%	24,1	23,0	21,6	16,5	8,9	3,9	1,1	0,5	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Pavlefshme /e papërcaktuar	frekuenca	296	364	332	323	289	150	98	33	17	9	4	4	3	0	0	0	0
	%	15,4	18,9	17,3	16,8	15,0	7,8	5,1	1,7	0,9	0,5	0,2	0,2	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0
Tjetër	frekuenca	4	3	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	%	36,4	27,3	18,2	18,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0

Duke iu referuar tabelës së mësipërme, ku numri 1 përfaqëson kryefamiljarin dhe numrat e tjerë deri te 17 të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes, nëse marrim si numër referimi numrin katër, pra katër pjesëtarë të një familje, pra përgjithësisht dy prindër dhe dy fëmijë, që është edhe niveli i zëvendësimit të popullsisë, do të shohim se brenda myslimanëve, familje me më shumë se katër persona përbëjnë 15,6% të tyre, tek bektashinjtë 12,1% të tyre, tek ortodoksët 7,8% të tyre, tek katolikët 16,9% të tyre, tek ungjillorët 12,1% të tyre, tek të krishterët e tjerë 8,5% të tyre, tek besimtarë të pacilësuar 13% të tyre, tek ateistët 10,4% të tyre, tek ata që nuk janë përgjigjur 14,8 % të tyre dhe tek të tjerët 0%. Ndërkohë familje me numrin maksimal të pjesëtarëve kemi ato

muslimane deri me 17 pjesëtarë, preferon të mos përgjigjet deri në 16 pjesëtarë, katolikë deri në 12 pjesëtarë, bektashi dhe besimtarë të pacilësuar deri në 11 pjesëtarë, ortodoks dhe ateistë deri në 9 pjesëtar, ungjillor deri në 7 pjesëtar, të krishterë të tjerë deri në 6 pjesëtarë. Pra shihet se familje me më shumë pjesëtar janë ato muslimane dhe katolike dhe më pak ato ortodokse dhe të krishterë të tjerë. Pra kjo shpjegon faktin se modernizimi dhe shkëputja nga familja tradicionale me shumë pjesëtarë ka prekur më së shumti ortodoksët dhe më pak katolikët dhe myslimanët. Dhe padyshim këto familje janë më të prira për të ruajtur dhe trashëguar përkatësinë fetare të të parëve, sesa ato familje më moderne, me më pak pjesëtarë.

Lindshmëria si faktor i ruajtjes së identitetit fetar

Studiues të ndryshëm kanë vënë në dukje se popullsitë më fetare kanë prirje të kenë lindshmëri më të lartë sesa ato më pak fetare dhe më të shekullarizuara.<sup>1</sup> P.sh. fetarizmi, migracioni dhe pjelloria luajnë një rol të rëndësishëm në Shtetet e Bashkuara. Amerikanët shekullar kanë një normë mesatare totale pjellorie prej 1,66, në krahasim me katolikët që mesatarisht e kanë 2,3; protestantët 2,21 dhe myslimanët 2,84. Lindshmëria tek ata që kanë pikëpamje konservatore fetare në lidhje me abortin është mesatarisht dy të tretat më e lartë se sa tek ata që mbrojnë pikëpamjet pro lirisë së abortit.<sup>2</sup> Studimet tregojnë gjithashtu se përbërja fetare e Shteteve të Bashkuara deri në vitin 2043, do të përcaktohet nga “pjelloria e ulët e amerikanëve shekullarë dhe fetarizmi i imigrantëve, të cilët sigurojnë një forcë kundërvepruese ndaj shekullarizimit”<sup>3</sup> Grupi më i madh i imigrantëve, ai hispanik katolikë, do të jetë ai që do të përjetojë edhe rritjen më të madhe se çdo grup etno-fetar tjetër, ndoshta duke arritur deri në 18% të popullsisë amerikane deri në 2043.<sup>4</sup>

Eric Kaufmann e cilëson këtë si “krizën e shekullarizmit” që po vjen. Sipas tij, intelektualët dhe politikanët liberalë u pëlqen ta konceptojnë “rënie” e besimeve dhe praktikave fetare në të gjithë botën, si një hap i pashmangshëm drejt përparimit më të madh shkencor dhe moral. Sipas kësaj pikëpamje, mbijetesa e fesë në shoqëritë shekullare, është gjithmonë në rënie. Por, Kaufmann argumenton se shekullarizmi përmban në vetvete një “kontradiktë demografike” të padukshme, e cila mund të minojë mbizotërimin e tij në të ardhmen. Demografët kanë vënë re se ndërsa shoqëritë janë industrializuar dhe kontracesioni është bërë më i gjindshëm, vlerat dhe ideologjitë janë bërë përcaktuese më të rëndësishme në sjelljen riprodhuese. Në vendet që kalojnë këtë “tranzicion të dytë demografik”, pjelloria është nën nivelin e zëvendësimit të popullsisë (2,1 fëmijë për grua) dhe kjo tani është normë, që i prijnë shekullarët dhe fetarët liberalë. Për këto grupe, individualizmi, barazia gjinore dhe shqetësimi për mjedisin, priren të jenë më të rëndësishme në synimet e tyre sesa objektivat tradicionale, siç është lindja e fëmijëve, veçanërisht në një ekonomi të globalizuar që shpesh i kërkon të ardhurat familjare nga dy drejtime, burra dhe grua. Në kontrast me këtë, konservatorët fetarë në Krishterim, Islam dhe

---

<sup>1</sup> Shih p.sh. Eric Kaufmann, *Shall the Religious Inherit the Earth? Demography and Politics in the Twenty-first Century*. 2011.

<sup>2</sup> Eric Kaufmann and Vegard Skirbekk “Go Forth and Multiply”, *Political Demography*, 204.

<sup>3</sup> Skirbekk, Vegard, Eric Kaufmann and Anne Goujon, “Secularism, Fundamentalism or Catholicism? The religious composition of the United States to 2043 *Journal for the Scientific Study of Religion*, 49(2): 293-310 (June 2010), 293.

<sup>4</sup> *Ibid* f. 304.

Judaizëm u janë kundërvënë shumë prej këtyre tendencave kulturore duke vazhduar të kenë më shumë fëmijë sesa ata që nuk janë fetarë.<sup>1</sup>

Arsyet e kësaj rënie demografike janë pra së pari ideore, ato janë rezultat i liberalizimit të vlerave që erdhën përmes proceseve të modernizimit dhe shekullarizimit, të cilat kanë mbivendosur moralin e individualizimit kulturor dhe vetërealizimit si vlerë sublimë, fakt ky që ndikon në uljen e pjellorisë mes njerëzve. Kjo sjellje ndaj pjellorisë është përçarur përmes modeleve kulturore mediatike, fillimisht si një praktikë e klasës së lartë dhe të mesme në vendet perëndimore, duke u bërë më pas fenomen global. Sidoqoftë, përjashtim nga kjo sjellje bëjnë shoqëritë fetare, ku niveli i pjellorisë i të cilave mbetet në nivelin e zëvendësimit ose më i lartë se ai. Fetarët po i rezistojnë në mbarë botën prirjes drejt rënies së niveleve të pjellorisë, sepse ata karakterizohen nga një frymë popullore që e lehtëson dhe e mirëpret lindshmërinë, të rrënjësuar në mësimet e shkrimeve të shenjta dhe në traditat para-moderne, që mbështesin dhe inkurajojnë lindshmërinë e lartë. Ky avantazh i pjellorisë në mesin e fetareve do të sjellë në mënyrë eksponentiale rritje të pjesës së tyre të popullsisë, duke paraqitur kështu një sfidë për vlerat shekulare.<sup>2</sup> Shkurtimisht mund të themi se, në çdo fe madhore botërore ka një prirje të fortë pro-nataliste, dhe demografikisht parashikohet që fetarët të tejkalojnë jofetarët, aq sa do të mund të ndodhë një përmbysje e mundshme, natyrisht modeste, e proceseve shekullarizuese brenda Shteteve të Bashkuara dhe Evropës rreth vitit 2050.<sup>3</sup>

Shqipëria dhe lindshmëria sipas përkatësive fetare

Duke iu referuar të dhënave të detajuara të mini-censusit të 2011, të publikuar nga INSTAT-i dhe duke qenë se ato përputhen gati plotësisht me censusin dhe e pasqyrojnë atë në nivelin makro, atëherë na jepet mundësia të shohim lidhjen mes përkatësisë fetare dhe lindshmërisë. Duke përdorur programin SPSS kemi këtë tabelë të dhënash:

Numri i fëmijëve të lindur gjallë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	
Përqindja brenda besimeve fetare	mysliman	11,0	32,1	24,1	12,8	7,2	5,2	3,0	2,3	1,2	0,6	0,2	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0
	bektashi	10,2	36,0	22,7	12,5	6,8	3,8	3,2	2,3	2,3	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0
	katolikë	10,7	25,2	25,0	13,7	8,0	6,1	4,2	3,4	1,9	1,2	0,4	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0
	ortodoksë	11,8	45,6	21,6	9,3	5,3	2,8	1,9	0,6	0,7	0,2	0,1	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0
	ungjillorë	15,2	54,5	15,2	9,1	3,0	0,0	0,0	0,0	3,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
	krishterë të tjerë	21,9	34,4	25,0	12,5	6,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
	të pacilësuar	13,4	33,6	24,1	11,5	6,5	4,3	3,0	1,7	0,9	0,7	0,1	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0
	ateistë	12,7	45,9	20,1	6,9	5,1	4,2	1,8	1,2	1,1	0,2	0,7	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0
	pa përgjigje	13,4	38,5	23,5	10,9	5,5	3,6	1,7	1,2	0,9	0,5	0,2	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0
	të pavlefshme /e papërcaktuar	9,9	29,9	26,0	17,4	5,3	4,3	1,6	2,6	1,6	1,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0

Nisur nga tabela e mësipërme, nëse marrim si pikë referimi numrin 2, që tregon lindjen e dy fëmijëve për grua, që është edhe numri i zëvendësimit të popullsisë, mund të vëmë re se gratë që janë identifikuar si myslimane, të cilat kanë lindur më shumë se dy fëmijë përbëjnë 56,9% të këtij

<sup>1</sup> David McClendon, (2013). Shall the Religious Inherit the Earth? Demography and Politics in the Twenty-First Century. *Sociology of Religion*, 74(3), 417–419.

<sup>2</sup> Ramos, Joshua. Demographics as Destiny: Globalization and the Resurgence of Religion Through Fertility,” in *Journal for Cultural and Religious Theory* vol. 12. no. 3 (Spring 2013)

<sup>3</sup> Eric Kaufmann and Vegard Skirbekk “Go Forth and Multiply”, *Political Demography*, f. 209.

komuniteti, gratë bektashiane 53,8% të këtij komuniteti, gratë katolike 64,1% të këtij komuniteti, gratë ortodokse 42,6% të këtij komuniteti, gratë ungjillore 30,3% të këtij komuniteti, të krishterët e tjera 43,7% të tyre, besimtare të pacilësuar 53% të këtij grupimi, ateiste 41,4% të tyre dhe ato që nuk janë përgjigjur 48,1% të këtij grupi. Ndërkohë mesatarja e lindshmërisë për grua, nisur nga besimi fetar i bie të jetë:

Besimi fetar	Numri i grave	Numri i fëmijëve të lindur	Mesatarja
Mysliman	13843	45361	3,28
Bektashian	528	1693	3,21
Ortodoks	1906	5277	2,77
Katolik	2337	8424	3,6
Ungjillor	33	82	2,48
Krishterë të tjerë	32	79	2,49
Besimtar të pacilësuar	1385	4301	3,11
Ateist	567	1619	2,86
Pa përgjigje	2933	8552	2,92

Rezultatet më sipër tregojnë qartë se lindshmërinë më të lartë, sipas të dhënave të mini-censurit të vitit 2011, e kanë gratë katolike, të pasuara nga ato myslimane dhe bektashiane, ndërsa më të ulët gratë e krishtera jotradicionale, ortodokse dhe ato ateiste. Kjo konfirmon edhe një herë faktin se edhe në Shqipëri lindshmërinë më të lartë e kanë ata njerëz që identifikohen se i përkasin një besimi në dallim me ateistët që e kanë më të ulët. Ndërkohë numri i ulët i lindshmërisë mes atyre që identifikohen si ortodoks dhe të krishterë të tjerë jotradicional (ungjillor etj.), mund të shpjegohet me faktin se ortodoksët kanë edhe nivelin më të lartë të urbanizimit dhe modernizimit, edhe pse i përkasin një besimi tradicional në Shqipëri, ndërsa për pjesën tjetër të të krishterëve që nuk i përkasin besimeve tradicionale shqiptare, është më se e kuptueshme që duke qenë se janë prurje më të vonshme, kryesisht pas viteve 90' janë edhe më të urbanizuar dhe modernizuar, ndaj dhe lindin më pak fëmijë. Në fakt edhe më herët, para censurit të 2011 studiues si Nathali Clare, kanë tërhequr vëmendjen se nëse i referohemi përkatësisë së origjinës së individëve, popullsia ortodokse del të ketë pësuar rënie dhe ajo katolike dhe myslimane rritje, nisur nga rritja demografike gjatë viteve 70-80, që kanë pësuar zonat veriore.<sup>1</sup> Fakt ky që konfirmohet edhe nga censusi i vitit 2011, edhe pse pas viteve 90' Shqipëria pësoi ndryshime të mëdha demografike, kryesisht për shkak të migrimit. Kështu p.sh. INSTAT-i pohon se:

Qarku me numrin mesatar më të lartë të fëmijëve, pasi ne kontrollojmë për faktorë të tjerë ndërhyrës, është Kukësi, i cili ka më shumë se 20% numër më të lartë të CEB sesa Vlora. Numri më i ulët i fëmijëve për grua mund të gjendet në Korçë, e cila ka një numër 10% më të vogël të CEB sesa Vlora. Pasi kontrolluam vendbanimin urban/rural, rezultoi se Tirana ka një CEB prej vetëm 2,7% më të ulët sesa Vlora. Rajonet e tjera që kanë


<sup>1</sup> Përpjekja, Botim i qendrës Përpjekja, nr. 20, Tiranë 2005 f. 13. Ajo jep si ilustrim, në shënimin në fund të faqes, duke thënë: "Për shembull në rrethin katolik të Mirditës shkalla e rritjes së popullsisë midis viteve 1970-1980 ishte 93% në Pukë (katolikë dhe myslimanë) dhe Skrapar (bektashi) ka qenë mbi 70%, në Kukës dhe Tropojë (musliman) ka qenë mbi 60% ndërsa në Gjirokastrë, Korçë dhe Kolonjë ka qenë rreth 30%. Shih Monographie par pays, Albanie 1993 (Statistisches Bundesamt Eurostat, Brüssel/Luxembourg 1994) 37."



lindshmëri më të lartë sesa Vlorë janë: Dibra (11% më të lartë), Durrësi (1% më të lartë), Lezha (4% më të lartë) dhe Shkodra (6% më të lartë).<sup>1</sup>

Më poshtë INSTAT jep edhe grafikun përkatës, ku Vlorë ka vlerën 1, dhe shërben si kategori referencë.<sup>2</sup>

Fig. 5.5: Efekti relativ sipas qarqeve mbi variablin "Fëmijët e lindur ndonjëherë" (CEB)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011  
<sup>a</sup> Kategori referencë (vlera =1)

Pra ajo që mund të themi në këtë rast është fakti se zonat e jugut dhe ato të mesme të Shqipërisë, të cilat karakterizohen për sa i përket përkatësisë fetare më së shumti nga myslimanët dhe ortodoksët, janë edhe zona me lindshmëri më të ulët, por ndërkohë zona veriore që karakterizohet më së shumti për sa i përket përkatësisë fetare nga myslimanët dhe katolikët, ka edhe lindshmërinë më të lartë, kështu që humbja që ka pësuar përkatësia myslimane në jug dhe në Shqipërinë e mesme, për shkak të lindshmërisë së ulët, është kompensuar në një farë mase nga lindshmëria e lartë në veri të vendit, në veçanti në zonën veri-lindore, që ka edhe lindshmërinë më të lartë në rang shtetëror. Ndërsa ortodoksët duke mos pasur shtrirje të madhe në veri të vendit, janë më të dëmtuarit, për sa i përket lindshmërisë.

#### Mosha dhe përkatësia fetare

Një tjetër element që mund të shpjegojë përqindjet e përkatësive fetare sot është edhe shpërndarja e saj sipas grup-moshave. Për ta testuar këtë i kemi ndarë grup-moshat me dhjetëvjeçar dhe pastaj kemi kryqëzuar të dhënat me besimin fetar, duke nxjerrë përqindjen e çdo grup-moshe brenda vetë komunitetit të caktuar fetar. Kështu që nga përpunimi i të dhënave kemi këtë tabelë:

Mosha	Myslimanë %	Bektashi %	Katolik %	Ortodoks %	Ungjillor %	Krishterë të tjerë %	Besimtar i pacilësuar %	Ateistë %	Pa përgjigje %	Pa vlefshme %	Tjetër %
0-10	13,7	11,4	13,7	8,6	18,4	12,8	12,5	13,3	17,6	19,5	0,0
11-20	18,4	14,0	19,9	13,1	13,6	11,4	19,2	15,6	18,4	20,6	18,2
21-30	15,0	14,7	14,6	12,2	20,8	12,9	15,2	14,6	14,9	19,9	0,0
31-40	12,3	10,4	11,8	11,0	24,8	20,0	12,7	11,6	11,4	9,0	9,1

<sup>1</sup> Popullsia dhe Dinamikat e saj në Shqipëri. Horizonte të reja demografike? Maj 2014, INSTAT f.55

<sup>2</sup> Ibid.

41-50	14,0	15,6	14,1	13,4	4,8	18,6	14,9	13,8	13,3	8,6	36,4
51-60	11,9	15,7	10,8	16,8	11,2	12,9	12,7	14,8	12,5	9,3	9,1
61-70	7,9	10,3	7,5	12,5	4,0	5,8	7,4	9,6	7,1	6,1	18,2
71-80	5,0	6,4	5,3	9,4	0,8	4,2	3,7	4,5	3,6	4,8	0,0
81-90	1,4	1,4	1,9	3,0	0,8	1,4	1,4	1,2	1,4	1,8	9,1
91-100	0,1	0,4	0,1	0,5	0,0	0,0	0,2	0,2	0,1	0,5	0,0

Siç edhe vihet re te myslimanët moshë 20 vjeç e poshtë përbën 32,1% të këtij komuniteti, ndërsa tek katolikët 33,6 % të tyre dhe tek ortodoksët 21,7% të tyre. Ndërsa moshë 50 e lartë përbën 42,2 % të ortodoksëve, 26,5% të katolikëve dhe 26,3% të myslimanëve. Nga këto të dhëna del se komunitetet me moshë më të re janë ai katolik dhe mysliman, dhe komuniteti me moshë më të plakur është ai ortodoks.

#### Përkatësia fetare dhe urbanizimi

Shoqëria shqiptare për arsye historike, gjeografike, sociale, kulturore etj., për shekuj ka qenë një shoqëri thellësisht rurale. Edhe pas themelimit të shtetit shqiptar në 1912 dhe me gjithë hapat drejt urbanizimit dhe industrializimit të tij, në të gjitha regjimet që ai kaloi, u desh të vinte viti 2011 dhe censusi që u bë në atë vit, për të treguar për herë të parë, pas gati një shekulli, se kishte ndryshuar raporti i popullsisë që jetonte në qytet me atë që jetonte në fshat, në favor të të parit.

Për arsye të kuptueshme të natyrës konservatore të jetës rurale, edhe besimi fetar është ruajtur më tepër në të sesa në qytet. E njëjta gjë ka ndodhur edhe më parë, p.sh. në konvertimin masiv të shqiptarëve në mysliman. Fillimisht Islami ka qenë fe që ishte e përqendruar në zonat urbane, duke nisur nga paria e vendit, që nisi të islamizohet që nga gjysma e dytë e shekullit XIV, ndërsa në zonat rurale shumë më vonë.<sup>1</sup> E njëjta gjë ndodh edhe me shekullarizimin dhe përhapjen e ideologjive moderne jofetare, të cilat fillimisht janë përhapur në zonat urbane. Nisur nga ky fakt, duke përpunuar të dhënat e mini-censurit, duke kryqëzuar të dhënat mes përkatësisë fetare dhe zonës së banimit, rural dhe urban, për të parë se si ndahet çdo besim fetar mes fshatit dhe qytetit. Kryqëzimi i këtyre dy dhënave na jep këtë tabelë:

Besimi fetar	Urban %	Rural %
Mysliman	50,5	49,5
Bektashi	58,3	41,7
Katolike	49,1	50,9
Ortodoks	62,7	37,3
Ungjillorë	68,5	31,5
Të krishterë të tjerë	87,1	12,9
Besimtar i pacilësuar	52,9	47,1
Ateist	71,6	28,4
Preferon të mos përgjigjet	63,0	37,0
E pavlefshme /e papërcaktuar	51,1	48,9

<sup>1</sup> Shih Ferit Duka, Shekujt Osmanë në hapësirën shqiptare, f. 42-45.

Nga tabela vëmë re se myslimanët e kanë të ndarë komunitetin e tyre pothuajse në mënyrë të barabartë mes zonës rurale dhe asaj urbane, me një diferencë fare të vogël (0,5%) në favor të asaj urbane, edhe katolikët me një diferencë pak më të madhe (0,9%), por në favor të zonës rurale. Duhet të mos harrojmë se kjo gati barazi mes zonave rurale dhe atyre urbane për të dyja komunitetet, por edhe të tjerët, është produkt i procesit të urbanizimit të pas viteve 90' më së shumti, por gjithsesi na tregon një nga arsyet se pse feja është ruajtur më shumë tek këto komunitete, në veçanti tek ai katolik. Ortodoksët janë ata që mes komuniteteve tradicionale fetare janë më të urbanizuarit, me një diferencë të theksuar prej 25,4%. Natyrisht urbanizimi i tyre ka nisur edhe më herët që para viteve 90', edhe pse padyshim pas këtyre viteve urbanizimi masiv preku të gjitha komunitetet. Siç shihet edhe nga tabela përçindjen më të lartë në zonat urbane e kanë ateistët dhe padyshim të krishterët jotradicional, të parët për shkak të ndikimit të edukimit ateist gjatë komunizmit dhe të dytët si prurje kryesisht të reja të pas viteve 90'.

#### Përkatësia fetare dhe arsimit

Shpesh thuhet se njerëzit më të arsimuar janë edhe ata më pak fetar. Dhe kjo është e vërtetë, por çështja në thelb nuk qëndron tek fakti se marrja e dijes të bën më pak fetar, por tek fakti se kjo lloj dije është jo vetëm afetare, por shpesh edhe anti-fetare. Pra arsimit nuk është neutral në fakt, por ai përshkruhet nga një frymë e përgjithshme filozofike që ushqen antipatinë ndaj fesë, ose së paku indiferencën ndaj saj, duke e konsideruar atë më së shumti, në mos si pjesë e miteve dhe folklorit, si pjesë e shijeve dhe zgjedhjeve individuale subjektive të çdo njeriu. Është fakt se në historinë e njerëzimit janë institucionet fetare ato që kanë ngritur të parët shkollat dhe kanë arsimuar njerëzit, jo vetëm me dije fetare, por edhe ato mondane. Mjafton të përmendim faktin se edhe tek shqiptarët shkollat e para ku arsimoheshin njerëzit edhe pse të pakta, qenë ato të ngritura nga institucionet fetare, qofshin këto të krishtera ose myslimane.<sup>1</sup> Dhe në këto shkolla nuk mësohej vetëm feja, por edhe dijet mondane. Ndërkohë përmbysja e tradicionales me modernen solli në pushtet mendimin laik, i cili e shndërroi edhe sistemin arsimor, ku i jepej theks i veçantë fesë dhe besimit, në një sistem që si “fe të re” kishin shkencën dhe mendimin pozitivist mohues të fesë. Kështu që shkolla në thelb të bën më të ditur, por më fetar ose jo të bën fryma filozofike që përmban ky arsim dhe jo thjesht dituria për të njohur botën që na rrethon. Gjithsesi këtu do të kryqëzojmë dy të dhëna, atë të besimit fetar dhe shkallës së arsimit të individëve për të parë se cili komunitet është më i shekullarizuar. Më tej kemi këtë tabelë:

Besimi fetar	Niveli shkollimit në %					
	Pa diplomë	Filllore	7/8/9 vjeçare	E mesme	Niveli i parë i arsimit të lartë	Niveli i dytë i arsimit të lartë
Mysliman	1,3	17,3	45,2	27,5	8,6	0,1
Bektashi	1,0	15,6	34,4	33,5	15,4	0,2

<sup>1</sup> Edhe pse këto shkolla nuk qenë në gjuhën shqipe, por këtu po flasim për nivelin e arsimit në përgjithësi që ndikon në formimin mendor dhe intelektual të çdo njeriu. Ndërkohë siç dihet me lindjen e nacionalizmit shqiptar fillon edhe themelimi i shkollave në gjuhën shqipe, ku u përfshinë kush më shumë e kush më pak, përfaqësues nga të gjitha komunitetet fetare në vend.

Katolike	1,3	18,1	43,9	27,6	8,9	0,1
Ortodoks	0,9	13,4	27,6	37,2	20,6	0,3
Ungjillorë	0,0	10,7	15,5	30,1	43,7	0,0
Tjetër i krishterë	0,0	9,8	31,1	49,2	9,8	0,0
Besimtar i pacilësuar	1,2	15,9	41,4	30,8	10,4	0,2
Ateist	0,8	13,5	28,7	34,8	21,70	0,4
Preferon të mos përgjigjet	1,3	14,8	37,1	31,9	14,7	0,1
E pavlefshme / e papërcaktuar	2,0	19,0	39,9	29,5	9,4	0,2
Tjetër	0,0	9,1	36,4	36,4	18,2	0,0

Edhe nga kjo tabelë vëmë re, nëse i referohemi nivelit të parë të arsimit të lartë, se përqindjen më të lartë brenda komunitetit të tyre e kanë ungjillorët me 43,7%, të pasuar nga ateistët me 21,7%, dhe pastaj me radhë ortodoksët me 20,6%, të tjerët me 18,2%, bektashinjtë me 15,4%, besimtar të pacilësuar me 10,4%, të krishterë të tjerë me 9,8%, katolikët me 8,9% dhe më pas myslimanët me 8,6%. Ndërkohë në nivelin e dytë të arsimit të lartë kryesojnë ateistët me 0,4%, më pas vijnë ortodoksët me 0,3%, bektashinjtë dhe besimtarët e pacilësuar me nga 0,2% secili, dhe myslimanët dhe katolikët me nga 0,1% secili.

Edhe kjo e dhënë konfirmon atë që thamë më sipër se ndër komunitetet tradicionale më i shekullarizuari dhe i integruari në shoqërinë moderne shqiptare janë ortodoksët dhe më pas myslimanët dhe katolikët, kjo edhe për shkak të nivelit të arsimit të tyre. Natyrisht këtu flasim në rang komuniteti fetar, duke u nisur nga shifrat e përgjithshme, por nuk duhet të harrojmë se komunitetet fetare mes shqiptarëve përgjithësisht nuk janë të ndarë me thikë mes tyre, por ndajnë pak a shumë të njëjtin mjedis social-kulturor, kështu që edhe këto dallime shpesh nuk janë aq të dukshme në jetën e përditshme.

#### Përkatësia fetare dhe emigracioni

Element shumë i rëndësishëm për të njohur më mirë përbërjen e përkatësisë fetare të shqiptarëve pas viteve 90' është edhe emigracioni. Në vitin 2011 sipas të dhënave të Eurostat-it në vendet e BE-së gjatë regjistrimit numëroheshin mbi 964 mijë shtetas shqiptar, ku nga këta mbi 480 mijë në Greqi dhe mbi 451 mijë në Itali.<sup>1</sup> Duke qenë se këto vende nuk e përfshijnë përkatësinë fetare në përgjigjet e Censurit, nuk është e lehtë të njohësh se çfarë besimi kanë emigrantët shqiptarë nëpër botë. Por duke u nisur nga fakti se shumë prej këtyre emigrantëve kanë lëvizur dhe duke u kthyer shpesh në Shqipëri, mund të shfrytëzojmë këtë si element të tërthortë. P.sh. Censuri i 2011 pyet nëse keni lindur jashtë Shqipërisë, këtë të dhënë mund ta kryqëzojmë me përkatësinë fetare dhe do të kemi këtë tabelë:

<sup>1</sup> Official website of Eurostat <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

Besimi fetar	Vendlindja	
	Në Shqipëri	Jashtë vendit
Mysliman	99,0	1,0
Bektashi	99,3	0,7
Katolike	98,5	1,5
Ortodoks	97,7	2,3
Ungjillorë	97,6	2,4
Të krishterë të tjerë	97,1	2,9
Besimtar i pacilësuar	98,9	1,1
Ateist	98,8	1,2
Pa përgjigje	98,1	1,9
Të tjerë	100,0	0,0
E pavlefshme /e papërcaktuar	76,5	23,5

Siç shihet numrin më të lartë të lindjeve jashtë Shqipërisë brenda një besimi fetar e kanë të krishterët e tjerë dhe ungjillorët, respektivisht me 2,9% dhe 2,4% dhe të tretët vijnë ortodoksët me 2,3%, dhe numrin e lindjeve më të ulët jashtë Shqipërisë e kanë bektashinjtë me 0,7% të pasuar nga myslimanët me 1%.

Pyetje tjetër është vendndodhja në momentin e regjistrimit. Këtu po paraqesim ata që ndodheshin jashtë Shqipërisë gjatë momentit të regjistrimit, nisur nga besimi i tyre fetar:

Besimi fetar	Vendndodhja në momentin e regjistrimit (nata 30 shtator-1 tetor)		
	Në të njëjtin vendbanim të zakonshëm	Diku tjetër në Shqipëri	Jashtë vendit
Mysliman	96,7	2,5	0,8
Bektashi	96,2	2,9	0,9
Katolike	96,8	2,6	0,6
Ortodoks	95,6	2,8	1,6
Ungjillorë	87,9	11,3	0,8
Të krishterë të tjerë	100,0	0,0	0,0
Besimtar i pacilësuar	96,6	2,2	1,2
Ateist	96,9	2,0	1,1
Pa përgjigje	96,4	2,7	0,9
E pavlefshme /e papërcaktuar	97,0	2,4	0,6
Tjetër	100,0	0,0	0,0

Siç shihet nga këto të dhëna popullsia e identifikuar si ortodokse është ajo që ka përqindjen më të lartë të vendndodhjes jashtë vendit në momentin e Censurit me 1,6%, e pasuar nga besimtarë të pacilësuar dhe ateistët, respektivisht me 1,2% dhe 1,1%. Ndërsa më të ulëtën të krishterët e tjerë me zero, të pasuar nga katolikët me 0,6% dhe myslimanët dhe ungjillorët me 0,8%.

Një pyetje tjetër është edhe ajo nëse personi i pyetur ka jetuar jashtë shtetit për më shumë se një vit, dhe duke kryqëzuar edhe një herë të dhënat me përkatësinë fetare kemi:

Besimi fetar	Ka jetuar ndonjëherë jashtë shtetit më gjatë se një vit	
	Po	Jo
Mysliman	1,2	98,8

Bektashi	1,7	98,3
Katolike	1,7	98,3
Ortodoks	3,7	96,3
Ungjillorë	6,2	93,8
Të krishterë të tjerë	3,2	96,8
Besimtar i pacilësuar	1,7	98,3
Ateist	3,2	96,8
Preferon të mos përgjigjet	1,5	98,5
Tjetër	0,0	100,0
E pavlefshme /e papërcaktuar	1,0	99,0

Siç shihet përqindjen më të lartë e kanë ungjillorët me 6,2%, pasuar nga ortodoksët me 3,7%, ndërsa më të ulët mysliimanët me 1,2% pasuar nga katolikët dhe bektashinjtë me 1,7% secili. Të gjitha këto të dhëna të tërthorta provojnë se emigracioni në mesin e komunitetit ortodoks ka qenë relativisht më i madh, sesa ai mysliiman dhe katolik.

Në përmbledhje mund të themi se komuniteti më shumë i prekur nga fenomeni i shekullarizimit duket se është ai ortodoks dhe disi më pak ai mysliiman dhe shumë më pak ai katolik. Disa zëra vënë në dukje madje se edhe gjatë periudhës së kaluar elementi ortodoks u integrua në administratë dhe në radhët e elitës në një shkallë të pa precedent.<sup>1</sup> Prof. Artan Fuga madje pohon se:

Sipas të dhënave tona tepër të sakta, në radhët e zyrtarëve të lartë drejtues të kulturës, edukimit, propagandës, diplomacisë, mediave, kishin historikisht një peshë tepër të madhe individë me tradita fetare familjare ortodokse; në radhët e drejtuesve më të lartë të partisë kishte një përzierje të spikatur individësh me prejardhje mysliimane dhe ortodokse; ndërsa në drejtuesit më të lartë të ekzekutivit mbisundonin individë me prejardhje fetare mysliimane. Ky fakt bëhet edhe më interesant po të mbahet parasysh se të gjithë këta individë kishin formim kulturor dhe një botëkuptim të afishuar ateist.<sup>2</sup>

Po ashtu gjatë regjimit komunist edhe pse nuk u bënë dallime fetare në ndalimin e besimit, kleri ortodoks rezulton të jetë persekutuar më pak se të tjerët.<sup>3</sup> Po kështu edhe objektet e kultit që u përzgjedhën më së shumti si monument kulture qenë ato ortodokse, ku nga 77 të tilla, 63 ishin ortodokse.<sup>4</sup> Për sa i përket sulmeve ideologjike kleri katolik rezulton më i sulmuari dhe dëmtuari

<sup>1</sup> Shih p.sh. Tonin Gjuraj, Një model shteti ekumenik? Si mund të bëhen fetë çështje politike në Shqipëri. Në East European Quarterly 34 (Mars 2000) 1, 21-49 (shih f. 40). Nathaly Clair, Feja në vendin e mercedezëve. Në revistën Përpjekja, nr. 20, Viti 2005, f.14. Hysamendin Ferraj, në Skicë e mendimit politik shqiptar, Shkup 1999, shih f. 342, 344, 346.

<sup>2</sup> Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri -rasti i Shqipërisë- Konferencë ndërkombëtare, Tiranë 14-15 nëntor 2003, botim i Qendra shqiptare për të drejtat e njeriut, Tiranë 2004, f.112.

<sup>3</sup> Shih kumtesën për persekutimin klerit ortodoks nga mitropoliti Andon Merdani, <https://interreligiouscenter.com/martiret-e-besimeve-deshmi-atdhedashurie/>

<sup>4</sup> AQSh, F. Ministria e Arsimit dhe Kulturës, nr. 511, viti 1967, d. 58, fl. 4-9. Cituar nga Artan R. Hoxha, në Marrëdhëniet midis Regjimit Komunist dhe Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë në vitet 1945-1967, f. 194. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/09/Doktoratura-Artan-Hoxha-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Historise.pdf>

dhe pas tij ai mysliman, ndërsa shumë më pak ai ortodoks. Kështu p.sh. sipas Viron Kokës në broshurën e tij “Ideologjia reaksionare e klerit në vitet 30’ të shekullit XX” ai merr në analizë shkrime dhe citime vetëm nga katolikët dhe nga myslimanët, ndërsa nga ortodoksët asnjë. Dhe këtë ai e përlligj me pohimin se: “Kleri ortodoks nuk u muar në atë kohë me diskutimin e problemeve aktuale politike-shoqërore... Megjithatë, pozita e tij nuk ishte më pak reaksionare se ajo e klerëve të tjerë.”<sup>1</sup> Këto dhe faktorë të tjerë, që nuk bëheshin në thelb për të kursyer fenë apo besimin ortodoks, por për arsye të tjera, kanë rezultuar në një klimë relativisht më pak agresive ndaj këtij komuniteti nga regjimi komunist dhe për rrjedhojë kanë krijuar një frymë më pak armiqësore nga ana e këtyre të fundit, dhe kjo pastaj ka ndikuar në shekullarizimin më të madh në mesin e tyre, në dallim me pjesën katolike e cila pikërisht për shkak të izolimit më të madh dhe nga sulmet më të egra ndaj saj, si kundërpërgjigje e ka ruajtur edhe më fort identitetin e saj, ndërsa pjesa myslimane e ka variuar sipas zonave. Kjo mund të shpjegojë deri diku, krahas emigracionit, se pse ka rënie përqindja e ortodoksëve në rang vendi, qoftë kjo sipas censusit apo edhe sipas anketimeve që kemi paraqitur më herët, që nga regjistrimi i pranuar i vitit 1927.

#### 6.4 Vështrim mbi fetarinë e sotme të shqiptarëve ndër vite

Njohja e fetarisë së njerëzve sot mund të matet në mënyra të ndryshme dhe nga përgjigjet e një sërë pyetjesh, të cilat lidhen me rëndësinë e besimit në jetë, në besimin në ekzistencën e Zotit, besimin në botën tjetër, frekuentimin e objekteve të kultit, pjesëmarrja në ritet fetare, përfshirja në lutje etj... Por jo të gjitha anketimet ndjekin të njëjtën linjë pyetjesh, çfarë e bën ndonjëherë të vështirë matjen dhe krahasimin e të dhënave, megjithatë do të mundohemi të bëjmë një pasqyrim të anketimeve të ndryshme që janë bërë ndër vite mes shqiptarëve të Shqipërisë, për të parë masën e fetarisë tek njerëzit dhe si ajo ka ndryshuar mes tyre ndër vite.

Anketimet ESV-së 1991-1992

Siç kemi përmendur edhe më parë, për përqindjet fetare në Shqipëri, “European Survey Value” në anketimet e saj të vitit 1991<sup>2</sup> dhe 1992 krahas pyetjes për përkatësinë fetare ka drejtuar edhe pyetjen *Sa herë merrni pjesë në shërbesat fetare?* Në anketimin e 91’ të anketuarit i janë përgjigjur: 3,9% disa herë në javë, 11,8% një herë në javë, 26% disa herë në vit, 19,5% një herë në vit dhe 38,8% asnjëherë.

Nga të dhënat vihet re se të anketuarit e 1991 që janë identifikuar si ortodoks kanë përqindjen më të lartë të frekuentimit të objekteve të kultit, pas tyre vijnë myslimanët dhe në fund katolikët. Të bie në sy gjithashtu se ortodoksët në 1991 kishin edhe frekuentimin më të lartë javor dhe vjetor, në krahasim me besimet e tjera. Kjo ndoshta mund të shpjegohet se në atë fillim ky komunitet që i pari që filloi të rimëkëmbet, për shkak edhe të mbështetjes nga Greqia fqinje, por edhe për shkak të prezencës më të madhe të objekteve të tyre të ruajtura të kultit.

<sup>1</sup> Publikuar nga shtëpia botuese “Naim Frashri” Tiranë 1969, f.4

<sup>2</sup> Reif, Karlheinz, & Cunningham, George (1992). Central and Eastern Eurobarometer 2 (Current Affairs and the Media). Për Shqipërinë Fatos Tarifa, Qendra e Studimeve Sociologjike, Universiteti i Tiranës. Adresa në web: <https://doi.org/10.4232/1.2251>.

Për sa i përket gjinisë, si edhe në anketimet e tjera, femrat janë ato që kanë përqindjen më të lartë të frekuentimit të objekteve të kultit. Ndërsa për sa i përket moshës ajo më e moshuara, me të dyja grupimet 45-59 dhe 60-74 vjeç, që janë rritur dhe edukuar para ndalimit të fesë, janë edhe frekuentuesit më të shumtë të objekteve të kultit, ndërsa mosha e mesme 30-44 vjeç dhe ajo e re 29 vjeç e poshtë, të cilët janë rritur dhe edukuar në periudhën e ndalimit të fesë janë edhe frekuentuesit me përqindjen më të ulët të objekteve të kultit. Ndërsa nëse i referohemi arsimimit shohim se ata me arsim të mesëm dhe të lartë kanë mungesën më të lartë të frekuentimit dhe frekuentimin më të ulët njëkohësisht. Ata që janë me filllore ose që kanë përfunduar arsimin 7/8 vjeçar e kanë disa më lartë, ndërsa mes këtyre dy skajeve gjenden ata që nuk e kanë përfunduar arsimin 7/8 vjeçar.

Pyetjes se sa herë merrni pjesë në shërbesat fetare sipas anketimit të 1992<sup>1</sup> të anketuarit i janë përgjigjur: 3,5% disa herë në javë, 10,1% një herë në javë, 34,7 % disa herë në vit, 13,8% një herë në vit ose më pak dhe 37,9% asnjëherë. Në krahasim me 1991 kemi një rritje prej 8,7% të frekuentimit disa herë në vit dhe rënie të lehtë të frekuentimit më të shpeshtë. Ajo që vihet re gjithashtu është se ka një rritje të frekuentimit të objekteve të kultit për përgjigjen disa herë në vit në përgjithësi për të gjitha ndarjet komunitare, në bazë të fesë, etnisë, gjinisë dhe moshës, edhe pse të gjitha këto nëndarje kanë ulje dhe ngritje, çka e bëjnë panoramën më të larmishme duke treguar se prirjet drejt fetarisë së njerëzve ndryshojnë, në baza komunitare për arsye të ndryshme, siç duket p.sh. të jetë mosha. Gjithashtu në anketimin e 92' bie në sy rritja e frekuentimit të objekteve të kultit nga komuniteti katolik dhe rënia e atij mysliman. Këtu duhet vënë në dukje se frekuenca e frekuentimit të objekteve të kultit është një element i pamjaftueshëm për të matur fetarinë e njerëzve, sidomos në veçanti për shqiptarët e pas viteve të komunizmit, ku mungonin me shumicë objektet e kultit dhe ku migracioni i brendshëm dhe i jashtëm, ashtu si edhe në aspekte të tjera të jetës, ndikoi edhe në këtë drejtim. Nëse shohim të dhënat e të dy anketimeve mbi bazën e ndarjes etnike do vëmë re se në të dy rastet minoriteti grek shfaqet më frekuentues dhe në rritje nga anketimi i parë në të dytin, shumë më tepër sesa ai shqiptar. Ndërsa për sa i përket arsimit del se ata më të arsimuarit janë edhe më pak ose aspak frekuentuesit e objekteve të kultit, në të dyja anketimet, megjithatë në anketimin e dytë ka një rritje nga kjo kategori e frekuentimi të objekteve të kultit në opsionin disa herë në vit dhe rënie të përqindjes së mos frekuentimit. Për më shumë detaje mund të shihen tabelat.

Frekuentimi i xhamive dhe kishave 91-92, sipas ndarjes gjinore, moshës dhe komunitetit

ESV 1991		Gjithsej %	Meshk	Femra	Moshaderi 29	Mosha 30-44	Mosha 45-59	Mosha <sup>2</sup> 60 <	Etnia			Besimi fetar					
									Shqip	Grek	Tjetër	Ortod	Katol	Myslim	Tjetër	Pa fe	
Frekuentimi i xhamisë/kishës	Disa herë në javë	3,9	3,5	4,3	4,1	3,3	5,0	0,0	3,9	5,0	0,0	2,0	3,8	4,8	0,0	0,0	
	Një herë në javë	11,8	10,1	13,6	11,5	9,8	14,9	28,6	11,7	20,0	0,0	24,4	6,2	9,3	100	0,0	
	Disa herë në vit	26,0	23,2	29,0	24,6	26,9	28,6	23,8	25,4	35,0	100	33,3	28,8	25,2	0,0	2,1	
	Një herë në vit	19,5	19,3	19,6	18,9	18,6	24,2	9,5	19,7	10,0	0,0	16,4	15,0	22,5	0,0	2,1	
	Asnjëherë	38,8	43,9	33,5	40,9	41,4	27,3	38,1	39,2	30,0	0,0	23,9	46,2	38,2	0,0	95,8	
ESV 1992								75 <	Shqip	Grek	Vllah						Jude

<sup>1</sup> Reif, Karlheinz, & Cunningham, George (1993). Central and Eastern Eurobarometer 3 (Political Disintegration) Adresa në web: <https://doi.org/10.4232/1.2321>.

<sup>2</sup> Anketimi kishte përfshirë edhe një kategori të pestë moshe mbi 75 vjeç, të cilës në pyetësor i përgjigjej vetëm një person, një grua 76 vjeçe, e cila ishte deklaruar si myslimane dhe nuk frekuentonte asnjëherë objektet e kultit.



Freku entim i i xham isë/ kishë s	Disa herë në javë	3,5	3,4	3,6	3,1	2,4	3,8	8,4	0,0	3,4	12,5	0,0	5,5	1,0	3,3	0,0	100
	Një herë në javë	10,1	9,9	10,2	6,8	11,8	10,5	12,6	10,0	10,1	12,5	0,0	17,6	24,5	6,2	0,0	0,0
	Disa herë në vit	34,7	31,5	38,0	32,2	34,5	36,2	37,9	30,0	34,7	25,0	100	37,6	54,1	31,3	33,3	0,0
	Një herë në vit	13,8	15,4	12,2	14,7	13,9	12,4	11,6	20,0	13,7	25,0	0,0	18,2	8,2	13,6	0,0	0,0
	Asnjëherë	37,9	39,7	36,0	42,1	37,3	37,1	29,5	40,0	38,0	25,0	0,0	21,2	12,2	45,6	66,7	0,0

Frekuentimi i xhamive dhe kishave 91-92, sipas arsimit.

ESV 1991	Disa herë në javë	Një herë në javë	Disa herë në vit	Një herë në vit	Asnjëherë	ESV 1992	Disa herë në javë	Një herë në javë	Disa herë në vit	Një herë në vit	Asnjëherë
Filloren ose më pak	4,3	12,7	28,0	21,3	33,7	Filloren ose më pak	5,9	9,2	33,9	12,5	38,5
7/8 vjeçare pa përfunduar	0,0	11,8	32,4	14,7	41,2	7/8 vjeçare pa përfunduar	4,0	12,7	28,6	13,5	41,3
Me 7/8 vjeçare	4,6	11,5	26,8	19,7	37,3	Me 7/8 vjeçare	2,2	9,9	37,6	14,9	35,4
E mesme/e lartë	1,6	12,5	18,0	15,6	52,3	E mesme/e lartë	0,8	10,4	30,4	13,6	44,8

## Anketimet e World Values Survey (WVS) 1998-2002

WVS-ja ka organizuar dy anketime në Shqipëri, në 1998 dhe 2002, ku mes pyetjeve të tjera kanë qenë edhe ato që tregojnë fetarinë dhe nivelin e saj te njerëzit. Në dallim me dy anketimet më lartë, këto anketime kanë bërë disa pyetje më të detajuara, çfarë japin një panoramë më të qartë të fetarisë së njerëzve në këto vite. Më poshtë do të paraqesim në tabelë të përmbledhur pjesën më të madhe të këtyre përgjigjeve. Për të reduktuar tabelën janë lënë jashtë përgjigjeve përzgjedhja nuk e di, pasi ajo vetëkuptohet nga përqindja e mbetur si dhe rastet e pavlefshme.

### Kuptimi i jetës

Nga të dyja anketimet duket se shqiptarët meditojnë rreth kuptimit të jetës, qoftë shpesh ose rrallë, ndërsa ata që nuk mendojnë asnjëherë për këtë gjë, me zor se e kalojnë 1% në anketimin e dytë. Natyrisht jo domosdoshmërisht përsiatja mbi kuptimin e jetës të çon si përfundim te besimi në Zot, por pa diskutim që kjo është një nga arsytet tepër të rëndësishme që të shpie në këtë rezultat. Dhe siç e kemi përmendur edhe në fillim të këtij studimi, njerëzit janë të prirë në mënyrë të natyrshe t'i japin kuptim teologjik ngjarjeve që e rrethojnë edhe kur ato në pamje të parë janë krejt të rastësishme, ndërkohë që vetë lindja, jeta dhe vdekja e njeriut, që janë stacionet më të rëndësishme në jetë, nuk ka sesi të kalohen pa i dhënë atyre një kuptim teologjik. Dhe ky kuptim, padyshim edhe nën ndikimin e kulturës së mjedisit rrethues, çon më së shpeshti në besimin e ekzistencës së një Krijuesi, i Cili i jep kuptim nevojës së brendshme njerëzore për të gjetur qëllimin e jetës.

### Besimi në ekzistencën e Zotit

Në anketimin e 1998 rezulton se mbi 90% e të pyeturve besojnë në Zot dhe janë vetëm 6,1% ata që e mohojnë. Ndërsa në anketimin e 2002 ata që pohojnë se besojnë te Zoti janë 87,6% dhe ata

që e mohojnë 7,9%. Kjo rënie mund të shpjegohet me zhvendosjen e brezit të ri të dikurshëm të edukuar dhe rritur në kohën e komunizmit dhe largimit të brezit më të vjetër, i cili e ka trashëguar besimin para vendosjes së ateizmit, si i vetmi besim i ligjshëm në Republikën e Shqipërisë. Gjithsesi me gjithë propagandën ateiste të asaj periudhe edhe ai brez që u edukua dhe u rrit në atë periudhë të ateizmit shtetëror, përsëri ateizmi mbetet në shifra të vogla mes shqiptarëve të sotëm. Kjo tregon se me gjithë dëmin e madh që i shkaktoi besimeve fetare edukimi dhe propaganda ateiste-komuniste, ateizmi nuk arriti kurrë të përthithet si identitet i qëndrueshëm i pjesës dërmuese të shqiptarëve.

Edhe këto anketime tregojnë se femrat kanë një nivel më të lartë besimi në Zot sesa meshkujt dhe po kështu me rritjen e moshës rritet edhe përqindja e atyre që besojnë në Zot.

### **Rëndësia e Zotit në jetë**

Një nga pyetjet më të rëndësishme të këtyre anketimeve është edhe ajo për rëndësinë e besimit në Zot në jetën e njerëzve. Nga të dyja anketimet duket se shqiptarët i japin një lloj rëndësie Zotit në jetën e tyre. Ajo që të bie në sy është se në anketimin e 2002 për vlerën maksimale të të qenit shumë i rëndësishëm kemi gati një dyfishim të shifrës, nga 16,1% në 1998 në 32% në 2002. Por ka edhe një rritje të përgjithshme, nëse nisemi nga vlerësimi me 6 e sipër. Ajo që vihet re gjithashtu është edhe një rritje e lehtë e vlerës ekstreme të mos pasjes asnjë rëndësi në jetë, që nga 3,5% në 1998 është rritur në 5% në 2002. Kjo e fundit mund të shpjegohet me çështje brezash, pasi duket se kjo përqindje ka rritje te pesëdhjetë vjeçarët, e vitit 2002, që i përkasin edhe brezit të rritur dhe edukuar në periudhën komuniste.

### **Rëndësia e fesë në jetë**

Pyetjes për rëndësinë e fesë në jetë i janë përgjigjur pozitivisht më shumë se gjysma e të anketuarve në të dyja anketimet. Ndërkohë në anketimin e 1998 vetëm 24,2 % pohonin se feja është shumë e rëndësishme, ndërsa në atë të 2002 këtë e pohonin 27,5 %. Që feja është mjaftueshëm e rëndësishme në 1998 e pohonin 34,5%, ndërsa në 2002 e pohonin 31,2%. Ndërsa si aspak të rëndësishme në 1998, këtë e pohonin 10,7 %, ndërsa në 2002 e pohonin 14,2%. Mes meshkujve dhe femrave, janë këto të fundit që e kanë përqindjen më lartë për rëndësinë që i japin fesë. Ndërsa sipas moshave, sa më e madhe të jetë ajo aq më shumë e vlerësojnë fenë si të rëndësishme në jetë. Duket përsëri se vlerësim më të pakët për rëndësinë e fesë e ka brezi i lindur dhe edukuar në kohën e komunizmit. Në të dy anketimet brenda një periudhe katër vjeçare nuk duket të ketë ndonjë ndryshim të madh të rëndësisë që shqiptarët i japin në jetë fesë, dhe pse disa ndryshime të lehta vihen re edhe nga këto shifra që përmendëm këtu. Nëse nuk marrim parasysh ndonjë tolerancë apo gabim të mundshëm dhe të kuptueshëm në rastin e këtyre anketimeve, nga ajo që vihet re në përgjithësi është se, brezi më i lidhur me besimin është ai i më i vjetri dhe pas tyre vjen ai më i riu, ndërsa brezi i ndërmjetëm është më pak fetari. Kjo vihet re edhe tek ndryshimet e përqindjeve nga njëri anketim në tjetrin, për shkak të zhvendosjes së brezave në kohë.

### **Sa fetar jeni?**

Kësaj pyetje për ndjesinë subjektive të njeriut sesa fetar ai ndjehet duket se nga anketimi i 98' me atë të 2002 ka një rritje të dukshme, ku nga 43,4% e të anketuarve që pohonin se ndjeheshin persona fetar, në anketimin e dytë këtë e kanë pohuar 65,2%. Ka një rënie të dukshme të

personave jofetar dhe një rritje të lehtë të ateistëve të bindur, nga 4,9% në 5,3%. Edhe pse disa nga këto ndryshime janë brenda mundësisë së gabimit, vihet re se ka një luhajtje në disa nga këto aspekte që shprehin fetarinë e njerëzve, e cila tregon se pjesë të caktuara të popullsisë bëhen më tepër fetar ndërkohë që të tjerat jo, dhe se nuk kemi një shpërndarje të njëtrajtshme dhe gjithëpërfshirëse në rritjen apo rënien e fetarisë tek njerëzit.

Pjesë e njohjes së fetarisë së njerëzve janë edhe pyetjet që zbulojnë besimet që shoqërojnë zakonisht besimin në Zot, siç janë besimi në ekzistencën e shpirtit, të botës tjetër etj. dhe ja disa nga këto pyetje:

#### **A besoni se njerëzit kanë shpirt?**

Në përgjigjen e kësaj pyetje vihet re se në anketimin e 1998 ata të cilët besonin se njerëzit kanë shpirt ishin 39,7%, ndërkohë që kjo shifër është rritur ndjeshëm në anketimin e 2002 deri në 61,4%.

#### **A besoni në ekzistencën e djallit?**

Sipas anketimit të 1998, ekzistencën e djallit e besojnë 27,8% e njerëzve. Kjo pyetje nuk është ripërsëritur më në 2002, për të parë nëse ka pasur ndryshim në qëndrimin ndaj këtij besimi ose jo.

#### **A besoni te jeta pas vdekjes?**

Në anketimin e 1998 kanë pohuar se po 23,%, ndërsa 36,5% në atë të 2002.

#### **Besimi në ekzistencën e ferrit**

Pjesë e besimeve tradicionale tek shqiptarët është edhe besimi në ekzistencën e Ferrit/Xhehenemit, pyetje të cilës ata i janë përgjigjur në 1998 se 28,7 % e tyre besojnë se ai ekziston, ndërsa në 2002 kemi një rritje fare të lehtë me 29,3%, që praktikisht është brenda nivelit të gabimit dhe në realitet të mos ketë asnjë ndryshim në këtë drejtim. Megjithatë ajo që vihet re është se, ka një rritje të lehtë të atyre që nuk janë përgjigjur për këtë pyetje ose nuk e dinë, nga 26,2% në 1998 në 28,6% në 2002. Edhe në këtë rast mosha e madhe është ajo që ka përqindjen më të lartë të besimit, dhe me nivel më të lartë në mesin e femrave.

#### **A besoni tek parajsja?**

Pyetjes a besoni në parajsë, i janë përgjigjur pozitivisht në 1998 rreth 31,7% e njerëzve, ndërsa në 2002 këtë e kanë pohuar 34,2% e tyre. Edhe pse Ferri dhe Parajsja janë dy koncepte fetare, të pandara mes tyre në besimet tradicionale, duket se njerëzit në besimin e tyre janë më të prirë të besojnë më shumë në njërin sesa në tjetrën, duke zgjedhur në këtë rast më shumë shpërblimin hyjnor sesa ndëshkimin dhe natyrisht shumë prej tyre nuk kanë njohuri të qarta se çfarë janë konkretisht këto besime në fetë tradicionale me të cilat ata identifikohen.

#### **A besoni te mëkati?**

Kjo pyetje nuk është përsëritur në anketimin e 2002, por është bërë vetëm në 1998 dhe tregon se 49% e njerëzve i janë përgjigjur pozitivisht. Edhe pse në thelb kjo pyetje e ka origjinën nga besimi i krishterë për mëkatin fillestar dhe trashëgueshmërinë e tij, mendoj se te shumica e

shqiptarëve, që i janë përgjigjur pozitivisht nuk ka të njëjtin kuptim, por vetëm pranim i faktit se njeriu është mëkatuar, për shkak se ai është krijesë që gabon. Gjithsesi këtu vlen të përmendet fakti se shpesh pyetjet e hartuara nga këto anketime të huaja nuk përshtaten në mënyrën e duhur në shqip, në mënyrë të atillë që t'i përshtatet mendësisë kulturore të vendit, siç e kemi përmendur këtë edhe në me raste konkrete kur kemi folur për përqindjet fetare.

### **Forcë dhe ngushëllim nga feja**

Edhe në përgjigjen e kësaj pyetje kemi një nivel të lartë pohimi, dhe rritje nga 51,8% në 1998 në 65% në 2002. Edhe pse praktikimi i fesë te shqiptarët është i ulët, përsëri më shumë se gjysma e tyre gjejnë ngushëllim dhe forcë te besimi fetar. Kjo tregon se ata e shohin fenë më shumë si një burim shprese për problemet e kësaj bote, sesa si rrugë shpëtimi për në botën tjetër.

### **Sa herë luteni?**

Në përgjigjen ndaj kësaj pyetje kemi një ndryshim të madh në katër vitet diferencë mes dy anketimeve, në anketimin e 1998, rreth 1,7% e të anketuarve janë përgjigjur se lutën më shumë se një herë në javë, ndërsa në 2002 këtë e pohojnë 12,4 %, por ndërkohë në këtë anketim është përfshirë në shkallën e vlerësimit edhe të luturit e përditshëm, i cili sipas këtij anketimi rezultoi në 33,8%, me një dallim të theksuar mes meshkujve, me 25,5%, dhe femrave, me 42%, e të anketuarve. Megjithatë duket se një peshë të madhe në këtë drejtim zënë rastet e festave fetare me 40% sipas anketimit të 1998 dhe 24,9% në 2002, nëse mbledhim mes përgjigjes disa herë në vit dhe më pak se kaq të këtij anketimi. Gjithashtu ka një rritje të lehtë të atyre që nuk lutën asnjëherë, nga 7% në 1998 në 10,5% në anketimin e 2002, i cili mund të shpjegohet me të njëjtën arsye zhvendosje brezash, siç vihet re edhe nga tabela e përqindjeve. Në anketimin e 2002 është përfshirë edhe një pyetje pak më specifike ku pyetet se *A keni ndonjë moment lutje, përsiatje, meditimi, apo diçka të ngjashme?* Kësaj pyetje i janë përgjigjur pozitivisht 75,4% dhe negativisht vetëm 17,5%. Dallim të madh edhe në këtë rast kemi mes femrave dhe meshkujve, ku këta të fundit rezultojnë të lutën, meditojnë apo përsiasin në 67,1% të tyre, ndërsa femrat në 83,6% të tyre.

### **Autoritetet fetare dhe përgjigjet për nevojat njerëzore**

Në anketimin e 2002 përfshihen edhe disa pyetje që lidhen me ndikimin dhe rolin e autoriteteve fetare në jetën individuale dhe sociale të njerëzve. Kështu pyetjes se *A mendoni se autoritetet fetare në vendin tuaj japin përgjigje të plota për problemet dhe nevojat morale të individit*, i janë përgjigjur pozitivisht 50,7% e të anketuarve, ndërsa negativisht vetëm 28,5%. Pjesa tjetër kanë pohuar se nuk e dinë. Ndërsa në lidhje me pyetjen se autoritetet fetare japin përgjigje për problemet e jetës familjare, shifra pohuese është më e ulët, 41,3%, ndërsa ajo mohuese 36,4%. Siç duket shqiptarët mendojnë se autoritetet fetare janë më tepër referencë për problemet morale të individit sesa për ato familjare. Kjo duket edhe më e qartë në pyetjen tjetër që ka të bëjë me nevojën shpirtërore individuale të njeriut ku 62,1% e të anketuarve pohojnë se autoritetet fetare japin përgjigje të plota për nevojat shpirtërore të njerëzve dhe vetëm 17% pohojnë të kundërtën. Kjo duket edhe në përqindjen për pikën ku vlerësohet se sa autoritetet fetare japin përgjigje për problemet sociale të vendit tonë, ku përgjigja pohuese e të anketuarve të 2002 bie në 21,1%, ndërsa ajo mohuese shkon në 42,6%. Ajo që të bie në sy në të tria këto raste është edhe shifra e lartë e atyre që pohojnë se nuk e dinë, kjo tregon se një masë e madhe njerëzish nuk kanë njohuri se çfarë feja apo udhëheqësit fetar pohojnë për shqetësimet dhe nevojat me të cilat përballet individi dhe shoqëria.

## **Besimi dhe politika**

Disa pyetje të tjera shtesë që janë bërë në anketimin e 2002, janë edhe ato që lidhin mes besimit dhe politikës. Kështu pohimin se politikanët që nuk besojnë te Zoti janë të papërshtatshëm për të qenë në pushtet e miratojnë 40,9% e të anketuarve, ndërsa nuk e miratojnë 26,4%, ndërsa pjesa tjetër nuk kanë qëndrim për këtë çështje. Kjo tregon se një numër i konsiderueshëm njerëzisht mendojnë se besimi në Zot i bën politikanët më të përgjegjshëm në qeverisje. Po kështu pohimin se do të ishte më mirë për Shqipërinë nëse në pushtet do të ishin më shumë njerëz me besim fetar, e miratojnë 37,3% e të anketuarve, ndërkohë e kundërshtojnë 28,6%. Pra edhe pse një pjesë e mirë e njerëzve mendojnë se politikanët jobesimtarë nuk janë të përshtatshëm për të qenë në pushtet, 3,6% e tyre nuk janë përfshirë në pohimin se duan në pushtet më shumë njerëz me besim fetar.

Ndërkohë në lidhje me pohimin se udhëheqësit fetar nuk duhet të kenë ndikim mbi njerëzit që votojnë në zgjedhje, e miratojnë shumica e të anketuarve të 2002 me 70,5% dhe e refuzojnë vetëm 8,1% e të anketuarve. Po kështu pohimin se udhëheqësit fetar nuk duhet të influencojnë në vendimet e qeverisë, e miratojnë 67,4% dhe e kundërshtojnë 10,4%. E gjitha kjo tregon se edhe pse besimi fetar i pushtetarëve shihet si i nevojshëm për një qeverisje më të mirë, sipas të anketuarve, autoritetet fetare nuk duhet të përzihen drejtpërdrejtë në politikë dhe qeverisje. Pra në këtë rast duket se morali fetar shihet të jetë më së shumti pjesë individuale dhe e brendshme e individit dhe jo si një normë e ardhur apo e imponuar nga bashkësitë dhe institucionet fetare dhe njerëzit e tyre. Kjo është tregues gjithashtu se shqiptarët në përgjithësi nuk janë të gatshëm të mbështesin me votë daljen në skenë të ndonjë partie politike me sfond fetar.

## **Edukimi fetar i fëmijëve**

Një tjetër pyetje në lidhje me rëndësinë e besimit fetar është edhe përzgjedhja e mësimin të besimit fetar të brezit të ri në gjirin e familjes. Në anketimin e 1998 këtë e pohonin 29,9%, ndërsa në 2002 e pohonin 36,3%. Edhe në këtë pyetje femrat janë ato që kanë përqindjen më të lartë se meshkujt për rëndësinë e edukimit të fesë për fëmijët. Ndërsa duke iu referuar grupmoshave, përqindjen më të lartë të atyre që e shohin të rëndësishme është përsëri moshë më e madhe. Kjo mund të shpjegohet me faktin se kjo moshë e ka përjetuar besimin fetar që para se ai të ndalohej në 1967 dhe madje ka lindur para ardhjes së regjimit komunist në fuqi, ndërsa moshë më pak e interesuar është ajo e cila është lindur pas '67' dhe është edukuar gjatë regjimit komunist.

## **Anëtar në një organizatë fetare**

Anketimi i 1998 përfshinte në përgjigje dy mundësi, njëra nëse dikush bënte pjesë në një organizatë fetare dhe e dyta nëse ishte ose jo aktivë në të. Ndërsa ai i 2002 ishte ndarë në dy pyetje të veçanta: në pjesëmarrjen në një organizatë të tillë ose jo dhe në pyetjen se a jeni përfshirë në punë vullnetare në një organizatë të tillë. Në të dyja anketimet nuk kemi i ndonjë ndryshim të dukshëm për sa i përket përqindjes së anëtarësimit, vetëm 21% në 1998 pohojnë se janë pjesë e organizatave të tilla dhe 20,4% në 2002. Ndërkohë bie në sy se në 1998 vetëm 4,8% ishin aktivë, kundrejt 14,6% në 2002, që bënin punë vullnetare në këto organizata. Natyrisht jo domosdoshmërisht të qenit aktivë nënkupton edhe të qenit vullnetar, por gjithsesi kemi një rritje të dukshme të aktivitetit brenda organizatave fetare edhe pse shumica duket që vazhdon të mos

jetë pjesë aktive në to. Femrat përsëri janë më të përfshira dhe më aktive dhe vullnetare sesa meshkujt në organizatat fetare. Edhe moshja në këtë rast, ajo më e madhja priret të jetë më e përfshira dhe më aktivja, sesa moshat e reja. Përmbledhtazi mund të thuhet se vetëm 1/5 e shqiptarëve të '98' dhe 2002, pranojnë se janë pjesë e një kishe apo organizate fetare dhe shumë më pak se kaq janë aktivë në to. Kjo tregon se fenë dhe besimin fetar shqiptarët e përjetojnë më së shumti individualisht dhe më pak si identitet dhe praktikë kolektive.

### Besimi tek institucionet fetare

Pyetjes se sa besim keni tek institucionet fetare, të anketuarit duket se pak më shumë se gjysma kanë besim në to, duke iu përgjigjur prej tyre 19,3% se kanë shumë besim, 33,7% mjaftueshëm besim, ndërsa 34,2 % jo shumë besim dhe 11,6% aspak besim. Edhe në këtë rast ajo që bie në sy është se mes tyre femrat janë ato që shprehin besim më të madh sesa meshkujt karshi institucioneve fetare me 24,4 % kundrejt 14,3 % të meshkujve, për përgjigjen shumë besim, dhe me 34,5% kundrejt 33,2 % të meshkujve për përgjigjen mjaftueshëm besim. Edhe moshja si edhe në pyetjet e mësipërme ajo më madhja mbi 70 vjeç ka përqindjen më të lartë me 42,9% dhe më e reja më të ulëtën.

### Frekuentimi i objekteve të kultit

Pyetjes në anketimit e 2002 se sa herë e kaloni kohën me njerëzit në xhami apo kishë, i janë përgjigjur 12,3% çdo javë, 14,1% njëherë ose dy në muaj, 31,7% vetëm disa herë në vit dhe 37,6% asnjëherë. Nga kjo duket se më shumë se gjysma e shqiptarëve, sipas këtij anketimi, i frekuentojnë objektet e kultit të paktën disa herë në vit.

Tabela përmbledhëse për anketimet e 1998 dhe 2002 të WVS

WVS 1998								WVS 2002					
Pyetja		Gjithsej %	Meshkuj	Femra	Mosha deri 25	Mosha 26--47	Mosha 48 sipër	Gjithsej %	Meshkuj	Femra	Mosha deri 29	Mosha 30-49	Mosha 50<
Beson në Zot	Po	90,8	85,7	96,0	77,5	89,8	95,9	87,6	83,8	91,3	83,7	87,9	90,5
	Jo	6,1	10,2	2,0	7,1	6,5	5,1	7,9	11,7	4,2	9,7	6,9	7,8
Mendojnë në kuptimin e jetës	Shpesh	41,5	41,4	41,6	41,65	43,85	33,1	52,4	51,5	53,3	58,9	53,1	45,6
	Ndonjëherë	41,6	43,0	40,2	48,9	43,1	48,7	29,1	27,9	30,3	26,0	29,5	31,3
	Rrallë	14,4	13,9	15,0	16,8	11,3	15,5	15,3	16,8	13,9	12,0	14,5	19,4
	Asnjëherë	0,9	0,8	1,0	1,5	0,4	1,5	1,3	1,8	0,8	-	1,3	2,4
Rëndësia e fesë në jetë	Shumë	24,2	18,4	29,9	8,7	21,8	55,3	27,5	23,2	31,7	22,5	23,9	37,4
	Mjaftueshëm	34,5	30,7	38,2	34,25	35,2	30,7	31,2	29,5	32,9	31,8	32,4	28,9
	Jo shumë e rëndësishme	28,2	33,6	22,8	31,7	32,2	17,3	25,2	26,7	23,8	24,8	27,2	22,4
	Aspak e rëndësishme	10,7	14,5	7,1	27,1	8,95	7,1	14,2	17,8	10,7	17,4	15,4	9,5
Edukim fetar i fëmijëve i rëndësishëm		29,9	24,8	35,0	22,4	29,4	28	36,3	31,7	40,8	31,8	32,8	45,6
Anëtarë në organizata fetare	Aktivë	4,8	3,3	6,3	2	4,1	97	20,4	16,4	24,4	19,0	18,1	25,2
	Joaktivë	16,2	14,8	17,6	10,2	16,1	19						
Punë vullnetare në organizata fetare		-	-	-	-	-	-	14,6	11,5	17,6	13,6	12,5	18,7
Besim tek institucionet fetare	Shumë	19,3	14,3	24,4	6,1	21,05	30,5	31,9	23,2	40,4	27,9	29,2	39,5
	Mjaftueshëm	33,7	33,2	34,5	32,45	29,5	39,7	33,5	36,4	30,7	34,1	33,0	33,7
	Jo shumë	34,2	38,3	30,1	50,95	40,95	22,5	17,9	20,2	15,6	17,1	20,8	14,3
	Aspak	11,6	12,7	10,5	23,5	7,9	10,6	15,1	18,6	11,7	17,8	15,8	11,6
Rritur me fe në shtëpi		50,8	42,8	58,4	29,1	49,4	39,3	-	-	-	-	-	-
Përveç dasmave, funeraleve dhe	Më >1 herë në javë	1,7	0,8	2,6	1,5	1,45	3	3,8	3,4	4,2	5,4	2,7	4,1
	1 herë në javë	16,2	12,5	20,0	5,1	12,6	34,9	16,5	14,1	18,8	12,4	14,1	23,8

pagëzimeve, sa herë mermi pjesë në aktivitetet fetare këto ditë	1 herë në muaj	17,3	14,1	20,2	19,95	20,4	15,2	9,1	7,3	10,9	7,0	10,0	9,5
	Vetëm në festa	40,0	38,7	41,6	41,3	43,1	34	32,4	32,3	32,5	35,3	32,4	29,9
	1 herë në vit	9,1	11,1	6,9	19,4	7,6	5,1	5,0	5,9	4,2	5,0	6,5	2,7
	Shumë më rrallë	8,5	12,5	4,6	15,8	8,2	5,8	9,9	11,1	8,7	12,4	9,6	8,2
	Asnjëherë	7,0	10,2	4,0	38,45	6,5	5,4	23,3	25,9	20,8	22,5	24,8	21,8
Sa person fetar jeni	Person fetar	43,4	35,5	51,1	27,35	40,65	43,8	65,2	59,2	71,1	61,6	61,8	73,5
	Person jofetar	47,8	54,3	42,0	49,05	52,75	21,9	25,0	28,3	21,8	25,6	27,9	20,1
	Ateist i bindur	4,9	6,6	3,2	4,1	4,1	6,2	5,3	7,3	3,4	5,0	5,6	5,1
Besoj te jeta pas vdekjes	Po	23,1	15,4	30,5	10,7	19,95	45,1	36,5	31,7	41,2	35,3	32,1	44,2
	Jo	50,7	58,6	43,4	65,25	53,9	28,9	40,8	46,3	35,4	39,9	44,9	35,4
Besoj se njerëzit kanë shpirt	Po	39,7	31,6	47,3	19,4	37,5	64	61,4	54,9	67,7	61,2	58,0	66,7
	Jo	37,9	46,1	30,3	42,4	40,1	19,5	20,4	24,6	16,2	21,3	20,5	19,4
Ekziston djalli	Po	27,8	22,5	32,7	24,3	27,85	36,6	-	-	-	-	-	-
	Jo	43,1	53,3	33,7	54,6	46,1	26,2	-	-	-	-	-	-
Ekziston ferri	Po	28,7	23,4	33,7	14,8	26,35	50,4	29,3	24,2	34,3	26,4	25,2	38,1
	Jo	45,0	54,9	35,8	60,9	50,25	22,5	42,1	47,3	37,0	42,6	45,5	36,4
Besojnë në parajsë	Po	31,7	25,4	37,6	16,3	29,2	53,4	34,2	28,9	39,4	33,7	29,9	41,2
	Jo	46,4	55,7	37,8	44,7	50,9	24,8	36,8	42,4	31,3	35,3	40,4	32,7
Besojnë te mëkati	Po	40,0	40,0	57,8	49,7	46,5	70,2	-	-	-	-	-	-
	Jo	29,5	38,5	21,0	35,25	32,75	15	-	-	-	-	-	-
Rëndësia e Zotit në jetë	Aspak	3,5	5,5	1,6	2	4,3	3,4	5,0	7,1	3,0	4,7	4,7	5,8
	2	4,6	6,4	2,8	9,2	4,2	2,1	3,4	3,8	3,0	3,9	3,3	3,1
	3	5,8	7,8	4,0	38,95	5,1	3,4	5,0	5,3	4,8	4,3	6,7	3,1
	4	5,5	6,8	4,2	3,1	6,65	5,3	4,7	4,8	4,6	4,7	5,6	3,4
	5	5,8	7,4	4,4	6,1	7,35	3,35	7,0	8,3	5,7	7,4	7,6	5,8
	6	6,6	5,1	8,1	7,7	9,15	2,4	4,9	6,3	3,6	6,2	5,8	2,4
	7	8,9	11,3	6,7	14,3	8,75	5,5	12,7	14,3	11,1	14,3	11,6	12,9
	8	20,6	20,5	20,4	17,9	23	14,6	10,0	10,3	9,7	10,5	10,3	9,2
	9	20,3	15,8	25,0	13,3	12,9	43,1	13,8	12,3	15,2	10,5	14,1	16,3
Shumë	16,1	11,3	20,8	22,5	16,25	20	32,0	25,9	38,0	31,8	28,8	37,1	
Forcë dhe ngushëllim nga feja	Po	51,8	41,4	61,8	30,7	49,1	77,3	65,0	59,8	70,1	58,1	64,1	72,4
	Jo	36,2	45,5	27,1	58,85	39,35	16,4	24,1	27,5	20,8	28,3	23,7	21,1
Sa shpesh i luteni Zotit jashtë aktiviteteve fetare	Çdo ditë	-	-	-	-	-	-	33,8	25,5	42,0	29,8	31,5	40,8
	Më > 1 javë	-	-	-	-	-	-	12,4	11,3	13,5	14,3	10,0	14,3
	1 herë javë	-	-	-	-	-	-	8,6	8,5	8,7	7,4	9,8	7,8
	1 herë muaj	-	-	-	-	-	-	6,6	7,3	5,9	7,0	7,4	5,1
	Disa herë vit	-	-	-	-	-	-	11,1	11,5	10,7	12,0	12,5	8,2
	Më rrallë	-	-	-	-	-	-	13,8	17,2	10,5	15,5	15,2	10,2
Kurrë	-	-	-	-	-	-	10,5	14,9	6,1	10,9	10,5	10,2	
Autoritet fetare japin përgjigje për problemet dhe nevojat morale të individit	Po	-	-	-	-	-	-	50,7	47,1	54,3	44,2	47,5	61,2
	Jo	-	-	-	-	-	-	28,5	30,1	26,9	29,5	30,6	24,5
Autoritet fetare japin përgjigje të plota për problemet familjare	Po	-	-	-	-	-	-	41,3	39,4	43,2	32,9	40,0	50,7
	Jo	-	-	-	-	-	-	36,4	35,4	37,4	37,2	38,4	32,7
Autoritet fetare japin përgjigje të plota për nevojat shpirtërore të njerëzve	Po	-	-	-	-	-	-	62,1	56,6	67,5	60,9	59,4	67,3
	Jo	-	-	-	-	-	-	17,0	19,2	14,9	14,3	19,2	16,0
Autoritet fetare japin përgjigje të plota për nevojat sociale për vendin tonë	Po	-	-	-	-	-	-	21,1	19,2	23,0	16,3	17,6	30,6
	Jo	-	-	-	-	-	-	42,6	41,4	43,8	41,9	44,4	40,5
A koni ndonjë moment lutje, përsiatje, meditimi apo diçka të tillë?	Po	-	-	-	-	-	-	75,4	67,1	83,6	72,5	74,3	79,6
	Jo	-	-	-	-	-	-	17,5	22,8	12,3	20,2	17,9	14,6
Politikanët jobesimtar të papërshtatshëm për të qenë në pushtet	Shumë dakord	-	-	-	-	-	-	16,1	14,7	17,4	16,3	15,6	16,7
	Dakord	-	-	-	-	-	-	24,8	23,4	26,1	23,6	23,2	28,2
	Neutral	-	-	-	-	-	-	24,7	25,3	24,2	24,4	27,9	20,1
	Jo dakord	-	-	-	-	-	-	19,2	22,2	16,2	18,6	19,0	20,1
	Aspak dakord	-	-	-	-	-	-	7,2	6,9	7,5	7,0	7,8	6,5
Do të ishte më mirë për Shqipërinë nëse do të ishin në	Shumë dakord	-	-	-	-	-	-	11,5	10,7	12,3	11,6	10,0	13,6
	Dakord	-	-	-	-	-	-	25,8	23,6	27,9	22,9	25,4	28,9
	Neutral	-	-	-	-	-	-	23,0	24,4	21,6	24,0	23,9	20,7

pushtet më shumë njerëz me besime fetare	Jo dakord						21,2	21,6	20,8	21,7	22,1	19,4
	Aspak dakord						7,4	9,3	5,5	8,1	7,4	6,8

## Fetaria mes komuniteteve të ndryshme

Përveç të dhënave të mësipërme që tregojnë fetarinë e qytetarëve të anketuar të Shqipërisë, pa dallimet fetare mes tyre, ne mund të shohim këtë fetari edhe duke u nisur nga përkatësia e tyre fetare dhe nëse kryqëzojmë të dhënat mes disave prej këtyre aspekteve të fetarisë që paraqitëm më sipër dhe përkatësisë fetare do të kemi një tabelë përmbledhëse për të dyja anketimet, atë të 1998 dhe 2002.<sup>1</sup>

Ajo që vihet re është se ka një dallim të qartë që tregon rritje të fetarisë mes anketimit të 1998 dhe atij të 2002 dhe kjo për të gjitha besimet fetare. Bie në sy një rritje e theksuar e të ndjerit fetar te katolikët me 41,4%, pas tyre vijnë myslimanët me 27,6%, dhe më pas ortodoksët me 22%. Të bie në sy gjithashtu rritje nga zero të atyre që nuk janë ateistë, nuk i përkasin asnjë feje, por që ndjehen fetar. Këta duhet të jenë pikërisht ajo kategori njerëzish që në Censusin e 2011 janë përfshirë si besimtarë të pacilësuar. Pra rritja e fetarisë së shqiptarëve është shoqëruar edhe me një fenomen bashkëkohor që është dalja në skenë e besimtarëve që nuk i përkasin asnjë feje tradicionale, por edhe nuk ndjekin ndonjë nga fetet e reja të ardhura në Shqipëri pas viteve 90'. Ndërkohë fetaria e lartë tek ungjillorët mund të shpjegohet me faktin, se ata i përkasin kryesisht, në mos të gjithë, konvertimit të tyre pas viteve 90' dhe duke qenë se nuk e kanë këtë besim të trashëguar nga prindërit e tyre, por është zgjedhje e tyre individuale, kjo i bën ata edhe më fetarët mes komuniteteve të tjera. Ajo që vihet re këtu gjithashtu është se kemi një përqindje të vogël njerëzish të cilët edhe pse identifikohen me një fe të caktuar ata shprehen se janë ateistë të bindur apo nuk besojnë në Zot. Pra se një pjesë e njerëzve që nuk besojnë, edhe pse në përqindje të vogël, e identifikojnë veten me një fe të caktuar. Kjo do të thotë se, edhe pse në pak raste, identiteti fetar për një pjesë të shqiptarëve është më së shumti një trashëgimi familjare, kulturore dhe sociale sesa një besim real në këto përkatësi fetare, megjithatë siç edhe të dhënat tregojnë kjo shifër është shumë e ulët. Ajo që vihet re gjithashtu është edhe dallimi mes përqindjes së atyre që deklarojnë se nuk besojnë në Zot dhe atyre që deklarohen si ateistë të bindur, i cili del të jetë më i ulët në të gjitha rastet, me përjashtimi të njërit.<sup>2</sup> Kjo do të thotë se jo të gjithë ata që thonë se nuk besojnë në Zot janë në vetvete ateistë të vendosur, por mund të jenë agnostikë ose diçka tjetër, por jo ateistë.

Anketimi WVS 1998							Anketimi WVS 2002					
Pyetja / Feja		Katolik %	Ungjillor %	Ortodoks %	Mysliman %	Pa fe %	Katolik %	Ungjillor %	Ortodoks %	Mysliman %	Pa fe %	Tjetër %
Sa person fetar jeni	Fetar	44,6	75,0	45,6	45,2	0,0	86,0	92,3	67,6	72,8	34,4	66,7
	Jofetar	46,2	25,0	52,8	49,7	37,5	12,8	7,7	28,3	23,6	26,1	16,7
	Ateist i bindur	9,2	0,0	1,5	5,1	62,5	1,2	0,0	4,0	3,6	5,6	16,7

<sup>1</sup> Këtu janë lënë jashtë vlera *nuk e di* dhe *pa përgjigje*, dhe janë marrë parasysh vetëm përgjigjet e vlefshme.

<sup>2</sup> Sipas anketimit të 1998 del se mes katolikëve ata që janë deklaruar si ateistë të bindur ishin 6 vetë, ndërkohë ata që nuk besonin në Zot 4 vetë! Kjo është disi kontradiktore në vetëve, kështu që mund të jetë ndonjë e dhënë e gabuar, ose mund të shpjegohet me përgjigjet e pavlefshme, pasi për të dy pyetjet numri i tyre ndryshon. Për pyetjen *a jeni fetar* kemi 38 përgjigje të pavlefshme, ndërsa për pyetjen *a besoni në Zot*, kemi 31 përgjigje të pavlefshme. Kështu që ka mundësi që ndonjë nga këto vlera të humbura të përfshihen tek këto shifra.



A besoni në Zot	Po	94,1	100%	93,4	94,3	54,5	97,7	100%	93,2	94,3	71,4	100%
	Jo	5,9	0,0	6,6	5,7	45,5	2,3	0,0	6,8	5,7	28,6	0,0
A besoni në jetën tjetër	Po	28,6	33,3	29,2	32,9	0,0	71,0	100%	31,9	51,4	22,6	80,0
	Jo	71,4	66,7	70,8	67,1	100%	29,0	0,0	68,1	48,6	77,4	20,0
A besoni në parajsë	Po	42,4	33,3	28,8	44,5	0,0	73,0	100%	32,3	51,1	30,4	83,3
	Jo	57,6	66,7	71,2	55,5	100,0	26,2	0,0	67,7	48,9	69,6	16,7
Rëndësia e Zotit në jetë	Aspak i rëndësishëm	7,4	0,0	3,5	3,0	16,7	2,3	0,0	4,4	4,4	12,5	0,0
	2	2,9	0,0	7,5	3,8	25,0	1,1	0,0	2,8	2,8	10,0	0,0
	3	4,4	0,0	4,0	6,7	8,3	1,1	0,0	6,7	4,0	11,7	0,0
	4	11,8	0,0	4,5	5,2	16,7	1,1	0,0	6,7	4,4	7,5	0,0
	5	7,4	0,0	6,5	5,7	8,3	2,3	0,0	12,2	5,7	10,0	0,0
	6	5,9	0,0	8,5	6,4	8,3	3,4	0,0	3,9	4,5	9,2	0,0
	7	4,4	25,0	7,5	10,0	8,3	5,7	15,4	13,3	12,9	16,7	16,7
	8	25,0	0,0	17,9	22,1	8,3	10,2	0,0	9,4	11,0	9,2	0,0
	9	25,0	0,0	24,4	19,6	0,0	18,2	15,4	13,9	15,2	4,2	50,0
Shumë i rëndësishëm	5,9	75,0	15,9	17,6	0,0	54,5	69,2	26,7	35,2	9,2	33,3	
Gjen ngushëllim dhe forcë te feja	Po	56,5	75,0	66,3	57,4	10,0	95,2	91,7	72,4	75,2	40,4	100,0
	Jo	43,5	25,0	33,7	42,6	90,0	4,8	8,3	27,6	24,2	59,6	0,0
Rëndësia e fesë në jetë	Shumë	35,3	0,0	20,2	25,4	9,1	48,3	76,9	24,2	29,8	7,2	20,0
	Mjaftueshëm	33,8	75,0	38,4	34,5	18,2	35,6	15,4	34,3	33,6	18,4	40,0
	Jo shumë	25,0	0,0	35,9	27,6	27,3	12,6	0,0	32,0	25,4	29,6	20,0
	Aspak	5,9	25,0	5,6	12,4	45,5	3,4	7,7	9,6	11,2	44,8	20,0
Pjesëmarrja në shërbime fetare	> 1 herë në javë	0,0	50,0	0,5	2,0	0,0	6,8	61,5	0,6	3,8	0,0	16,7
	1 herë në javë	15,7	25,0	13,8	17,3	0,0	29,5	30,8	20,0	16,7	0,8	16,7
	1 herë në muaj	20,0	0,0	19,2	16,9	0,0	18,2	7,7	6,1	10,0	3,1	16,7
	Ditë festash	44,3	0,0	50,2	37,4	8,3	34,1	0,0	51,7	30,2	19,4	16,7
	1 herë në vit	7,1	0,0	5,9	10,5	0,0	3,4	0,0	5,6	5,2	5,4	0,0
	më rrallë	8,6	25,0	6,9	8,8	16,7	1,1	0,0	6,1	10,3	17,8	33,3
	asnjëherë	4,3	0,0	3,4	7,2	75,0	6,8	0,0	10,0	23,8	53,5	0,0
Besimi tek institucioni fetar	Shumë besim	20,0	50,0	12,9	21,6	0,0	59,1	76,9	30,1	33,4	7,3	50,0
	Mjaftueshëm	48,6	25,0	35,8	32,6	0,0	30,7	7,7	44,3	35,7	17,7	33,3
	Jo shumë besim	25,7	0,0	42,3	33,6	27,3	4,5	15,4	13,6	18,1	35,5	16,7
	Aspak besim	5,7	25,0	9,0	12,2	72,7	5,7	0,0	11,0	12,7	39,5	0,0

## Anketimi i Eurobarometrit 2005

Ky anketim është i ngjashëm me ato ESV më sipër dhe ka drejtuar vetëm dy pyetje për matjen e fetarisë, atë të frekuentimit të objekteve të kultit dhe një të dytë, atë të ndjesisë personale se sa fetar ndjehet dikush.<sup>1</sup> Edhe nga ky anketim, frekuentimi i xhamive dhe kishave duket i ulët dhe duket se ka një rritje të përqindjes së atyre që nuk i frekuentojnë asnjëherë ato, por edhe ulje në përgjithësi nëse e krahasojmë me anketimin e 2002. Megjithatë ka rritje të ndjesisë së të qenit

<sup>1</sup> Ilirjani, Altin, Bean, Clive, Gibson, Rachel K., McAllister, Ian, Billiet, Jaak, De Winter, Lieven, Frogner, Andre-Paul, (2015). Adresa në web: <https://doi.org/10.7804/cses.module2.2015-12-15>.

fetar në përgjithësi, çka tregon edhe një herë se shqiptarët fetarinë e tyre nuk e lidhin domosdoshmërisht me frekuentimit e objekteve të kultit të besimeve tradicionale edhe pse shumica dërmuese e tyre identifikohen me to. Kemi pra një zhvendosje drejt një besimi më individual dhe më pak institucional dhe klerikal, por gjithmonë brenda të njëjtave përkatësi fetare tradicionale. Nga ky anketim, siç paraqitet edhe në tabelë, duket se frekuentimin më të lartë të objekteve të kultit dhe fetarinë më madhe e kanë zonat rurale dhe ato periferike të qyteteve.

Eurobarometri 2005		Gjithsej %	Meshkuj	Femra	<29 vjeç	30-44 vjeç	45-59 vjeç	60 < vjeç	Fshat	Qytet	Periferi Qyteti	Ortodoks	Katolik	Mysliman	Tjetër	Pa fe
Frekuentimi i xhamisë/kishës	1 herë në javë	9,5	9,3	9,8	6,8	7,0	9,5	12,0	10,2	6,4	11,2	19,8	21,4	5,2	4,5	0,0
	2 < në muaj	5,1	4,3	5,8	7,6	3,7	4,5	6,1	5,2	3,0	6,9	12,3	9,0	2,8	4,5	0,0
	1 herë në muaj	9,1	6,6	11,8	4,3	10,8	9,3	15,4	8,9	9,1	9,7	11,7	20,7	6,2	13,6	0,0
	2-11 herë në vit	15,8	13,8	18,0	21,8	14,9	13,7	6,9	16,4	17,0	13,9	25,3	22,8	12,5	19,7	0,0
	1 herë në vit	14,0	14,2	13,9	15,3	14,3	14,5	6,6	13,5	13,7	14,8	13,0	10,3	15,3	16,7	4,8
	Asnjëherë	46,3	51,5	40,6	44,3	48,9	48,3	53,0	45,3	51,0	43,5	17,9	15,9	57,9	40,9	95,2
Sa fetar jeni	Shumë fetar	37,7	32,3	43,8	35,0	33,0	36,3	39,0	40,3	31,5	39,3	40,7	49,0	35,1	42,4	4,8
	Deri diku fetar	37,7	36,8	38,7	35,3	43,2	36,3	25,3	39,1	39,8	34,4	32,7	41,4	40,1	33,3	14,3
	Jo shumë fetar	14,8	16,1	13,2	12,7	15,0	18,1	21,5	11,0	17,5	17,8	18,5	6,9	15,6	16,7	14,3
	Nuk ka besim fetar	9,1	13,8	4,1	8,7	7,9	9,1	14,2	8,7	10,9	8,2	7,4	2,1	8,9	7,6	66,7

## Anketimet e ALPSA-s 2005-2006

Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike (ALPSA) ka kryer në 2005-2006 tre anketime, dhe mes pyetjeve të tjera janë bërë edhe disa që kanë lidhje me fenë dhe fetarinë e shqiptarëve. Duke qenë se janë bërë në të njëjtën periudhë me anketimin e mësipërm kemi mundësinë të testojmë edhe saktësinë mes tyre.

Në anketimin e parë pyetjes: *Sa herë shkon në kishë ose në xhami/teqe?* Iu përgjigjën 46,4% asnjëherë, 14% shumë rrallë, 25% rrallë, 5,1% shpesh dhe 9,5% shumë shpesh.<sup>1</sup> Sipas anketuesve kjo do të thotë se “mund të mendohet se në Shqipëri sot përkatësia fetare është më tepër një marrëdhënie nominale sesa besim real”.<sup>2</sup> Në anketimin e dytë, që u kufizua në Tiranë dhe Durrës, u drejtua po e njëjta pyetje dhe përgjigjet qenë: 63% asnjëherë, 11% një herë në vit, 17% disa herë në vit, 3% një herë në muaj, 2% dy herë ose më shumë në muaj dhe 4% çdo javë.<sup>3</sup> Dhe në anketimin e tretë që u kufizua vetëm në Tiranë, të njëjtës pyetje iu përgjigjën: 55% kurrë, 12,5% një herë në vit, 20,3% disa herë në vit, 3,4% një herë në muaj, 4,4 dy herë ose më shumë në muaj dhe 4,4 % çdo javë.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Altin Ilirjani, Përmbledhje e disa rezultateve të Studimit Elektorale Shqiptar 2005, publikuar nga Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike (ALPSA). f. 33. Burimi në web: <http://alpsa.org/aes/docs/AES2005-permbledhje.pdf>

<sup>2</sup> Ibid f.4

<sup>3</sup> Altin Ilirjani, Albania Survey # 1: Tirana – Durrës The First 100 Days of the Democratic Party Government, fq. 24.

<sup>4</sup> [http://albania.globic.us/docs/globic2\\_report\\_shqip.pdf](http://albania.globic.us/docs/globic2_report_shqip.pdf) f.3



Sa herë shkoni në kishë ose në xhami/teqe	Anketimi Korrikut 2005 %	Sa herë shkoni në kishë ose në xhami/teqe	Anketimi Dhjetorit 2005 %	Anketimi Qershorit 2006 %
Asnjëherë	46,4	Asnjëherë	63,0	55,0
Shumë rrallë	14,0	Një herë në vit	11,0	12,5
Rrallë	25,0	Disa herë në vit	17,0	20,3
Shpesh	5,1	Një herë në muaj	3,0	3,4
Shumë shpesh	9,5	2 herë ose më shumë në muaj	2,0	4,4
-	-	Çdo javë	4,0	4,4

Ndryshimet që vihen re në këtë rast mendoj se kanë të bëjë më shumë me ndryshimin e zonës ku u kryen këto anketime sesa me kohën, e cila nga një anketim në tjetrin ka qenë vetëm disa muaj. Kështu që mund të vihet re se, në rang kombëtar frekuentimi i objekteve të kultit është më i lartë sesa në zonën Tiranë-Durrës, ndërkohë vetëm në Tiranë është më i lartë sesa i marrë me Durrësin së bashku.

Në anketimin e tretë studiuësit janë shprehur për dallimin mes fetarisë së brezave se:

Dhe rezultatet tona tregojnë se moshë është një faktor shumë i rëndësishëm. Kjo ndodh sepse breza të ndryshëm në Shqipëri janë socializuar në mjedise shumë të ndryshme fetare. Me pak fjalë, brezat më në moshë u rritën në një mjedis që mund të quhet ‘anti-fetar,’ ndërsa sot është më pak kështu për brezat e rinj (sidomos grupmosha 18-29). Kështu, është e mundur që grupmosha të ndryshme e aplikojnë fenë në nivele të ndryshme. Për ta shqyrtuar këtë mundësi, Figura 1 e grupon pjesëmarrjen fetare në tri kategori: pjesëmarrje e Ulët (Kurrë/Një Herë në Vit), e Mesme (Disa Herë/Një Herë në Muaj), dhe e Lartë (Dy Herë në Muaj/çdo Javë). Në këtë figurë, përpjesëtimet e grupmoshës janë paraqitur për çdo kategori pjesëmarrjeje në boshtin y. Figura 1(a) paraqet të dhënat për pjesëmarrje të Ulët dhe 1(b) paraqet grupet e Pjesëmarrjes së Mesme dhe të Lartë. Kjo ndarje synon të theksojë rrymat e grupmoshave për çdo kategori pjesëmarrjeje. Në Figurën 1 vëzhgojmë dy modele interesante: Së pari, në ndryshim me moshat e reja, një numër shumë më i madh qytetarësh më në moshë hyjnë në kategorinë e Pjesëmarrjes së Ulët. Së dyti, moshat e reja janë mesatarisht ata me më shumë gjasa për të ndjekur shërbesa fetare më rregullisht. Me fjalë të tjera, ata që janë më të rinj janë edhe më fetarë. Megjithatë, pavarësisht nga dallimet e dukshme të grupmoshave në pjesëmarrje, nuk mund të përjashtohet mundësia që këto dallime të mos jenë karakteristika të të gjithë popullsisë...<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Ibid. f.4.



(a) Pjesëmarrja Fetare sipas Grupmoshës (Vetëm Pjesëmarrja e Ulët)

(b) Pjesëmarrja Fetare sipas Grupmoshës (Vetëm Pjesëmarrja e Mesme, e Lartë)

## Anketimi i European Values Study (EVS) i 2008

Në anketimin e “European Values Study”<sup>1</sup> janë bërë një sërë pyetjesh, kur krahas pyetjeve që zbulojnë fetarinë e njerëzve dhe ndjekjen nga ana e tyre të praktikave fetare edhe kur ata nuk frekuentojnë objektet e kultit, janë bërë edhe pyetje që zbulojnë bindjet dhe besimet që ata kanë për botën e përtejme, për hyjnoren dhe atë që njerëzit konsiderojnë si të shenjtë, duke përfshirë këtu p.sh. edhe besimin tek nuskat dhe hajmalitë.

Edhe ky anketim tregon nivelin e lartë të besimit në Zot dhe se mbi gjysma e shqiptarëve të sotëm e shohin fenë si diçka të rëndësishme në jetë (52,8%), madje shumica e tyre dërmuese e konsiderojnë veten si fetar gati në të njëjtën përqindje që ata besojnë edhe në ekzistencën e Zotit (90,8%), por frekuentimi i objekteve të kultit apo pjesëmarrja në aktivitete fetare mbetet e ulët, kryesisht në raste festash (30,8%). Përkundër kësaj përshpirtja individuale dhe lutjet janë të shpeshta (33,8% luten çdo ditë). Kjo tregon se kemi një zhvendosje të fetarisë së njerëzve nga ajo tradicionalja, e cila përfshin në masë të madhe pjesëmarrjen në aktivitete komunitare, në më të shumti atë individuale, personale dhe private. Kjo në fakt provon tezën që trajtuam edhe në fillim se feja para se të jetë një produkt komunitar është së pari një nevojë e natyrshme individuale e njeriut, kështu që në këtë botë të sotme ku është zbehur roli i bashkësisë, duke nisur që nga familja e komuniteti, shprehja e fesë dhe besimit kufizohen tek individualja dhe privatja, ndërkohë që hapësira publike duket se mbetet përgjithësisht laike. Megjithatë duke qenë se publikja ndikon edhe tek privatja dhe bota e brendshme e njeriut, dhe kundërta gjithashtu, mund të themi se sa më i lartë të jetë aktiviteti i brendshëm dhe privat fetar tek individët aq edhe

<sup>1</sup> Të dhënat e EVS (2010): European Values Study 2008, 4th wave, Albania. GESIS Data Archive, Cologne, Germany, ZA4783 Data File Version 1.1.0 (2010-11-30), doi:10.4232/1.10176.

më publik ai tenton të bëhet, ndërkohë që sa më publike të jetë aktiviteti fetar aq edhe më shumë ndikon ai në rritjen e fetarisë së brendshme dhe publike të njerëzve. Kjo vlen edhe për të kundërtën, për rënien e fetarisë së njerëzve, si atë publike e komunitare ashtu edhe atë private e individuale.

Një fakt interesant që vëmë re në këtë anketim është nëse marrim në shqyrtim përgjigjet e pyetjes se *Sa shpesh keni marrë pjesë në shërbimet fetar kur keni qenë 12 vjeç?* dhe përgjigjen e pyetjes se sa herë merrni pjesë në aktivitetet fetare në ditët e sotme. Ajo që bie në sy dukshëm është se në të gjashtë nivelet që shprehin frekuencën e pjesëmarrjes në aktivitete fetare në moshën 12 vjeçare përqindja është më e ulët sesa në pjesëmarrjen e aktuale të vitit të anketimit, çka tregon se kemi një rritje të fetarisë, e cila nuk vjen që nga mosha e rinisë së hershme, për rrjedhojë dhe nuk është fetari e marrë nga familja, por e shtuar më pas nga ndikime të tjera.

Nëse shohim përgjigjet që lidhen me atë se çfarë besojnë njerëzit do të vëmë re përgjithësisht se besimi te doktrinat fetare që kanë të bëjnë me botën metafizike, me përjashtim të besimit tek Zoti, apo një genie e mbinatyrshme, janë shumë më të ulëta edhe pse në këtë anketim duket se ka rritje të atyre që besojnë në jetën pas vdekjes (75,3%), por ndërkohë doktrinat e tjera tradicionale që shoqërojnë këtë besim si ringjallja, parajsa dhe ferri mbeten në nivele shumë më të ulëta besimi, edhe pse në përgjigjen për ringjalljen pyetja e bërë duket se ka lidhje më së shumti me konceptin hindus e budist të rimëshërimit në këtë botë, besim ky përgjithësisht i largët për shqiptarët, sesa me besimet tradicionale fetare të feve në Shqipëri për ringjalljen, ndaj kam përshtypjen se edhe ata që i janë përgjigjur pozitivisht (19,1%) kësaj pyetje duhet ta kenë ngatërruar atë me konceptin e mësipërm të feve tradicionale.<sup>1</sup>

Ajo që të bie në sy gjithashtu është se, edhe pse shqiptarët besojnë 94% e tyre në Zot, diçka më pak se gjysma nuk e konceptojnë këtë Zot si personal apo ashtu siç e konceptojnë fetë tradicionale. Kjo shpjegon në fakt edhe përqindjen e lartë të mënyrës personale të lidhjes me të shenjtën. Ndërkohë edhe pse shumica e shqiptarëve identifikohen me besimet tradicionale, diçka më pak se gjysma e tyre (45,6%) nuk besojnë se ka një fe të vetme të vërtetë. Ndërkohë gati 1/3 e të anketuarve janë të lidhur deri në njëfarë mase me besimin e ndikimit të nuskave dhe hajmalive. Shërbesat fetare konsiderohen deri diku të rëndësishme për momentet kyçe të jetës, në veçanti për rastet e ceremonive mortore, të cilat duhet thënë janë më së shumti tregues i trashëgimisë kulturore dhe familjare të shqiptarëve, dhe për shkak kryesisht të peshës dhe rëndësisë emocionale dhe sociale që ka akoma familja tek shqiptarët. Pra përqindja e lartë e atyre që e shohin të rëndësishme ceremoninë fetare në raste të tilla (71,7%) vjen si pasojë e respektit familjar dhe social që tregohet ndaj të vdekurit, familjes dhe shoqërisë, sesa për shkaqe të mirëfillta fetare. Shqiptarët vazhdojnë ta shohin rolin e klerit fetar më së shumti të kufizuar në udhëzimin shpirtëror dhe moral dhe shumë pak atë social, ndërkohë edhe për sa i përket politikës, të paktë janë ata që mendojnë se kleri duhet të ndikojë në qeverisjen e vendit, por ndërkohë 35,1% bien dakord me pohimin se politikanët jobesimtarë janë më pak të përgjegjshëm për qeverisjen e vendit.

---

<sup>1</sup> Kjo tregon në fakt atë që kemi vënë në dukje se anketimet e huaja çalojnë ndonjëherë në përkthimin apo përshtatjen e tyre sipas kulturës vendase. Duke qenë se ky anketim ishte ndërkombëtar duket se kjo pyetje, si shumë të tjera në këtë pyetësor, u drejtohej qytetarëve evropian që përballen edhe me këtë prurje të re konceptesh fetare në perëndim.

Anketimi i EVS 2008 përveç besimit aktual ka pyetur edhe për besimin që kanë pasur dikur njerëzit dhe numri i atyre që kanë ndryshuar besimin ishte 66 vetë, ose ndryshe vetëm 4,3% e të gjithë të anketuarve. Pra kjo tregon se në përgjithësi shqiptarët nuk kanë ndryshuar përkatësinë fetare të paraardhësve të tyre. Nga 66 vetë mbi gjysma (34 vetë) janë bërë të pafe. Pjesa më e madhe e tyre i përkisnin dikur besimit mysliman dhe bektashi, të cilët ndërkohë kanë edhe shkëmbimin më të madh mes tyre. Nga tabela e mëposhtme duket se më të prekurit nga ndryshimi i fesë janë myslimanët dhe ortodoksët dhe më pak katolikët, ndërkohë bektashinjtë duket se kanë rikuperuar veten. Gjithsesi ky përfundim ngelet për tu studiuar më tej, pasi numri i pjesëmarrësve në këtë përgjigje, për ta vlerësuar më saktë këtë fenomen, është i pamjaftueshëm.

Besimi sot	Mysliman	Bektashi	Ortodoks	Katolik	D. Jehovahit	Tjetër	Pa fe	<b>Gjithsej</b>
Besimi dikur								
Mysliman		9	3	2	1		11	<b>26</b>
Bektashi	6						6	<b>12</b>
Ortodoks	1	4		1			5	<b>11</b>
Katolik	1		2				4	<b>7</b>
D. Jehovahit	1			1			6	<b>8</b>
Tjetër							2	<b>2</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>1</b>		<b>34</b>	<b>66</b>

Pyetja		Gjithsej %	Meshkuj	Femra	Mosha deri 29	Mosha 30-49	Mosha 50 sipër	Mysliman	Bektashi	Ortodoks	Katolik
Besoni në Zot	Po	94	91,6	96,3	93,6	94,1	94,2	98,1	90,4	99,2	99,2
	Jo	6	8,4	3,7	6,4	5,9	5,8	1,9	9,6	0,8	0,8
Besoni se do të rilindim në këtë botë përsëri	Po	19,1	19,0	19,2	19,7	16,7	21,8	21,0	22,2	15,4	38,0
	Jo	80,9	81,0	80,2	80,3	83,3	78,2	79,0	77,8	84,6	62,0
Rëndësia fesë në jetë	Shumë	14,9	13,9	15,8	9,0	16,8	17,8	21,8	5,8	12,8	17,2
	Mjaftueshëm	37,9	36,2	39,6	40,3	33,7	41,2	38,9	48,1	44,4	64,1
	Jo shumë e rëndësishme	28,9	30,8	27,1	30,9	29,8	26,0	26,9	34,6	21,4	13,3
	Aspak e rëndësishme	18,3	19,1	17,5	19,8	19,8	15,0	12,5	11,5	21,4	5,5
Edukim fetar i fëmijëve i rëndësishëm		20,4	19,5	21,3	17,4	21,3	22,1	23,6	13,1	28,6	40,2
Anëtarë në organizata fetar		12	12,5	11,5	13,5	11,5	11,1	7,7	12,1	10,1	36,4
Punë vullnetare në organizata fetare		9,4	10,5	8,3	9,0	9,3	9,9	6,2	10,3	6,7	26,5
Cili pohim qëndron më pranë besimeve tuaja	Ka një Zot personal	58,2	55,8	60,6	57,9	58,1	58,8	61,8	44,4	73,7	75,4
	Ka një shpirt ose forcë e jetës	18,9	18,4	19,4	21,8	16,3	19,6	21,5	17,2	13,2	12,3
	Nuk e di	14,7	14,9	14,6	12,4	16,7	14,4	11,8	26,3	9,6	9,0
	Nuk ka shpirt, Zot ose forcë jete	8,1	10,9	5,4	7,9	8,9	7,3	4,9	12,1	3,5	3,3
Sa shpesh keni marrë pjesë në shërbimet fetare kur keni qenë 12 vjeç	Më >1 herë në javë	1,7	1,7	1,7	1,6	1,4	2,3	3,1	0,0	1,9	1,9
	1 herë në javë	4,3	3,9	4,6	7,8	2,0	4,1	3,7	2,9	3,8	17,0
	1 herë në muaj	3,5	3,1	3,9	5,4	2,0	3,7	2,6	6,9	9,4	5,7
	Vetëm në festa	16,7	16,7	16,7	22,5	13,4	15,9	14,2	18,6	19,8	29,2
	1 herë në vit	2,4	2,3	2,4	3,4	2,0	2,1	2,4	0,0	1,9	1,9
	Shumë më rrallë	4,5	4,4	4,6	3,9	4,8	4,6	3,5	6,9	3,8	1,9
	Asnjëherë	66,9	67,8	66,0	55,4	74,5	67,4	70,5	64,7	59,4	42,5
Përveç dasmave, funeraleve dhe pagëzimeve, sa herë merrni pjesë në aktivitete fetare këto ditë	Më >1 herë në javë	1,9	2,0	1,7	2,1	1,0	2,8	3,1	1,0	0,8	3,1
	1 herë në javë	7,2	6,3	8,1	7,2	6,0	8,8	4,0	5,8	17,8	29,0
	1 herë në muaj	5,3	5,2	5,5	5,5	4,3	6,5	4,3	6,8	10,2	7,6
	Vetëm në festa	30,8	30,4	31,2	27,9	32,8	30,8	31,3	30,1	47,5	35,9
	1 herë në vit	5,2	4,1	6,3	5,7	5,0	5,0	5,3	2,9	7,6	3,1
	Shumë më rrallë	7,9	9,3	6,5	5,5	10,1	7,1	7,1	9,7	5,1	3,1
	Asnjëherë	41,7	42,7	40,7	46,1	40,8	39,0	44,8	43,7	11,0	18,3
Sa fetar jeni	Person fetar	90,8	87,7	93,9	88,9	91,3	91,8	97,1	80,2	99,1	97,7
	Person jofetar	6,2	7,9	4,6	5,7	6,9	5,8	2,3	18,8	0,9	2,3
	Ateist i bindur	3	4,4	1,6	5,4	1,8	2,4	0,6	1,0	0,0	0,0
Besoj te jeta pas vdekjes	Po	75,3	22,9	26,5	29,1	20,8	25,6	27,2	20,0	23,1	62,7
	Jo	24,7	77,1	73,5	70,9	79,2	74,4	72,8	80,0	76,9	37,3
Shërbimet fetare të rëndësishme gjatë vdekjes	Po	71,7	69,8	73,6	69,5	69,7	76,4	82,3	59,4	83,0	93,7
	Jo	28,3	30,2	26,4	30,5	30,3	23,6	17,7	40,6	17,0	6,3
Institucionet fetare janë përgjigje për problemet morale	Po	61,2	35,4	42,2	37,0	38,6	40,5	40,7	38,5	44,9	56,1
	Jo	38,8	64,6	57,8	63,0	61,4	59,5	59,3	61,5	55,1	43,9
Beson te ferri	Po	24,8	22,8	26,9	26,6	21,3	27,8	29,5	19,1	19,0	59,5
	Jo	75,2	77,2	73,1	73,4	78,7	72,2	70,5	80,9	81,0	40,5
Besojnë në parajsë	Po	35,7	31,5	39,9	38,0	32,0	38,3	44,5	29,3	29,9	72,5
	Jo	64,3	68,5	60,1	62,0	68,0	61,7	55,5	70,7	70,1	27,5
Besojnë te mëkati	Po	36,4	33,8	39,1	30,8	35,2	43,1	40,3	28,0	35,7	58,6
	Jo	63,6	66,2	60,9	69,2	64,8	56,9	59,7	72,0	64,3	41,4
Rëndësia e Zotit në jetë	Aspak	7,6	9,9	5,4	7,5	8,2	6,9	4,5	17,1	2,5	1,6
	2	4,2	4,9	3,5	3,9	4,8	3,7	2,7	6,7	3,4	1,6
	3	5,8	5,6	6,0	7,7	6,5	3,2	4,6	2,9	8,4	1,6
	4	4,4	4,6	4,3	4,6	4,1	4,8	4,0	1,9	5,0	3,9
	5	8,5	9,3	7,8	8,2	9,2	8,0	9,0	11,4	10,9	3,1
	6	6,8	6,4	7,1	6,5	6,3	7,6	6,4	4,8	6,7	3,9
	7	8,7	9,1	8,4	10,6	8,0	8,0	7,5	12,4	6,7	12,4
	8	12,9	13,6	12,2	12,5	12,1	14,3	11,7	13,3	10,9	26,4

	9	12	11,8	12,2	10,6	11,2	14,3	13,9	7,6	11,8	20,2
	Shumë	29,1	24,8	33,2	28,0	29,6	29,4	35,6	21,9	33,6	25,6
Forcë dhe ngushëllim nga feja	Po	58,4	54,1	63,0	55,2	58,1	62,4	69,3	58,4	66,7	84,9
	Jo	41,3	45,9	37,0	44,8	41,9	37,6	30,7	41,6	33,3	15,1
Sa shpesh i luteni jashtë aktiviteve fetare	Çdo ditë	33,8	28,2	39,2	25,7	34,4	40,0	44,1	26,2	40,4	41,5
	Më > 1 javë	12,9	13,4	12,4	17,5	12,6	9,3	13,8	11,7	13,2	28,8
	1 herë javë	6,9	7,4	6,5	5,9	7,3	7,3	6,6	2,9	10,5	5,9
	1 herë muaj	9,5	9,5	9,4	11,3	9,1	8,4	8,8	15,5	8,8	11,0
	Disa herë vit	11,7	10,5	12,8	11,3	12,4	11,1	10,9	13,6	14,9	5,1
	Më rrallë	8,9	9,1	8,8	9,0	8,6	9,3	8,1	5,8	8,8	2,5
Shërbimet fetare të rëndësishme gjatë lindjes	Po	42,9	38,0	47,4	41,9	41,0	46,2	64,1	55,0	32,7	20,0
	Jo	57,1	62,0	52,6	58,1	59,0	53,8	35,9	45,0	67,3	80,0
Shërbimet fetare të rëndësishme gjatë martesës	Po	51,2	47,2	55,0	56,9	46,5	51,9	43,7	48,5	74,3	88,6
	Jo	48,8	52,8	45,0	43,1	53,5	48,1	56,3	51,5	25,7	11,4
Autoritet fetare japin përgjigje të plota për nevojat shpirtërore të njerëzve	Po	70,9	65,8	75,8	65,7	73,8	71,8	76,0	61,2	87,5	81,1
	Jo	29,1	34,2	24,2	34,3	26,2	28,2	24,0	38,8	12,5	18,9
Autoritet fetare japin përgjigje për nevojat sociale	Po	16,7	14,4	19,1	14,5	18,2	16,7	16,9	20,0	15,0	26,7
	Jo	83,3	85,6	80,9	85,5	81,8	83,3	83,1	80,0	85,0	73,3
A koni ndonjë moment lutje, përsiatje, meditimi apo diçka të tillë?	Po	81,8	76,8	86,8	78,5	82,7	83,7	90,1	75,7	95,0	90,0
	Jo	18,2	23,2	13,2	21,5	17,3	16,3	9,9	24,3	5,0	10,0
Politikanët jobesimtar të papërshtatshëm për të qenë në pushtet	Shumë dakord	17,6	17,4	17,8	15,3	19,3	17,6	20,3	10,5	15,2	14,3
	Dakord	17,5	16,4	18,5	14,5	19,3	17,8	17,5	24,2	27,6	20,5
	Neutral	23,5	22,4	24,5	23,7	23,3	23,5	23,8	24,2	21,9	21,4
	Jo dakord	28,8	28,3	29,2	32,9	27,3	26,8	27,0	26,3	23,8	32,1
	Aspak dakord	12,7	15,4	9,9	13,7	10,8	14,3	11,3	14,7	11,4	11,6
Mënyrë personale e lidhjes me të shenjtën	Aspak	32,3	36,4	28,4	24,2	34,6	36,7	38,3	38,2	23,0	14,2
	2	16,3	16,0	16,6	17,0	15,6	16,5	17,1	13,7	22,1	22,5
	3	19,5	20,1	18,9	21,4	20,3	16,7	16,6	20,6	21,2	16,7
	4	16,7	13,6	19,7	20,1	14,5	16,5	12,2	19,6	12,4	35,8
	Shumë	15,2	13,9	16,4	17,3	14,9	13,6	15,8	7,8	21,2	10,8
Sa interesoheni për të shenjtën ose të mbinatyrshmen	Shumë i interesuar	19,4	16,4	22,4	15,8	18,6	23,7	24,7	15,4	28,4	19,2
	Deri diku i interesuar	37,3	35,0	39,5	35,3	36,4	40,1	38,9	37,5	36,2	55,4
	Jo shumë i interesuar	26,3	27,7	24,9	29,6	28,2	20,9	24,9	19,2	25,0	20,0
	Aspak i interesuar	17	20,8	13,2	19,3	16,8	15,3	11,5	27,9	10,3	5,4
Cili qëndrim shpreh më së miri pikëpamjen tuaj	Vetëm një fe e vërtetë	34,4	31,5	37,2	31,4	35,7	35,5	36,7	29,1	54,7	31,0
	Vetëm një fe e vërtetë, por të tjerat kanë disa të vërteta	20	18,9	21,1	19,6	19,7	20,8	24,1	26,7	16,0	17,7
	Nuk ka ve të vërtetë, të gjitha kanë disa të vërteta bazike	32,7	32,7	32,6	37,5	32,7	28,6	32,4	31,4	17,0	49,6
	Asnjë fe nuk ofron ndonjë të vërtetë	12,9	16,9	9,0	11,4	12,0	15,2	6,8	12,8	12,3	1,8
A besoni se nuskat ose hajmalitë mund t'iu mbrojnë ose	Absolutisht jo	26,1	31,5	20,8	26,6	26,2	25,4	26,7	33,0	27,2	12,6
	2	7,4	8,6	6,2	5,6	9,1	6,9	6,6	2,9	7,0	2,4
	3	7,9	8,6	7,3	7,7	7,4	8,8	8,0	7,8	5,3	3,1



ndihmojnë	4	7,5	6,9	8,0	9,4	7,0	6,2	7,7	6,8	4,4	10,2
	5	9,9	9,9	9,9	8,9	10,0	10,6	9,9	11,7	8,8	6,3
	6	8,1	7,2	8,9	7,0	8,3	8,8	9,4	5,8	5,3	11,0
	7	8,3	6,9	9,6	7,5	9,8	7,1	7,6	6,8	7,9	13,4
	8	10,3	8,1	12,5	10,9	9,1	11,3	7,2	16,5	19,3	18,9
	9	5,4	4,5	6,2	5,6	4,9	5,8	5,5	3,9	6,1	10,2
	Plotësisht po	9,2	7,8	10,6	10,9	8,1	9,1	11,4	4,9	8,8	11,8
Udhëheqësit fetar nuk duhet të ndikojnë në vendimet e qeverisë	Shumë dakord	24,3	26,3	22,3	22,2	23,7	27,0	27,0	23,7	12,9	13,9
	Dakord	37,1	37,4	36,8	36,7	38,1	36,2	37,6	38,1	36,6	38,9
	Neutral	20,9	18,9	23,0	22,0	21,4	19,4	20,4	22,7	29,7	24,1
	Jo dakord	13	13,0	12,9	13,2	12,6	13,2	11,2	13,4	15,8	13,9
	Aspak dakord	4,7	4,3	5,0	5,9	4,1	4,3	3,8	2,1	5,0	9,3
Besimi i njëjtë fetar në një martesë të suksesshme	Shumë i rëndësishëm	20,9	22,3	19,4	16,9	20,5	24,9	29,0	15,5	18,5	23,7
	Mjaftueshëm i rëndësishëm	26,6	26,0	27,1	25,1	27,7	26,5	26,2	23,3	42,0	29,7
	Jo shumë i rëndësishëm	52,6	51,6	53,5	58,1	51,8	48,6	44,8	61,2	39,5	46,6
Sa besim keni te institucioni fetar	Shumë	21,1	21,3	20,8	20,2	18,7	24,9	27,5	11,4	24,4	23,6
	Mjaftueshëm	29,3	24,8	33,7	23,8	31,9	31,1	32,3	34,3	35,3	48,8
	Jo shumë	32,7	34,2	31,2	34,7	34,8	28,3	30,0	28,6	34,5	20,5
	Aspak	16,9	19,6	14,2	21,4	14,6	15,7	10,2	25,7	5,9	7,1
Sa krenar jeni që jeni qytetar shqiptar	Shumë krenar	42,5	45,0	40,1	38,0	43,9	44,7	50,8	44,2	34,9	32,0
	Mjaft krenar	44,9	42,0	47,7	47,3	45,1	42,5	40,7	50,0	52,3	53,3
	Jo shumë krenar	11,6	11,7	11,4	14,3	9,6	11,6	7,8	5,8	12,8	13,1
	Aspak krenar	1,0	1,3	0,8	0,5	1,4	1,1	0,6	0,0	0,0	1,6

## Anketimi i Gallup-it 2009

Për këtë anketim nuk kam mundur të gjej të dhëna të detajuara, si në rastet e tjera, megjithatë sipas burimit të këtij anketimi në të thuhet se ai është ndërmarrë në 114 vende të botës dhe është zhvilluar me një kampion përfaqësues prej 1000 të rriturish. Anketimi është zhvilluar me telefon dhe drejtpërdrejtë. Sipas këtij anketimi pyetjes: *A është feja një pjesë e rëndësishme e jetës suaj të përditshme?* Me “Po” i janë përgjigjur 39% e të anketuarve në Shqipëri, dhe me “Jo” 53% e tyre.<sup>1</sup>

## Anketimi i ESS 2012

Një tjetër anketim nga një organizatë ndërkombëtare e huaj është edhe ai i “European Social Survey” (ESS).<sup>2</sup> Edhe në këtë anketim janë bërë disa pyetje që matin fetarinë e njerëzve. Edhe ky anketim tregon një rritje të lehtë të fetarisë krahasuar me anketimin e mëparshëm të 2008. P.sh. pyetjes se sa fetar jeni, në këtë anketim i janë përgjigjur si aspak fetar 4,5% e të anketuarve, ndërkohë që në 2008 ateistët e bindur dhe jo fetarët së bashku bënë 9,2%, për të njëjtën pyetje. Ndërsa nëse marrim në konsideratë vlerën shumë fetar deri tek vlerësimi me 2 i fetarisë, atëherë përqindja e atyre që deklarojnë se janë fetar, pavarësisht nivelit, arrin në 90,6%, pra pothuajse e njëjta vlerë fetarie e deklaruar edhe në anketimin e 2008. Në pyetjen sesa herë merrni pjesë në aktivitetet fetare vihet re një rritje e përgjithshme, që konstatohet nga shumica e përgjithshme e të gjitha niveleve të frekuentimit 63,1%, por edhe nga rënia e përqindjes së atyre që nuk marrin pjesë asnjëherë në aktivitetet fetare nga 41,7% në 2008 në 36,9% në 2012. Megjithatë në

<sup>1</sup> <https://news.gallup.com/poll/142727/religiosity-highest-world-poorest-nations.aspx>

<sup>2</sup> Anketa Sociale Evropiane, (2012). ESS Raundi i 6-të i pyetësorit kryesor. Londër: Qendra për Studime Krahasuese Sociale, City University London. Adresa në web: <https://www.europeansocialsurvey.org/data/country.html?c=albania>

pjesëmarrjen më të shpeshtë vihet re një rënie në disa nga frekuencat e pjesëmarrjes, kështu që nëse i marrim për të sakta këto përqindje në të dy rastet, atëherë mund të themi se edhe pse ka një lloj rritje të pjesëmarrjes në përgjithësi në aktivitetet fetare, kjo nuk është e njëtrajtshme në të gjitha rastet, por ka ulje dhe ngritje, çfarë tregon edhe paqëndrueshmëri për shkaqe edhe arsytet nga më të ndryshmet. Për pyetjen se sa shpesh luteni jashtë aktivitetëve fetare kemi rënie në përgjithësi dhe në shumicën e niveleve të përgjigjes, ku përqindja e atyre që kanë pohuar se nuk luteni asnjëherë jashtë aktivitetëve fetare nga 16,3% në 2008 shkon në 28,6% në 2012.

Nëse shohim fetarinë të ndarë sipas komuniteteve fetare do të vëmë re se në këtë anketim katolikët përgjithësisht shfaqen më fetarët me përqindjen më të lartë të atyre që ndjehen si shumë fetar (58,1%) dhe luten (54,3%), dhe më të ulët të atyre që nuk marrin pjesë asnjëherë në aktivitetet fetare (5,7%). Ndërkohë deklarimi i të qenit aspak fetar është shumë i ulët edhe për të tre komunitet e tjera, por në shpërndarjen e nivelit të fetarisë vihen re disa dallime mes tyre, por gjithësi përqindja më e lartë vihet re tek niveli 10 dhe më i lartë, për myslimanët 43,5%, bektashinjtë 39,7% dhe ortodoksët 35,7%. Pra të habit fakti që edhe pse në përgjithësi në këtë anketim praktikant fetare duket sikur kanë rënie, niveli i të ndjerit fetar është i lartë, dhe pavarësisht niveleve të vlerësimit nga 1 deri tek 10-ta i fetarisë, asnjëri komunitet nuk e arrin 2% e të deklaruarit aspak fetar. Kjo ndjenjë subjektive e të qenit fetar, e cila nuk vihet re të shoqërohet me ndonjë pjesëmarrje të lartë në aktivitetet fetare, duket se është karakteristikë deri diku e qëndrueshme e pjesëmarrësve në këto anketime. Gjithësi vihet re një lloj segmentimi i fetarisë së njerëzve, si për sa i përket ndjekjes së praktikave fetare ashtu edhe për ndjeshmërinë e të qenit fetar, ku brenda të njëjtut komunitet njerëzit shfaqen me nivele të ndryshme fetarie, por që përgjithësisht nis me përqindje të ulët për nivelin më të ulët të fetarisë dhe vjen duke u ngritur deri tek niveli i mesit (5-sa), pas kësaj pike bie deri diku dhe pastaj fillon përsëri të rritet duke arritur te niveli më i lartë, i cili ka edhe përqindjen më të lartë të fetarisë, në shkallën e vlerësimit të fetarisë me 10 pikë, te të katër komunitetet brenda tyre.

Anketimi i ESS 2012											
Pyetja		Gjithsej %	Meshkuj	Femra	Mosha deri 29	Mosha 30-49	Mosha 50 sipër	Mysliman	Bektashi	Ortodoks	Katolik
<b>Përveç rasteve të veçanta, sa herë merrni pjesë në aktivitetet fetare këto ditë</b>	Çdo ditë	1,1	1,5	0,8	0,9	1,9	0,6	1,7	0,9	0,0	1,9
	Më shumë se 1 herë në javë	2,2	3,1	1,5	2,6	2,8	1,7	2,0	1,7	5,2	5,7
	1 herë në javë	8,4	8,6	8,3	7,8	8,3	9,0	7,2	6,9	17,4	25,7
	Së paku 1 herë në muaj	6,4	6,7	6,1	7,8	4,7	6,7	5,5	8,6	8,7	21,0
	Vetëm ditët e festave	28,1	27,7	28,4	27,0	24,9	31,7	29,3	46,6	46,1	28,6
	Më rrallë	16,9	16,8	17,0	20,1	12,1	14,7	19,5	17,2	10,4	11,4
	Asnjëherë	36,9	35,7	37,9	33,7	40,3	35,6	34,8	18,1	12,2	5,7
<b>Sa fetare jeni</b>	Aspak fetar	4,5	4,7	4,3	4,4	3,9	4,4	1,3	1,7	0,9	0,0
	1	1,5	1,6	1,4	1,2	1,7	1,7	0,6	0,0	0,9	0,0
	2	3,1	2,9	3,2	2,9	2,5	3,6	1,1	2,6	0,9	1,0
	3	3,9	5,5	2,6	5,0	3,9	3,1	3,3	1,7	2,6	0,0
	4	3,5	5,3	2,0	3,5	5,0	2,5	4,2	2,6	0,0	0,0
	5	13,3	14,8	11,6	13,7	15,0	11,2	13,3	17,2	18,3	4,8
	6	5,5	6,4	4,8	5,5	5,5	5,5	5,4	3,4	8,7	5,7
	7	8,3	8,6	8,0	11,7	7,8	6,6	8,5	6,9	10,4	14,3
	8	11,6	11,5	11,7	10,8	11,1	12,5	11,8	15,5	14,8	10,5
	9	5,9	3,8	7,7	7,3	4,7	5,9	7,0	8,6	7,0	5,7
Shumë fetar	39,0	34,9	42,5	34,1	39,1	42,9	43,5	39,7	35,7	58,1	
<b>Sa shpesh i luteni jashtë</b>	Çdo ditë	31,8	21,9	40,1	25,3	32,0	36,3	37,1	27,6	38,3	54,3

aktiviteteve fetare	Më > 1 javë	6,5	5,5	7,4	8,4	6,4	5,0	5,7	7,8	13,0	8,6
	1 herë javë	6,8	7,8	5,8	7,6	6,4	6,5	9,0	8,6	6,1	10,5
	Së paku 1 herë muaj	3,2	4,4	2,2	4,7	2,8	2,5	2,2	6,0	3,5	4,8
	Vetëm në ditët e shenjta	10,5	11,9	9,4	10,5	9,7	11,1	10,3	12,1	18,3	13,3
	Më rrallë	12,7	13,5	12,0	16,6	13,3	9,9	12,2	12,9	13,0	7,6
	Asnjëherë	28,6	35,0	23,2	27,0	29,6	28,6	23,4	25,0	7,8	1,0
A përkisni ndonjë grupimi fetar	Po	74,2	74,3	74,2	68,2	74,0	79,5	100	100	100	100
	Jo	25,8	25,7	25,8	31,8	26,0	20,5	0	0	0	0
Diskriminoheni për shkak të fesë		0,6	0,5	0,6	0,9	1,1	0,0	0,7	0,0	0,9	1,0

## Fetaria e ndarë sipas qarqeve të vendit

Duke kryqëzuar të dhënat e pyetjeve që matin fetarinë në anketimin e 2012 me të dhënë për qarqet e anketuesve kemi nxjerrë disa të dhëna të cilat janë pasqyruar në tabelë. Sipas kësaj table përqindjen më të lartë të të ndjerit *shumë fetar* e ka qarku i Lezhës me 65,5%, i pasuar nga ai i Elbasanit me 49,6% dhe në vend të tretë ai i Dibërës me 47,8%. Ndërsa përqindjet më të larta të ndjerit aspak fetar i ka qarku i Vlorës me 13,6%, i ndjekur nga ai i Gjirokastrës me 10,6% dhe ai i Fierit me 7,4%. Për sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes në shërbimet apo aktivitet fetare të përditshme, Kukësi ka përqindjen më të lartë me 6,5% i pasuar nga Shkodra dhe Dibra me 2,2%. Por ndërkohë përqindjen më lartë gjithashtu të mospjesëmarrjes në këto aktivitete e ka përsëri Kukësi me 51,6%, i ndjekur nga Fieri me 50,4% dhe Tirana me 47,2%. Përqindjet tregojnë se një pjesëmarrje deri diku të lartë shfaqet në rastin e festave fetare me një mesatare prej rreth 25%, për të gjitha qarqet të marra në tërësi, me përjashtim të Korçës e cila ka edhe përqindjen më të lartë të frekuentimit të shërbesave fetare me rastin e festave fetare që shkon në masën 56,4% dhe deri diku Gjirokastrës me 38,3%. Ndërsa për pyetjen se sa herë luteni jashtë aktiviteteve fetare qarku i Lezhës del me përqindjen më të lartë të lutjeve ditore me 56,4%, i pasuar nga qarku i Shkodrës me 41,1% dhe ai i Elbasanit me 39,8%. Ndërsa përqindjet më të larta të mospërfshirjes asnjëherë në lutje e kanë qarku i Beratit me 44,4%, i ndjekur nga ai i Fierit me 41,3% dhe ai i Vlorës me 40,8%. Edhe pse brenda këtyre vlerave skajore ka përqindje të ndryshme, që tregojnë për një lloj larmie të fetarisë në këtë drejtim, por gjithsesi vlerat skajore janë edhe më të lartat për këtë pyetje të fundit.

Ajo që nxjerrim në përgjithësi nga këto të dhënat, të cilat më në detaj mund t'i shihni në tabelën përkatëse, është se qarqet e veriut, në veçanti ai Lezhës që është edhe i vetmi qark me një shumicë dermuese katolike, sipas Censurit të 2011, del të jetë edhe më fetari, ndërsa qarqet më pak fetare janë ato të jugut të Shqipërisë. Ndërkohë vihet re se zonat me ndjesi fetarie më të lartë kanë edhe praktikën më të lartë fetare dhe se në disa zona identiteti fetar është shumë më shumë i lidhur me atë kulturor, si p.sh. në raste festash, sesa një besim i rregullt praktikant.

Anketimi i ESS 2012		Berat	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Dibër	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Sa fetar jeni	Aspak	1,6	2,7	2,4	7,4	10,6	3,4	3,3	0,0	0,0	2,2	4,2	13,6
	1	1,6	2,7	0,8	3,3	0,0	0,9	0,0	0,0	0,0	0,0	2,8	0,0
	2	4,8	3,6	3,9	5,8	4,3	0,9	0,0	1,8	0,0	0,0	4,6	1,0
	3	7,9	3,6	3,1	11,6	8,5	0,9	0,0	0,0	0,0	3,3	2,5	4,9
	4	7,9	4,5	3,1	3,3	0,0	3,4	3,3	0,0	0,0	3,3	4,9	1,9
	5	12,7	12,5	7,9	12,4	17,0	16,2	6,7	5,5	23,9	11,1	13,7	16,5
	6	7,9	6,2	6,3	2,5	8,5	3,4	6,7	3,6	6,5	4,4	6,7	4,9

	7	6,3	8,0	5,5	3,3	4,3	8,5	20,0	12,7	8,7	15,6	8,1	8,7
	8	7,9	12,5	11,8	14,0	8,5	14,5	10,0	7,3	8,7	12,2	10,9	13,6
	9	4,8	6,2	5,5	4,1	2,1	15,4	3,3	3,6	4,3	4,4	6,7	1,9
	Shumë fetar	36,5	37,5	49,6	32,2	36,2	32,5	46,7	65,5	47,8	43,3	34,9	33,0
Sa herë merrni pjesë në shërbimet fetare	Çdo ditë	0,0	0,9	1,6	0,0	2,1	0,9	6,5	1,8	2,2	2,2	0,7	0,0
	Më se 1 herë në javë	1,6	1,8	0,0	0,0	4,3	6,0	6,5	7,3	2,2	2,2	1,7	1,0
	1 herë në javë	1,6	5,3	7,8	1,7	4,3	12,0	0,0	29,1	8,7	24,4	4,2	11,5
	1 herë në muaj	7,9	6,2	4,7	6,6	12,8	1,7	0,0	16,4	6,5	16,7	4,5	2,9
	Vetëm në rast festash	19,0	28,3	28,1	27,3	38,3	56,4	29,0	18,2	28,3	26,7	20,3	25,0
	Më rrallë	30,2	20,4	17,2	14,0	10,6	11,1	6,5	16,4	15,2	8,9	21,3	16,3
	Asnjëherë	39,7	37,2	40,6	50,4	27,7	12,0	51,6	10,9	37,0	18,9	47,2	43,3
Sa herë luteni	Çdo ditë	15,9	33,9	39,8	21,5	23,4	29,1	32,3	56,4	39,1	41,1	33,9	17,5
	Më se 1 herë në javë	4,8	7,1	5,5	2,5	2,1	10,3	9,7	9,1	2,2	8,9	7,0	6,8
	1 herë në javë	6,3	5,4	3,9	4,1	10,6	7,7	0,0	9,1	6,5	18,9	5,2	6,8
	1 herë në muaj	3,2	1,8	4,7	3,3	2,1	0,9	0,0	5,5	4,3	4,4	4,5	0,0
	Vetëm në rast festash	7,9	8,0	10,	10,7	14,9	25,6	3,2	9,1	4,3	10,0	6,6	11,7
	Më rrallë	17,5	12,5	7,8	16,5	6,4	15,4	19,4	3,6	13,0	7,8	13,3	16,5
	Asnjëherë	44,4	31,2	27,3	41,3	40,4	11,1	35,5	7,3	30,4	8,9	29,4	40,8
A i përkisni ndonjë grupi fetar	Po	77,8	70,5	67,2	71,1	72,3	87,2	87,1	89,1	82,6	94,4	69,9	53,8
	Jo	22,2	29,5	32,8	28,9	27,7	12,8	12,9	10,9	17,4	5,6	30,1	46,2

## Fetaria dhe arsimi

Nga anketimi i 2012 mund të nxjerrim edhe lidhjen mes të qenit fetar dhe nivelit të arsimit. Nga tabela bie në sy përgjithësisht se të anketuarit me arsim më të ulët shfaqen edhe me nivel më të lartë fetar. Megjithatë nuk përjashtohen nga fetaria edhe ata me arsim të lartë dhe madje me arsim pas universitar, me mastër dhe doktoratë, por në dy rastet e fundit duke qenë numri i tyre shumë i vogël (3 vetë) nuk mund të merret si numër përfaqësues i kësaj kategorie. Gjithsesi duket se kjo kategori bashkë me niveli universitar kanë një përqindje të konsiderueshme frekuentimi në raste fetash fetare, por e përgjithshmeja ngelet që ata me arsim më të lartë kanë edhe fetari më të ulët.

Anketimi i ESS 2012		Pa shkollë	Shkollë fillore	Shkollë 8/9 vjeçare	Shkollë e mesme gjimnaz	Shkollë e mesme prof (2 vjeçare)	Shkollë e mesme prof (mbi 2 vjet)	Shkollë e lartë jouniversit	Bachelor	Master profesion	Shkollë pasuniver	Master artesh	Master shkenc	Specializim afatgjatë	Phd
I përkisni një grupimi fetar	Po	77,3	83,6	76,3	69,8	71,8	72,3	68,4	73,2	57,1	85,7	100	72,2	100	50
	Jo	22,7	16,4	23,7	30,2	28,2	27,7	31,6	26,8	42,9	14,3	0,0	27,8	0,0	50
Sa fetar jeni	Aspak	9,1	5,5	4,6	5,6	2,6	1,8	2,6	4,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0
	1	0,0	1,6	1,0	1,4	0,0	2,7	7,9	0,0	7,1	14,3	0,0	0,0	0,0	0
	2	0,0	1,6	1,7	3,5	0,0	4,5	13,2	4,2	7,1	0,0	0,0	11,1	0,0	0

	3	0,0	3,1	3,4	3,8	2,6	6,3	2,6	7,3	0,0	0,0	0,0	5,6	0,0	0
	4	4,5	0,8	2,9	4,2	5,1	7,2	5,3	2,1	7,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0
	5	4,5	7,0	12,4	13,3	12,8	17,1	21,1	15,6	21,4	14,3	0,0	22,2	0,0	0
	6	0,0	5,5	6,1	3,8	5,1	4,5	7,9	4,2	14,3	28,6	0,0	16,7	0,0	0
	7	4,5	3,9	6,1	10,8	15,4	5,4	7,9	17,7	14,3	0,0	50,0	0,0	0,0	0
	8	4,5	10,2	10,7	13,6	12,8	12,6	5,3	13,5	7,1	28,6	50,0	5,6	0,0	50
	9	4,5	6,2	6,1	6,3	10,3	4,5	0,0	9,4	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0
	Shumë	68,2	54,7	45,1	33,6	33,3	33,3	26,3	21,9	21,4	14,3	0,0	38,9	100	50
Sa herë merrni pjesë në aktivitetet fetare	Çdo ditë	4,5	0,8	1,4	1,0	0,0	0,0	0,0	2,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0
	<1 herë në javë	0,0	3,1	2,4	2,1	5,1	1,8	2,6	1,0	0,0	0,0	0,0	5,6	0,0	0
	1 herë në javë	18,2	8,6	10,9	8,0	2,6	5,4	0,0	9,3	0,0	0,0	0,0	5,6	0,0	50
	1 herë në muaj	0,0	8,6	7,0	5,6	5,1	8,0	5,3	4,1	7,1	0,0	0,0	5,6	0,0	0
	ditë festash	36,4	31,2	25,4	27,4	25,6	25,0	31,6	35,1	14,3	42,9	100	38,9	100	0
	më rrallë	9,10	12,5	16,2	17,0	23,1	13,4	28,9	22,7	28,6	14,3	0,0	22,2	0,0	50
	asnjëherë	31,8	35,2	36,7	38,9	38,5	46,4	31,6	25,8	50,0	42,9	0,0	22,2	0,0	0
Sa herë luteni	Çdo ditë	45,5	42,5	32,4	30,2	33,3	30,4	15,8	30,9	28,6	0,0	0,0	22,2	0,0	50
	<1 herë në javë	13,6	6,3	4,6	8,7	0,0	4,5	7,9	9,3	21,4	0,0	0,0	11,1	0,0	0
	1 herë në javë	13,6	8,7	6,8	6,9	2,6	5,4	2,6	5,2	0,0	14,3	50,0	5,6	0,0	0
	1 herë në muaj	0,0	1,6	3,9	3,5	2,6	3,6	0,0	2,1	0,0	14,3	0,0	5,6	0,0	0
	ditë festash	9,1	8,7	13,1	8,7	15,4	10,7	10,5	7,2	0,0	14,3	0,0	5,6	0,0	0
	më rrallë	9,1	6,3	12,1	11,5	10,3	12,5	18,4	22,7	14,3	14,3	50,0	33,3	0,0	50
	asnjëherë	9,1	26,0	27,1	30,6	35,9	33,0	44,7	22,7	35,7	42,9	0,0	16,7	100	0

## Anketimi i Gallup International i 2016

Ky anketim është zhvilluar në 66 vende të botës gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2016,<sup>1</sup> ku edhe në këtë rast kampioni përfaqësues ishte 1000 persona, burra dhe gra, të cilët janë intervistuar drejtpërdrejtë dhe në mënyra të tjera.<sup>2</sup> Nuk kam mundur të gjej të dhëna të detajuara për këtë anketim përveç pyetjes që jep edhe burimi i poshtëshënuar: *A e miratoni ose jo pohimin se disa fe janë më superiore se të tjerat?* Në rastin e Shqipërisë sipas këtij anketimi 15,9 % e miratojnë me forcë këtë pohim, 28,1% thjesht e miratojnë, ndërsa 18,3% nuk e miratojnë dhe 25,4% e të anketuarve nuk e miratojnë atë me forcë. Ndërsa 12,2% janë përgjigjur nuk e di, ose nuk kanë dhënë përgjigje.

<sup>1</sup> [https://www.gallup-international.com/wp-content/uploads/2017/11/2016\\_Religion\\_Race\\_Culture.pdf](https://www.gallup-international.com/wp-content/uploads/2017/11/2016_Religion_Race_Culture.pdf)

<sup>2</sup> Sipas të njëjtit burim në 25 vende anketimi është kryer drejtpërdrejtë, me telefon në 13 vende, në 25 të tjerë me internet dhe 3 të mbetur me metodë mikse.

## Anketimi i EVS 2017

European Values Study ka realizuar në 2017 një tjetër anketim në Shqipëri, <sup>1</sup>ku edhe në të janë përfshirë një larmi pyetjesh zbuluese për fetarinë e njerëzve. Në këtë anketim ata që besojnë në Zot del të jenë 97,2%. Ndërsa pyetjes sesa është feja e rëndësishme në jetë 72% i janë përgjigjur pozitivisht se ajo është e rëndësishme, ndërsa vetëm 11,3% i janë përgjigjur se nuk është e rëndësishme. Në këtë anketim bie në sy përqindja e ulët e atyre që pohojnë se janë pjesë e organizatave fetare (2,8%). Ndërkohë si edhe në anketimin e 2008 nga e njëjta organizatë është drejtuar përsëri pyetja: *Sa shpesh keni marrë pjesë në shërbimet fetare kur keni qenë 12 vjeç?* Dhe nëse krahasojmë përqindjet përkatëse me ato të pyetjes se sa herë merrni pjesë në aktivitetet fetare sot, përveç rasteve të veçanta, konfirmohet si në rastin e parë se pjesëmarrja në këto aktivitete është më e lartë sot, gjatë kohës së anketimit, sesa kur të anketuarit ishin fëmijë. Kjo konfirmon edhe një herë faktin se frekuentimi i aktiviteteve fetare dhe fetaria e sotme në përgjithësi e shqiptarëve nuk është thjesht produkt i trashëgimisë familjare, por i fituar edhe në vitet e tranzicionit, në dallim me përkatësinë fetare, e cila ruhet përgjithësisht nga trashëgimia familjare. Pyetjes *Sa fetar ndjeheni* 81,1% i janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa vetëm 2,7% pohojnë se janë ateistë të bindur, ndërkohë pjesa tjetër e mbetur, 16,2% përgjigjen se nuk janë fetar. Ndërkohë nëse e krahasojmë pjesëmarrjen në aktivitet fetare me anketimin e 2012, vëmë re rënie në të gjitha nivelet e frekuentimit, me përjashtim të festave fetare (39,3%) ku duket se është edhe përqendruar më shumë pjesëmarrja dhe ka rritje. Në këtë anketim pyetjes sesa shpesh luteni jashtë aktiviteteve fetare 69% e të anketuarve e kanë pohuar dhe 11,1 % thonë se asnjëherë, pjesa tjetër luten në intervale të ndryshme kohe. Edhe në këtë rast konfirmohet fakti se fetaria në mesin e sotëm të shqiptarëve ka më tepër natyrë private dhe individuale. Gjithashtu rëndësia e Zotit në jetë mbetet e lartë ku vetëm 2,5% mendojnë se nuk ka aspak rëndësi dhe 78,8% e vlerëson rëndësinë e Zotit në jetë me pikën maksimale si shumë të rëndësishëm. Edhe koncepti për Zotin duket se ka ndryshuar dukshëm në favor të besimeve tradicionale, ku në këtë anketim 80,1% besojnë në një Zot personal dhe 10,7% se kanë zgjedhur si më pranë besimit të tyre pohimin se ka një shpirt ose forcë jete.

Duke iu referuar komuniteteve fetare 85,5% e katolikëve dhe 82,2% e myslimanëve e vlerësojnë Zotin si shumë të rëndësishëm në jetë, ndërsa tek ortodoksët ky vlerësim maksimal shkon në 67,8% e tyre dhe te bektashinjtë në 65,8%. Edhe në këtë anketim vihet re në përgjithësi një fetarizëm më i lartë i katolikëve, i pasuar nga ai i myslimanëve dhe më pas ai i ortodoksëve. Natyrisht këto janë konstatime deri diku të kufizuara nga anketimet, dhe nuk janë të njëtrajtshme në të gjithë territorin e vendit, por gjithsesi ky është një përgjithësim që mendojmë se është përafërsisht i pranueshëm.

Kjo ishte një panoramë e përmbledhur e anketimeve ndër vite që mundëm të mbledhim, ndërkohë për një vështrim më të detajuar mund të shihen tabelat përkatëse që kemi përpiluar nga të gjitha këto anketime.

---

<sup>1</sup> Gedeshi, Ilir, Kritzing, Sylvia, Poghosyan, Gevorg, Rotman, David, Pachulia, Merab, Fotev, Georgy, Kolenović-Đapo, Jadranka, . . . (2020). European Values Study 2017: Integrated Dataset (EVS 2017). GESIS Data Archive, Cologne. ZA7500 Data file Version 3.0.0, <https://doi.org/10.4232/1.13511>.

EVS 2017

EVS 2017											
Pyetja		Gjithsej %	Meshkuj	Femra	Mosha deri 29	Mosha 30-49	Mosha 50 sipër	Mysliman	Bektashi	Katolik	Ortodoks
Besoni në Zot	Po	97,2	95,6	98,1	96,8	99,0	96,3	98,4	96,2	99,3	94,6
	Jo	2,8	4,4	1,9	3,2	1,0	3,7	1,6	3,8	0,7	5,4
Besoni se do të rilindim në këtë botë përsëri	Po	11,9	11,2	12,4	12,5	13,7	10,4	10,4	6,4	25,0	10,0
	Jo	88,1	88,8	87,6	87,5	86,3	89,6	89,6	93,6	75,0	90,0
Rëndësia fesë në jetë	Shumë e rëndësishme	23,8	23,7	23,8	24,8	20,6	26,0	23,3	7,7	52,6	21,5
	Mjaft e rëndësishme	48,2	49,0	47,8	42,5	49,5	50,3	49,9	52,6	39,4	58,1
	Jo shumë e rëndësishme	16,7	15,9	17,2	19,4	18,8	13,5	16,4	23,1	5,1	14,0
	Aspak e rëndësishme	11,3	11,4	11,2	13,3	11,1	10,3	10,5	16,7	2,9	6,5
Edukim fetar i fëmijëve i rëndësishëm		18,4	18,7	18,3	22,1	18,6	16,6	18,2	12,5	34,1	14,9
Anëtarë në organizata fetar		2,8	2,3	3,1	3,5	3,7	1,8	2,2	2,5	6,5	3,2
Cili pohim qëndron më pranë besimeve tuaja	Ka një Zot personal	80,1	79,8	80,3	70,1	78,5	86,5	84,5	74,4	80,3	72,0
	Ka një shpirt ose forcë e jetës	10,7	10,5	10,9	14,5	12,8	7,2	7,4	16,7	15,3	18,3
	Nuk e di	6,4	5,4	7,0	12,2	6,5	3,6	6,5	5,1	3,6	6,5
	Nuk ka shpirt, Zot ose forcë jete	2,7	4,3	1,8	3,3	2,1	2,8	1,7	3,8	0,7	3,2
Sa shpesh keni marrë pjesë në shërbimet fetare kur keni qenë 12 vjeç	Më >1 herë në javë	1,6	1,3	1,8	3,6	1,5	0,8	1,2	0,0	3,8	2,2
	1 herë në javë	4,4	4,6	4,3	9,7	4,0	2,1	2,8	1,2	19,5	4,4
	1 herë në muaj	1,7	2,1	1,5	2,9	1,5	1,3	1,1	1,2	6,0	2,2
	Vetëm në festa	11,7	10,4	12,4	19,4	11,7	7,9	11,4	10,0	15,8	15,4
	1 herë në vit	1,3	1,2	1,5	1,9	1,0	1,1	1,3	2,5	0,0	3,3
	Shumë më rrallë	2,5	2,5	2,5	1,9	2,5	2,6	2,2	3,8	1,5	3,3
	Asnjëherë	76,8	77,8	76,1	60,5	77,8	84,2	80,0	81,2	53,4	69,2
Përveç dasmave, funeraleve dhe pagëzimeve, sa herë merrni pjesë në aktivitetet fetare këto ditë	Më >1 herë në javë	2,1	2,5	1,9	2,5	1,7	2,2	1,7	1,2	3,6	3,2
	1 herë në javë	6,3	6,1	6,5	6,3	7,3	5,6	4,1	1,2	24,8	8,5
	1 herë në muaj	5,4	6,8	4,6	4,1	4,2	7,1	3,7	5,0	19,7	7,4
	Vetëm në festa	39,3	39,3	39,4	38,7	39,5	39,6	38,9	42,5	43,1	67,0
	1 herë në vit	2,4	3,4	1,8	3,2	1,9	2,2	2,3	7,5	0,0	2,1
	Shumë më rrallë	2,3	3,0	1,9	2,5	2,1	2,4	2,3	2,5	2,2	3,2
	Asnjëherë	42,1	38,9	44,0	42,5	43,5	40,8	47,1	40,0	6,6	8,5
Sa fetar jeni	Person fetar	81,1	77,2	83,4	78,2	81,4	82,5	83,6	76,9	95,6	79,6
	Person jofetar	16,2	19,8	14,1	19,5	16,7	14,1	15,6	17,9	2,9	18,3
	Ateist i bindur	2,7	3,1	2,5	2,3	1,9	3,4	0,8	5,1	1,5	2,2
Besoj te jeta pas vdekjes	Po	27,4	26,2	28,2	33,0	29,9	22,9	27,7	12,3	42,0	19,5
	Jo	72,6	73,8	71,8	67,0	70,1	77,1	72,3	87,7	58,0	80,5
A i përkisni një grupimi fetar	Po	94,1	94,7	93,7	92,1	94,2	95,2	100	1000	100	100
	Jo	5,9	5,3	6,3	7,9	5,8	4,8	0	0	0	0
Beson te ferri	Po	27,5	25,2	28,9	34,6	27,4	24,1	28,4	10,8	45,0	17,3
	Jo	72,5	74,8	71,1	65,4	72,6	75,9	71,6	89,2	55,0	82,7
Besojnë në parajsë	Po	33,0	29,4	35,2	39,2	34,8	28,8	34,9	13,6	49,1	21,0
	Jo	67,0	70,6	64,8	60,8	65,2	71,2	65,1	86,4	50,9	79,0
Rëndësia e Zotit në jetë	Aspak	2,5	4,0	1,75	3,9	1,2	2,6	1,5	3,8	0,7	4,6
	2	0,3	0,4	0,2	0,0	0,6	0,2	0,2	0,0	0,7	0,0
	3	0,6	0,8	0,6	0,3	0,8	0,6	0,5	0,0	0,0	1,1
	4	0,5	0,2	0,7	0,6	0,4	0,5	0,3	1,3	0,0	0,0
	5	3,7	5,5	2,6	5,1	3,1	3,4	3,1	5,1	2,2	6,9
	6	1,7	2,3	1,3	2,3	1,5	1,6	1,4	0,0	2,2	4,6
	7	3,3	4,8	2,4	3,2	2,9	3,5	2,5	13,9	2,2	2,3
	8	4,5	4,2	4,7	4,5	5,0	4,2	4,7	3,8	1,4	5,7
	9	4,1	4,0	4,1	6,8	3,8	3,1	3,7	6,3	5,1	6,9
	Shumë	78,8	73,8	81,7	73,3	80,6	80,3	82,2	65,8	85,5	67,8
Sa shpesh i luteni jashtë aktiviteteve fetare	Çdo ditë	69,0	58,6	75,1	63,1	70,2	71,2	72,1	57,7	78,3	52,1
	Më > 1 javë	7,3	8,4	6,7	9,9	7,7	5,8	7,3	9,0	8,0	6,4
	1 herë javë	4,3	6,3	3,1	5,8	4,4	3,5	4,4	5,1	1,4	7,4
	1 herë muaj	2,5	3,3	2,1	3,2	2,5	2,2	2,1	3,8	4,3	5,3
	Disa herë vit	2,1	3,8	1,1	1,9	1,7	2,6	1,2	3,8	1,4	7,4
	Më rrallë	3,6	4,4	3,1	3,8	2,7	4,2	3,1	5,1	2,2	9,6
	Kurrë	11,1	15,1	8,8	12,2	10,8	10,6	9,9	15,4	4,3	11,7
Sa besim keni te institucioni fetar	Shumë	17,8	17,4	18,0	19,3	16,5	18,2	17,6	8,8	32,8	18,3
	Mjaftueshëm	33,4	34,1	33,0	27,0	32,3	37,5	34,4	30,0	42,3	34,4
	Jo shumë	31,6	29,2	33,0	34,1	31,6	30,3	32,3	42,5	19,7	32,3
	Aspak	17,2	19,3	15,9	19,6	19,6	14,0	15,7	18,8	5,1	15,1
Sa krenar jeni që jeni	Shumë krenar	79,1	80,7	78,1	66,7	75,1	88,7	80,6	82,5	79,7	74,7

qytetar shqiptar	Mjaft krenar	15,9	14,6	16,6	25,4	18,5	8,7	15,2	13,8	13,0	15,4
	Jo shumë krenar	4,3	4,2	4,4	6,7	5,4	2,3	3,7	3,8	5,8	7,7
	Aspak krenar	0,8	0,6	0,9	1,3	1,0	0,3	0,5	0,0	1,4	2,2
Sa i besoni njerëzve të feve të tjera	U besoj plotësisht	10,5	11,4	10,0	8,6	9,1	12,6	9,8	7,9	17,4	13,8
	U besoj deri diku	37,0	39,8	35,3	41,7	34,1	36,5	35,3	47,4	37,9	41,4
	Nuk u besoj shumë	30,8	27,9	32,5	29,1	31,3	31,2	31,7	28,9	25,8	31,0
	Nuk u besoj fare	21,7	20,9	22,2	20,5	25,5	19,6	23,2	15,8	18,9	13,8

## Rinia dhe besimi fetar

Anketimet e mësipërme përfshijnë mbarë popullsinë në moshë madhore, ku përfshihet edhe rinia në të. Ndërkohë duke qenë se fondacioni “Friedrich Ebert” ka zhvilluar disa anketime të veçanta për të rinjtë mes viteve 2011-2019 i kam ndarë ato veç. Këto anketime përfshijnë të rinjtë nga moshë 14-29 vjeç, dhe disa nga pyetjet e drejtuara kanë qenë edhe ato që matin fetarinë e tyre. Në dallim me anketimet e mësipërme këtu të dhënat më duhet t’i paraqes nga përfundimet dhe interpretimet e burimit referues, çfarë më kufizon në një masë të madhe në interpretimin e tyre, sepse në mjaft raste nuk jepen të gjitha të dhënat në tabela, ku të pasqyrohen përqindjet për çdo përgjigje, por ato shpesh dalin të pjesshme pa pasur mundësi të shohë edhe përqindjet e përgjigjeve të tjera.

### Besimi në Zot te të rinjtë

Nga anketimi i 2011 del se vetëm 2% e të rinjve janë përgjigjur se janë ateistë.<sup>1</sup> Ndërsa nga anketimi i 2015 del gjithashtu se vetëm 2 % thonë se nuk praktikojnë ndonjë fe të caktuar dhe 1,2 % se janë ateistë.<sup>2</sup> Pjesa tjetër, besojnë në Zot, që e lidhin kryesisht me besimet tradicionale fetare apo edhe besime të tjera. Sipas këtyre të dhënave del edhe një herë qartë se besimi në Zot është në përqindje më të larta në brezin e ri, në krahasim me brezat e edukuar në periudhën komuniste.

### Rëndësia e besimit te të rinjtë

Të pyetur mbi rëndësinë që ka Zoti në jetën e të rinjve, në anketimin e 2018-2019, 62 % e tyre thonë se ka shumë rëndësi. Këtë e pohojnë mbi 70 % e femrave dhe 56 % e meshkujve. 9 % e të rinjve i japin Zotit njëfarë rëndësie në jetën e tyre, ndërkohë që 3–4 % nuk e vlerësojnë fare këtë gjë.<sup>3</sup>

### Praktikimi i fesë nga të rinjtë

Të rinjtë që deklarojnë se nuk praktikojnë asnjë fe, janë pak. Shumica e të rinjve e identifikojnë veten me një nga besimet tradicionale në vend; megjithatë, kjo nuk tregon domosdoshmërisht shpeshësinë e praktikimit të rriteve fetare.<sup>4</sup> Nga të rinjtë e anketuar në 2011, 16,5% janë shprehur se nuk praktikojnë asnjë fe, por nuk janë deklaruar si ateistë. Kjo përqindje rritet në Tiranë, ku rreth 22% thonë se nuk praktikojnë asnjë fe. Edhe në këtë rast vihet re dallimi mes dy gjinive, ku 1/5 e meshkujve deklaron se nuk praktikon asnjë fe, ndërsa mes femrave kjo shifër është dy herë

<sup>1</sup> Albanian Youth 2011. f.35.

<sup>2</sup> Rinia Shqiptare 2015. f.20.

<sup>3</sup> Rinia Shqiptare 2018-2019. f. 21.

<sup>4</sup> Albanian Youth 2011. f. 12.



më pak.<sup>1</sup> Edhe në 2015 shkalla e identifikimit të të rinjve me fetë tradicionale ishte e lartë, mbi 95 % gjithsej, shprehen që i përkasin një feje të caktuar, por ndërkohë niveli i praktikimit të fesë nga ana e tyre është i ulët, i kufizuar kryesisht gjatë festave kryesore fetare 2-3 herë në vit.<sup>2</sup> Anketimi i 2015 tregon se shumica e të rinjve, rreth 61% e tyre, e praktikojnë fenë vetëm në rastet e festave fetare, ndërsa 23% pohojnë se nuk e praktikojnë asnjëherë atë.<sup>3</sup> Vetëm 11% e të rinjve e praktikojnë fenë një ose dy herë në javë dhe një grup shumë i vogël prej 5 % janë praktikantë të përditshëm të fesë së tyre. Kjo shifër rezulton të jetë pak më e lartë sesa mesatarja e përgjithshme e popullsisë, e pasqyruar në anketimet e mësipërme. Kështu që edhe të rinjtë në Shqipëri në përgjithësi, ashtu si edhe të rriturit nuk janë praktikantë të rregullt të fesë, por kujtohen më së shumti në rastet festave fetare.<sup>4</sup> Nga të anketuarit, sipas burimit, vetëm një pjesë e vogël e të rinjve pohojnë se vizitojnë shpesh vendet e kultit. Shumica ndërkohë pretendon se e bëjnë një gjë të tillë shumë rrallë, ose nuk e kanë bërë kurrë. Anketimi gjithashtu tregon se rreth 4 në 5 të rinj të intervistuar praktikojnë fetë e tyre vetëm gjatë festave fetare.<sup>5</sup>

Në anketimin e vitit 2018-2019 “më shumë sesa 62 % e të rinjve, kur pyeten a identifikohen me një nga besimet kryesore fetare në vend, ata pranojnë se Zoti ka një vend të rëndësishëm në jetën e tyre.<sup>6</sup> Megjithatë, në rininë shqiptare, feja është ende një element identifikimi dhe ndjesish shpirtërore, tradicionale e familjare se sa një set praktikash dhe ritualesh. Më pak se sa 15 % e të rinjve ndjekin rregullisht ritet fetare.”<sup>7</sup> Ndërkohë 30 % e të rinjve thonë se nuk i ndjekin kurrë, ndërkohë që një tjetër grup prej 17 % thonë se i ndjekin maksimumi një herë në vit. Një e treta e të rinjve, rreth 34 %, i ndjek ritet fetare dhe viziton vendet përkatëse me rastin e festave kryesore fetare, ndërkohë që vetëm 12 % i ndjek shërbimet dhe ritet fetare rregullisht çdo javë.<sup>8</sup> Ndërkohë vihet re se niveli i fetarisë te femrat është më i lartë se te meshkujt dhe po kështu në zonat rurale dhe në veri është më i lartë sesa në ato urbane dhe në jug dhe në zonën e mesme. Anketuesit paraqesin këtë tabelë:<sup>9</sup>

---

<sup>1</sup> F.35, Albanian Youth 2011.

<sup>2</sup> F.10 Rinia Shqiptare 2015.

<sup>3</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.20.

<sup>4</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.34.


<sup>5</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.191.

<sup>6</sup> Kështu janë shprehur autorët e studimit, duke e bërë deri diku të paqartë përgjigjen dhe përzierë dy përgjigje në një.

<sup>7</sup> Rinia Shqiptare 2018-2019, f. 17.

<sup>8</sup> Rinia Shqiptare 2018-2019, f. 21, 23.

<sup>9</sup> Rinia Shqiptare 2018-2019, f. 22.



Siç shihet edhe nga tabela Zoti zë një pjesë të rëndësishme në jetën e të rinjve shqiptarë dhe në të gjitha nënndarjet përqindja e vlerësimit është relativisht e lartë, megjithatë siç e vunë në dukje më sipër edhe autorët e studimit, diferenca më e madhe vihet re mes fetarisë së të rinjve në veri dhe atyre në juglindje, ku këta të fundit rezultojnë më pak fetar.

Të pyetur rreth prindërve, 48 % e të rinjve thonë se prindërit e tyre janë mesatarisht ose dhe shumë fetarë ndërkohë që 23 % thonë se feja e prindërve është në nivel të moderuar. Rreth 28 % thonë se prindërit nuk janë fetarë.<sup>1</sup>


### Sa herë luten të rinjtë

Një e treta e të rinjve në anketim thonë se ata luten çdo ditë ose, të paktën, disa herë në javë. Një pjesë tjetër, prej 30 % luten me raste. Sipas anketimit, vajzat luten më shpesh se djemtë. Ndërkohë të diplomuarit në universitet duket se luten më shpesh.<sup>2</sup> 18% luten shumë shpesh, 15% luten shpesh, 14% me raste, 21% rrallë, 32% kurrë.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> F.23 Rinia Shqiptare 2018-2019.

<sup>2</sup> F. 10, Rinia Shqiptare 2018-2019.

<sup>3</sup> F. 10, Rinia Shqiptare 2018-2019.



## Puna vullnetare që motivohet nga feja tek të rinjtë

Të rinjtë në këto anketime u pyetën nëse ata kishin marrë pjesë në ndonjë aktivitet vullnetar gjatë 2010 dhe vetëm 16% e tyre e pohuan këtë, nga këta vetëm 2,6 % ishin ata që ishin inkurajuar për këtë nga besimi i tyre fetar.<sup>1</sup>

## Të diskriminuar për shkak të fesë tek të rinjtë

Shumica e të rinjve të anketuar, 82%, shprehen se nuk janë ndjerë kurrë të diskriminuar për shkak të fesë së tyre, dhe 9% se janë ndjerë rrallë, 6% ndonjëherë, dhe vetëm 2% se janë ndjerë shpesh.<sup>2</sup>

## Besueshmëria e udhëheqësve fetar tek të rinjtë

Edhe pse ka një rigjallërim të besimeve fetare, duket se në përgjithësi, të rinjtë nuk kanë besim tek udhëheqësit fetarë. Vlera mesatare e besimit tek kjo kategori është 3,78 nga 10. Pra 40 % e të anketuarve raportojnë se nuk kanë besim te udhëheqësit fetarë, ndërsa vetëm 8% raportojnë se kanë besim të plotë tek ata.<sup>3</sup> Ndërkohë duket se kjo shifër është rritur në anketimin e 2015 ku të rinjtë shfaqin një nivel besimi pak më të mirë me 45 pikë, nga 100 maksimalet.<sup>4</sup> Kështu që përkundrejt të tjerëve, të rinjtë shprehin një shkallë më të lartë besimi ndaj liderëve fetarë, me 18%, se u besojnë shumë atyre, 23% disi, 24% pak, dhe 32% nuk u besojnë aspak.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Albanian Youth 2011, f.37.

<sup>2</sup> Albanian Youth 2011, f.43.

<sup>3</sup> Albanian Youth 2011, f.34.

<sup>4</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.21.

<sup>5</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.162.

Nëse e përballim këtë shifër të ulët të besimit tek udhëheqësit fetar me përqindjen e lartë të besimit në Zot dhe identifikimit me përkatësitë e ndryshme fetare, mund të arrijmë lehtë në përfundimin se besimi fetar te të rinjtë është tepër individualist dhe nuk lidhet shumë me institucionet fetare dhe as përfaqësuesit e tyre.

### **Toleranca fetare tek të rinjtë**

Një element i dukshëm që karakterizon fetarinë tek shqiptarët e sotëm është edhe toleranca fetare.

Është folur gjatë dhe vazhdon të flitet për këtë çështje, të cilës i janë kushtuar edhe studime dhe monografi të ndryshme, ndaj nuk kemi ndërmend të qëndrojmë gjatë në të, vetëm se para se të cekim disa nga elementët që tregojnë anketimet në këtë drejtim për të rinjtë, do të vëmë në dukje përmbledhtazi disa elementë që ndonjëherë anashkalohen rreth kësaj çështje.

Së pari, toleranca fetare ndër shqiptarët është përgjithësisht diçka e qëndrueshme dhe historikisht nuk ka pasur luftë apo konflikte fetare me bazë të gjerë shoqërore, të tilla që do të vinin në rrezik ekzistencën e kombi shqiptar, apo do të cenonin seriozisht vazhdimësinë e paqes sociale mes tyre.

Së dyti, toleranca fetare mes shqiptarëve është fryt i një kombinimi të rrethanave historike, kulturore, gjeografike, sociale dhe etnike të shqiptarëve.

Së treti, nuk është i vërtetë miti se shqiptarët janë më pak fetar sesa njerëzit e tjerët, aq sa disa gati sa nuk e përshkruajnë këtë si një element gjenetik të shqiptarëve. Shqiptarët janë si gjithë të tjerët në këtë drejtim dhe fetaria e tyre e ulët ose e lartë është ndikuar nga rrethanat historike dhe sociale në të cilat ata janë gjendur. Nga këtu mund të themi se nuk mund të bëhen përgjithësime të nivelit absolut apo shumë afër tij kur flitet për shqiptarët në përgjithësi, ndërkohë që për arsye historike, sociale dhe gjeografike shqiptarët janë të ndarë në sub-kultura të ndryshme që kanë ndikuar në fetarinë e ulët apo të lartë të zonave të caktuara të trojeve shqiptare. Kështu p.sh. edhe siç ky studim konstaton, zona veriore e Shqipërisë apo gegët në përgjithësi shfaqin një fetarizëm më të lartë sesa jugorët, apo toskët në përgjithësi. Por kjo nuk është absolute, pasi si në veri edhe në jug ekzistojnë zona apo xhepa, ku fetaria është më e lartë apo më e ulët dhe faktorë të ndryshëm dhe të shumtë janë ata që kanë ndikuar në këtë drejtim, si p.sh. ekzistenca apo mungesa e një objekti kulturi, prezenca ose jo e një kleriku aktiv apo pasiv në x fshat...etj. Kështu që toleranca fetare nuk mundet t'i atribuohet tërësisht apo kryesisht fetarisë së ulët të shqiptarëve, që gjithsesi padyshim ka rolin e vetë në këtë drejtim.

Së katërti, shqiptarët përkatësinë fisnore dhe etnike e kanë pasur të fortë dhe të lidhur gjithashtu me gjuhën, kështu që feja edhe pse në mjaft raste ka dalluar mes pjesëtarëve të një familje, fisi apo krahine, ajo nuk ka shkaktuar krisje identitare të atillë sa të çojë në konflikte dhe armiqësi. Është e vërtetë se në shumicën e rasteve nuk ka pasur martesë të përziera fetare, por kjo nuk ka ndodhur vetëm për shkak të ndryshimit të fesë, por edhe për shkak të një tradite të fortë lokale që nuk e lehtësonte përzierjen martesore.

Së pesti, rrallë përmendet se toleranca në thelb është cilësi e më të fortit dhe më të shumtit në numër, është pikërisht ai që toleron ekzistencën e pjesës tjetër dhe ai që garanton vazhdimësinë e kësaj tolerance. Dhe padyshim këtu e kam fjalën për myslimanët, të cilët kanë qenë garantët e kësaj tolerance mes shqiptarëve. Mjafton si shembull tepër domethënës se çfarë ndodhi me

myslimanët e Ballkanit, gjatë formimit të shteteve kombe në të dhe largimit të osmanëve prej tij. Sipas historianit demograf amerikan Justin McCarthy myslimanët në Ballkan nën shtetin osman përbënin një shumicë të lehtë të popullsisë në të, e megjithatë të dhënat nga luftërat ballkanike tregojnë se “në Ballkanin Qendror dhe Perëndimor, 27% e myslimanëve kanë vdekur dhe 35% e tyre kanë marrë arratinë. Shqiptarët pësuan një vdekshmëri që ishte, të paktën po aq e madhe.”<sup>1</sup> Shtetet kombe të Ballkanit, që u formuan në shekullin e XIX, përdorën si element të fuqishëm kombformues fenë e ndryshme nga ajo e Shtetit Osman dhe e përdorën atë si kriter thelbësor në spastrimin etnik dhe fetar që shoqëruan formimin e këtyre shteteve-kombe. Shqiptarët myslimanë ishin mes të tjerëve edhe ata që e pësuan nga të tjerët në këtë drejtim, për fat të keq jo vetëm nga etnitë e tjera që i rrethonin, por edhe nga shqiptarë të tjerë etnik,<sup>2</sup> të cilët e identifikonin veten me kombin e atyre me të cilët kishin fenë të përbashkët.<sup>3</sup> Kështu që duam të theksojmë se shqiptarët myslimanë janë ndër faktorët më të rëndësishëm në vendosjen e tolerancës fetar ndaj të tjerëve, dhe këtu kemi për qëllim në radhë të parë edhe vetë klerikët myslimanë dhe Islamin si fe, që garanton edhe në doktrinën e tij, bashkëjetesën paqësore edhe me ithtarët e feve të tjera.<sup>4</sup>

Së gjashti, fetaria e shqiptarëve në një masë të madhe është karakterizuar dhe vazhdon të karakterizohet nga një padije e theksuar fetare, për fetë respektive me të cilat ata identifikohen, të cilat në thelb janë eskuziviste në vërtetësinë e tyre. Kjo duket qartë nga pjesëmarrja në festat apo frekuentimi i objekteve të kultit të ndryshme të njeri-tjetrit, nga një masë e madhe njerëzish kudo në Shqipëri. Ndonjëherë këto festa apo objekte kulturi edhe pse në dukje i përkasin një feje apo besimi të caktuar, ato qëllon që në origjinë të kenë qenë kulte pagane mbi të cilat janë mbivendosur traditat fetare të ardhura më pas, siç është p.sh. festa e Shën Gjergjit, apo kulti i malit të Tomorit, Sari Salltikut, Shna Ndout etj. Natyrisht edhe ky tipar nuk është ai vendimtari, që ka ruajtur apo ruan tolerancën fetare ndër shqiptarët, pasi në thelb padija nuk është kurrë diçka pozitive.

Gjithsesi t'i kthehemi shfaqjes së tolerancës fetare mes të rinjve të sotëm. Anketimet p.sh. tregojnë se gjatë vitit 2010 gjysma e të rinjve (50 %) kanë vizituar një objekt kulturi të një feje tjetër, për afërsisht i njëjti nivel rezulton edhe nga anketimi i 2015, me rreth 47%, të të anketuarve, të cilët pranojnë se kanë vizituar gjatë 2014 një godinë kulturi të fesë tjetër.<sup>5</sup> Të dhënat tregojnë se të rinjtë myslimanë kanë prirje më të lartë për të vizituar një objekt kulturi të një feje tjetër, ndërkohë që të rinjtë katolikë kjo është më e vogël. Kjo mund të shpjegohet përveç të tjerash edhe me faktin se myslimanët shtrihen në të gjithë vendin dhe shkalla e përzierjes së tyre

---

<sup>1</sup> Justin McCarthy, Vdekje dhe dëbim, spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922. Botuar nga ALSAR, Tiranë 2015, f. 16.

<sup>2</sup> Shih p.sh. artikullin <https://shoqatacameria.blogspot.com/2008/09/perpara-me-kryqin-ne-nje-dore-dhe-ne.html> dhe <https://www.cameriame.com/tradhetia-arvanito-suliot-e-epiken-dhe-kenget-popullore-came/> nga i njëjti autor, Abedin Rakipi.

<sup>3</sup> Këtu kam për qëllim Napoleon Zervën, nga fshati Zervë i Çamërisë, por edhe të tjerë që u përfshinë e u bënë bashkë me grekët dhe masakruan dhe dëbuan shqiptarët çam myslimanë nga trojet e tyre. Kështu që pyetja që lind në këtë rast është, nëse në rrethana të ndryshme historike, shqiptarët myslimanë nuk do të ishin shumicë, çfarë do të ndodhte me ta pas rënies së shtetit osman? Është e vështirë ndoshta të thuhet me saktësi, por së paku historia e fqinjëve tanë ballkanikë na sugjeron se ata mund të pësonin ndoshta një fat të ngjashëm si bashkëfetarët e tyre bullgarë, grek, serb, rumun etj.

<sup>4</sup> Në fakt në kohën e sotme duket se tolerancën fetare mes shqiptarëve e rrezikon më shpesh politika dhe jo vetë bashkësitë fetare. Dhe kjo kryesisht duke u përpjekur të imponojë simbole dhe figura të pakicës ndaj shumicës, si dhe duke pasur shpesh një sjellje diskriminuese kulturore dhe politike ndaj identitetit fetar të shumicës apo edhe të tjerëve dhe duke potencuar shpesh dhe në mënyrë të pavend origjinën fetare të dikurshme të shqiptarëve.

<sup>5</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.20, 36.

me besimet e tjera fetare është edhe më e madhe, ndërsa katolikët duke qenë më të përqendruar në veri dhe historikisht deri diku më të izoluar dhe më pak të përzierë me të tjerët, janë edhe më tërhequr në këtë drejtim. Femrat janë ato që raportojnë se kanë bërë më shumë vizita të kësaj natyre sesa meshkujt, në veçanti në Tiranë.<sup>1</sup> Në 2015 ky raport ishte me rreth 52 % të femrave dhe 43% të meshkujve.<sup>2</sup>

Përgjithësisht të rinjtë shqiptarë nuk kanë probleme besueshmërie mes njeri-tjetrit për shkak të dallimeve fetare mes tyre. Tiranë ka edhe nivelin më të lartë të besueshmërisë ku 13,2 % e të anketuarve raportojnë se nuk kanë asnjë problem me fenë e njerëzve të tjerë dhe se ata plotësisht besojnë te njerëzit që kanë një fe tjetër. Por në rang kombëtar, vetëm 4,8 % e të anketuarve raportojnë se kanë besim të plotë te njerëzit e feve të tjera, duke treguar kështu se ata nuk preken nga dallimi fetar mes tyre.<sup>3</sup>

Sipas anketimit të 2018-2019 të rinjtë kanë vlerësuar me 2,9 pikë nga 5 maksimale besim ndaj personave me fe të ndryshme.<sup>4</sup> Ndërkohë që nuk duhet të harrojmë se përgjithësisht në vlerësimin se kujt mund t'i besoni më shumë pikët maksimale i marrin familjarët, dhe pastaj hap pas hapi të tjerët. Kështu që vlerësimi që duket i ulët karshi besueshmërisë së tjetrit për shkak të dallimit fetar, në thelb në shumicën e rasteve nuk ka lidhje me vetë fenë e ndryshme të tjetrit, sesa me faktin se ai është një njeri i huaj ose jo i familjes. Kështu që në pothuaj asnjë rast, nuk vihet re ndonjë tendencë e të rinjve të anketuar, për të pasur një marrëdhënie armiqësore me miq të besimeve të tjera.<sup>5</sup> Kështu p.sh. sipas anketimit të 2018-2019, 85 % e të rinjve të intervistuar deklarojnë se kanë shokë apo shoqe me prejardhje të ndryshme fetare. Në Tiranë kjo prirje është më e lartë me 93 %, çka tregon se kryeqyteti, me larminë e tij urbane, i zbut dallimet.<sup>6</sup>

Kjo tolerancë apo indiferencë ndaj fesë shprehet edhe në çështjen e martesës, ku vetëm 6,6% e të rinjve e shohin si tepër të rëndësishme fenë e atij me të cilin do të ndajnë jetën e përbashkët bashkëshortore në të ardhmen, dhe 10,8% si të rëndësishme dhe 17,3% deri diku të rëndësishme. Kjo do të thotë se 2/3 e të rinjve nuk i kushtojnë asnjë rëndësi elementit fetar në zgjedhjen e partnerit, por i japin përparësi cilësive të tjera. Por kjo ndarje nuk është e njëjtë kudo në Shqipëri. Në veri p.sh. vetëm 26,5% janë ata që nuk e konsiderojnë këtë element të rëndësishëm, ndërsa në jug kjo shifër shkon në 40%. Ndërkohë që në Tiranë është përqindja më e lartë e të rinjve që nuk i kushtojnë rëndësi fesë së partnerit të ardhshëm.<sup>7</sup> Autorët shprehen se: “Në veri, ky element është i lidhur deri në një shkallë të caktuar me prirje të forta për ruajtjen e identitetit, qoftë edhe përmes varësisë fetare.”<sup>8</sup>

Këto shifra në 2015 duket se kanë ndryshuar, ku 12% e të rinjve e shohin si tepër të rëndësishme fenë e bashkëshortit të ardhshëm dhe 15% si të rëndësishme.<sup>9</sup> Pra ka një rritje të dukshme, çfarë patjetër përkon me rritjen e rëndësisë së fesë në jetën e të rinjve. Megjithatë anketimi i 2015 lidhur me përkatësinë fetare të partnerit tregon se 28,9% e të rinjve të pyetur e konsiderojnë të parëndësishme, ndërsa 29,2% krejtësisht të parëndësishme. Pra, për afro 58% e të rinjve të

<sup>1</sup> Albanian Youth 2011, f.35-36.

<sup>2</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.36.

<sup>3</sup> Albanian Youth 2011. Kështu pohojnë autorët, por ndërkohë nga kjo e dhënë kuptohet e kundërta! f.30

<sup>4</sup> Rinia Shqiptare 2018-2019. f.21,

<sup>5</sup> Rinia Shqiptare 2015. f.192,

<sup>6</sup> Rinia Shqiptare 2018-2019. f. 31,

<sup>7</sup> Albanian Youth 2011. f. 72,

<sup>8</sup> Albanian Youth 2011. f. 73,

<sup>9</sup> Rinia Shqiptare 2015. f. 58,

intervistuar përkatësia fetare e partnerit për tu lidhur në martesë nuk luan asnjë rol në përzgjedhjen e tyre, përkundër të dhënave të vitit 2011 kur kjo prirje ishte afro 64%. Pra vërehet një ulje që tregon se ky element ka marrë një rëndësi më të madhe. Megjithatë të dhënat dëshmojnë se tek të rinjtë nga kryeqyteti ky element ngelet sërish i ulët, kjo edhe për shkak të peshës së madhe që ushtron metropoli ndaj identitetit fetar të të rinjve. Kështu, nëse në zonat e tjera urbane dhe rurale kjo përqindje është respektivisht 20,2% dhe 27,0%, në Tiranë është 58%, madje me një rritje të dukshme përkundërt të dhënave të vitit 2011 kur kjo shifër tek të rinjtë e kryeqytetit ishte 40,5%.<sup>1</sup>

Ndërsa arsimimi i të anketuarve rritet, ata duket se tregohen më pak të interesuar për fenë e partnerëve të tyre si kriter i përzgjedhjes. Më konkretisht 28,9 % e të anketuarve para-universitare pohojnë se feja e partnerit të tyre nuk ka rëndësi, krahasuar me 32,2 % e të anketuarve me një diplomë universitare dhe 39,2 % e të anketuarve me një diplomë pasuniversitare, që japin të njëjtën përgjigje.<sup>2</sup>

Në anketimin e 2018-2019, kur të rinjtë janë pyetur lidhur me rëndësinë e përkatësisë fetare të partnerit, 52 % e tyre janë përgjigjur se këtë nuk e konsiderojnë fare të rëndësishme. Pra edhe në këtë anketim të tretë shihet trendi në rritje i marrjes në konsideratë të besimit fetar të partnerit bashkëshortor të ardhshëm. Te 19 % e të rinjve, që e konsiderojnë shumë të rëndësishëm këtë element, 25 % e tyre janë nga zonat rurale.<sup>3</sup>

Të rinjtë e intervistuar në 2015 janë pyetur sesi do reagonin ndaj një familje fqinje që është praktikante e devotshme e fesë (shumë besimtare). Në këtë pikë të rinjtë shqiptarë shfaqen tolerantë dhe pa paragjykimë teksa mbi 50 % e të rinjve pohojnë se do ta mirëprisnin atë ndërsa 38% deklarojnë se do të ndiheshin indiferentë ndaj një situatë të tillë,<sup>4</sup> dhe vetëm 8% pohuan se do të ndiheshin keq.<sup>5</sup>

### **Ndjekja e programeve televizive me natyrë fetare nga të rinjtë**

Anketimi i vitit 2011 për të rinjtë tregoi se vetëm 23,3% e të rinjve ishin ata që ndiqnin programe fetare në TV, kur mes tyre 12,8% më pak se njëherë në javë, 5,8% rreth një herë në javë, 3,4% dy-tre herë në javë, dhe vetëm 1,3% çdo ditë.<sup>6</sup> Ndërkohë që mbi 2/3 duket krejt e painteresuar për të tilla programe. Ndërkohë anketimi i 2015 tregon se 64% e të rinjve ndiqnin programe fetare në TV, nga këta 16% më pak se një herë në javë, 27% rreth një herë në javë, 15% rreth dy tre herë në javë, dhe vetëm 6% çdo ditë.<sup>7</sup> Edhe kjo e dhënë duket se tregon se të rinjtë ka një rritje interesi për fenë, qoftë kjo edhe duke ndjekur programe me të tillë përmbajtje.

---

<sup>1</sup> Rinia Shqiptare 2015. f.54.

<sup>2</sup> Albanian Youth 2011. f. 73.

<sup>3</sup> Rinia Shqiptare 2018-2019. f.30.

<sup>4</sup> Rinia Shqiptare 2015. f.19.

<sup>5</sup> Rinia Shqiptare 2015. f.25.

<sup>6</sup> Albanian Youth 2011. f.139.

<sup>7</sup> Rinia Shqiptare 2015, f.120. Këto të dhëna që jepen me tabelë grafike në fakt bien ndesh me atë që materiali në fjalë thotë një faqe më poshtë (121) me fjalë, ku shprehet se: “mes të rinjve 66 % e tyre pohojnë se nuk i ndjekin kurrë ato. 16 % thonë se i ndjekin rrallë dhe vetëm 13 % i ndjekin të paktën një herë gjatë javës.”!

## **Kapitulli VII: Feja mes besimtarë praktikantë**

7.1 Besimtarët e sotëm praktikantë dhe feja

7.2 Rezultatet e anketimit



## 7.1 Besimtarët e sotëm praktikantë dhe feja

Ky kapitull synon shqyrtimin e shkaqeve dhe arsyeve të drejtpërdrejta të fetarisë së sotme të besimtarëve, e hulumtuar kjo kryesisht përmes një anketimi të kufizuar brenda besimtarëve praktikantë, ndaj dhe përgjithësimet e nxjerra prej tij kanë kufizimet e tyre dhe natyrisht që nuk pretendohet aspak të jenë përfundimtare apo shteruese.

Edukimi shkencor dhe indoktrinimi ateist-komunist ishin mjetet të cilat shteti komunist përdori, krahas të tjerave, për të larguar njerëzit nga besimet fetare. Natyrisht që përdorimi i këtyre mjeteve buron nga premisa se besimet fetare e kanë burimin nga padija shkencore për të shpjeguar botën dhe nga indoktrinimi mjedisor me të cilin njeriu rritet dhe edukohet. Kështu që është më se e kuptueshme që kësaj “padije” t’i kundërvihesh me dijen shkencore, e cila jep përgjigje për të shpjeguar gjithçka mbi botën, si dhe “indoktrinimin fetar” ta zëvendësosh me atë ateist, që propaganda komuniste e quante edukim shkencor materialist. Ndërkohë kthimi tek besimet fetare apo rigjallërimi i këtyre besimeve pas rënies së sistemit komunist-ateist, ka nevojë të shpjegohet edhe nga vetë përjetimi dhe arsyet e vetë besimtarëve të sotëm, se cilat qenë shkaqet dhe arsyet se pse ata i janë kthyer këtyre besimeve.

Cilat janë shkaqet dhe arsyet që vetë brezi i ri i besimtarëve të viteve 90’ e më pas thonë për besimin e tyre? A ka ndikuar familja në këtë besim dhe sa ka qenë ky ndikim? A ka pasur rol në këtë rigjallërim fetar predikimi fetar, apo joshja materiale, apo nevoja të tjera shpirtërore? Këto janë disa nga pyetjet të cilave do të përpiqemi t’i japim shpjegimin këtu.

### Dallimi mes shkaqeve dhe arsyeve

Edhe pse në gjuhën e folur të përditshme këto fjalë shpesh nuk bëjnë dallim mes tyre në përdorim dhe i përgjigjen të njëjtës pyetje *përse*, në një vështrim më të thellë shkaqet paraqesin efektin e drejtpërdrejtë të një ndodhie, ngjarje a ndryshimi, ndërsa arsyet atë të tërthortë. Shkaku është i lidhur rrënjësisht me pasojën apo me efektin e tij, ndërsa arsyeja lidhet më së shumti me proceset mendore, me qëndrimin, me motivin që e shtyn dikë të bëj diçka edhe nëse nuk ka një shkak të jashtëm të drejtpërdrejtë të menjëhershëm. Në përgjithësi, shkaku vepron si një faktor instrumental duke prodhuar një efekt të veçantë. Nga ana tjetër, arsyeja ka një qëllim mendor, sepse përfshin procese njohëse siç janë marrja e vendimeve, dalja me shpjegime dhe të qenit në harmoni me realitetin.<sup>1</sup>

Kështu që nisur nga ky dallim themi se kemi shkaqe dhe arsye pse njerëzit i janë kthyer besimit, ku tek shkaqet mund të përfshijmë ndikimin e drejtpërdrejtë familjar, një ngjarje që kanë lënë gjurmë, përmbushja e një nevojë sociale dhe materiale etj. Ndërsa tek arsyet mund të përfshijmë nevojën e brendshme për të kuptuar botën dhe realiteti që na rrethon, nevojën për siguri dhe qetësi shpirtërore etj.

---

<sup>1</sup> <http://www.differencebetween.net/language/difference-between-cause-and-reason/>

Në kapitullin e V-të kemi marrë në shqyrtim hipotezën e këtij studimi, se dështimi i ideologjisë dhe praktikës komuniste, la një hapësirë boshe në besimin e njerëzve, e cila kishte nevojë të mbushej me një besim të ri, dhe pjesë e këtij besimi të ri ishin edhe besimet fetare. Aty me anë të anketimit që u krye për testuar këtë hipotezë, iu dha përgjigje kësaj hipoteze. Por ndërkohë për të pasur një panoramë më të qartë të shkaqeve dhe arsyeve të mirëfillta, se pse besimtarët e sotëm, në këtë periudhë post-komuniste, janë besimtarë, kemi hartuar dhe zhvilluar një anketim të dytë, më të kufizuar sesa i pari brenda vetë besimtarëve, kryesisht ata praktikantë.

### **Metoda e përdorur në anketim**

Anketimi kësaj here është bërë online me “google form”<sup>1</sup> dhe është shpërndarë në rrjetet sociale, njerëzve të njohur dhe të panjohur, femra dhe meshkuj, të rinj dhe madhorë. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në të i përkasin besimit islam, me ndonjë përjashtim.<sup>2</sup> Numri i pjesëmarrësve në të ka qenë 319 vetë, ku nga këta rreth 70% ishin femra dhe 30% meshkuj. Moshja e pjesëmarrësve ka qenë nga 14 vjeç deri në 74 vjeç. Shpërndarja gjeografike ka përfshirë qarqe në veri, në mes dhe jug të Shqipërisë, zona rurale dhe urbane.<sup>3</sup> Për sa i përket pyetësorit, ai përfshin një sërë pyetjesh që lidhen me origjinën fetare të familjes, sa ka qenë ndikimi i tyre dhe i shoqërisë në fetarinë e sotme të të anketuarve, cili ka qenë motivi që i ka shtyrë ata drejt besimit, sa vjet kanë që e praktikojnë besimin, kur i kanë pasur fillesat e besimit, si janë ndjerë para dhe pasi u bënë besimtarë, sa ka qenë ndikues rënia në kontakt me propagandën fetare në drejtim të besimit, si dhe pyetje të tjera që kanë të bëjnë me të dhënat demografike dhe sociale. Pyetësori është formuluar gjysmë i strukturuar, ku janë dhënë përgjigje orientuese dhe i anketuari mund të zgjidhte prej tyre atë që ai shihte më të saktë, ose më shumë se një prej tyre në disa raste, por është lënë edhe mundësia për të shprehur mendimin e tij të lirë, nëse në opinionin e tij asnjë nga përgjigjet e paraqitura nuk ishte e duhura.

Të dhënat janë hedhur fillimisht në programin Exel dhe më pas janë përpunuar me SPSS.

Natyrisht për të pasur një kampion më përfaqësues do të duhej një numër më i madh të anketuarish dhe një përfshirje më e madhe e besimeve të tjera fetare, por duke qenë se synimi i këtij pyetësori ka qenë për të testuar në një farë mënyre saktësinë e pyetësorit të mëparshëm, dhe për t’iu përgjigjur se cilat janë disa nga shkaqet dhe arsyet e rikthimit tek besimet fetar, dhe duke qenë se myslimanët përbëjnë edhe komunitetin më madh në vend dhe duke qenë më e lehtë për mua, që i përkas këtij komuniteti, jam mjaftuar me të, duke supozuar se deri diku këto përgjigje japin një panoramë më të qartë, qoftë edhe të pjesshme, rreth shkaqeve dhe arsyeve se pse njerëzit i janë kthyer në këtë periudhë në Shqipëri besimeve fetare.

---

<sup>1</sup> <https://docs.google.com/forms/d/1iljp4A04okGbyYfrsH4ORHfrWNNGnz9ui50TlSrOrbY/edit>


<sup>2</sup> Më saktësisht e kanë identifikuar veten si mysliman suni 309 vetë, 1 si mysliman selefi, 3 si mysliman bektashi, dhe 3 thjesht si mysliman. Të tjerët janë identifikuar nga 1 si protestant dhe ortodoks dhe 1 që nuk i përket asnjë feje. Ndërsa si origjinë fetare të familjes së tyre 261 e kanë identifikuar atë si myslimane sunite, 3 si thjesht myslimane, 30 si bektashie, 7 si ortodokse, dhe 16 si të përziera dhe 1 që nuk e dinte origjinën.

<sup>3</sup> Në pyetësor kam përfshirë vendlindjen ose vendin e origjinës. Të ndarë sipas 12 qarqeve të vendit të anketuarit rezultojnë të jenë nga Shkodra 65 vetë, Kukësi 17, Lezha 1, Dibra 22, Durrësi 12, Tirana 98, Elbasani 17, Berati 12, Fieri 32, Korça 30, Gjirokastra 3, Vlora 5, dhe 5 nuk janë përgjigjur. Ndërsa për sa i përket vendlindjes nga aspekti rural dhe urban 63,6% kanë pohuar se janë nga zonat urbane dhe 35,7% nga ato rurale.

## 7.2 Rezultatet e anketimit


### Ndikimi i familjes

Pyetjes: *Sa ka ndikuar familja apo prindërit që ju të bëheni besimtar?* I janë përgjigjur në këtë mënyrë:



Siç shihet edhe nga diagrami<sup>1</sup> gati 1/3 e besimtarëve të anketuar pohojnë se familja ka luajtur rol të madh në drejtimit të përcimit të besimit fetar tek ta, ndërsa 27% e tyre pohojnë se roli familjes ka qenë i pjesshëm dhe 16% se ky rol ka qenë i pakët. Kjo tregon se familja ka qenë një nga burimet kryesore që i ka shtyrë këta shqiptarë drejt besimit dhe se të paktën më shumë se gjysma e të anketuarve

besimin e sotëm e kanë si ndikim i plotë ose i pjesshëm i familjes. Ndër të tjera, njëri nga të anketuarit pohonte se familja ka qenë baza, ndërsa një tjetër se familja ka ndikuar “shumë në aspektin e respektit ndaj Zotit dhe frikën ndaj Tij, por jo në praktikimin e besimit apo (dhënien e) njohurive nga thellimi në lexim i fesë”. Ndërkohë për 28% e të anketuarve familja nuk ka pasur asnjë rol në besimin e tyre, madje diçka më pak se gjysma e tyre kanë qenë kundra praktikës fetare të fëmijëve të tyre; njëri nga të anketuarit pohonte se madje familjarët e tallnin duke e quajtur ‘prift’. Kemi raste madje kur pasardhësit kanë ndikuar në shtimin e besimit apo në tërheqjen tek praktika fetare e prindërve të tyre, siç shprehet një nga anketuarit, por dhe raste të cilat i njoh personalisht. Megjithatë për të kuptuar më mirë se deri në çfarë mase familja ka ndikuar në fetarinë, pra në praktikimin e fesë sot, kemi bërë një tjetër pyetje: *Si ka qenë familja juaj në lidhje me besimin dhe praktikën fetare?* Të cilës i janë përgjigjur si më poshtë:



Përqindjet në këtë diagram<sup>2</sup> tregojnë se diçka më pak se gjysma (46%) e familjeve të besimtarëve të anketuar nuk kanë qenë praktikuese të fesë, por vetëm kanë besuar në Zot dhe 32% kanë qenë pak

e gatshme për tu përzgjedhur, por është im në anketim nga një anketues, ndryshe

ë në përgjigjet e gatshme për tu zgjedhur, k të dy rasteve që janë përgjigjur në këtë

praktikues të fesë. Ndërsa si shumë fetar rezultojnë të kenë qenë më pak se 1/5 (19%) e familjeve të besimtarëve të sotëm të anketuar. Kjo tregon se ndikimi i familjes nuk ka qenë vendimtar dhe i vetmi në drejtim të besimit dhe shtimit të praktikës fetare të pasardhëseve.

Por, për të kuptuar edhe më mirë lidhjen mes të qenit familje besimtare ose jo dhe ndikimin që ato kanë pasur në drejtim të fetarisë ose jo të pasardhëseve të tyre mund të kryqëzojmë mes këtyre të dhënave dhe do të kemi këtë tabelë:

Familja në lidhje me besimin dhe praktikën fetare	Frekuenca/ Përqindja	Ndikimi i familjes për të bërë besimtar					
		I kam pasur kundra	Aspak	Neutral	Pak	Pjesërisht	Shumë
Besimtare dhe pak fetare (praktikues)	Rastet	2	13	0	18	38	32
	Përqindja	1,9	12,6	0,0	17,5	36,9	31,1
Besimtare dhe shumë fetare (praktikues)	Rastet		0	0	2	10	47
	Përqindja	0,0	0,0	0,0	3,4	16,9	79,7
Nëna besonte, babai jo	Rastet	0	0	0	0	1	0
	Përqindja	0,0	0,0	0,0	0,0	100	0,0
Nëna ka qenë besimtare praktikante, babai ka qenë besimtar, por indiferent.	Rastet	0	0	0	0	1	0
	Përqindja	0,0	0,0	0,0	0,0	100	0,0
Nuk besonin	Rastet	2	4	0	1	2	1
	Përqindja	20,0	40,0	0,0	10,0	20,0	10,0
Vetëm besonin se ka Zot, nuk ishin fetarë (praktikues)	Rastet	35	33	1	29	34	13
	Përqindja	24,1	22,8	0,7	20,0	23,4	9,0

Tabela më sipër na tregon se në gati 80% të rasteve të familjeve shumë fetare, kjo fetari është përcjell edhe tek pasardhësit e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa në rreth 20% të rasteve ky ndikim ka qenë i pjesshëm dhe i pakët. Nga tabela vëmë re edhe një përqindje shumë të vogël 1,9% (dy raste) të familjeve pak fetare të cilat kanë qenë kundra fetarisë së pasardhëseve të tyre. Duket se përqindjen më të lartë të kundërshtimit për fetarinë e pasardhëseve të tyre, e kanë pasur mes besimtarëve të anketuar, familjet të cilat besonin në Zot, por nuk ishin praktikante, me 24,1% dhe nëse këtë e mbledhim me 22,8% të atyre familjeve që nuk kanë ndikuar fare te pasardhësit e tyre, edhe pse vetë besonin në Zot, do të kemi se diçka më pak se gjysma e familjeve që besonin në Zot nuk kanë luajtur ndonjë rol nxitës në drejtim të praktikës fetare te pasardhësit e tyre. Kjo tregon edhe një herë se nxitja shpesh për tu bërë fetar apo praktikantë i fesë nuk ka ardhur nga besimi i familjes, por nga faktorë të tjerë. Ndërkohë vëmë re se në katër raste familjet që nuk besonin kanë ndikuar në besimin e sotëm të pasardhëseve të tyre, kjo duket ndoshta kontradiktore, por mund të shpjegohet me ndryshimin e vetë kësaj familje ose si efekt i kundërt, ose njëra nga përgjigjet është e gabuar.

Për të testuar edhe një element tjetër që ka lidhje me fetarinë e sotme të njerëzve është edhe marrëdhënia që familjet e tyre ka pasur me regjimin e kaluar. Për këtë kemi bërë një tjetër pyetje në këtë anketim: *A është persekutuar familja juaj (apo ju) gjatë regjimit komunist?* Dhe përgjigjet për të qenë: 69% se nuk kanë qenë të persekutuar dhe kanë qenë njerëz të thjeshtë e të papërzier, 5,6% se kanë qenë familje komunistësh ose të lidhur me regjimin, ndërsa 23,5% janë ata që kanë pohuar se familja e tyre është persekutuar apo prekur nga regjimi komunist. Pra kemi më pak

pasardhës fetar nga familjet ish-komuniste ose të lidhura me regjimin dhe më shumë nga familjet e persekutuar, çka dhe është e kuptueshme. Tani nëse këto të dhëna i kryqëzojmë me pyetjen: *Sa ka ndikuar familja juaj në drejtim të besimit*, për të kuptuar më mirë dallimin, sidomos mes familjeve të papersektuara dhe atyre të persekutuar, kemi këtë tabelë në përqindje:<sup>1</sup>

Ndikimi i familjes në drejtim të besimit	Familje komuniste/ e lidhur me regjimin	Familje e papërzier/e papersektuar	Familje e persektuar
Aspak	22,2	14,5	18,7
I kam pasur kundra	33,3	10,5	12
Neutral	0	0,5	0
Pak	11,1	15,5	17,3
Pjesërisht	22,2	30	18,7
Shumë	11,1	29,1	33,3

Ajo që vihet re këtu është se familjet e persekutuar janë ato që kanë edhe përqindjen më të lartë të ndikimit *shumë* të madh në drejtim të besimit me 33,3%, ndërsa ato komuniste apo të lidhura me regjimin kanë të njëjtën përqindje më të lartë, por kundra besimit apo fetarisë së pasardhësve të tyre. Dallimet mes këtyre dy kategorive të familjeve janë të qarta dhe të kuptueshme dhe duken edhe në përqindjet e të gjitha niveleve të refuzimit dhe mbështetjes ndaj besimit fetar. Por ndërkohë, nëse krahasojmë familje e persekutuar me ato të papersektuara do të vëmë re në të përgjithshmen e tyre, se familjet e persekutuar kanë edhe përqindjen më të lartë të mos mbështetjes apo të kundërshtimit të fetarisë së fëmijëve të tyre dhe natyrisht edhe nivelin më të ulët në përgjithësi në ndikimin e besimit fetar të pasardhësve të tyre, në krahasim kjo me familjet e papërziera me regjimin komunist dhe të papersektuara njëkohësisht. Edhe pse diferenca në përqindje nuk është shumë e madhe mes këtyre dy grupimeve, kjo duket disi e habitshme, por mund të shpjegohet edhe më mirë nëse kryqëzojmë mes të dhënave për lidhjen ose jo të familjeve me regjimin komunist dhe të dhënës që flet për ndikimin e propagandës fetare pas viteve 90' dhe do të kemi këtë tabelë:

Ndikimi i propagandës fetare pas 90'	Familje komuniste/ e lidhur me regjimin	Familje e papërzier/e papersektuar	Familje e persektuar
Vendimtar	5,9	10,1	14,7
Shumë i madh	47,1	35,5	32
I madh	23,5	29,5	25,3
I pjesshëm	17,6	19,9	18,7
I vogël	0	2,3	6,7
Shumë i vogël	0	2,8	1,3
I parëndësishëm	5,9	0,9	1,3

<sup>1</sup> Përqindjet janë nxjerrë nga 313 përgjigje të vlefshme, ku nuk janë përfshirë përgjigjet nuk e di dhe pa përgjigje.

Kjo tabelë na qartëson se pasardhësit besimtarë të familjeve të lidhura me regjimin komunist janë ato që e kanë përthithur edhe besimin më së shumti nga predikimi fetar i pas viteve 90', dhe pas tyre vijjnë pasardhësit e familjeve të papërziera dhe në fund ata të familjeve të persekuatuara.

Nga këto të dhëna rezulton se mund t'i klasifikojmë besimtarët e sotëm praktikantë, duke iu referuar anketimit, në tre kategori, për sa i përket origjinës së tyre familjare e lidhur kjo me rënien e regjimit komunist:

E para, pasardhës nga familje fetare, të cilat e kanë ruajtur identitetin fetar edhe gjatë regjimit komunist, si një identitet të rëndësishëm të tyre dhe si një formë të heshtur disidence ndaj tij, edhe pse këto familje e fshihnin religjiozitetin e tyre në publik në kohën e komunizmit, por e ekspozonin atë brenda familjes dhe të afërmeve, si në raste festash fetare apo nevojash shpirtërore. Këto familje nuk kishin lidhje të forta me ideologjinë komuniste ose ishin kundërshtarë të heshtura të tij. Kjo është arsyeja pse shumica e shqiptarëve më fetar i gjen pikërisht nga zonat të veriut, dhe krahina të caktuara në zona të tjera të vendit, ku feja ka qenë një identitet i fortë social, si p.sh. te çamët. Te ky grupim njerëzish, besimin fetar, zakonisht e gjen te të tria moshat, sidomos tek brezi i tretë dhe ai i ri, pra te gjyshërit dhe nipërit.

E dyta, pasardhës nga familje që e pranuan komunizmin. Natyrisht që këta janë edhe më të pakët dhe vijjnë kryesisht nga familje që nuk kanë qenë disidente ndaj regjimit, por minimalisht pranues të tij. Familje të tilla përmbysja e regjimit i gjeti pa asnjë identitet të dytë ideologjik ku ata të besonin, sidomos për pasardhësit e tyre të pabrumosur nga jeta dhe në raste të caktuara edhe të zhgënjyer deri diku që në rini nga rënia e komunizmit, kështu që në kërkim të identitetit të ri alternativ ata e gjejnë veten tek besimi fetar. Besimi fetar, tashmë diçka e re për këta njerëz të rinj, ashtu si edhe komunizmi dikur ofron shpëtim, ofron një siguri apo ideal ku të besosh. Ky grupim është më së shumti produkt i ofertës religjioze nga kontakti direkt me misionarët e ndryshëm ose nga miq e të afërm, të cilët kanë ndikuar tek ta.

E treta, në radhët e familjeve që u persekutuan gjatë regjimit komunist, që ishin ose u bënë kundërshtar të tij, dhe që nuk kishin një identitet të fortë të trashëguar fetar, pra një identitet të dytë, tek i cili ata besonin, por besonin tek ide të tjera politike apo ideologjike, rënia e regjimit komunist tregon se ka ndikuar më pak te fetarizimi i tyre, se pjesa te pjesa tjetër e popullsisë që nuk qe persekutuar drejtpërdrejtë, për shkak se një pjesë e tyre kanë vuajtur për shkaqe ideologjike jofetare, kështu që duke qenë se ata e kishin tashmë një bindje të ndryshme nga feja, besimi fetar zuri një vend më të vogël në identitetin e tyre e tyre social, pas rënies së regjimit komunist.


Ndikimi i familjes në ruajtjen e fesë mes shqiptarëve është vënë re edhe nga studime të tjera, si p.sh. Elira Çela në një studim të publikuar që në vitet e para të demokracisë pohon:

Ka shumë faktorë social që ndikojnë në rindërtimin e ndjenjës fetare në Shqipëri, por deri tani më e rëndësishmja është familja, përmes së cilës u ruajtën ritet fetare gjatë 25 viteve të fundit. Roli i familjes vërtetohet nga studimet e kryera kohët e fundit me fëmijë të moshës parashkolllore dhe shkollore. Në një studim të fundit të kryer në Tiranë, 40% e fëmijëve të kopshtit të pyetur ishin në gjendje të identifikonin saktë përkatësinë fetare të familjeve të tyre. Fëmijët e mëdhenj (10 deri në 12 vjet) shfaqën një konceptim edhe më konkret të fesë: 96,7% e nxënësve të kampionuar të kësaj moshe ishin në gjendje të

identifikonin besimin që i përmbaheshin. Për më tepër, shumica (90%) i dinin mirë festat kryesore karakteristike për besimin e tyre. Fëmijët që vinin nga martesat të përziera (16.7% e mostrës totale) deklaruan se familjet e tyre festuan festat kryesore të të dy feve.<sup>1</sup>

## Ndikimi i shoqërisë

Pyetjes: *Sa ka ndikuar shoqëria ose të afërmit dhe miqtë tuaj që ju të bëheni praktikant i fesë?* I janë përgjigjur në këtë mënyrë:



Në këtë diagram shihet se shoqëria ka përqindje më të larta ndikimi në shtytjen drejt praktikës fetare, sesa familja, ndërkohë që edhe rastet e kundërshtimit kanë qenë shumë më të ulëta. Kjo konfirmon faktin se rrethi shoqëror në epokën e sotme ka më tepër ndikim sesa familja, në përgjithësi, në formimin e identitetit social dhe fetar. Megjithatë mund të mendohet se aty ku nuk ka pasur ndikim fetar familja ka pasur ndikim

shoqëria, por kryqëzimi i të dhënave na tregon se kjo ka qenë e pakët, madje rastet më shumta janë ato ku ndikimi fetar i familjes dhe shoqërisë ka qenë i madh në të dyja rastet, siç paraqitet nga tabela e mëposhtme:

		Ndikimi i familjes me numër rastesh						
		I kam pasur kundra	Aspak	Neutral	Pak	Pjesërisht	Shumë	Gjithsej
Ndikimi i shoqërisë	Aspak	3	12	0	9	6	8	38
	I kam pasur kundra	4	2	0	1	2	1	10
	Pak	7	4	0	8	14	11	44
	Pjesërisht	11	19	0	12	<b>29</b>	<b>35</b>	106
	Shumë	14	13	1	20	<b>35</b>	<b>38</b>	121
	Gjithsej	39	50	1	50	86	93	319

Siç shihet edhe nga tabela, anketimi tregon se rastet e ndikimit janë më të larta pikërisht aty ku takohen ndikimi i familjes me ndikimin e shoqërisë. Kjo do të thotë se përtej familjes dhe shoqërisë ka pasur shkaqe dhe arsye të tjera që kanë ndikuar te një pjesë e besimtarëve të anketuar, që padyshim duhet të kenë qenë të brendshme. Megjithatë këtu duhet përmendur fakti se njëri nga këto shkaqe të brendshme, krahas atyre intelektual, ekzistencial, shpirtëror është dhe nevoja e socializimit. Mjedisi i parë me të cilin socializohet njeriu është ai familjar dhe pas tij vijnë të gjithë të tjerët me radhë. Migrimi masiv drejt zonave urbane, kryesisht drejt kryeqytetit dhe zonave përreth tij, që ndodhi në vitet 90' në Shqipëri krijoi, sidomos te të rinjtë e ardhur nga

<sup>1</sup> Celá, Elira, Innovation in Social Sciences Research. 1992, Vol. 5 Issue 3, p115-125. 11p. Historical background and characteristics of the evolution of Islam in Albania.

zona të tjera nevojën për afirmim brenda një grupi social, që i siguronte atij edhe një identitet të qëndrueshëm social. Objektet e kultit dhe komunitetet fetare qenë pikërisht mjediset shpesh më të lehta dhe më të përshtatshme dhe më mikpritëse, që ofronin një socializim të shpejtë dhe një identitet bashkues, të të rinjve të ardhur kryesisht nga zonat rurale apo veriore, me pjesën tjetër të shoqërisë vendase,<sup>1</sup> identitet ky i cili nuk ishte në shumicën raste i huaj për ta, dhe nuk haste gjithashtu as rezistencë në shumicën e rasteve nga familja, kështu që qe shumë më e lehtë për ta të përfshihen dhe integroheshin në to dhe krahas kësaj të fetarizoheshin, duke ruajtur kështu identitetin fetar të familjes, por njëkohësisht edhe duke e shtuar atë dhe fituar një identitet të ri social. Ky identitet përcakton edhe një lloj prestigji social mes grupit dhe për rrjedhojë vendos edhe besimin e grupit tek individët e tij. Pra, ata fillojnë t'i besojnë dhe mbështeten më shumë njeri-tjetrit dhe rritja e fetarisë së tyre është shenjë e besnikërisë ndaj grupit apo komunitetit fetar përkatës, nëpërmjet besnikërisë së shfaqur ndaj parimeve që e bashkon grupin, kështu që familja dhe fisi apo besnikëria ndaj tyre kalon në një plan më të ulët dhe shoqëria e re urbane bëhet përcaktuese e identitetit të individit, kryesisht të rinjve. Kështu që mendojmë se në rigjallërimin e sotëm fetar rolin më të fortë e ka luajtur pikërisht faktori shoqëror më shumë sesa ai familjar. Duke konfirmuar në masë të pranueshme edhe teorinë e ofertës apo tregut religjioz, të përmendur në pjesën e teorisë së këtij studimi.

### Motivi i besimit

Duke vazhduar më tej me këtë anketim, pyetjes se: *Cili mendoni (ose kujtoni) se ka qenë motivimi juaj më i fortë që ju shtyu të bëheni besimtar dhe praktikant i fesë?* I janë dhënë në tërësi 25 përgjigje, nga këto 9 të parat (nga 10 gjithsej) janë dhënë në anketim si mundësi zgjedhjeje, ndërsa pjesa tjetër e përgjigjeve janë formuluar nga vetë të anketuarit. Natyrisht që një numër më i madh pjesëmarrësish do të jepte edhe formulime të tjera, por gjithsesi këto janë shkaqet dhe arsyet që ky anketim paraqet:

Nr.	Motivi më i fortë që ju shtyu të bëheni besimtar dhe praktikant i fesë	Rastet	Përqindja %
1	Besimi tek Zoti i jep kuptim jetës dhe i përgjigjet nevojave të njeriut	97	30,4
2	Kam qenë besimtar dhe doja ta njihja më mirë Zotin dhe besimin	79	24,8
3	Arsye njohëse (kurioziteti, kërkimi i së vërtetës, njohja e Zotit...etj.)	61	19,1
4	Në kërkim të ndihmës së Zotit (nga një stres, hall, fatkeqësi, sëmundje...etj.)	24	7,5
5	Ndjenja se përtej kësaj bote ka një Fuqi të Mbinatyrshme.	22	6,9
6	Një ëndërr që kam parë.	8	2,5
7	Më ka tërhequr një material që kam lexuar.	6	1,9
8	Zhënjimi nga ideologjia komuniste-ateiste.	2	0,6
9	Më ka bërë për vete një video predikimi i dikujt që kam parë në internet rastësisht	1	0,3

<sup>1</sup> Kjo për arsyen e thjeshtë se komunitet fetare nuk ngrihen mbi bazën e interesit material, por mbi parime dhe besime të përbashkëta. Ata e shohin veten si një familje e përbashkët dhe pjesëtarët e komunitetit si vëllezër dhe motra, dhe për rrjedhojë të kësaj lidhje painteres ata lidhen përmes ndjenjave të respektit, dashamirësisë, besimit dhe përgjegjësisë. Për këtë arsye dhe bashkësitë fetare e ruajnë lidhjen e individëve mes tyre edhe pa pasur nevojën e shkëmbimit të të mirave materiale mes tyre.



10	Rritur dhe edukuar në mjedis fetar.	2	0,6
11	Kërkimi ndaj të vërtetës absolute.	1	0,3
12	Besoj në Zot dhe jo tek feja.	1	0,3
13	Kombinim mes qenies besimtar dhe njohjes së Zotit më shumë, në fazat e para të besimit, pastaj mbështetjen nga besimi në faza të vështira të jetës dhe aktualisht marrjen e kuptimit të jetës nga Zoti.	1	0,3
14	Me kane pëlqyer cilësitë e besimtarëve në Kuran	1	0,3
15	Kë do Zoti e udhëzon. Pak nga te gjitha me sipër, por më tepër ka qenë një lëndë e masterit e cila ka të bëjë me kodet. Doja të mësoja arabisht për të deshifruar Kuranin, por më deshifroj Kurani mua.	1	0,3
16	Nga gjyshi.	2	0,6
17	Bashkëshorti im.	1	0,3
18	Është bërë dikush se bep.	1	0,3
19	Vdekja e prindit tim.	1	0,3
20	Natyrshëm, dhuratë e Zotit.	1	0,3
21	Isha e paplotësuar, po kërkoja plotësimin.	1	0,3
22	Detyrimi moral.	1	0,3
23	Gjendje emocionale.	1	0,3
24	Qetësia shpirtërore që të jep besimi.	2	0,6
25	Kam lindur e tillë dhe u ndjeva krenare dhe e sigurt për ta vazhduar për shkak të çdo detaji që ky besim përmbledh.	1	0,3
<b>Gjithsej</b>		<b>319</b>	<b>100%</b>

Padyshim që shkaqet dhe arsyet mund të ndërthuren me njëra-tjetrën në faza të ndryshëm të rrugëtimit drejt fesë dhe nuk mund të ndahen shpesh me thikë dhe mund të jenë të shumta dhe jo vetëm një, por gjithsesi këtu do të mundohemi të bëjmë një ndarje klasifikuese të përafërt.

Nga tabela vihet re se përgjigjet 1, 3, 5, 11, mund t'i klasifikojmë si arsye që kanë të bëjnë më së shumti me motive të brendshme, intelektuale, që lidhen me nevojën për t'i dhënë kuptim botës dhe jetës njerëzore dhe këto përbëjnë 56,7% të të anketuarve. Përgjigjet 4, 21, 23, 24 apo edhe 19 dhe 22 mund të klasifikohen si nevoja shpirtërore të njeriut, për të pasur qetësi shpirtërore dhe siguri në jetë, për të tejkaluar dhimbjen dhe misterin e vdekjes, dhe për të përmbushur një detyrim moral, me të cilin e identifikon një përgjigje, besimin në Zot. Të gjitha këto raste përbëjnë 9,3% të të anketuarve. Ndërsa përgjigjet 2, 13, 10, 16, 17, 18, 25, që përbëjnë gjithsej 27,2% e të anketuarve, mund t'i klasifikojmë si një grup që e ka përthithur besimin më së shumti nga mjedisi social dhe familjar, ku shkak i jashtëm dhe ai brendshëm ndërthuren me një-tjetrin. Përgjigjet 6, 7, 9, 14 dhe 15, që përbëjnë 5,3% e të anketuarve mund t'i klasifikojmë si shkaqe rastësore, të cilat më pas kanë motivuar këta njerëz në futjen e rrugës së besimit fetar. Ndërsa përgjigja 20 e paraqet besimin si diçka krejt të natyrshme apo dhuratë hyjnore, pa dhënë një shkak ose arsye tjetër. Ndërkohë vetëm 2 raste, që përbëjnë 0,6% të të anketuarve kanë pohuar se i janë kthyer besimit për shkak të zhgënjimit nga ideologjia komuniste, dhe sipas të dhënave demografike njëri nga të anketuarit ishte 55 vjeç dhe tjetri 48 vjeç, të dy me arsim të lartë, ku njëri pohon se para se të besonte ka qenë ateist i lëkundur, ndërsa tjetri indiferent ndaj fesë. Të dy këto raste, duke iu referuar këtij anketimi, tregojnë se janë të pakët ata besimtar

praktikantë, të cilët kanë lindur gjatë periudhës së komunizmit dhe e kanë përthithur edukimin e asaj kohe, duke besuar tek ideologjia komuniste, dhe më pas dështimi i saj është bërë shkak i drejtpërdrejtë për të përqaftuar besimin fetar.

Por ndërkohë për të parë opinionin e këtyre të anketuarve në lidhje me besimin e të tjerëve kemi bërë edhe një tjetër pyetje në anketim: *Sipas jush, cili (ose cilët) mendoni se kanë qenë shkak (ose shkaqet) kryesor(e) dhe më i (të) shumtë që njerëzit e tjerë t'i kthehen besimit fetar?*

Kjo pyetje kishte më shumë se një mundësi zgjedhjeje, kështu që analiza e mëposhtme nuk bazohet mbi numrin e të anketuarve, por mbi tërësinë e përgjigjeve të tyre, të cilat në rreth 60% të rasteve kanë qenë përgjigje me më shumë se një opsion zgjedhjeje. Megjithatë rreth 40% të përgjigjeve kanë identifikuar vetëm një përgjigje, ku nga këto bien në sy se 55 përgjigje të vetme i përkasin opsionit “nevoja për t'i dhënë kuptim jetës” dhe 28 përgjigje “besimi i jep shpresë njeriut”, ndërsa 16 përgjigje ka marrë opsioni “duke shpresuar një jetë me mirëqenie më të mirë, sepse besimi sjell mbarësi”, 15 përgjigje “shoqëria”, 8 përgjigje “ndikimi familjar”, 3 përgjigje “frika nga vdekja” dhe pjesa e mbetur ato që paraqiten më poshtë në tabelë. Nisur nga kjo mund të themi se mbi 17% e të anketuarve mendojnë se motivi i vetëm kryesor i atyre që i janë kthyer fesë është motiv intelektual, dhe asnjë prej këtyre që kanë dhënë një përgjigje si shkak të vetëm të kthimit në besim nuk kanë përzgjedhur një shkak thellësisht material, siç është opsioni “ndihmat humanitare”, çka tregon se ky element shihet si krejt i pa përfshirë si arsye nga një pjesë jo e vogël e besimtarëve. Por ndërkohë “ndihmat humanitare” janë përfshirë si shkak i afrimit me fenë nga 21 të anketuar (6,9% e të anketuarve), por jo si shkak i vetëm, por bashkë me të kanë përzgjedhur edhe shkaqe të tjera. Ndërkohë të gjitha përgjigjet e dhëna të klasifikuara sipas përzgjedhjes nga të anketuarit janë si më poshtë:<sup>1</sup>

Nr.	Shkaqet apo arsyet që mendoni për të tjerët se i janë kthyer fesë	Rastet
1	Nevoja për t'i dhënë kuptim jetës	74
2	Besimi i jep shpresë njeriut	70
3	Shoqëria	54
4	Ndikimi familjar	53
5	Një përjetim i fortë shpirtëror që ata kanë pasur në jetë	41
6	Duke shpresuar një jetë me mirëqenie më të mirë, sepse besimi sjell mbarësi	35
7	Propaganda fetare nga misionarët dhe klerikët e ndryshëm të ardhur nga jashtë	35
8	Zhgënjimi nga gjendja e mëparshme	31
9	Frika nga vdekja	28
10	Thjesht kanë ndjekur prindërit ose shoqërinë në mënyrë të pavetëdijshme	22
11	Ndihmat humanitare	21
12	Besimi është i natyrshëm	1
13	Të gjitha nga pak	1
14	Shpirti i humbur, kërkon gjithmonë të vërtetën.	1
15	Varet nga cili aspekt i ka ardhur thirrja shpirtërore secilit.	1

<sup>1</sup> Njëmbëdhjetë përgjigjet e para kanë qenë si opsion zgjedhjeje, ndërsa të tjerat janë të të vetë anketuarve.

16	Nuk e di	2
Gjithsej përgjigje		470

Nga tabela shihet se në krye të listës qëndron nevoja intelektuale, pas saj vjen nevoja shpirtërore dhe nëse këtyre i bashkëngjisim edhe përgjigjet 8, 9, 14 apo edhe 5, të cilat mund t'i klasifikojmë të gjitha si nevojë konjitive dhe shpirtërore do të kemi 225 të tilla, që zënë 47,9% të të gjitha përgjigjeve. Ndërkohë përgjigjet 3, 4, 10, që mund të klasifikohen si besim i ndikuar nga mjedisi social përbëjnë 27,4% të të gjithë përgjigjeve, dhe gati përputhet me të njëjtin vlerësim më sipër kur të anketuarit janë përgjigjur për veten e tyre. Përgjigjet 6 dhe 11, mund t'i klasifikojmë si motive deri diku materiale edhe pse siç e përmendëm më sipër përgjigja 11 nuk është zgjedhur asnjëherë si i vetmi shkak dhe më shumë se gjysma e zërave të përgjigjes 6 është përfshirë bashkë me përgjigjet e tjera. Gjithsesi të dyja këto përgjigje përbëjnë 16,2%. Ndërsa 35 përgjigje ose 7,4% mendojnë se propaganda fetare ka qenë një nga shkaqet e kthimit të njerëzve në fe, edhe pse këtë nuk e shohin si shkakun e vetëm. Ajo që vihet re në përgjithësi është se edhe mes besimtarëve praktikantë ka një pjesë, edhe pse e vogël, të cilët mbajnë opinionin se arsyet materiale kanë qenë një nga shtytësit kryesorë të afrimit me praktikën fetare nga një pjesë e besimtarëve të sotëm, por ndërkohë të dyja pyetjet konfirmojnë në përgjithësi se besimi fetar dhe futja në rrugën e praktikës fetare nuk mbizotërohet nga shkaqe apo arsye materiale, por më së shumti të brendshme shpirtërore dhe të jashtme sociale.

### Çfarë ishte para se të bëheshit besimtar?

Për të parë nëse ky kalim drejt fesë mes besimtarëve të anketuar ka qenë një kthesë e madhe në jetë, apo një evoluim i natyrshëm i besimit të tyre në klimën e lirisë, kemi përfshirë në anketim pyetjen: *Para se të bëheshit praktikant i besimit, si e ndjenit veten? Të cilës i janë përgjigjur në këtë mënyrë:*<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Përgjigjet: *i paditur, nuk e mbaj mend, besimtar dhe besimtar mstar*, janë dhënë nga vetë të anketuarit, ndërsa të tjerat ishin si opsione zgjedhjeje.





Tabela tregon se diçka më pak se gjysma e të anketuarve (46,4%) pohojnë se para se të bëheshin besimtar praktikantë ata ishin pak besimtar, ndërkohë bashkë me kategoritë e tjera ku përfshihen edhe nivelet e tjera të besimit, shkojnë deri në 73,7% të të anketuarve. Pra këto të dhëna tregojnë se mbi 2/3 e besimtarëve të anketuar kanë pasur një nivel të caktuar besimi, para se ata të bëheshin më shumë fetar apo praktikantë të fesë. Të dhënat nga anketimi tregojnë gjithashtu se dy grupmoshat e para dhe më të rejat, nuk kanë në përbërjen e tyre asnjë ateist dhe agnostik, ndërsa 5 raste ish-ateistësh dhe 2 ish-agnostikësh gjenden në tre kategoritë e moshave më të mëdha. Kjo provon edhe një herë se mungesa e besimit është më së shumti e përhapur në brezat që janë rritur dhe formuar në vegjëlinë dhe rininë e tyre, gjatë periudhës së regjimit komunist, sesa në periudhën pas tij.

### Ndikimi i fesë te besimtarët praktikantë

Në anketim kemi përfshirë edhe një pyetje tjetër që nxjerrë edhe më në pah nivelin e transformimit të brendshëm: *Pasi jeni bërë besimtar praktikant, a mendoni se keni gjetur qetësinë dhe sigurinë e jetës, që ju mungonte?* Dhe përgjigjet për të qenë:



Si përgjigje të kësaj pyetje ishin lënë gjashtë mundësi si dhe opsionin e lirë, për dikë nga të anketuarit që mund të shprehej ndryshe nga opsionet e dhëna. Rreth 60% e të anketuarve janë përgjigjur se e kanë pasur qetësinë dhe sigurinë në vetvete, por feja ua ka shtuar edhe më shumë atë, 6,6% kanë pohuar se e kanë pasur qetësinë dhe se besimi i ka ndihmuar të gjejnë të vërtetën ndërsa 14,5% janë përgjigjur se kanë akoma nevojë të shtojnë besimin e tyre. Ndërkohë 5,7% e të anketuarve pohojnë se i tremben se çfarë pason pas vdekjes dhe se kjo i shtyn të jenë besimtarë praktikant. 1,5% janë përgjigjur se nuk e kanë gjetur akoma këtë qetësi, sepse janë akoma të rinj në besim dhe vetëm një person ose 0,3% është përgjigjur se nuk e ka gjetur akoma qetësinë edhe pse ka vite në besim. Ndërkohë anketimi ka pasur edhe një numër përgjigjesh të dhëna nga vetë të anketuarit, ku shumica e tyre janë shprehur me fjalët e tyre se e kanë gjetur qetësinë, si p.sh.: “kam gjetur atë që se kam pasur kurrë më parë prej qetësisë dhe lumturisë dhe nuk do ta ndërroja me asgjë”, “sigurisht që po, besimi është timoni në këtë jetë, duke shpresuar një përfundim të mirë dhe takimin me Zotin”, “e kam gjetur qetësinë, sigurinë dhe të vërtetën, që më mungonte kur nuk isha në besimin që sot jam”, “po, mendoj se besimi ishte ai që më dhuroi qetësinë dhe siguritë”, apo disa janë përgjigjur edhe shkurt se “po e kam gjetur”, “e kam gjetur plotësisht” etj. Ndërkohë tre të anketuar kanë pohuar se e kanë pasur atë, sepse kanë jetuar me besim si p.sh.: “jam rritur praktikante dhe nuk e kam humbur ndonjëherë”, “kam jetuar gjithmonë nën hijen e qetësisë dhe të vërtetës me besimin tim” apo “nuk u bëra, isha. Jam shumë e qetë”. Ka pasur edhe disa përgjigje, tre të tilla, që pohojnë se e kanë gjetur por janë të lëkundur, njëra prej tyre shprehej: “Varet, ndonjëherë kam shumë besim pastaj ka ditë që jam e lëkundur. Se kuptoj as vete, por di të them që gjatë kohës që falesha ndihesha shumë e lumtur dhe e frikësuar njëherësh.”


Ajo që vëmë re në mënyrë të përgjithshme është se pjesa më e madhe e besimtarëve të anketuar, duke qenë se nuk vijnë nga një mosbesim absolut dhe nga pikëpamje të kundërta me fenë, edhe pse një pjesë e tyre kanë jetuar nën një sistem ku kjo gjë imponohej dhe ishte ideologji zyrtare, duket se nuk kanë kaluar kriza të forta ekzistenciale dhe identitare, ndaj dhe nuk konstatohet të kemi ndryshime të forta radikale në perceptimin e tyre për jetën, me përjashtim të pak rasteve, të cilat i përkisnin një shtrese qytetare dhe të arsimuar mirë gjatë regjimit komunist dhe që kishin përthithur në mos komunizmin, ateizmin si besim të tyre. Gjithsesi ky anketim, edhe pse i kufizuar konfirmon edhe njëherë faktin se përmbysja e regjimit komunist u përjetua nga pjesa më e madhe e njerëzve këtu,<sup>1</sup> si diçka e mirë dhe pa trauma identitare të mëdha. Kjo tregon se një pjesë e madhe e shqiptarëve, të paktën ata që besonin në Zot, nuk e kishin përthithur dhe bërë të veten ideologjinë komuniste dhe as nuk kanë besuar thellësisht në të.

### **Koha kur ka nisur besimi dhe praktika fetare**

---

<sup>1</sup> Në anketimin e bërë kam përfshirë edhe një pyetje të tillë: *Si e vlerësoni mirëqenien tuaj dhe të familjes tuaj, nëse e krahasoni atë me periudhën e regjimit komunist?* Përgjigjet ishin të tilla: 66,5% shumë më mirë, 22,9% përgjithësisht më mirë dhe 5% pak më mirë.

Pyetjes se: *Sa vjet keni si praktikantë i besimit?* I janë përgjigjur sipas grafikut të mëposhtëm:



Të dhënat e anketimit, siç duken edhe në tabelë, tregojnë se grupmosha 36-46 dhe 47-57 kthimin e tyre më të madh në praktikantë fetarë e kanë që në vitet e para pas rënies së regjimit komunist, ndërkohë që brezat më të rinj kanë një kurbë në rritje me kalimin e viteve. Është interesant fakti që në grupin me moshë 36-46, ka individë që pohojnë se kanë qenë praktikantë të besimit gjatë gjithë jetës së tyre që nga fëmijëria e hershme. Kemi dy raste nga 45 vjeç, një nga Preza e Tiranës dhe një nga Dobraçi i Shkodrës, dhe dy raste respektivisht 37 dhe 38 vjeç, nga Gurra e Matit dhe Tirana, ku të gjithë pohojnë se fillimet e praktikës fetare i kanë pasur që në moshë të hershme të fëmijërisë së tyre, që praktikisht tregon se edhe para rënies së shtetit komunist, ka pasur familje të cilat e kanë ruajtur në fshehtësi praktikën e fortë fetare brenda familjes, dhe nga kjo e dhënë duket se kjo praktikë ka qenë më e theksuar në zonat rurale. Por për të parë edhe më tej se në çfarë moshe kanë rënë për herë të parë në kontakt me besimin në Zot, të anketuarve u është drejtuar pyetja: *Sa ka qenë moshë juaj kur keni filluar të besoni tek Zoti?* Të cilës i janë përgjigjur:


	Moshë kur keni filluar të besoni te Zoti					
	0-7 vjeç	8-10 vjeç	11-15 vjeç	16-20 vjeç	21-24 vjeç	25-50 vjeç
<b>Rastet</b>	112	39	74	65	18	10
<b>Përqindja</b>	35,1%	12,2%	23,2%	20,4%	5,6%	3%



është tërheqës për klientët. Teoricienët e kësaj qasjeje nuk e kufizojnë këtë vetëm mes feve të ndryshme, por edhe për ngjyrimet e ndryshme brenda një besimi të vetëm fetar. E rëndësishme në këtë mes është të mos kemi një monopol institucional mbi fenë, i cili e kufizon “klientin”, në këtë rast besimtarin e mundshëm, në zgjedhjen e tij. Duket si vulgarizim i besimit fetar në fakt, trajtimi i tij si produkt apo shërbim në shitje, por qëllimi këtu, përtej termave të përdorur, është ta trajtojë nevojën shpirtërore të njeriut si diçka që i nënshtrohet edhe ajo zgjedhjes së lirë të njerëzve. Megjithatë këtu duhet të bëjmë dallim në mes faktit se përqaftimi i besimit përgjithësisht motivohet nga arsye të brendshme dhe të jashtme, që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me predikimin apo ndryshe ofertën religjioze dhe faktit se predikimi luan rol të rëndësishëm në orientimin e zgjedhjes së fesë apo rritjes së nivelit të fetarisë mes njerëzve.

Shqipëria për vetë historinë e saj me fetë dhe rrethanat në të cilat u gjend pas hapjes së vendit ndaj çdo prurje fetare vendase apo të huaj, dhe duke mos pasur një monopol institucional mbi fetë, për shkak të së kaluarës komuniste, është një vend ideal për tu testuar saktësia e kësaj teorie. Në fakt këtu nuk pretendohet të bëhet një studim gjithëpërfshirës mbi bazën e kësaj teorie, sepse kjo kërkon një hulumtim më vete, por është evidente se pjesë të këtij studimi interpretohen përmes kësaj teorie, dhe këtu gjithashtu brenda limiteve që na jep hapësirë ky anketim që po marrim në analizë.

Nga ajo që vumë re deri tani nga anketimi ky aspekt nuk del shumë i qartë, me përjashtim të faktit se 35 të anketuar mendojnë se predikimi apo propaganda fetare ka ndikuar te kthimi i njerëzve në praktikantë fetar. Për ta parë më qartë këtë aspekt kemi bërë një pyetje tjetër. Pyetjen: *Si mendoni, sa i vlefshëm ka qenë ndikimi i thirrjes dhe i predikimit fetar pas viteve 90’ në afrimin e njerëzve tek besimi?* Të cilës i janë përgjigjur në këtë mënyrë:



Grafiku tregon qartë se 73,4% e të anketuarve i japin një rëndësi të madhe predikimit apo në gjuhën e teorisë së më sipërme, marketimit të fesë, në radhën e njerëzve, si faktor i rëndësishëm në fetarizimin e tyre. E ndërlidhur edhe me përgjigjet e pyetjeve të më sipërme mund të themi se vërtetë njerëzit mund të jenë natyrshëm besimtar në Zot, qoftë si nevojë e brendshme qoftë edhe si ndikim i mjedisit social, por të qenit fetar apo praktikantë i fesë ka nevojë

pikërisht për predikimin dhe propagandimin e fesë dhe ky rezultat i anketimit tregon pikërisht këtë gjë, që fetaria e besimtarëve të sotëm në përgjithësi është kryesisht produkt i predikimit fetar, çka tregon se teoria e mësipërme del të jetë e saktë për vendin tonë, më së shumti për fetarizimin e mëtejshëm të besimtarëve sesa në kthimin masiv të njerëzve drejt fesë. Në opinionin tonë kjo ka qenë më e dukshme te myslimanët, jo vetëm për faktin se ata përbëjnë komunitetin më të madh në vend, por edhe për shkak edhe të strukturës së këtij komuniteti, i cili nuk ka një strukturë klerikale hierarkike dhe hermetike të ngjashme me komunitete e tjera, por



lejon brenda tij një demokraci më të madhe, kështu që oferta e larmishme religjioze ka qenë më tepër prezentë në këtë komunitet, natyrisht edhe për shkak të prurjeve të ndikimeve të reja nga bota arabe dhe islame, e cila që nga vitet 80' ka shfaqur një rritje të dukshme të fetarisë dhe aktivitetit fetar. Këtu është për tu përmendur edhe komuniteti ungjillor, i cili edhe pse me fillimet e tij që në fund të shekullit XIX, vetëm pas viteve 90' arriti, falë predikimit intensiv dhe tepër të dukshëm të atyre viteve nga kisha dhe bashkësi të ndryshme, të jetë i dukshëm në jetën fetare të shqiptarëve të sotëm. Edhe pse censusi i 2011 i paraqet ata dhe të krishterët e tjerë jotradicional në shifra tepër të vogla, është fakt se ata falë ofertës së tyre religjioze arritën të krijojnë edhe një bashkësi fetare, tashmë të njohur zyrtarisht nga shteti shqiptar. Është për tu vënë në dukje këtu se oferta religjioze e krishterë jotradicionale ka qenë edhe më ambiciozja dhe më e larmishmja mes besimeve fetare,<sup>1</sup> me shfaqjen e një sërë kishash dhe rrymash fetare krejt të reja dhe të padëgjuaara për shqiptarët, të cilët nuk kishin dhe nuk kanë lidhje organike me komunitetet katolike dhe ortodokse tradicionale në vend në dallim me prurjet e reja islame, të cilat përgjithësisht edhe pse ishin të reja për vendin tonë ishin brenda Islamit sunit dhe operuan brenda bashkësisë myslimane sunitë shqiptare. Ndërkohë edhe oferta religjioze katolike dhe ortodokse nuk ka munguar pas viteve 90', por duket se ajo ka qenë më pak e larmishme dhe ka operuar më së shumti brenda komuniteteve përkatëse dhe në veçanti në zonat ku kanë edhe tradicionalisht përqendrimin më të madh këto komunitete. Ndërkohë këtu nuk mund të lë pa vënë në dukje se ndikimin më të madh katolikët dhe ortodoksët e kanë pasur tek shqiptarët të cilët janë larguar nga Shqipëria si emigrantë në vendet si Italia dhe Greqia, të cilat qenë edhe vendet që priten më shumë shqiptarë se çdo vend tjetër pas viteve 90', dhe pikërisht në këto vende kishat respektive kanë luajtur rolin e tyre në drejtim të afrimit të shqiptarëve me fenë. Por sa ka qenë ndikues dhe ndryshues i fetarisë së shqiptarëve ky fakt, ka nevojë të studiohet më në detaje. Ndoshta në këtë mes mund të thuhet se në Greqi ky ndikim ka qenë më i madh, për shkak të ndryshimit të shumtë të emrave dhe pagëzimeve që janë bërë atje për shqiptarët, por edhe kjo ngelet për tu vërtetuar se në çfarë mase ky ka qenë një fetarizim formal, për shkak të nevojës, dhe sa real për shkak të ndryshimit të brendshëm shpirtëror. Gjithsesi brenda territorit shqiptar duket se shqiptarët më së shumti i kanë qëndruar identitetit fetar të paraardhëseve, edhe pse pa ndonjë fetari të dukshme për pjesën më të madhe të tyre. Ndërkohë duke e lidhur këtë pikë të anketimit edhe me pikat e mësipërme, në veçanti me ndikimin shoqëror dhe atë familjar, mund të themi me një farë sigurie se ndikimi i madh i predikimit dhe “marketimit” fetar, si faktor ndikues i fuqishëm në fetarizimin e njerëzve sot, ka kaluar më së shumti përmes rrjeteve sociale shoqërore dhe familjare të vetë shqiptarëve sesa i ndikuar drejtpërdrejtë nga misionarët e huaj. Është pra lidhja e ngushtë shoqërore dhe familjare ajo e cila ka shërbyer si kanali kryesor i përçimit të predikimit fetar, që ka shkaktuar edhe rritjen e fetarisë në radhën e besimtarëve të sotëm praktikantë.

---

<sup>1</sup> Sipas raportit të DASH-it të 2009 Komiteti Shtetëror për Kultet ka raportuar një total prej 245 grupesh, organizatash, dhe fondacionesh fetare, përpos katër grupeve tradicionale fetare. Kjo shifër përfshinte 34 organizata islamike dhe 189 organizata protestante, shumica prej tyre me lidhje me Vëllazërinë Ungjillore Shqiptare (VUSH). <https://2009-2017.state.gov/documents/organization/132811.pdf>

## **Kapitulli VIII:**

### **Përfundimet**

## Përfundimet

1. Studimet në fushën e psikologjisë konjitive, na bëjnë me dije se feja është shumë më komplekse dhe e thellë në ndërgjegjen njerëzore dhe nuk kufizohet aspak vetëm te ndikim i mjedisit social që e rrethon njeriun. Ajo që mund të themi si përfundim është fakti “se feja para së gjithash është çështje individuale, një gjendje e brendshme e përjetuar nga njeriu”,<sup>1</sup> si e tillë ajo nuk mund të studiohet, analizohet dhe interpretohet vetëm si fenomen social. Megjithatë është fakt i pamohueshëm se përjetimet fetare nuk janë vetëm individuale, por kjo ndjesi kalon dhe përjetohet edhe nga të tjerët, dhe nga përjetuesi i parë feja pasqyrohet edhe te të tjerët. Dhe ky është edhe fillimi i ndikimit të burimit bashkësi ndërtues të fesë dhe dimensionit të saj social.<sup>2</sup> Kështu që ajo që merret në shqyrtim në thelb dhe më së shumti në këtë studim janë shkaqet dhe arsyet e fetarisë dhe besimit të shtuar fetar në mesin e besimtarëve shqiptarë të Shqipërisë, pas rënies së komunizmit dhe jo të vetë besimit në ekzistencën e hyjnore.

2. Studiuesit e modernizimit dhe shekullarizimit janë të ndarë për sa i përket qasjes së tyre ndaj ndikimit që ka modernizimi mbi fenë në qasjen klasike apo ortodokse, e cila pohon se feja ka humbur rëndësinë e saj në nivelin shoqëror, organizativ dhe individual. Qeveritë nuk kanë më nevojë për legjitimim fetar; anëtarët e shoqërisë nuk kanë më nevojë për teologji fetare, që kur ata kanë qasje në sisteme alternative që ofrojnë kuptim; feja është bërë një shpjegim më pak i besueshëm i njeriut dhe i gjithësisë. Feja ka humbur monopolin e saj për kuptimin, ndërsa institucionet jofetare tani kujdesen për shumë aktivitete që dikur kryheshin nga organizatat fetare. Pluralizmi fetar gërryen në mënyrë drastike angazhimin personal fetar. Në përgjithësi, procesi i rënies fetare ndalet përkohësisht vetëm kur feja lidhet me identitetin kulturor të një shoqërie të kërcënuar ose te pakicat e mëdha të emigrantëve. Në nivelin individual, ka rënie të frekuentimit të kishave dhe besimi te autoriteti fetar është gërryer.

Në të kundërt, siç thotë McKenzie, mendimtarët “joortodoks” shohin se diferencimi shoqëror dhe de-zyrtarizimi fetar në nivelin shoqëror kanë shkaktuar një treg konkurrues fetar, në të cilin organizatat e mëdha fetare në tension më të vogël me kulturën përreth kanë tendencën të shekullarizojnë vetveten, ndërsa sektet dhe grupimet më të vogla mbeten në gjendje më të lartë tensioni. Këto tendenca ekuilibrojnë forcat shekullore, të cilat përfundimisht janë mposhtur, sepse ato nuk i ofrojnë individit shpërblime përfundimtare në botën tjetër. Personat individualë kërkojnë gjithmonë “kompensime shpirtërore”, të cilët gjenden në traditat fetare tashmë të njohura ose në format e reja të rrugëve shpirtërore. Kështu, pluralizmi fetar pasurohet dhe rritet nga kërkesat shpirtërore individuale.<sup>3</sup>

Ndërkohë “teoria e sigurisë ekzistenciale” edhe pse mbështet në të dhëna të shumta empirike, siç e paraqesin autorët e saj, ajo duket sikur e redukton çështjen në interpretim, dhe e kufizon fenë vetëm në hapësirën e sigurisë që jep mirëqenia materiale, dhe e lë pak mënjanë kulturën, megjithatë mendoj se kjo qasje i shkon më shumë për shtat çështjes së religjiozitetit, pra të rënies

<sup>1</sup> Freyer, Hans “Sociologjia e fesë”, Shtëpia Botuese Logos A: Shkup 2016, f.59.

<sup>2</sup> Ibid.

<sup>3</sup> Germán McKenzie, f.22-23.

dhe ngritjes së fetarisë mes njerëzve sesa për vetë prezencën e fesë në shoqërinë njerëzore, edhe pse siç shprehen vetë autorët kjo nuk mund të përgjithësohet në mënyrë absolute.

3. Ideologjia dhe praktika komuniste krijoi në Shqipëri një identitet të ri social, identitet ky që e përjashtonte fenë si pjesë përbërëse të tij, të cilën edhe pse në shumë raste nuk arriti ta zhdukë plotësisht, për shumicën e njerëzve ajo që një identitet që mbijetoi në një nivel tepër të ulët, në veçanti për brezin e ri, që u edukua dhe formua në periudhën e këtij regjimi. Rënia e komunizmit dhe bashkë me të edhe burimi i identitetit të krijuar në atë regjim, sollën një lloj zhgënjimi dhe krize identitare të shqiptarët, të cilët në një masë jo të vogël iu rikthyen besimit në Zot, dhe besimeve fetare, kryesisht ato tradicionale të paraardhësve të tyre. Rezultatet e nxjerra nga studimi gjithashtu na sugjerojnë se rënia e komunizmit nuk la ndonjë boshllëk të ndjeshëm shpirtëror tek njerëzit, çka tregon se, ideologjia komuniste ose nuk kishte arritur të depërtonte thellësisht në shumicën e shpirtëve të shqiptarëve, aq sa rrëzimi i saj veç zhgënjimit dhe krizës së identitetit, të shkaktonte edhe brengë dhe dilemë shpirtërore dhe përjetim traume shpirtërore dhe ekzistenciale, ose se pse zhgënjimi erdhi në mënyrë gradual, që para rrëzimit të komunizmit dhe për rrjedhojë ai nuk shkaktoi ndonjë brengë të madhe deri në zbrazëti të plotë e të ndjeshme shpirtërore, por filloi të zëvendësohej po gradualisht me procesin e këtij ndryshimi; ose mund të jenë të dyja këto arsye për grupe të ndryshme njerëzish.

4. Proceset shekullarizuese të modernitetit shqiptar kanë prekur mbarë popullsinë, pa dallim feje, por pavarësisht këtij fakti, komuniteti fetar më pak i prekur nga ky proces është ai katolik, cili është i pozicionuar kryesisht në veri-perëndim të vendit, pas tij vjen ai mysliman, cili për shkak të shpërndarjes në të gjithë vendin dhe për shkak se përbën edhe komunitetin më të madh në vend është prekur në mënyrë të diferencuar nga zona në zonë, ku zonat e veriut janë ato më pak të prekurat, në dallim me ato të mesme dhe të jugut.

5. Të gjitha anketimet ndër vite tregojnë qartë se ka një rritje të dukshme të shkallës së fetarisë, sidomos asaj subjektive individuale, e shprehur në besimin në Zot dhe në ndjeshmërinë e të qenit fetar. Njohja dhe besimi të doktrinat fetare është i ulët. Pjesëmarrja në ritet fetare në raste festash është relativisht e lartë, ndërkohë pjesëmarrja në ritualet fetare të përbashkëta periodike nëpër objektet e kultit nuk është e lartë. Por duket se ka pasur përgjithësisht një rritje domethënëse, nëse i referohemi faktit se në Shqipëri çdo gjë nisi nga zero në këtë drejtim. Sado e vogël të duket kjo pjesëmarrje duke u krahasuar me vendet e tjera, për atë që ka kaluar vendi ynë është tregues i mjaftueshëm se Shqipëria është përfshirë nga një rigjallërim fetar modest, shpesh jo i dukshëm por domethënës. Në veçanti ka një rritje të theksuar të fetarisë në zona dhe grupe të caktuara njerëzish, të cilët edhe pse duket se janë pakicë përbëjnë gjithsesi një shenjë të dukshme të rigjallërimit fetar të shqiptarëve pas rënies së komunizmit. Nga leximet dhe bisedat me njerëz të ndryshëm të moshuar mund të them me bindje se fetaria e sotme e një pjese jo të vogël të shqiptarëve është shumë më e lartë sesa çka qenë para ndalimit të fesë, edhe pse natyrisht sot përqindja e atyre që nuk besojnë mund të jetë pak më e lartë sesa në periudhën para komunizmit me të cilën po e krahasojmë, por padyshim në përgjithësi ngelet e vogël dhe shumë herë më e vogël sesa në periudhën e komunizmit.

## Literatura

- Albanian Youth 2011, *Between Present Hopes and Future Insecurities!*, 2013.
- Aron, Raymond në *Opiumi i intelektualëve*, Shtëpia botuese “Dituria” 2005.
- Barrett, Justin L. *Born Believers: The Science of Children's Religious Belief*, Free Press, New York 2012.
- Basha, Ali M. *Islami në Shqipëri gjatë shekujve*, 2000.
- Berger, Peter, *The desecularization of the world. Resurgent religion and world politics*, Ethics and Public Policy Center, Washington, D.C. 1999.
- Bërxfholi, Arqile, *Revista demografia*, Nr. 1 Viti 2013.
- Bloom, Paul. (2007) “Religion is natural”, *Developmental Science*, Vol. 10, f. 147–151.
- Bruce, Steve, *Secularization, In Defence of an Unfashionable Theory*, Oxford University Press Inc., New York, 2011.
- Casanova, Jose, *Rethinking Secularization: A Global Comparative Perspective*, January 2006.
- Celá, Elira, *Historical background and characteristics of the evolution of Islam in Albania*. *Innovation in Social Sciences Research*. 1992, Vol. 5 f. 115-125.
- Chiot, Daniel Si *Ndryshojnë Shoqëritë*, bot. AIIS, Tiranë 2012.
- Cimbalo, Giovanni, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri*, botuar dhe përkthyer në shqip nga shtëpia botuese “Naimi” 2013.
- Colman, Andrew M. *Oxford dictionary of Psychology*, 2015.
- Çami, Foto, Hako, Hulusi, Angjeli, Kristaq, *Feja është opium për popullin*, N.SH. “Naim Frashëri”, Tiranë 1964.
- Davidson, Donald, *Essays on Actions and Events* (2001), Oxford Scholarship Online: November 2003.
- Douglas, C.N. comp. *Forty Thousand Quotations: Prose and Poetical*. 1917. Plutarch. Duka, Ferit, *Shekujt Osmanë në hapësirën shqiptare*, UET Press, 2009.
- Durkheim, Emile, *Format elementare të jetës fetare*, Botimet “Korbi” 2000.
- Durkheim, Emile, *The division of labour in society*, 2 edition, Palgrave Macmillan, 2013.
- Ferraj, Hysamendin, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Shkup 1999.
- Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri -rasti i Shqipërisë- Konferencë ndërkombëtare, Tiranë 14-15 nëntor 2003, Qendra shqiptare për të drejtat e njeriut, Tiranë 2004.
- Freyer, Hans, *Sociologjia e fesë*, Shtëpia Botuese Logos A, Shkup 2016.

- Frose, Paul, Hungary for Religion: A Supply-Side Interpretation of the Hungarian Religious Revival. *Journal for the scientific study of religion*, Vol. 40, No. 2 (Jun., 2001), f. 251-268.
- Gentile, Emilio, Fetë e politikës, Pika pa sipërfaqe, 2017.
- Giddens, Anthony, Sociologjia, Botimet “Çabej”, Tiranë 2004.
- Gorski, Philip S. & Ateş Altinordu, After Secularization, *Annual Review of Sociology*, Vol. 34 (2008), f. 55-85.
- Graziano, Manlio, Lufta e Shenjtë dhe e Shenjta Aleancë, Saras.
- Gjirokastra një udhëtim nëpër kulturë, CHWB Albania.
- Gjuraj, Tonin, Një model shteti ekumenik? Si mund të bëhen fetë çështje politike në Shqipëri. *East European Quarterly* 34 (Mars 2000) 1, 21-49.
- Habermas, Jürgen, Dialektika e sekularizmit, ISHM & IDK.
- Hako, Hulusi Akuzojmë fenë, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” Tiranë 1968.
- Historia e Partisë Punës së Shqipërisë. Botimi i dytë. «8 Nëntori», Tiranë, 1981.
- Hoxha, Artan R. Marrëdhëniet midis Regjimit Komunist dhe Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë në vitet 1945–1967. Tezë doktore.
- Hoxha, Enver, Vepra 35, Shtëpia botuese “8 Nëntori” Tiranë 1982.
- Hoxha, Ermir Arti në Shqipëri 1945 – 1990. Tezë doktore. Tiranë 2014.
- Hutington, Samuel P., Përplasja e qytetërimeve, Logos-A, 2004.
- Jacques, Edwin, Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme. Tiranë: Kartë e Pendë – F. A. Linkoln, 1995.
- Kaufmann, Eric Shall the Religious Inherit the Earth? *Demography and Politics in the Twenty-first Century*. 2011.
- Kazdin, Alan E, Editor-in-Chief, *Encyclopedia of Psychology*, May 2001.
- Kocani A., (2013), Një qasje plotësuese epistemologjike në Metodologjinë e kërkimit të shkencave sociale, AU Press. f.19-25, 32.
- Koka, Viron, Ideologjia reaksionare e klerit në vitet 30 të shekullit XX, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1969.
- Kondi, Pirro & L. Hoxha, “Hulusi Hako: Si i bëra “gjqy Zotit” dhe propagandova ateizmin në Shqipëri”, Panorama, 19 shkurt, (2004).
- Lewis Coser & Larry Ridener, Teoritë Sociologjike, Botuar nga “Plejad” 2005.
- Lubonja, Fatos Revista “Përpyekja” nr. 20, 2006.
- Lufta kundër fesë – Aspekt i luftës së klasave, Zëri i Popullit, 12 shkurt, 1967.

- Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare – shprehje e luftës së klasave, “Naim Frashri”, Tiranë 1967.
- Malinowski, Bronislaw, Njeriu Primitiv dhe Feja e Tij. Shqip, Botimet Zenit.
- Marshall, Gordon, Fjalori Sociologjik, IDK.
- McCauley, Robert N. Why Religion Is Natural and Science Is Not, Oxford University Press, 2011.
- Mcguire, Meredith B. Religjioni konteksti shoqëror, Logos-A, 2007.
- McKenzie, Germán në Sophia Studies in Cross-cultural Philosophy of Traditions and Cultures, volume 20, Springer International Publishing AG 2017.
- McCarthy, Justin, Vdekje dhe dëbim, spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922. ALSAR, Tiranë 2015.
- Moghadam, Assaf, A Global Resurgence of Religion? Weatherhead Center For International Affairs; Havard University, 2003.
- el-Munexhid, Salahudin, Belshevetul Islam indel marksijin uel ishterakijin el-arab (Bolshevizimi i Islamit te marksistet dhe socialistet arab), Bot. Darul el-Kitab el-Xhedid, 1967.
- Norris, Pippa & Ronald Inglehart. Sacred and Secular, Religion and politics worldwide. Publikuar nga Cambridge University Press, 2011.
- Nuk ka liri të vërtetë shoqërore pa emancipim të plotë të gruas, Shtëpia botuese “8 Nëntori” Tiranë 1967.
- Qazimi, Azem, Procesi i Asgjësimit të Fesë në Komunizëm”, Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. Tiranë 2012.
- Ramos, Joshua. Demographics as Destiny: Globalization and the Resurgence of Religion Through Fertility,” in Journal for Cultural and Religious Theory vol. 12. no. 3, Spring 2013.
- Rinia Shqiptare 2015, Ndryshim i ngadaltë, mbështetje tek interneti...dhe besim tek BE! 2016.
- Rinia Shqiptare 2018/2019.
- Selenica, Teki, Shqipria më 1927, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë 1929.
- Sinani, Gjergj, Feja dhe edukimi, Fondacioni “Friedrich Ebert”, 2017.
- Skirbekk, Vegard, Eric Kaufmann and Anne Goujon, “Secularism, Fundamentalism or Catholicism? The religious composition of the United States to 2043 Journal for the Scientific Study of Religion, 49(2): 293-310 (June 2010).
- Strickland, Bonnie B, The Gale encyclopedia of psychology, 2nd ed, Gale Group, 2001.
- Tarifa, Fatos, To Albania, With Love, Hamilton Books 2007.
- Telo, Ilia, Revista demografia, Nr. 1 Viti 2013.

Tonnes, Bernhard, (1975) Albania: An atheist state, Religion in Communist Lands. Religion in Communist Lands Volume 3. 1975.

Turner, Bryan S. Sociologjia dhe studimi i fesë, e shenjtë dhe laikja në shoqëritë moderne. Në “Shkencat e shoqërisë”, editor Fatos Tarifa, Onufri, Tiranë, 2013.

Vail, Kenneth E., Jamie Arndt, and Abdolhossein Abdollahi. (2012), Exploring the Existential Function of Religion and Supernatural Agent Beliefs Among Christians, Muslims, Atheists, and Agnostics, në Personality and Social Psychology Bulletin Vol. 38.

Velo, Maks, Kohë antishenjë, Zenit, Tiranë 2005.

Weber, Max, Essays in Sociology, Science as Vocation, Routledge 1991.

Weber, Max, The Sociology of Religion. Introd. by Talcott Parsons, Beacon Press, 1963.

Weber, Max, Etika protestante dhe shpirti i kapitalizmit, Plejad, 2005.

Zachou, Chryssanthi & Kalie Kerpaci, God’s “Second Coming”: Youth and New Religious Movements in Post-Communist Albania, XVII ISA World Conference on Sociology Research Committee 22 Sociology of Religion Gothenburg, Sweden 11-17 July 2010.

Faqe interneti:

<https://www.britannica.com/biography/Bronislaw-Malinowski>

<https://www.livescience.com/7973-human-speech-gene.html>

[https://en.wikipedia.org/wiki/Justin\\_L.\\_Barrett](https://en.wikipedia.org/wiki/Justin_L._Barrett)

<https://www.pewresearch.org/>

<https://www.pewforum.org>

<https://wcfia.harvard.edu/publications/global-resurgence-religion>

<https://www.marxists.org/archive/marx/works/1843/critique-hpr/intro.htm>

<https://www.youtube.com/watch?v=62zSU-U9GGE>

<https://www.researchgate.net/publication/265540966>

<http://www.observatorikujteses.al>

[http://licodu.cois.it/?page\\_id=1036&lang=en](http://licodu.cois.it/?page_id=1036&lang=en)

<http://fjala.info/arkiv/fjala1/politikanet-e-shkurtit-67-qe-sundojne-shqiperine/>

<https://www.bksh.al/>

<https://www.proletari.com/tragjedia-dhe-lavdia-e-kishes-katolike-shqiptare/html>



<http://hoxhallaret.al/2018/03/19/liste-e-hoxhallareve-dhe-figurave-te-shquara-muslimane-te-denuar-dhe-te-persekutuar-nga-regjimi-komunist/>

<https://kryegjyshataboterorebektashiane.org/persekutimi-i-klerit-bektashi/>

<https://interreligiouscenter.com/martiret-e-besimeve-deshmi-atdhedashurie/>

<https://shqiptarja.com/lajm/lufta-kund-euml-r-fes-euml-nbsp-si-u-mbyll-euml-n-brenda-br-gjasht-euml-muajve-2-169-kisha-e-xhami?r=app>

<https://www.youtube.com/watch?v=ywoGl3ro9NI>

<http://isp.com.al/>

<https://kujto.al/kufij-te-pergjakur/>

[https://en.wikipedia.org/wiki/State\\_atheism](https://en.wikipedia.org/wiki/State_atheism)

<http://kshk.gov.al/legjislacioni-per-fene-pas-vitit-1990/>

[https://web.archive.org/web/20080917072216/http://www.tiranaobserver.com.al/al/index.php?option=com\\_content&task=view&id=6374&Itemid=26](https://web.archive.org/web/20080917072216/http://www.tiranaobserver.com.al/al/index.php?option=com_content&task=view&id=6374&Itemid=26)

<https://babadauti.wordpress.com/tarikati-halveti-lista-e-teqeve-viti-2005/>

<https://kryegjyshataboterorebektashiane.org>

<https://orthodoxalbania.org>

<https://vush.al>

<https://www.jw.org/sq/>

<https://www.kishaejezukrishtit.org>

<https://preview.state.gov/reports/>

<https://al.usembassy.gov>

<https://edukimikatolik.al>

[https://www.researchgate.net/post/How can I intepret the effect sizes of Cramers V when DF 3](https://www.researchgate.net/post/How_can_I_intepret_the_effect_sizes_of_Cramers_V_when_DF_3)

<http://www.gazetatema.net/2011/10/01/nis-sot-regjistrimi-i-popullsise-aleanca-kuq-e-zi-grisni-fleten-per-fene-e-etnine/>

<http://www.e-zani.com/2011/10/04/kmsh-mbeshtet-censusin-edhe-pse-me-rezerva/>

<http://www.panorama.com.al/fete-kunder-censusit-bektashinjte-nuk-u-pyetem/>

<http://www.arkivalajmeve.com/Katoliket-kunder-Censusit-Do-te-regjistrojme-besimtaret.1047134631/>

<http://www.instat.gov.al/>

<https://www.gesis.org/home>

<http://www.europeanvaluesstudy.eu/>

<http://library.fes.de/>

<http://alpsa.org/>

<http://albania.globic.us/>

<http://www.worldvaluessurvey.org/>

<https://www.federalregister.gov/>

<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

<https://news.gallup.com/poll/142727/religiosity-highest-world-poorest-nations.aspx>

<https://www.cameriame.com/tradhetia-arvanito-suliot-ne-epiken-dhe-kenget-popullore-came/>

<http://www.differencebetween.net/language/difference-between-cause-and-reason/>

## Shtojca

### Shtojcë 1

**Tabela 1. Interpretimi i vlerës së nivelit të shoqërimitI**

Niveli i shoqërimit: Vlera e Cramer's V	Përshkrimi
0.00	Nuk ka marrëdhënie
.00 to .15	Shumë e dobët
.15 to .20	E dobët
.20 to .25	E moderuar
.25 to .30	E moderuar e fortë
.30 to .35	E Fortë
.35 to .40	Shumë e fortë
.40 to .50	Jashtëzakonisht e fortë
.50 to .99	Pothuajse e plotë
1.00	Marrëdhënie perfekte

[https://www.researchgate.net/post/How\\_can\\_I\\_intepret\\_the\\_effect\\_sizes\\_of\\_Cramers\\_V\\_when\\_DF\\_3](https://www.researchgate.net/post/How_can_I_intepret_the_effect_sizes_of_Cramers_V_when_DF_3)

### Shtojcë 2

**Anketimet për fenë dhe komunizmin**

**Anketimi i 2015**

**Frequencies**

	Kodi	nr	sishter	arsyeren	rikthkom	vlerside	ideolkom	deshideo	perjdesh
N Va lid	200	200	189	200	188	189	189	189	189
Mi ssi ng	0	0	11	0	12	11	11	11	11

	renibosh	plotbosh	cenimide	kriziden	identri	kthimbesh	saktperq	identfet	gjinia
--	----------	----------	----------	----------	---------	-----------	----------	----------	--------

N	Valid	188	200	188	200	188	189	200	200	189
	Missing	12	0	12	0	12	11	0	0	11

#### Statistics

		shkolla	gjcivile	statsoc	rrethi	qytet	fshat	gmosha	rruga
N	Valid	187	183	200	200	200	200	200	200
	Missing	13	17	0	0	0	0	0	0

#### Frequency Table

##### Si ishte regjimi komunist?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Një regjim shumë i keq	43	21.5	22.8	22.8
	Një regjim i keq	24	12.0	12.7	35.4
	Një regjim me të këqija dhe të mira	89	44.5	47.1	82.5
	Një regjim me më shumë të mira	22	11.0	11.6	94.2
	Një regjim padyshim më i mirë se ky i sotmi	5	2.5	2.6	96.8
	Një regjim ideal	2	1.0	1.1	97.9
	Nuk e di	3	1.5	1.6	99.5
	Pa përgjigje	1	.5	.5	100.0
	Total	189	94.5	100.0	
Missing	System	11	5.5		
Total		200	100.0		

##### Arsyet e rënies së regjimit komunist

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		11	5.5	5.5	5.5
	Si pasojë e rënies së tij në gjithë Evropën Lindore	53	26.5	26.5	32.0

Si pasojë e rënies së tij në gjithë Evropën Lindore ,5	1	.5	.5	32.5
Si pasojë e ndërhyrjeve të fuqive perëndimore	38	19.0	19.0	51.5
Si pasojë e ndërhyrjeve të fuqive perëndimore, Si pasojë e dështimit kryesisht ekonomik	2	1.0	1.0	52.5
Si pasojë e dështimit kryesisht ekonomik	44	22.0	22.0	74.5
Si pasojë e dështimit të ndërtimit të shoqërisë komuniste	16	8.0	8.0	82.5
Për arsye se shoqëria komuniste ishte diçka e pamundur, utopike	25	12.5	12.5	95.0
Nuk e di	7	3.5	3.5	98.5
Pa përgjigje	3	1.5	1.5	100.0
Total	200	100.0	100.0	

**Rikthimi te modelet e regjimit komunist përbën:**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Një zgjidhje të suksesshme të problemeve aktuale të shoqërisë shqiptare	10	5.0	5.3	5.3
	Një rrugë më të mirë për të zgjidhur problemet që kemi	22	11.0	11.7	17.0
	Një zgjidhje jo fort të mirë për problemet që kemi si shoqëri	42	21.0	22.3	39.4
	Një rrugë të gabuar për ecjen përpara të kësaj shoqërie	58	29.0	30.9	70.2
	Një rrugë shumë të gabuar për ecjen përpara të kësaj shoqërie	45	22.5	23.9	94.1
	Nuk e di	6	3.0	3.2	97.3
	Pa përgjigje	5	2.5	2.7	100.0
	Total	188	94.0	100.0	
Missing	System	12	6.0		
Total		200	100.0		

**Sistemit demokratik a përbën**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Një zgjidhje të suksesshme të problemeve aktuale të shoqërisë shqiptare	47	23.5	24.9	24.9
	Një rrugë më të mirë për të zgjidhur problemet që kemi	95	47.5	50.3	75.1

	Një zgjidhje jo fort të mirë për problemet që kemi si shoqëri	26	13.0	13.8	88.9
	Një rrugë të gabuar për ecjen përpara të kësaj shoqërie	15	7.5	7.9	96.8
	Një rrugë shumë të gabuar për ecjen përpara të kësaj shoqërie	5	2.5	2.6	99.5
	Pa përgjigje	1	.5	.5	100.0
	Total	189	94.5	100.0	
Missing	System	11	5.5		
Total		200	100.0		

**Sot ideologjia komuniste konsiderohet si**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Një ideologji shumë e keqe	45	22.5	23.8	23.8
	Një ideologji në përgjithësi e keqe	66	33.0	34.9	58.7
	Një ideologji as e mirë dhe as e keqe	57	28.5	30.2	88.9
	Një ideologji në përgjithësi e mirë	15	7.5	7.9	96.8
	Një ideologji shumë e mirë	5	2.5	2.6	99.5
	Nuk e di	1	.5	.5	100.0
	Total	189	94.5	100.0	
Missing	System	11	5.5		
Total		200	100.0		

**A ka dështuar ideologjia komuniste?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ka dështuar plotësisht	68	34.0	36.0	36.0
	Tani mund të thuhet se ka dështuar	51	25.5	27.0	63.0
	Ka dështuar, por jo për faj të vet	18	9.0	9.5	72.5
	Nuk ka dështuar	15	7.5	7.9	80.4
	Është e vlefshme edhe sot	27	13.5	14.3	94.7
	Nuk e di	6	3.0	3.2	97.9
	Pa përgjigje	4	2.0	2.1	100.0
	Total	189	94.5	100.0	
Missing	System	11	5.5		
Total		200	100.0		

**Në se ka dështuar, si e përjetoni këtë dështim?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Si një zhgënjim total	37	18.5	19.6	19.6

	Më shumë si një zhgënjim	5	2.5	2.6	22.2
	Pa ndonjë ndjesi të veçantë	65	32.5	34.4	56.6
	Është e vlefshme edhe sot	54	27.0	28.6	85.2
	Nuk e di	3	1.5	1.6	86.8
	Pa përgjigje	25	12.5	13.2	100.0
	Total	189	94.5	100.0	
Missing	System	11	5.5		
Total		200	100.0		

**Rënia a ka sjell boshllëk shpirtëror?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Individa	44	22.0	23.4	23.4
	Kolektiv	43	21.5	22.9	46.3
	Individual dhe kolektiv	38	19.0	20.2	66.5
	Asnjë boshllëk shpirtëror	48	24.0	25.5	92.0
	Nuk e di	8	4.0	4.3	96.3
	Pa përgjigje	7	3.5	3.7	100.0
	Total	188	94.0	100.0	
Missing	System	12	6.0		
Total		200	100.0		

**Ata që kanë ndjerë boshllëk shpirtëror nga rënia e ideologjisë komuniste:**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		11	5.5	5.5	5.5
	Kanë përqafuar besime fetare jo tradicionale për vendin tonë, Besojnë në ideologji të reja jo fetare	1	.5	.5	6.0
	Kanë menduar ta plotësojnë atë me një ideologji tjetër	50	25.0	25.0	31.0
	U janë rikthyer besimeve fetare tradicionale	67	33.5	33.5	64.5
	Kanë përqafuar besime fetare jo tradicionale për vendin tonë	10	5.0	5.0	69.5
	Kanë përqafuar besime mistike	2	1.0	1.0	70.5
	Besojnë në ideologji të reja jo fetare	22	11.0	11.0	81.5
	Nuk e di	23	11.5	11.5	93.0
	Pa përgjigje	14	7.0	7.0	100.0
	Total	200	100.0	100.0	

**A ka sjellë rënia e regjimit komunist edhe cenim të identitetit?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pak cenim të identitetit social	49	24.5	26.1	26.1
	Cenim disi të identitetit social	27	13.5	14.4	40.4
	Cenim të konsiderueshëm të identitetit social	66	33.0	35.1	75.5
	Cenim të plotë të identitetit social	30	15.0	16.0	91.5
	Nuk e di	9	4.5	4.8	96.3
	Pa përgjigje	7	3.5	3.7	100.0
	Total	188	94.0	100.0	
Missing	System	12	6.0		
Total		200	100.0		

**Ky cenim a ka shkuar deri në krizë identiteti?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		11	5.5	5.5	5.5
	Po, plotësisht	30	15.0	15.0	20.5
	Po, në një masë të konsiderueshme	40	20.0	20.0	40.5
	Po, disi	44	22.0	22.0	62.5
	Më shumë jo	25	12.5	12.5	75.0
	Aspak	31	15.5	15.5	90.5
	Nuk e di	7	3.5	3.5	94.0
	Pa përgjigje	12	6.0	6.0	100.0
	Total	200	100.0	100.0	

**Në se ka krizë, apo cënim, a mund të flitet për krijim të një identiteti të ri?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	I domosdoshëm, por nuk po ndodh	58	29.0	30.9	30.9
	I domosdoshëm, por është në fillimet e veta	77	38.5	41.0	71.8
	I domosdoshëm dhe po ndodh në një masë të konsiderueshme	24	12.0	12.8	84.6
	Tashmë ka ndodhur	9	4.5	4.8	89.4
	Nuk është i domosdoshëm	14	7.0	7.4	96.8
	Nuk e di	4	2.0	2.1	98.9
	Pa përgjigje	2	1.0	1.1	100.0
	Total	188	94.0	100.0	
Missing	System	12	6.0		
Total		200	100.0		

**Në se ka një proces të krijimit të identitetit të ri social, sipas jush, a është pjesë e tij kthimi te besimet fetare?**



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po, plotësisht	32	16.0	16.9	16.9
	Po, në një masë të konsiderueshme	49	24.5	25.9	42.9
	Po, disi	45	22.5	23.8	66.7
	Më shumë jo	35	17.5	18.5	85.2
	Aspak	19	9.5	10.1	95.2
	Nuk e di	4	2.0	2.1	97.4
	Pa përgjigje	5	2.5	2.6	100.0
	Total	189	94.5	100.0	
Missing	System	11	5.5		
Total		200	100.0		

Sipas mendimit tuaj, a janë të sakta përqindjet e përkatësive fetare të censusit të vitit **2011** (myslimanë **56.7%**, bektashinj **2.09%**, katolik **10.03%**, ortodoks **6.75%**, të krishterë të tjerë **0.21%**, besimtarë të pa cilësuar **5.49%**, ateistë **2.5%**, pa përgjigje **13.79%**)

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		12	6.0	6.0	6.0
	Plotësisht të sakta	13	6.5	6.5	12.5
	Në përgjithësi të sakta	27	13.5	13.5	26.0
	Pjesërisht të sakta	50	25.0	25.0	51.0
	Pjesërisht të sakta, Pak të sakta	1	.5	.5	51.5
	Pjesërisht të sakta, Nuk e di	1	.5	.5	52.0
	Pak të sakta	14	7.0	7.0	59.0
	Të pasakta	22	11.0	11.0	70.0
	Të falsifikuara	4	2.0	2.0	72.0
	Të falsifikuara [a] Të gjitha	1	.5	.5	72.5
	Të falsifikuara Kryesisht % për besimtarët bektashinj	1	.5	.5	73.0
	Nuk e di	43	21.5	21.5	94.5
	Pa përgjigje	11	5.5	5.5	100.0
	Total	200	100.0	100.0	

Nëse mendoni se censusi është i saktë ose deri diku i saktë [përgjigjet 1), 2) dhe 3) më sipër], a mendoni se këto përqindje fetare pasqyrojnë vërtetë një identitet fetar të sotëm të rigjetur të shqiptarëve?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		12	6.0	6.0	6.0
	Jo, janë vazhdim i trashëgimisë familjare	42	21.0	21.0	27.0
	Jo, janë vazhdim i trashëgimisë familjare, Pjesë e trashëgimisë familjare dhe e rilindjes fetare	1	.5	.5	27.5

	Më së shumti pjesë e trashëgimisë familjare	46	23.0	23.0	50.5
	Pjesë e trashëgimisë familjare dhe e rilindjes fetare	16	8.0	8.0	58.5
	Më së shumti pjesë e rilindjes fetare	14	7.0	7.0	65.5
	Nuk e di	12	6.0	6.0	71.5
	Pa përgjigje	57	28.5	28.5	100.0
	Total	200	100.0	100.0	

#### gjinia

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	102	51.0	54.0	54.0
	Mashkull	85	42.5	45.0	98.9
	Nuk e di	1	.5	.5	99.5
	Pa përgjigje	1	.5	.5	100.0
	Total	189	94.5	100.0	
Missing	System	11	5.5		
Total		200	100.0		

#### Shkollimi

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Asnjë	2	1.0	1.1	1.1
	Fillor	2	1.0	1.1	2.1
	7, 8, 9 vjeçar	15	7.5	8.0	10.2
	I mesëm teknik	12	6.0	6.4	16.6
	Gjimnaz	50	25.0	26.7	43.3
	I lartë	87	43.5	46.5	89.8
	Pas universitar	19	9.5	10.2	100.0
	Total	187	93.5	100.0	
Missing	System	13	6.5		
Total		200	100.0		

#### Gjendja civile

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Beqar/e	64	32.0	35.0	35.0
	I/e martuar	110	55.0	60.1	95.1
	Bashkëjeton	3	1.5	1.6	96.7
	I/e divorcuar	1	.5	.5	97.3
	I/e ndarë	1	.5	.5	97.8
	I/e ve	2	1.0	1.1	98.9

	Pa përgjigje	2	1.0	1.1	100.0
	Total	183	91.5	100.0	
Missing	System	17	8.5		
Total		200	100.0		

#### Statusi social

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	13	6.5	6.5	6.5
I/e papunë	32	16.0	16.0	22.5
Agronom/e	1	.5	.5	23.0
Veteriner/e	1	.5	.5	23.5
Inxhinier/e	2	1.0	1.0	24.5
Pensionist/e	33	16.5	16.5	41.0
Tjetër	42	21.0	21.0	62.0
Student/e	37	18.5	18.5	80.5
Nëpunës/e	29	14.5	14.5	95.0
Nëpunës/e, Mjek/e	1	.5	.5	95.5
Arsimtar/e	6	3.0	3.0	98.5
Pedagog/e	1	.5	.5	99.0
Mjek/e	1	.5	.5	99.5
Ushtarak/e	1	.5	.5	100.0
Total	200	100.0	100.0	

#### Rrethi

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	13	6.5	6.5	6.5
Berat	3	1.5	1.5	8.0
Burrel	2	1.0	1.0	9.0
Diber	5	2.5	2.5	11.5
Durres	6	3.0	3.0	14.5
Elbasan	2	1.0	1.0	15.5
Erseke	1	.5	.5	16.0
Fier	4	2.0	2.0	18.0
Fushe-kruje	1	.5	.5	18.5
Gjirokaster	5	2.5	2.5	21.0
Gramsh	1	.5	.5	21.5
Has	2	1.0	1.0	22.5
Kavaje	1	.5	.5	23.0
Koplik	1	.5	.5	23.5

Korce	8	4.0	4.0	27.5
Kruje	1	.5	.5	28.0
Kukes	8	4.0	4.0	32.0
Kurbin	1	.5	.5	32.5
Lezhe	2	1.0	1.0	33.5
Librazhd	2	1.0	1.0	34.5
Lushnje	2	1.0	1.0	35.5
Mallakastra	2	.5	.5	36.5
Mat	1	.5	.5	37.0
Mirdite	1	.5	.5	37.5
Permet	6	3.0	3.0	40.5
Perrenjas	1	.5	.5	41.0
Peshkopi	1	.5	.5	41.5
Pogradec	1	.5	.5	42.0
Prizren	1	.5	.5	42.5
Puke	3	1.5	1.5	44.0
Rreshen	1	.5	.5	44.5
Sarande	2	1.0	1.0	45.5
Shkoder	4	2.0	2.0	47.5
Skrapar	3	1.5	1.5	49.0
Struge	1	.5	.5	49.5
Tepelene	5	2.5	2.5	52.0
Tirane	82	41.0	41.0	93.0
Tropoje	7	3.5	3.5	96.5
Vlore	7	3.5	3.5	100.0
Total	200	100.0	100.0	

**qytet**

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	57	28.5	28.5	28.5
b.curri	1	.5	.5	29.0
bajram-curr	1	.5	.5	29.5
Baldushk	1	.5	.5	30.0
berat	3	1.5	1.5	31.5
burrel	1	.5	.5	32.0
Burrel	1	.5	.5	32.5
diber	3	1.5	1.5	34.0
durres	5	2.5	2.5	36.5
Elbasan	1	.5	.5	37.0

fier	2	1.0	1.0	38.0
Fier	2	1.0	1.0	39.0
fushe-kruje	1	.5	.5	39.5
gjirokaster	3	1.5	1.5	41.0
Gjirokaster	1	.5	.5	41.5
Gramsh	1	.5	.5	42.0
kavaje	1	.5	.5	42.5
Konispol	2	1.0	1.0	43.5
korce	6	3.0	3.0	46.5
kruje	1	.5	.5	47.0
kukes	4	2.0	2.0	49.0
